



RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
MBI
(Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë)

“BASHKIA TROPOJË”

Tiranë, Nëntor 2023



PËRMBAJTJA

I. PËRMBLHDHJE EKZEKUTIVE	4-13
1. Përshkrim i shkurtër i Raportit Përfundimtar të Auditimit.....	4-5
2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-9
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni	9-12
II. HYRJA	12
1. Objektivi i auditimit	13
2. Qëllimi i auditimit	13
3. Identifikimi i çështjes.....	13
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	13
5. Përgjegjësitë e audituesve.....	14
6. Kriteret e vlerësimit	14
7. Standardet e auditimit	15
8. Metodologjia e auditimit	15
9. Dokumentimi i auditimit	17
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	17-
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.....	17
2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	18
2.1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm	18
2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.....	22
2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike- Asetet.....	48
2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.	68
2.4.1 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.	106
2.5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.....	128
2.6 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Nj.V.....	142
2.7 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme	142

2.8 Të ndryshme të dala gjatë auditimit(Ankesa).....	
152	
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME	154
V. ANEKSET.....	191
VI. LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT.....	224

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
B	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të planit vjetor të auditimeve kreu auditimin financiar dhe të përputhshmërisë me objektiv vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Tropojë, për aktivitetin ekonomik dhe financiar, prokurimet publike, investimet publike, planifikimi dhe zhvillimi i territorit, etj. Auditimi mbuloi periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2022 për përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit me kuadrin rregullator në fuqi dhe 01.01.2022 deri më 31.12.2022 për veprimtarinë financiare. Auditimi është kryer duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manualin e auditimit financiar të KLSH-së, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së, Kodin e Etikës, si dhe praktikatat më të mira audituese të fushës.

Auditimi u fokusua në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi kryesore nga Bashkia Tropojë si planifikimi, hartimi dhe realizimi i zërave të shpenzimeve buxhetore, realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, auditim me zgjedhje i transaksioneve financiare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore, mbajtjen e evidencës kontabël, zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e procedurave të prokurimit publik, planifikimi dhe zhvillimi i territorit etj. Për analizimin dhe vlerësimin e aktivitetit të subjektit sipas pikave të planifikuara në programin e auditimit, grupi i auditimit vlerësoi sistemet e kontrollit të brendshëm dhe analizoi të gjitha evidencat e grumbulluara gjatë kryerjes së auditimit në terren sipas çështjeve përkatëse.

Në përfundim të punës audituese në terren, grupi i auditimit ka mbajtur dhe protokolluar në Bashkinë Tropojë 12 akt konstatime dhe 1 akt verifikim. Mbi akt konstatimet dhe akt verifikimet e mbajtura nga grupi i auditimit janë paraqitur observacione nga Bashkia Tropojë të cilat janë trajtuar në përputhje me përcaktimet e Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH-së.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi rezultoi se:

- Bashkia Tropojë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.
- Investimet nga të ardhurat e veta kanë një nivel të ulët të realizimit krahasuar me planifikimin.
- Nuk janë marrë masa të plota për uljen e detyrimeve të prapambetura. Edhe pse janë likuiduar gjatë vitit buxhetor detyrime të prapambetura, nga ana tjetër edhe gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura.
- Mangësi në evidentimin dhe vlerësimin e nivelit të detyrimeve debitore, kontabilizimet dhe procedurat e ndjekjes së borxhit tatimor për subjektet që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Tropojë.
- Rezultojnë detyrime kontraktore të pa likuiduara, nga përdorimi i aseteve të Bashkisë Tropojë, për vlerën totale 3,835,358 leke, nga 15 subjektet. Gjithashtu dosjet e qirave rezultojnë të pa plotësuara me dokumentacionin dhe të pa inventarizuara.
- Parregullsi dhe mangësi në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e Pasqyrave Financiare për vitin 2022.

- Nga auditimi i procedurave të prokurimit, u konstatua moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në hartimin e kritereve dhe vonesa për vlerësimin e ofertave.
 - Nga auditimi i veprimtarisë së IMTV Bashkia Tropojë, u konstatua Niveli i ulët i arkëtimit të gjobave të vendosura nga IMTV për shkeljet e konstatuara.
- Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Tropojë, KLSH ka dhënë “*Opinion të modifikuar me rezervë*” për pasqyrat financiare dhe “*Opinion të modifikuar*” për përputhshmërinë. Referuar gjetjeve të auditimit për përmirësimin e gjendjes janë dhënë rekomandimet përkatëse.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJEVE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
I	<p>Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së konstatohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nuk është hartuar “Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, përveç trajnimeve që kryhen nga ASPA. - Në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS- n). - Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.- Nuk janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë - Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë. Gjithashtu Bashkia Tropojë nuk kanë përditësuar Rregulloren e Brendshme, të miratuar me shkresën nr. 1143. prot., datë 06.03.2018. - Bashkia Tropojë nuk ka miratuar “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”, e cila duhet të përditësohet rregullisht (çdo 3 vite), në zbatim të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të MFK- së dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike”, pikën 5.3. - Procesi i Menaxhimit të Riskut për periudhën e auditimit rezulton të mos jetë realizuar dhe dokumentuar me vendimet përkatëse në mos zbatim të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010, Kreu III dhe nenit 10, Kreu II, ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 si dhe Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të MFK dhe kordinatorit të riskut njësitë publike”. - Në mbështetje të Ligjit nr. 10296 dt. 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 	E mesme	<p>Nga Kryetari i Bashkisë Tropojë, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshkrimit të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësive dhe të drejtave të punonjësve të njësisë. - Të organizojë trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik në fushën e Menaxhimit të Riskut dhe atë të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit; - Të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin; - Të miratojë planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”; - Të miratojë “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”;

	<p>27, në zbatim të Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK në Njësitë Publike” pika 2/2,4, nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për Përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm. Bashkia Tropoje nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”.</p> <p>- Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për Përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm.</p> <p>- Bashkia Tropojë nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”.</p>		
2	<p>Ne 7 raste, Vendimet e këshillit bashkiak Tropoje nuk janë marrë me shumicën e votave të anëtareve, pasi kane votuar dhe nënshkruar nën 50 % të tyre, ose nën 3/5 e 21 anëtareve, duke mos plotësuar kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 48, pika 4 dhe nenin 17, pika 3 të ligjit nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.</p>	E mesme	<p>Këshilli Bashkiak Tropojë të marrë masa që në çdo rast votimi i vendimeve të bëhet me shumice votash, në zbatim të kërkesave ligjore, me qëllim që vendimi kolegjial të ketë zbatueshmëri, në interes të komunitetit, brenda juridiksionit që mbulon.</p>
3	<p>Nga auditimi i shpenzimeve për pagat për vitin 2022, konstatohet se:</p> <p>- Struktura dhe organet e bashkisë Tropojë dhe njësitë të vartësisë, në disa raste paraqesin fyerje (gjithsej 361 punonjës) në raport me kryerjen e detyrave sipas pozicioneve, referuar numërit real të banoreve të kësaj bashkie dhe mundësive financiare. Gjithashtu nuk justifikohet puna e kryer, me dokumente dhe programe pune. Kjo gjendje ka sjellë rritjen e vështirësive financiare, duke ndikuar në rritjen e borxhit të kësaj bashkie, Vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin MF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë sektorit publik” dhe VKM nr. 323, datë 14.6.1993.</p> <p>“Normat për vendosjen e personelit në çerdhe”.</p> <p>- Shpenzimet për ndihmën ekonomike dhe paaftësisë zënë peshën kryesore për vlerën 386 milion lekë ndaj shpenzimeve gjithsejtë prej 825 milion leke ose 47 %, çka bën të domosdoshme</p>	E mesme	<p>Bashkia Tropojë të marrë masa:</p> <p>- Të rishikojë mundësitë për shkurtimin e organikës, duke vendosur një raport të drejte midis numrit të punësuarve me ngarkesën e punës, sipas drejtorive dhe sektorëve të trajtuar, duke argumentuar çdo pozicion dhe proces pune, me dokumente dhe programe pune.</p> <p>- Të krijojë kushte për nxitjen e punësimit dhe përmirësimin e politikave sociale, për të zbutur papunësinë, pasi ndihma ekonomike dhe paaftësisë zënë peshën kryesore 47 % ndaj shpenzimeve të përgjithshme për vitin 2022.</p> <p>- Të rishikojë emërtesën dhe pagesën për 9 specialistë të gjendjes civile, të cilët nuk janë emëruar dhe paguar si “përgjegjës”, sipas përcaktimeve ligjore.</p>

	<p>nxitjen e punësimit dhe përmirësimin e politikave sociale, për të zbutur papunësinë dhe varfërinë. Ndihma sociale ne vitin 2022 për 386 milion leke paraqet tendence rritje nga viti 2021 prej 308 milion - U konstatua se 9 specialistet e gjendjes civile nuk janë emëruar dhe paguar si “përgjegjës”.</p>		
4	<p>Nga auditimi i zbatimi i buxhetit për vitin 2022, konstatohen shkelje dhe parregullsi nga Bashkia Tropojë, lidhur me shpenzimet e karburantit, ku konstatohet shpenzime në vlera të konsiderueshme prej 14,000,000 lekë, për 30 automjete te lehta dhe te renda (<i>fadromë, makine vetëshkarkuese pastrimit, kamion etj</i>), ku rreth 30 % e tyre janë te amortizuara, pasi janë mbi 30 vjeçare. Gjithashtu normat mujore të shpenzimit të karburantit rezultojnë te larta, për disa automjete, konkretisht: <i>Kamion benz me targa AA 469 BB 33 litra/100, viti i prodhimit 1983, 2 Fadroma 31 dhe 32 litra/100 km, Boti i ujit 28 litra/100 km</i>, për pastrim rruge, <i>Makina mbeturinave 44 litra/100 km, Bore pastruesja 24 litra/100 km, Fugoni i Policisë 11 litra/100 km, Makina administratës(foristrada)16 litra/100 km.</i></p>	E mesme	<p>Bashkia Tropoje te marrë masa, për kontrollin e gjendjes teknike dhe kolaudimin e disa automjeteve shumëvjeçare në kushtet e amortizimit të plotë, çka ndikojnë ne koston e shpenzimeve te karburantit dhe pjesëve këmbimit, me qellim nxjerrjen jashtë përdorimi te tyre sipas procedurave ligjore. Gjithashtu të rishikohen me tendencë për uljen e normativave të harxhimit të karburantit nga automjetet, pasi rezultojnë te larta dhe ndikojnë ne efektivitetin e tyre.</p>
5	<p>Nga auditimi i zbatimi i buxhetit për vitin 2022, konstatohen shkelje dhe parregullsi nga Bashkia Tropojë, lidhur me fatura të palikujduara në vlerën 86 milion lekë, duke krijuar bashkisë vështirësi financiare, pasi ato zënë mbi 25 % të shpenzimeve vjetore prej 220 milion leke. Faturat e pa likuiduara sipas llojit te tyre, paraqiten: <i>vlera 3,7 milion leke detyrim për vendime gjyqësore; vlera 1.2 milion leke detyrim për shërbime; vlera 2,2 milion leke detyrim për mirëmbajtje; vlera 64 milion leke detyrim për investime; vlera 15 milion leke detyrim për investime Ministria e Infrastrukturës.</i> - Gjendja debitorë progresive e taksave e tarifave vendore deri më 31.12.2022 paraqitet për 31,787,531 lekë, nga të cilat: <i>Taksa/Tarifa nga Biznesi për 2012-2022, debitorë për vlerën 23,389,028 lekë, Kamatëvonesa (0.06%) për biznesin për 2012-2019 debitorë për vlerën 2,351,899 lekë, Taksa/Tarifa Institucione/Ente debitorë për vlerën 468,960 lekë, Tarife shërbimesh (Operator ekonomik) debitorë për vlerën 204,000 lekë, Tarife licencimi 5 vjeçar tregtim karburanti debitor për vlerën 4,600,000 lekë, Takse ndikimi infrastrukture debitor për vlerën 773,645 lekë.</i></p>	E lartë	<p>Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve pa likuiduara te prapambetura prej 86 milion leke, duke norMzuar situatën ne drejtim te rishikimit buxhetit, rritjes taksimit, ulje shpenzimeve, rishikimit te organikes, përdorimin e fondit veçante, etj. Gjithashtu të likuidojnë vendimet gjyqësore për vlerën 3,7 milion leke dhe vendimet gjyqësore të fituara nga ish-punonjësit për largime nga puna për vlerën 935,000 lekë dhe të arkëtoje vlerën 31,787,531 lekë, nga debitorë progresivë, te taksave e tarifave vendore te krijuara deri më 31.12.2022, si dhe të analizojë duke nxjerrë përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës.</p>

6	<p>Nga auditimi u konstatua se në procedurat e prokurimit me objekt:</p> <p>- Në 4 raste dhe konkretisht në procedurat e prokurimit për objektet “Blerje kamioni, Bashkia Tropojë”, “Rikualifikimi urban Lagja “Partizani”, Blloku 1&2, Qyteti Bajram Curri”, “Rikonstruksion i Shkollës “Oso Dauti”, Njësia Administrative Llugaj”, “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë-Lekurtaj”, zhvilluar në periudhën 2021 - 2022, janë vendosur kritere të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.</p>	E lartë	Kryetari i Bashkisë Tropojë të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anoMve të konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kritere të veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet.
7	<p>Nga auditimi rezultoi se në 5 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik.</p>	E lartë	Titullari i AK Bashkia Tropojë, të analizojë arsyet e anoMve në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.
8	<p>Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV(5 gjoba në vlerën 1,550,000 lekë), konstatohet se niveli i arkëtimeve është i ulët, IMTV dhe Bashkia Tropojë nuk kanë marrë të gjitha masat për arkëtimin e këtyre gjobave.</p>	E lartë	Nga Bashkia Tropojë dhe IMTV të marrin masat, të ndjekin të gjitha hapat ligjore dhe administrative, me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme, për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën 1,550,000 lekë.
9	<p>Nga auditimi i procedurave të prokurimit, lidhur me planifikimin e nevojave pasqyruar në regjistrin e planifikimit të prokurimeve, për periudhën nga data 01.01.2021 deri në datën 31.12.2022, në disa raste nga Autoriteti Kontraktor janë kryer procedura prokurimi duke copëzuar fondin dhe shmangur procedurat standarde të prokurimit, për shkak të ndryshimit artificial të kufirit monetar pa arsye objektive. Mosaplikimi i rregullt i llojit të procedurës dhe devijimi nga aplikimi i LPP-së, ka ndikuar negativisht në mirëpërdorimin e fondeve publike dhe përbën një risk eventual për prokurimin e objektit me një vlerë më të lartë.</p>	E ulët	AK Bashkia Tropojë dhe strukturat përgjegjëse të krijuara për administrimin dhe menaxhimin e procesit të prokurimit të fondeve publike, të marrin masa për të shmangur çdo ndryshim artificial të kufirit monetar, pa arsye objektive, duke krijuar kushte për kryerjen e prokurimeve në përputhje me procedurat standarde të prokurimit publik. Gjithashtu AK, gjatë përlogaritjes së vlerës limit të kontratës, duhet të ketë si qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes të sa më shumë operatorëve ekonomikë.
10	<p>Kontrata për zbatimin e punimeve me objekt “Rikonstruksion i 5(pesë) segmenteve rrugore, fshati Gri, Buljan, Cernikë, Tropojë” me vlerë të kontratës është 408,506,281.2 lekë me TVSH. Nga auditimi i zërave të preventivit dhe zërave të situacionit përfundimtar të punimeve sipas</p>		

	<p>kontratës së lidhur, u konstatua se nuk është ekzekutuar zëri “An. 3.226/1 Shtresë asfaltobetoni”. Ky zë nuk është ofertuar dhe nuk është situacionuar pra faturuar. Mos ekzekutimi i këtij zëri, pra i tapetit mbi binder, e bën investimin të jetë më shumë i ekspozuar ndaj fenomeneve natyrore. Kjo shtresë, jo vetëm që e mbron nga shkatërrimi shtresën e binderit ndaj kushteve natyrore por mbi të gjitha, garanton sigurinë në lëvizjen e mjeteve rrugore. Në këto kushte që është kryer investimi dhe nuk është hedhur shtresa e asfaltit, shtresa e binderit dhe vijëzimet mbi të, janë të destinuara të shkatërrohen me kalimin e kohës nëse nuk merren masa për hedhjen e asfaltit mbi binder. Vlera e binderit të investuar dhe vlera e vijëzimeve mbi binder, mund të sjellin dëm ekonomik në të ardhmen pasi për hedhjen e asfaltit duhet një frezim i binderit në rastin më të mirë ose shtresë e re binderi në rastin më të keq. Si rezultat, në gjykimin e grupit të auditimit, vlera në total prej 129,181,200 lekë, që korespondon për cdo rrugë lidhur me zërat shtresë binderi dhe vijëzime me bojë, konsiderohet si dëm ekonomik i mundshëm në të ardhmen nëse Bashkia Tropojë nuk merr masat sa më shpejt për hedhjen e asfaltit/tapetit mbi binder.</p>	<p>Bashkia Tropojë, të marrë masat për hedhjen e shtresës së asfaltit me qëllim shmangien e dëmit ekonomik prej 121,181,200 lekë, që korespondon me vlerën e binderit dhe të vijëzimeve në të gjitha segmentet rrugore të prokuruar për rikonstrukcion.</p>
--	--	---

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

I. Opinioni i auditimit financiar.

Grupi i auditimit të KLSH, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Tropojë për periudhën ushtrimore 01.01.2022–31.12.2022, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i modifikuar me rezervë:

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, shprehim një opinion **të modifikuar me rezervë**¹ për llogaritë vjetore të Bashkisë Tropojë, duke arritur në përfundimin se anomali të e konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura në llogaritë vjetore të vitin 2022, të sprehura në bazën për opinion.

Baza për opinion:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Tropojë, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700-ISSAI 1700). Opinionin e dhënë e mbështesim në vlerën e materialitetit prej 13,358 mijë lekë, llogaritur mbi shpenzimet e vitit 2022, si dhe në anomalitë e mëposhtme :

Nga auditimi i pasqyrave financiare se për llogaritë: 210 “Toka, Troje, Terrene”, 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, 212 “Ndërtime e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”, kanë respektivisht vlerat:: 22,460,270 lekë, 10,017,959 lekë, 1,057,967,697 lekë dhe 1,676,415,929 lekë, por vlerat e këtyre llogarive nuk japin siguri se janë të sakta, pasi janë të pa mbështetura me listën analitike të aktiveve.

Këto llogari janë mbajtur në bilancin kontabël pa pasur një analizë të detajuar, ku të përcaktohet origjina e vlerës së aseteve. Fakti që nuk ka një regjistër kontabël për të gjitha AAM, e vështirëson më tej njohjen dhe verifikimin e saktësisë së vlerave kontabël të këtyre llogarive.

II. Opinion i auditimit për përputhshmërinë.

Nga auditimi mbi veprimtarinë e subjektit “Bashkia Tropojë” (periudha 01.01.2022 – 31.12.2022), audituesit vlerësuan shkallën e zbatimit nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*).

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 4000 shprehim një opinion të **modifikuar/kualifikuar** për përputhshmërinë, për periudhën e auditimit nga data 01.01.2022 deri më datën 31.12.2023, duke arritur në përfundimin se anotomitë e konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku janë materiale, por jo të përhapura.

Baza për opinionin:

- Bashkia Tropojë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim;

- Janë konstatuar mangësi në evidentimin dhe vlerësimin e nivelit të detyrimeve debitore, kontabilizimet dhe procedurat e ndjekjes së borxhit tatimor për subjektet që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Tropojë.

- Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e detyrimeve kontraktuale nga dhënia e aseteve me qira, pasi nga 15 kontrata qiraje është konstatuar një detyrim i pa likuaduar në vlerën 3,835,358 lekë;

-Nga auditimi i llogarisë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Tropojë për arkëtim ndaj të tretëve, e cila është pasqyruar saktë, kjo llogari ka pësuar rritje për vitin 2022 pasqyruar për vlerën 44,710,681 lekë, ndërsa në vitin

2021 paraqitet në vlerën 42,876,907 lekë. Drejtoria e Financës Bashkia Tropojë, të marrë masat e nevojshme për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 470 “Të ardhura për tu marrë”;

- Nga auditimi u konstatua se për objektet e përfunduara dhe të likuiduara plotësisht, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës, pavarësisht se nuk janë marrë të gjitha në dorëzim nga Bashkia Tropojë, nuk është bërë zhbllokimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuara në degën e Thesarit. Nga Drejtoria e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së garancisë sipas objekteve ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjekte sipërmarrëse; - Nga llogaritë 210 “*Toka, Troje, Terrene*”, 211 “*Pyje, Kullota, Plantacione*”, 212 “*Ndërtime e konstruksione*” dhe 213 “*Rrugë, rrjete vepra ujore*”, nga Bashkia Tropojë nuk është marrë asnjë masë për të inventarizuar, kontabilizuar dhe regjistruar në kadastër tokat, trojet dhe terrenet të cilat i janë transferuar me VKM-të përkatëse ish-komunave, në kuadër të inventarizimit dhe transferimit të pasurive publike;

- Nga auditimi i 6 procedurave të prokurimit publik në katër prej tyre janë konstatuar anomali në hartimin e kriterëve të veçanta të DT, pasi janë vendosur kriterë të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me natyrën dhe madhësinë e kontratës;

- Në 5 raste në procedurat e prokurimit publik në vlerën totale 88,342,209 lekë, janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik;

-Janë konstatuar mangësi në menaxhimin e të ardhurave nga taksa e lëshimit të Autorizimeve/Liçencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, Bashkia Tropojë;

- Janë konstatuar shkelje afatesh në realizimin e kontratave për punë publike, si dhe amendime kontratash të pa argumentuara, lidhur me shtyrjen e afateve të zbatimit;

-Niveli i ulët i arkëtimit të gjobave të vendosura nga IMTV për shkeljet e konstatuara.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Tropojë.

Strukturat drejtuese të subjektit Bashkia Tropojë, Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator të fushës.

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomie që mund të ekzistojë. Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të japë opinionin përkatës.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të programit të auditimit nr. 518/1 Prot, datë 08.06.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 12.06.2023 deri në datën 21.07.2023, në subjektin Bashkia Tropojë u krye “Auditimi Financiar për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 dhe Auditimi i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022”. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

- 1.L.K, *Përgjegjës Grupi*
- 2.B.B, anëtar
- 3.F.C, anëtar
- 4.A.T, anëtar

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Tropojë ka si objektiva kryesore:

Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;

Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)¹;

Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;

¹Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Tropojë është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/ shërbimeve dhe investimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare. Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

Për kryerjen e gjithë veprimtarisë ekonomike dhe financiare, qëllimi i auditimit është të kuptohet se deri në çfarë shkalle subjekti zbaton kuadrin rregullator në fuqi, zbulimi i shkallës së devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së ligjshmërisë, me qëllim që për rastet individuale të identifikuar personat përgjegjës të ngarkohen me përgjegjësi, si dhe të merren masa për parandalimin e shkeljeve në të ardhmen.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësitë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Tropojë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndajë komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

1. Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.
2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
3. Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2022.
4. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2021-31.12.2022.
5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
6. Mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV-së.

7. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
8. Të ndryshme të dala gjtë auditimit

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Tropojë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

6. Kriteret e vlerësimit

Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe i'u jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, me ndryshime;
- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji Nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- “VKM nr. 187, datë 8.3.2017 për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, i ndryshuar.
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”;
- VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020 “Për përgatitjen e PBA vendor 2021-2023”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 ”Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.
- Etj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Tropojë grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë :

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik“;
- ISSAI 200 “Parimet themelore të auditimit financiar”.
- ISSAI 2200-2899 "Standardet e auditimit financiar";
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Tropojë me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit.

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomeve materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar

kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale².

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruar nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH^{ja} aplikon³.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektive* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektive fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i

² ISSAI 1315

³ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm.

Auditimi në subjektin “Bashkia Tropojë”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave. Bashkia Tropojë është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”.

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

Bashkia Tropojë kufizohet në veri me kufirin shtetëror me Republikën e Kosovës dhe Republikën e Mt të Zi, në jug-lindje me Bashkinë Has, në jug me Bashkinë Fush Arrëz dhe Bashkinë Vau Dejës dhe në perëndim me Bashkinë Shkodër. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Bajram Currit. Bashkia Tropojë përbëhet nga 8 njësi administrative që janë: Bajram Curri, Bujan, Bytyç, Leibaj, Fierzë, Llugaj, Tropojë dhe Margegaj. Burimet e financimit në Bashkinë Tropojë përbëhen nga, të ardhura nga burime të veta vendore; transferta e pakushtëzuar; taksa të ndara; transferta të kushtëzuara. Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 20517 banorë me densitet prej 19.4 banorë për km², ndërsa që sipas Regjistrit Civil numëron një popullsi prej 28216 banorë, me dendësi prej 26.95 banorë për km². Bashkia Tropojë ka një sipërfaqe prej 1058 km². Bashkia e Tropojës shtrihet në një zonë kodrinore dhe malore në përgjithësi, dhe shtrihet në të dy anët e Lumit Valbona. Tropoja është një zonë kryesisht bujqësore dhe blektorale. Sektorët prioritarë me bazë zhvillimi konsiderohen turizmi rural dhe malor, prodhimi i produkteve bujqësore dhe blektorale. Ndër sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë konsiderohet industria nxjerrëse e mineraleve.

2.Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

2.1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-s

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nësesistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe si ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Në këtë drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Tropojë, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i kontrollit”, “Menaxhimi i riskut”, “Aktivitetet e kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime”, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijojnë dhe vlerësojnë sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri-tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Titulli i gjetjes: Në Bashkinë Tropojë ngritja dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, nuk është në nivelin e kërkuar sipas dispozitave ligjore.

Situata:

Mjedisi i kontrollit - Nga ana e Titullarit të Bashkisë, nuk janë nxjerrë urdhra me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit. Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 4 pika 19, neni 16 pika 2 dhe neni 22. Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsisve, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme. - Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.- Nuk janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë - Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Gjithashtu Bashkia Tropojë nuk kanë përditësuar Rregulloren e Brendshme, të miratuar me shkresën nr. 1143. prot., datë 06.03.2018.

-Menaxhimi i riskut. Lidhur me identifikimin e aktiviteteve me risk, hapjen e regjistrit të riskut si dhe menaxhimin e tij, nuk është miratuar strategjia e menaxhimit të riskut, nuk janë identifikuar aktivitete me risk, si dhe nuk janë marrë masa për menaxhimin e tij. Nuk janë nxjerrë urdhra me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit, në kundërshtim

me kërkesat e nenit 22 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010. Megjithëse është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk janë miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se sa 5 vjet, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 32. Nuk ka plan-veprime vjetore operationale të miratuar, për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme.

-Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut.

- Nuk është hartuar një regjistër kompleks për gjithë Bashkinë, ku të identifikoheshin dhe të bëhej vlerësimi i risqeve për të gjitha Drejtoritë e NJA.

-Nuk është ndërmarrë dhe dokumentuar asnjë veprim për të adresuar mangësitë dhe përditësimi i 20 regjistrave të riskut.-Në raportet e AB nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. - Krahas vlerësimit të riskut nuk është bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë. Njësia Publike nuk ka vlerësuar mundësinë e riskut për mashtrime”.

-Veprimtaritë e kontrollit. Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up). Nuk ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit IT. Nuk ka procedura të veçanta të shkruara, mbi sistemet IT, të cilat përdoren në Bashkinë Tropojë, të cilat i janë bërë me dije stafit. Aktualisht nuk ka një manual të shkruar për sigurinë e IT. Mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të IT të miratuar nga Kryetari si dhe nuk është përfshirë si drejtim auditimi nga AB. Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Aktualisht punohet me sistemin online AMFIS i përdorur për pagesat i cili ruan në sistem praktikat e pagesave të kryera me Degën e Thesarit.

Informacioni dhe komunikimi. -Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj. Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Në Rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprohet me komunikim verbal, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Monitorimi: Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, realizohet në mënyrë formale duke respektuar ato kritere mbi të cilat edhe raportohet pranë Ministrisë së Financave. Nuk janë përcaktuar rregulla të qarta lidhur me ndjekjen e zbatimit të kontratave të lidhura pas procedurave të prokurimit me tender. Për projektet në bujqësi, arsim, urbanistikë, infrastrukturë etj., në rregulloren e funksionimit të brendshëm nuk janë përcaktuar detyra se kush duhet të ndjekë zbatimin e kontratave lidhur me afatet dhe cilësinë e punimeve.

Këto raste janë shkelje e kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar Kap. III, pikat 42, 47. Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të MFK. Në Bashkinë Tropojë aktivitetet e vlerësimit të njësive janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të

objektivave përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 20, 21.

Shkaku: Neglizhencë e drejtorive/sectorëve për hartimin e regjistrit të riskut, hartimin e strategjisë së riskut si dhe miratimin e gjurmëve të auditimit.

Ndikimi/Efekti: Mungon ndarja e qartë e detyrave sipas drejtorive/sectorëve, mos identifikim i shkallës së riskut, mos trajnim efektiv për rritjet profesionale të stafit. Rëndësia: E lartë 21

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, si dhe Kryetarit të GMS-së, duhet të marrë masa të menjëhershme për:

- Hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshkrimit të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësive dhe të drejtave të punonjësve të njësisë.

- Të organizojë Sistemin e Kontrollit të Brendshëm, duke siguruar funksionimin e tij në të gjithë sektorët, drejtoritë dhe struktura të tjera varësie dhe të ketë vijueshmëri, duke u monitoruar nga instancat drejtuese.

- Të organizojë trajnime të vazhdueshme të personelit, si dhe për Grupin e Menaxhimit Strategjik në fushën e Menaxhimit të Riskut dhe atë të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;

- Të miratojë planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”, si dhe të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të GMS-së, për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin;

- Të miratojë “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”, si dhe të funksionojë sistemi i raportimit për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj.

- Grupi i Menaxhimit Strategjik, të hartojë strategjinë e riskut, regjistrin e riskut, si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi, Z. R.B, Kryetar i Bashkisë Tropojë.

Lidhur me sa trajtuar në Projekt raportin e auditimit nuk janë paraqitur observacione nga subjekti i audituar.

- Vlerësim mbi veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm.

Titulli i gjetjes: Mangësi në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm.

Situata: Në Bashkinë Tropojë nuk funksionon njësia e Auditit të Brendshëm dhe nuk ka lidhur kontratë me institucion tjetër për realizimin e këtij funksioni. Me shkresën nr.2027 prot., datë 15.05.2020 me lëndë “Informacion për sektorin e Auditimit të Brendshëm”, është vënë në dijeni Ministria e Financave dhe Ekonomisë për shkrirjen e Sektorit të Auditimit të Brendshëm për shkak se nga Titullari është konstatuar performancë e dobët në punë dhe është arsyetuar se nëse

lind nevoja do të paraqitet projekt-vendim në Këshillin Bashkiak, sipas rasteve për të marrë audit të specializuar nga jashtë.

Shkrimja e Njesisë së Auditimit të Brendshëm nga Kryetari i Bashkisë është në kundërshtim me nenin 49 të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe pikën 1 të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të brendshëm në sektorin publik”, ku përcaktohet se në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore krijohet njësi e auditimit të brendshëm.

Kriteri: Neni 49 i ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe pikën 1 të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të brendshëm në sektorin publik”, ku përcaktohet se në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore krijohet njësi e auditimit të brendshëm.

Shkaku: Mungesë e kapaciteteve për kryerjen e gjitha angazhimeve, neglizhenca e drejtuesit për plotësimin e Strukturës Organizative të Auditimit të Brendshëm.

Ndikimi/Efekti: Nuk jep garanci në mbështetje të menaxhimit të lartë për zbatimin e objektivave, në Bashkinë Tropojë.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë të marrë masa për organizimin dhe funksionimin e strukturës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm brenda si pjesë e strukturës organizative të Bashkisë Tropojë, duke patur në konsideratë rekrutimin e punonjësve të certifikuar si “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi, Z. R.B, Kryetar i Bashkisë Tropojë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues.

Nga Bashkia Tropojë nuk u paraqitën observacione mbi Projekt raportin e auditimit.

2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

Përmbledhje e konstatimeve:

- **Vendimet e këshillit bashkiak Tropoje ne 7 raste nuk janë marre me shumicën e votave të anëtareve**, pasi kane votuar dhe nënshkruar nen 50 %, ose nen 3/5 te 21 anëtareve tij, për vitin 2021 dhe 2022, ne kundërshtim me kërkesat e nenit 48/4 dhe nenit 17/3 te ligjit nr. 139/2015 date 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

- Për vitin 2022 **struktura dhe organika e bashkisë Tropoje dhe njësive si dhe sektorëve tjerë ne disa raste paraqesin fyerje (gjithsejtë 361) ne raport me ngarkesën e punës**, madje është me e larte se 2021, çka nuk e justifikojnë punën e tyre me dokumente dhe programe pune, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, konkretisht:

* Aparati bashkisë paraqet 3 zv/kryetar, 2 sekretar këshilli bashkisë, 5 punonjës sektori financës, 6 punonjës sektori i taksave dhe tarifave vendore etj.

* Çerdhja e qytetit ka në organikë gjithsej 6 punonjës, të cilët ju shërbejnë mesatarisht 25 fëmijëve që frekuentojnë çerdhen, çka nuk kanë ngarkesën e duhur, në vend që të mbulohej

nga 4 veta, në kundërshtim me VKM nr. 323, datë 14.6.1993 “ Normat për vendosjen e personelit në çerdhe”.

* Qendra kulturore ka në organike 6 punonjës dhe pallati i sportit 4 veta.

* Sektori i pyjeve e kullotave ka në organike 25 punonjës.

* Sektori i pastrim gjelbërimit të qytetit paraqet në organike 87 punonjës.

- **Ne 1 rast, u konstatua se 9 specialistet e gjendjes civile nuk janë emëruar dhe paguar si “përgjegjës”,** në zbatim të VKM nr. 1299 datë 16.12.2009 “Për miratimin e strukturës të organikes të numrit nëpunësve të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake sot administrative dhe në degët e Qarqeve”, pasqyra 2, e cila citon emërtimin “përgjegjës” për çdo njësi administrative Tropoje dhe jo “specialist” siç është.

- **Shpenzimet për ndihmën ekonomike dhe paaftësisë** zënë peshën kryesore për vlerën 386 milion lekë ndaj shpenzimeve gjithsejtë prej 825 milion leke ose 47 %, **çka bën të domosdoshme nxitjen e punësimit dhe përmirësimin e politikave sociale,** për të zbutur papunësinë dhe varfërinë. Ndihma sociale në vitin 2022 për 386 milion leke paraqet tendencë rritje nga viti 2021 (308 milion).

- Për vitin 2022 bashkia Tropoje paraqet **shpenzime të larta në karburant** për vlerën 14 milion leke, për 20 automjete të lehta dhe të renda (fadrome, makine vetëshkarkuese pastrimit, kamion etj), pasi disa **automjete janë të vjetra** dhe kanë plotësuar të plote kuoten sipas normave të amortizimit, pavarësisht riparimit të tyre që i bën të funksionojnë mjetet, por me kosto të larta.

Normat mujore të karburantit rezultojnë të larta për disa automjete të vjetra, sipas evidencës të 20 automjeteve.

-Vlera e **faturave të pa likuiduara paraqitet 86 milion leke.** Sipas llojit të detyrimit:

vlera 3,7 milion leke detyrim për vendime gjyqësore, vlera 1.2 milion leke detyrim për shërbime, vlera 2,2 milion leke detyrim për mirëmbajtje, vlera 64 milion leke detyrim për investime dhe vlera 15 milion leke detyrim për investime Ministria e Infrastrukturës.

a. Vlera e faturave të pa likuiduara detyrime të prapambetura prej 86 milion leke do të rëndojë në fondet e viteve në vazhdim krahas likuidimeve të radhës të vitit ushtrimor.

b. Peshën më të madhe të detyrimeve për vitin 2022 e zënë zëri i faturave të pa likuiduara për investimet prej 80 milion leke (64+15), ose 93 % ndaj totalit të detyrimeve prapambetura.

c. Detyrimet e prapambetura 86 milion leke i kanë krijuar bashkisë Tropoje **vështirësi financiare,** pasi ato zënë mbi 25 % të shpenzimeve vjetore (220 milion), sipas nenit 56 të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, çka i lind domosdoshmëri bashkisë që të marrë masa për normalizimin e situatës, në drejtim të rishikimit të buxhetit, rritjes së taksimit, uljes së shpenzimeve, rishikimit të organikes, përdorimit të fondit veçantë, etj. Fakti për vështirësinë financiare të saj është se bashkia nuk ka shlyer detyrimet e planifikuara të vitit 2022 për detyrimet prapambetura në masën 30% ose në vlerën 23 milion leke, pasi janë likuiduar vetëm 6,2 milion leke nga 23 milion që duhej. Mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj operatorëve ekonomik është në kundërshtim me nenin 52 të ligjit 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit të buxhetit”, ndryshuar, me UMF 5 datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve prapambetura”, me Udhëzimin plotësues “Për buxhetin vitit”, pikat 82-91 “Detyrimet prapambetura Njësi Vetëqeverisjes Vendore”.

Bashkia Tropojë për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2022 ka shpenzuar vlerën 4,635,000 lekë, nga e cila vlera prej 935,000 lekë i përket vendimeve gjyqësore me objekt "dëmshpërblim page" për largime nga puna të punonjësve, ndërsa vlera prej 3,700,000 lekë i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore.

Vlera totale 4,635,000 lekë e shpenzuar për periudhën 01.01.2022- 31.12.2022 nga Bashkia Tropojë, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, ndikon pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, ndihmon në evidentimin e procedurave të bëra gabim, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit buxhetit".

- Gjendja debitorë progresive e taksave e tarifave vendore deri më 31.12.2022 paraqitet për 31,787,531 lekë, nga të cilat:

-Taksa/Tarifa nga Biznesi 2012-2022	23,389,028 lekë
-Kamatëvonesa (0.06%) për biznesin 2012-2019	2,351,899 lekë
-Taksa/Tarifa Institucione/Ente	468,960 lekë
-Tarife shërbimesh (Operator ekonomik)	204,000 lekë
-Tarife licencimi 5 vjeçar tregtim karburanti	4,600,000 lekë
-Takse ndikimi infrastrukture	773,645 lekë

- 15 subjekte nuk kane shlyer detyrimet kontraktore te qirave te aseteve bashkisë për vlerën 3,835,358 leke, për vitin 2021-2022.

Disa dosje te qirave te aseteve paraqiten pa inventarë dhe me mangësi dokumentare, konkretisht: mungojnë dokumentet bankare te likuidimit qirave, mungojnë njoftimet ndaj subjektit për mos-pagesat ne afat, mungojnë procedurat ligjore deri ne zgjidhjen e kontratës për subjektet e parregullta, mungojnë kamat vonesat, mungojnë inventarët për secilën dosje ne vitin 2022, por është mjaftuar me inventarin e dosjeve deri ne vitin 2019, ndërsa pas kësaj periudhe nga 2019 deri 2022 nuk ka vazhduar inventari i dokumenteve.

Veprime ne kundërshtim me kushtet e kontratave respektive, me VKM 391 date 21.06.2006 ndryshuar me VKM 1064 date 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave ne sektorin e pyjeve dhe kullotave", me VKM 54 datë 05.02.2014, me VKM nr. 693, datë 05.10.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", me ligjin 10296 datë 08.07.2010, me UMF 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin aktiveve njësitë sektorit publik" ndryshuar, me ligjin 7850 date 29.07.1994 "Kodi Civil RSH", me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat".

Më hollësisht sipas nëndarjeve të pikave të programit, trajtohen si më poshtë:

Aktiviteti i Bashkisë Tropojë.

Bashkia Tropoje shtrihet ne një pozicion gjeografik ne Alpet e Shqipërisë dhe kufizohet me Shkodrën, Hasin, Pukën dhe Gjakovën. Bashkia për vitin **2022** funksionon me një strukture dhe organike prej mesatarisht **391 punonjës**, nga këto: 16 drejtues, 141 specialiste larte, 9 teknike,

167 nëpunës thjeshtë, 28 punëtorë. Bashkia Tropoje është e organizuar në **7 njësi administrative dhe bashkia qender** dhe administron 68 fshatra, përkatësisht: Sektori i burimeve njerëzore, Sektori juridik dhe i prokurimeve, Policia Bashkiake, Sektori i financës, Sektori i ceshtjeve sociale, Sektori i tatim taksave, Drejtoria e shërbimeve publike, Arsimi baze dhe i mesem, Administrimi i pyjeve dhe kullotave, Mbrojtja nga zjarri, sektori i rrugeve rurale, Ujitja dhe kullimi, Pallati i sportit, Qendra Kulturore, Cerdhe, Gjendja civile, Njësi administrative Leibaj, Njësi administrative Bujan, Njësi administrative Fierze, Njësi administrative Margegaj, Njësi administrative Tropoje, Njësi administrative Llugaj, Njësi administrative Bytyç.

Keshilli bashkiak

Keshilli bashkiak i Bashkisë Tropoje për vitin 2022 përbehet nga **21 anëtarë**. Bashkia Tropoje ka 28,164 banorë, sipas regjistrimit civil. Nga verifikimi me zgjedhje të protokollit të mbledhjeve të keshillit bashkiak për vitin 2021-2022, u konstatua se:

- **Vendimet e keshillit bashkiak në 7 raste nuk janë marrë me shumicën e votave të anëtareve, pasi kanë votuar dhe nënshkruar nën 50 % (11), ose nën 3/5 e anëtareve (12)**, në kundërshtim me kërkesat e nenit 48/4 dhe nenit 17/3 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht:

- Në mbledhjen e KB datë 12.01.2022 “...Mbi buxhetin 2022 të bashkisë Tropoje” kanë votuar dhe nënshkruar 9 veta nga 13 veta që duhej.

- Në mbledhjen e KB datë 28.04.2022 “Mbi ndihmën ekonomike Mars 2022, për qytetar nderi, për miratimin e marrëveshjes me sha ALB-Telekom, ndihma financiare për 12 veta /20,000 leke, e tjerë” kanë votuar dhe nënshkruar 9 veta me pak se gjysma ose nën 50 %.

- Në mbledhjen e KB datë 01.06.2022 “...Mbi ndihmën ekonomike Prill 2022” kanë votuar e nënshkruar 7 veta me pak se gjysma nën 50 %.

- Në mbledhjen e KB datë 15.07.2022 “...Mbi miratimin e tavanit shpenzimeve buxhetit afatmesëm, për planin e mbylljes detyrimeve prapambetura e tjerë” kanë votuar dhe nënshkruar veta me pak se gjysma ose nën 50 %.

- Në mbledhjen e KB datë 01.08.2022 “...Mbi miratimin e tavanit përgatitor afatmesëm, për rrugën “Harry Bajraktari” me donator, thuhet në procesverbal se kanë votuar 11 veta, në fakt kanë votuar dhe nënshkruar 8 veta me pak se gjysma (11) ose nën 50 %.

- Në mbledhjen e KB datë 23.07.2021 “...Mbi rend dite me 9 pika” kanë votuar dhe nënshkruar 8 veta me pak se gjysma (11) ose nën 50 %.

- Në mbledhjen e KB datë 28.09.2021 “...Mbi rend dite me 11 pika” kanë votuar dhe nënshkruar 8 veta me pak se gjysma (11) ose nën 50 %. **Ngarkohet me përgjegjësi kryetarja e keshillit bashkiak zj. Sh.B.**

Misioni për njësinë që auditohet është:

- kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (të ardhurat e veta, grantin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin).

- Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në

përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve. **Objektivat** burojnë nga ligji “Për vetëqeverisjen vendore”. Administrata i këtij institucioni ka si qëllim: Përmirësimin e kushteve të punës, Rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, Zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, Rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.

Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: Njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; Respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; Zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; Ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; Realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.

Organi përfaqësues i Bashkisë është Këshilli Bashkiak. Organi ekzekutiv i Bashkisë është Kryetari i Bashkisë. Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor: krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre, vendos taksa e tarifa për shërbimet si dhe nivelin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesat e bashkësisë, harton, miraton dhe ndjek zbatimin e buxhetit tyre. Bashkia kryen funksione të veta, të përbashkëta dhe funksione të deleguara. Sa më sipër organizimi dhe funksionet në NJQVV, burojnë nga kërkesat e ligjit nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Buxheti.

Bashkia Tropojë për vitin 2022 ka hartuar dhe miratuar buxhetin e saj, në zbatim të kërkesave: të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ndryshuar, të ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, të UMF nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afat mesëm vendor 2023-2025” dhe UMF nr. 23, datë 30.07.2018, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të shkresës 22922/203 date 08.02.2022 te DPESHM.

Detajimi i shpenzimeve dhe ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre janë miratuar me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar e ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit.

2.2.1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor 2022;

Nëpërmjet grupit të punës për menaxhimin strategjik (GMS), ngritur nga Kryetari i Bashkisë, është hartuar dhe miratuar me vendimin e KB nr. 125 date 29.12.2022 PBA për periudhën 2023-2025 dhe për periudhën 2020-2022, raportuar në Ministrinë e Financave, bazuar në udhëzimin e MF nr. 10 date 28.02.2020 “Për përgatitjen e PBA vendor 2021-2023, bazuar në udhëzimin e MF nr. 8 dhe 9 date 28.02.2022, në udhëzimit 23 date 08.07.2022 etj. Janë zbatuar fazat e hartimit të PBA duke dokumentuar procesin e hapave të punës që duhet të ndiqen nga EMP dhe GMS-.

Për hartimin e PBA 2022 te programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin sipas degjeses publike 4868 date 11.11.2022 dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore dhe sektorëve bashkisë sipas shkresave date 12.03.2022, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”, në përputhje me shkronjën “ç”, neni 5 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

Tavanet buxhetore kane konfirmimin e Prefektures sipas shkreses nr. 2/25 date 10.08.2022 te vendimit KB nr. 66 date 01.08.2022.

Theksojmë se hartimi i PBA (Program Buxheti Afatmesëm 2020-2022) është kryer dhe audituar me pare nga grupi i auditimit.

Për hartimin e buxhetit të vitit 2022 është ngritur grup pune nga titullari bashkisë. Ky dokument është hartuar nga Drejtoria Financës dhe Buxhetit.

Në Bashkinë Tropoje buxheti i vitit 2022 është hartuar kryesisht mbi bazën e disa programeve, te cituara me lart.

Për vitin 2022 buxheti vjetor është planifikuar dhe krijuar nga të ardhurat vendore, transferta e pakushtëzuar dhe ajo specifike, nga transfertat dhe të ardhurat e trashëguara.

Në buxhetin e vitit 2022 bëjnë pjesë të ardhurat dhe shpenzimet e trashëguara nga viti i kaluar të cilat në hartimin e PBA-së nuk planifikohen.

Buxheti është hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë dhe institucionet vartëse, drejtoritë e shkollave, drejtoritë e bashkisë, njësitë administrative, etj.

Plani i të ardhurave dhe shpenzimeve për buxhetin e vitit 2022 është planifikuar duke përcaktuar fushat prioritare përkatëse.

Në varësi të fondeve të çelura në thesar në fillim të vitit ushtrimor janë bërë edhe miratimet e buxhetit fillestar të bashkisë.

Për vitin 2022 programimi i plan buxhetit i miratuar nga KB është sipas pasqyrës:

Pasqyra e planit të buxhetit të vitit 2022 krahasuar me planin e PBA.

Tabela nr. 1

	Emërtimi	Buxhet 2022 sipas VKB 111 dt 24.12.2021
600	Paga	189.630.000
601	Sigurime Shoqërore	30.971.000
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	29.798.000
603	Subvencione	
604	Transferta Korrente te Brendshme	
605	Transferta Korente të Huaja	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	10.754.000
I	Shpenzime Korrente	261.153.000
230	Kapitale të Patrupëzuara	
231	Kapitale të Trupëzuara	112.955.000
	Shp. Kapitale me financim te brendshem	
230	Kapitale të Patrupëzuara	
II	Shpenzime Kapitale	112.955.000
	I-II Totali I Shpenzimeve	374.108.000

Buxheti i bashkisë Tropoje për vitin 2022 është miratuar me VKB nr. 111, datë 24.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës.

Ndërsa Miratimi i buxhetit faktik 2022 është bere sipas vendimit KB nr. 46 date 28.02.2023. Buxheti i Bashkisë Tropojë dhe PBA, në përgjithësi është miratuar në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore.

Për vitin 2022 planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve në total sipas artikujve (bashke me ndryshimet që miratuar me vendim keshillit bashkiak, perkatesisht sipas VKB nr. 17 date 28.02.2022, nr. 109 dhe nr. 110 date 16.12.2022), paraqitet:

Tabela nr. 2

Nr.	EMERTIMI	Plani vjetor	Fakti	Realizimi %
1	600 Paga	194,110,484	193,328,605	99.59%
2	601 Sig.Shoq.Sh	30,455,169	30,237,162	99.28%
3	602 Shpenz.operative	66,448,910	61,404,665	92.4%
4	Studime, projektme			
5	231 Investime	182,592,482	148,418,519	81.28%
6	604,	5,182,488	4,983,954	96.17%
7	i 606	388,157,828	386,224,918	99.5%
	Shuma	866,947,361	824,597,823	95,1%

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

Buxheti i Bashkisë Tropoje për vitin 2022 është miratuar me VKB nr. 111, datë 24.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe njërive të saj për vitin 2022”. Miratimi i buxhetit nga njësia vendore për vitin 2022 është bërë brenda afateve ligjore, në përputhje me kërkesat e nenit 32 të ligjit 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku citohet: *Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore. Si rregull, brenda muajit nëntor të vitit buxhetor, Kryetarët e njërive të qeverisjes vendore paraqesin për miratim buxhetet në këshillat e tyre. Këshilli brenda datës 25 dhjetor, miraton buxhetin vendor, në bazë të vlerësimit të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor.*

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore.

Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj.

Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit, e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Plani i të ardhurave dhe shpenzimeve për buxhetin e vitin 2022 është planifikuar duke përcaktuar fushat prioritare përkatëse. Në varësi të vlerave të fondeve të çelura në thesar në fillim të vitit ushtrimor janë bërë edhe miratimet e buxhetit fillestar të bashkisë. Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti

Qendror të granteve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, granteve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit. Gjate vitit 2022 buxheti ka pësuar ndryshime shtesa/paketime, sipas VKB nr. 17 date 28.02.2022, nr. 109 dhe nr. 110 date 16.12.2022, sa vijon:

Tabela nr. 3 e ndryshimeve në buxhet viti 2022.

Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar	Buxheti shtesë				Shtesat dhe Pakësimet total	VKB 69 dt. 30.09.2021	Buxheti Baze +Shtese
	VKB nr. 111 24.12.2021	VKB 17dt 28.02.2022	VKB 109 16.12.2022	VKB 110 16.12.2022	Shk 1007/1 17.06.2022			
600.	189.630.000		468.026			468.026	+6.517.000	196.615.026
601	30.971.000		460.000			460.000	+ 4.916.148	36.347.148
602.	29.798.000	9.377.441		11.879.000		21.256.441		51.054.441
604.					5.279.238	5.279.238		5.279.238
230-231.	112.955.000	23.570.650				23.570.650	-6.517.000	130.008.650
609.	10.754.000						-4.916.148	5.837.852
TOTA	374.108.000	32.948.091	928.026	11.879.000	5.279.238	51.034.355	0	425.142.355

Për vitin 2022 buxheti vjetor është miratuar me VKB nga të ardhurat vendore, transferta e pakushtëzuar dhe ajo specifike, nga transfertat dhe të ardhurat e trashëguara, sa vijon:

Pasqyrë përmbledhëse për planifikimin e buxhetit për vitin 2022, sipas VKB përkatëse:

Tabela nr. 4

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2022				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2022			
Burimi i të ardhurave	Buxh. fill.	Buxh sht	Vlera	Emër zëra shpen	Buxheti fillestar,	Buxheti shtesë	buxheti fill + shtes 000/lek
ardh veta tr. pl 2022	19.437.761		19.437.761	601	30.971.000	460.000	31.431.000
Total ardhur veta	75.437.761		75.437.761	602	29.798.000	21.256.541	51.054.541
Ardh. trashg. grant pak	11.159.279		11.159.279	603			
ardh trashg. transf. specif	2.351.051		2.351.051	604		5.279.238	5.279.238
Transf. pakusht 2022	212.843.524	11.879.000	224.722.524	606			
Transferta specif 2021	105.264.729	928.026	106.192.755	230-231	112.955.000	23.570.550	136.525.550
.....		5.279.238	5.279.238	609	10.754.000		10.754.000

Total ardhurat transf buxht	331.618.583	18.086.264	349.704.847				
TOTALI ARDHURAVE	407.056.344	18.086.264	425.142.608	TOTALI	374.108.000	51.034.355	425.142.355

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2022, paraqitet:

Tabela nr. 5

Bashkia Tropojë së bashku me njësitë vartëse. Vetëm me të ardhurat e veta vendore + transfertat e pakushtëzuar. Viti 2022. Në 000/lekë.							
Art.	1	2	3	4	5	(6)=(4)-(5)	Realizimi ne %
	Fakti 2021	PBA. Plan 2022	Plan Fill. 2022 trasheg	Rishikuar 2022	Fakti 2022	Diferenca	
600	100.940.580			104.739.879	104.060.382	679.499	
601	17.953.020			16.287.744	16.280.473	7.271	
602	42.185.331		9.377.441	56.056.914	51.012.670	5.044.244	
604	70.000			4.514.450	4.316.000	198.450	
606	5.700.831			7.566.383	7.083.495	482.888	
Non-Totali	166.849.762		9.377.441	189.165.370	182.753.020	6.412.350	
231	169.028.363		23.570.550	68.834.241	37.172.831	31.661.410	
Non-Totali			23.570.550	68.834.241	37.172.831		
Totali	335.878.125		32.948.091	257.999.611	219.925.851	38.073.760	

Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të mos realizimit të të ardhurave dhe mosrealizimi për efekt të vendosjes së limitit të likuidimeve nga Ministria e Financave, sjellin mos plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës së njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

Bashkia Tropoje nuk ka ndërmarrje ne varësi. Ujësullësi sha është me aksione te plota 100 % Kjo tabelle rakordon me situacionin e 12-mujorit.

Konkluzion:

Nga auditimi referuar situacionit të shpenzimeve sipas artikujve për vitin 2022 (buxhetit përfundimtar bashke me njësite administrative etj), rezulton se: Për vitin 2022 nuk ka tejkalim shpenzimesh sipas artikujve, pasi këto kanë qenë dhe nën kontrollin e degës thesarit.

Shpenzimet për paga

Shpenzimet për paga ne total janë realizuar për vlerën 193 milion lekë nga 194 milion leke te planifikuara. Dinamika e shpenzimeve për paga është rritur krahasuar me vitin 2021 si ne planifikim dhe realizim prej 175 milion. Ndikim ka pasur shtesa e numrit punonjësve dhe rritja e pagave.

Struktura dhe orgaN e bashkisë dhe njësiteve si dhe sektorëve tjerë paraqesin fyerje ne raport me ngarkesën e punës ne aparatit e bashkisë dhe disa sektor e njësi, çka nuk e justifikojnë punën e tyre me dokumente dhe programe pune dhe nuk kanë ngarkesën e duhur. Gjithashtu

nuk është patur parasysh numri real i banoreve Tropojës, borxhi i larte ndaj te treteve prej 86 milion leke, vështirësia financiare etj.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kryer nga përgjegjesi i Sektorit të Burimeve Njerëzore znj. K.A dhe Zv/Kryetare dhe drejtoreshë e finance–buxhetit znj. Z.I.

Kështu lind domosdoshmëri ne te ardhmen rishikimi i organikes dhe strukturës bashkisë, për efekt te uljes shpenzimeve dhe rritjes aftësisë paguese. Nga verifikimi rezulton se ka vend për shkurtime ne aparatit dhe administratën e bashkisë, pallatin sportit e qendra kulturore, bordi i kullimit, pyje kullota, çerdhe e kopshte etj, konkretisht:

* Aparati bashkisë paraqet 3 zv/kryetar, 2 sekretar këshilli bashkisë, 5 punonjës sektori financës, 6 punonjës sektori taksave vendore etj.

* Çerdhja e qytetit ka në organikë gjithsej 6 punonjës (1 përgjegjëse çerdhe, 3 edukatore, 1 kuzhinier, 1 sanitare), të cilët ju shërbejnë mesatarisht 25 fëmijëve që frekuentojnë çerdhen, çka nuk kanë ngarkesën e duhur, në vend që të mbulohej nga 4 veta, në kundërshtim me VKM nr. 323, datë 14.6.1993 “ Normat për vendosjen e personelit ne çerdhe”.

* Qendra kulturore ka ne organike 6 punonjës, dhe pallat sportit 4 veta.

* Sektori i pyjeve e kullotave ka ne organike 25 punonjës.

* Sektori i pastrim gjelbërimit te qytetit paraqet ne organike 87 punonjës.

Rritja e numrit të punonjësve në organikë të bashkisë nga viti në vit, në kundërshtim me VKM nr. 472, datë 02.7.2011”Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore.....” dhe UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” etj.

Përlllogaritje e pagave dhe shitesave mbi paga.

Përlllogaritje e pagave dhe shitesave mbi paga paraqet përputhje me kërkesat ligjore, përjashtuar 1 rast, ku **9 specialistet e gjendjes civile nuk janë emëruar dhe paguar si “përgjegjës”**, ne zbatim te VKM nr. 1299 date 16.12.2009 ”Për miratimin e strukturës te organikes te numrit nëpunësve te gjendjes civile ne bashki/njësi bashkiake sot administrative dhe ne degët e Qarqeve”, pasqyra 2, e cila citon emërtimin “përgjegjës” për çdo njësi administrative Tropoje dhe jo “specialist” siç është.

Marrëdhëniet e punës për punonjësit e administratës së Bashkisë Tropoje rregullohen pjesërisht sipas kriterëve të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil” ose **61 punonjës me status nëpunësit civil dhe 332 punonjës me Kod Pune** (ndihmës dhe të policisë bashkiake) sipas ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Bashkia ka planifikuar dhe miratuar pagat për vitin 2022 për çdo vend pune sipas strukturave organizative, mbështetur në Vendimet e Këshillit Bashkiak, ne VKM 598 datë 27.4.2009 “Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njërive të qeverisjes vendore, për efekt page, e përcaktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore” ndryshuar me VKM nr. 518, datë 16.8.2012 dhe VKM nr. 586, datë 17.7.2013, bazuar në klasat, kategoritë, pagën e grupit dhe shitesën për vjetërsi e pozicion.

Nga auditimi i ushtruar për disa listë pagesa rezultoi se pagat dhe shtesat mbi paga si vjetërsia e punës etj janë përlogaritur drejtë, sipas tabelës së pagave, kjo në përputhje me VKM-të e sipërcituara.

Janë llogaritur dhe ndaluar sistematikisht për çdo muaj, detyrimet për tatimin mbi të ardhurat personale dhe sigurime shoqërore e shëndetësore. Pagesat për punonjësit bëheshin për çdo muaj mbi bazën e kohëshënuesit që lëshohej nga përgjegjësi i administratës. Kjo listprezence konfirmohej nga kryetari dhe dërgohej sektorit të financës për të kryer veprimet.

U audituan pagesat e kryera për shpërbimin e anëtarëve të Këshillit të Bashkisë dhe u konstatua se kjo pagesë është kryer në masën 10 për qind të pagës së kryetarit të Bashkisë. Numri 21 i Këshilltareve Bashkiak është bazuar në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 24 “Numri i anëtarëve të Këshillit Bashkiak” ndryshuar me ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Shpenzimet për investime

Shpenzimet për investime paraqiten te realizuara për vlerën 148 milion lekë në vitin 2022 nga 182 milion leke te planifikuara dhe janë ne nivelin e shpenzimeve për paga, paraqesin rritje nga viti 2021 (118 milion).

Shpenzimet për ndihmën ekonomike dhe paaftësisë.

Shpenzimet për ndihmën ekonomike dhe paaftësisë **zënë peshën kryesore për vlerën 386 milion lekë ndaj shpenzimeve gjithsejtë** (825 milion) ose 47 %, **çka bën të domosdoshme nxitjen e punësimit dhe përmirësimin e politikave sociale, për të zbutur papunësinë.** Ndihma sociale 2022 (386 milion) paraqet tendence rritje nga viti 2021 (308 milion).

Shpenzimet operative 602.

Shpenzimet operative janë realizuar për vlerën 61 milion lekë nga 66 milion te planifikuara, por ato **kane tendence rritje ne planifikimin dhe realizimin e tyre si dhe janë më të larta se ato të vitit 2021 (61-42)** për diferencën 19 milion lekë, çka ndikon në eficienten, ekonomikitetin dhe efektivitetin e shpenzimeve operative ne funksion te aktivitetit te bashkisë. Shpenzimet operative janë në raport të drejtë me shpenzimet për paga ne masën 34 %. Theksojmë se shpenzimet operative te bashkisë shoqërohen edhe me shpenzimet e njëjësive administrative dhe pastrimin e qytetit, i cili mbulohet nga bashkia.

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve operative te bashkisë për 2022, sipas zërave analitikë, paraqitet :

Tabela nr. 6

Nr.	Emertimi I materialit te shërbimit	000 /leke		Realizimi
		Plani	Fakti	%
1	Materiale zyre dhe të përgjithshme	648	598	92.3%
2	Kancelari	900	830	92.2%
3	Materiale për pastrim dhe dizenfektim	800	334	41.8%
4	Materiale per funksionimin e paisjeve te zyrës	170	70	41.2%
5	Blerje dokumentacioni			
6	Materiale dhe sherbime special	2'500	2'415	96.6%
7	Furnizime dhe sherbime me ushqime	2'500	1'655	66.2%
8	Posta dhe sherbim korrier	900	820	91%

9	Sherbim per ngrohje	9'500	9'480	99.78%
10	Sherbime bankare			
11	Sherbime te pastrimit dhe gjelberimit			
12	Sherbime te printimit dhe publikimit			
13	Sherbime transporti	100	83	83.4%
14	Karburant dhe vaj	15'000	14'180	94.5%
15	Pjese kembimi goma dhe bateri	1'750	1'652	94.4%
16	Shpenzime te tjera transporti			
17	Shpenzime udhetimi			
18	Udhetim i brendshem	2'550	2'504	98.2%
19	Udhetim i jashtem			
20	Shpenzime per mirembajtje	1'100	1'010	91.85%
21	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore	4'000	3'910	97.77%
22	Shpenzime mirembajtje rrugeve, rrjeteve dhe vepra ujore			
23	Shpenzime te tjera operative	3'080	2'570	83.44%
24	Shpenzime per pritje dhe percjellje	100	99	99.4%
25	Aktivitete	700	699	99.9%
26	Shpenzime gjyqesore	1'900	1'647	86.6%
27	Dekor	500	40	8%
28	Shpenzime /kompensime per te zgjedhur	2'000	1'772	88.5%
29	Te tjera shpenzime operative	600	512	85.4%
30	Mirembajtje makinerie	1'550	1'462	94.3%
31	Dru zjarri	5'600	5'529	98.7%
32	Keshilltare dhe kryepleq	8'000	7'533	94.15%
SHUMA		66'448	61'404	92.4%

Nga të dhënat më sipër rezulton se shpenzimet operative ne total dhe zëra analitik nuk kanë rezultuar me tejkalime nga ato të programuara, por ne planifikim ka rezerva dhe mosparashikim të saktë në disa zëra, konkretisht:

- Shpenzimet për karburant.

Shpenzimet për karburant për vitin 2022 paraqiten per 63,072 litra karburant gjithsej per vleren 14 milion leke nga 15 milion te planifikuara.

Janë mbajtur akt rakordimet për çdo muaj nga sektori shërbimeve me drejtuesit automjeteve, lidhur me sasinë e harxhimit karburantit dhe sasinë e furnizuar, ku gjendja e rezultuar ka kaluar për llogari te muajit pasardhës.

Nuk disponohet evidenca vjetore 2022 për planin e karburantit dhe realizimin e tij per 20 mjete e bashkisë, por disponohet evidenca e normave te karburantit sipas drejtueseve te këtyre mjeteve *te cilët kane përdorur dhe mbuluar 2-3 makina*.

Për hartimin e normave te karburantit për 20 automjetet është ngritur grupi i punës i përbëre nga 5 veta, përkatësisht:

Sh.D, K.R, P.R, Sh.V, J.Q, sipas urdhrit nr. 479 date 01.12.2020 te titullarit bashkisë.

Përveç 20 automjeteve te bashkisë (*përfshirë mjetet e lehta korse bari, kaldaja*) bashkia Tropoje për nevoja emergjente ka përdorur me qira edhe 4 automjete tjera private me te cilat ka lidhur kontratat përkatëse ne vitin 2022.

Nga auditimi i dokumentacionit karburantit rezultoi se:

a. Ne disa procesverbale rekordimi karburantit u vërejtën parregullsi (korrigjime), konkretisht:
-procesverbali janar 2022,
-procesverbali korrik 2022 për fugonin BC 0890B korrigjuar tek km,
- procesverbali i tetorit 2022 për kamionin C. B. 4560,
-procesverbali i nëntorit 2022 për kamionin TR 8485 E e,
-procesverbali 01.09.2022 për kamionin HD 04560, paraqet korrigjim tek orët e punës,
-procesverbali 31.07.2022 për kamionin, paraqet korrigjim tek orët e punës,
Veprim ne kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, pika 36, ku thuhet:

*Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkaktun e veprimit datën dhe vendin e kryerjes,objektin , treguesit sasiorë dhe ato të vlerës , personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.
Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime...,*

Ngarkohet me përgjegjësi sektori shërbimeve **K.S.**

b. normat mujore te karburantit rezultojnë ne disa raste te larta dhe per disa raste ato jane rritur nga viti ne vit, si rezultat i amortizimit dhe vjetersise tyre, çka ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve të karburantit, konkretisht:

- 2 Fadromat paraqesin normat e karburantit prej 31 litra/100 km dhe 32 litra/100 km,
- 2 Kmionat benx dhe volvo paraqesin 33 litra/100 km dhe 28 litra/100 km, nga 17 dhe 26 litra/100 km qe kishin ne vitin 2014.
- 1 Boti i ujit 28 litra/100 km, (nga 24 litra ne vitin 2014),
- Makina mbeturinave 44 litra/100 km, (nga 28 litra/100 km ne vitin 2014).
- Bore pastruesja 24 litra/100 km, (nga 18 litra/100 km ne vitin 2014).

Per rrjedhoje, disa automjete te renda duhet t'i nënshtrohen kontrollit te gjendjes teknike nëse janë rentabël ose jo, pasi paraqesin jetëgjatësi mbi 30 vjet dhe kane mbushur kuoten e plotë te amortizimit sipas normave te amortizimit, bazuar ne kërkesat e ligjit nr. 8841, date 11.12.2001 dhe VKM nr. 401, datë 23.10.1989 “Për normat e amortizimit”, per efekt te shmangies shpenzimeve larta te karburantit dhe pjeseve këmbimit, konkretisht:

1. Autobot benx 47 vjeçar viti i prodhimit 1976.
2. Kamioni benx 40 vjeçar, viti i prodhimit 1983.
3. Kamion benx 37 vjeçar, viti i prodhimit 1986.

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit;

Sipas situacioneve të shpenzimeve të rakorduara me thesarin për vitin 2022 shpenzimet buxhetore në Bashkinë Tropojë janë planifikuar dhe realizimi paraqitet në masën 95%. Është rakorduar çdo muaj me degën e thesarit Tropojë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën

e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me degën e thesarit Bajram Curri duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me VKB, ose të diktuar nga grantet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se është respektuar disiplina buxhetore. Nga auditimi në lidhje me planifikimin dhe realizimin e investimeve në Bashkinë Tropojë u konstatua se për vitin 2022, me financim nga buxheti i Bashkisë dhe nga transfertat e qendrës janë planifikuar investime në vlerën 182,592 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 148,419 mijë lekë ose në masën 81,3 %. Për shpenzimet e reja kapitale janë zbatuar hallkat e miratimit për përfshirjen në buxhet, pasi janë bazuar në prioritetet e caktuara, në kërkesat e paraqitura dhe verifikimit në vend të problemit. Nga Bashkia është bërë miratimi në kohë i buxhetit. Në çdo rast janë ndjekur hapat për realizimin e pagesave të shpenzimeve, duke nxjerre urdhrin e prokurimit, është zhvilluar procedura e prokurimit, është lidhur kontrata, pune apo shërbime, janë marrë në dorëzim në çdo rast nga grupi i kolaudimit i ngritur për këtë qëllim, ndërsa për investimet grupi i ngritur nga Zyra e Urbanistikës. Në çdo procedure prokurimi janë dokumentet nga urdhri i prokurimit, kontrata, fatura tatimore, situacioni në rastet e punëve apo shërbimeve, fletë hyrja e magazinës etj. Për çdo procedure prokurimi, urdhri është regjistruar në kohë dhe kanë vulën dhe datën e depozitimit të tyre në Degën e Thesarit Tropojë. Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në Degën e Thesarit dhe të shtrira në kohë sipas financimit. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, ku është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli i realizimit të ardhurave; (Faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të grandeve si FZHR, Ministrinë linjës etj.

a. Fatura të pa likuiduara.

Fatura të pa likuiduara për investime dhe shpenzime operative deri më datë 31.12.2022, Bashkia Tropoje paraqet një detyrim ndaj të tretëve vlerën **86 milion leke** (71+15), bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare në datën 31.12.2022 (llogaria 486, furnitor e llogari të lidhura me to).

Vlerës të detyrimeve 71 milion leke i shtohet edhe vlera 15 milion leke detyrim për investime nga Ministria e Infrastrukturës, fond i cili nuk është planifikuar për shlyerje, në total 86 milion leke.

a. Vlera 86 milion leke detyrime të prapambetura e zbërthyer në mënyrë analitike **sipas burimit të financimit**, paraqitet:

- vlera **71 milion leke** detyrim **financimi nga të ardhurat e veta**.

- vlera **15 milion leke** detyrim **financimi nga të grandit** (FZHR+Ministria Infrastrukturës).

b. Vlera e faturave të pa likuiduara prej 86 milion leke, **sipas llojit të detyrimit**, perbehet:

- vlera **3,7 milion leke** detyrim për vendime gjyqësore.
- vlera **1.2 milion leke** detyrim për shërbime.
- vlera **2,2 milion leke** detyrim për mirëmbajtje.
- vlera **64 milion leke** detyrim për investime.
- vlera **15 milion leke** detyrim për investime Ministria e Infrastrukturës.

Stoku i detyrimeve të Bashkisë është raportuar i sakte dhe sipas klasave të Buxhetit për të gjitha detyrimet e prapambetura, të cilat janë pasqyruar në aktiv të bilancit në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe sipas llogarive 231 dhe 602.

Për stokun e detyrimeve të prapambetura, Bashki Tropoje ka njoftuar thesarin dhe zyrën përbarimore, sipas shkresës saj nr. 4697/10 date 14.02.2022, bazuar në udhëzimin e MFE nr. 1 date 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit 2022”, kreu III, pika 126.

Bashkia Tropoje, në zbatim të udhëzimit MFE nr. 37 date 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin e detyrimeve të prapambetura” dhe aktit normativ 34 date 03.12.2021, ka hartuar planin e shlyerjes të detyrimeve prapambetura prej 71 milion leke për periudhën 2022-2024 (pa përfshirë vlerën 15 milion të MI), përkatësisht:

* Për vitin 2022= 30 % ose 23 milion leke, **i cili nuk është zbatuar i plote**, pasi janë likuiduar vetëm 6,2 milion leke nga 23 milion që duhej.

* Për vitin 2023= 30 % ose 23 milion leke.

* Për vitin 2024= 40 % ose 3 milion leke.

Pasqyra totale e detyrimeve të bashkisë Tropoje ndaj të tremeve deri në 31.12.2022, paraqitet:
Tabela nr. 7

Emertimi i detyrimit prapambetur	Detyr. prap. 31.12.2021	Vlera paguar 2022 detyr. Prap.	Vlera totale detyr. Prap. 31.12.2022
Detyrime vendime gjyqësore	6'730'584	2'975'158	3,755,426
Detyrime për shërbime	3'574'046	179'040	1,183,360
Detyrime për mirëmbajtje			2,211,646
Detyrime për investime	66'930'347	3'079'997	63,850,350
Totali burimeve nga ardhur veta	77,234,977	6,234,195	71,000,782

Theksojmë se: Detyrime për shërbime dhe mirëmbajtje në vitin 2021 nuk kanë qenë të ndara po në total 3.574,046 leke. Ndërsa gjatë vitit 2022 janë likuiduar 179,040 leke dhe shuma e mbetur është ndare në 1,183,360 leke detyrime shërbime dhe 2,211,646 leke detyrime mirëmbajtje.

Sa sipër,

a. Vlera e faturave të pa likuiduara detyrime të prapambetura prej **86 milion leke do të rëndojë në fondet e viteve në vazhdim** krahas likuidimeve të radhës të vitit ushtrimor.

b. Peshën më të madhe të detyrimeve për vitin 2022 e zënë zëri **faturat e pa likuiduara për investimet** prej 80 milion leke (64+15), ose në masën 93 % ndaj totalit detyrimeve prapambetura.

c. Detyrimet e prapambetura 86 milion leke i kane krijuar bashkisë Tropoje **vështirësi financiare**, pasi ato zëne mbi 25 % te shpenzimeve vjetor prej 220 milion leke (*përjashtuar ndihmën sociale*), sipas nenit 56 te ligjit 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, çka i lind domosdoshmëri bashkisë qe te marre masa për normalizimin e situatës, ne drejtim te rishikimit buxhetit, rritjes taksimit, ulje shpenzimeve, rishikimit te organikes, përdorimin e fondit veçante, etj.

Fakt për veshtiresine financiare te saj është se bashkia nuk ka shlyer detyrimet e planifikuara te vitit 2022 për detyrimet prapambetura ne masën 30% ose ne vlere absolute 23 milion leke, pasi janë likuiduar vetëm 6,2 milion leke nga 23 milion qe duhej.

Mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj operatorëve ekonomik është në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor*”, i ndryshuar, me UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*”, me Udhëzimin plotësues “*Për buxhetin e vitit*” etj, pikat 82-91 “*Detyrimet e prapambetura Njësive Vetëqeverisjes Vendore*”.

Neni 52: *Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik.*

Sa sipër konkretisht:

- fatura 329 date 31.05.2019 “*A.K*” është likuiduar me vonese mbi 3 vjet, sipas urdhër shpenzimit nr. 413 date 30.12.2022,
- fatura 203 date 27.05.2019 “*N*” shpk është likuiduar me vonese mbi 3 vjet, sipas urdhër shpenzimit 414 date 30.12.2022, për 706,30 leke.
- fatura 8 date 19.07.2019 “*L.I*” është likuiduar me vonese mbi 3 vjet, sipas urdhër shpenzimit 416 date 30.12.2022, për 143,028 leke.

Madje disponohen fatura te pa likuiduara qe nga viti 2014-2015, **me hollësisht vonesat e likuidimit te faturave prapambetura parqiten ne tabelën nr. 8, bashkëlidhur.**

b. Vendime gjyqësore.

- Për vitin 2022 **vendimet gjyqësore paraqiten për vlerën 3,7 milion leke** nga 6,7 milion leke ne vitin 2021, **me efekt negativ ne buxhet.**

- Për vitin 2022 shpenzime për **vendime gjyqësore të fituara nga ish-punonjësit për largime nga puna**, paraqiten për vlerën **935,000 lekë**, çka ka shkaktuar **dublim pagese për të njëjtin vend pune** dhe ka dhënë **ndikim negativ në buxhetin** e bashkisë (*pagese për zëvendësuesin dhe për te larguarin, fituar me vendim gjykatës*).

Nuk ka dalë përgjegjësia ndaj personave fajtor dhe nuk ka masa administrative, në kundërshtim me nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, i ndryshuar me MF nr. 01, datë 17.01.2019 “*Për buxhetin e vitit 2019*” dhe ngarkon me përgjegjësi ish-Kryetarin e Bashkisë dhe kryetarin aktual si dhe juristen.

Bashkia Tropoje ne 1 rast nëpërmjet zyrës juridike ka apeluar vendimet e shkallës së parë, por pa dale vendimi i formës prere ka vazhduar likuidimi, çka e bën te pavlere apelimin.

Ngarkohen me përgjegjësi ish kryetari i Bashkisë Tropoje **B.D** dhe kryetari aktual **R.B** si dhe juriste **J.C dhe drejtorja ekonomike.**

Lista analitike e detyrimeve te prapambetura te likuiduara ne vitin 2022, sa vijon:

Tabela nr. 9

<i>N r</i>	<i>Emertimi</i>	<i>Vlera</i>	<i>Urdher shpenzim/ data</i>
1	K. shpk	1,500,000	Ush 45 dt 17.02.2022
2	Sistemim I ujrave te larta Margegaj	565,757	Ush 72 dt 28.03.2022
3	Zyra Permbartimore K.C (R.D	331,286	Ush 68 dt 16.03.2022
4	Vendime gjyqesore - largim nga puna	603,872	Ush 80 dt 01.04.2022
5	Riparim Fadrome - N.M	179,040	Ush 101 dt 11.04.2022
6	I. C. Project	1,440,000	Ush 102 dt 11.04.2022
7	Diference e projekteve -Derbi	1,614,240	Ush 132 dt 12.05.2022
TOTALI		6,234,195	

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve te përfituara nëpërmjet FZHR, saktësia e raportimit buxhetor te tyre;

Rezulton se nuk ka pasur fonde te çelura nga FZHR për vitin 2022.

2.2.6. Burimi i krijimit te ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i te ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes se te ardhurave ne përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes se kontratave për dhënien me qira te asetëve. Evidentimi i detyrimeve tatimore te pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit auditivit.

a. Taksat vendore

Bashkia Tropoje ka miratuar paketën fiskale te vitit 2022 sipas vendimit KB nr. 103 date 03.12.2021.

Te ardhurat te veta për vitin 2022 nga Bashkia Tropoje janë realizuar 69,000 mije leke nga 56,000 mije leke te planifikuara, ose ne masën 123.8%.

Ne fakt nuk ka tejkallim dhe as realizim te taksave për vitin 2022, pasi planifikimi paraqet rezerva për çdo takse dhe tarife, pavarësisht se ndikim ka pasur arkëtimi i detyrimit qerese për 2.2 milion lek nga subjekti B. G. E. shpk i paplanifikuar.

Kështu **nuk ka zbërthim analitik dhe planifikim për çdo takse,** për rrjedhoje nuk justifikohet vlera e planifikuar, konkretisht:

- **taksa e biznesit** nuk pasqyron numrin e subjekteve, ngarkesën e tyre dhe vend ndodhjen ne qendër apo ne periferi.

- **taksa e ndërtesës dhe hotelit** nuk llogaritet sipas sipërfaqeve dhe ambiente, sipas numrit dhomave dhe shtretërve, bazuar ne dokumentet e urbanistikes ose verifikimit ne terren me komision.

- **te ardhurat nga qira asetesh,** pyje dhe objekte nuk janë planifikuar sakte, pasi:

* janë planifikuar 2,250 mije leke ne vend te vlerës 6,325 mije leke, sipas 35 kontratave qirave lidhura (përjashtuar vlerën 2.2 milion leke nga subjekti B. G. E. shpk te pa planifikuar), pra me një diference **rezerve ne planifikim prej 4,075 mije leke.**

* realizimi i te ardhurave nga qiratë asetëve paraqitet 4,856 mije leke ose me tejkalim sipas taksave vendore, ndërsa **ne fakt paraqitet mos realizim për vlerën 1,469 mije leke** (6,325 mije – 4,856 mije).

Fakt se nuk janë realizuar qiratë e asetëve për vitin 2022 është vlera 2,227 mije leke debitorë, e pasqyruar nga vete taksat vendore.

Planifikimi dhe realizimi i te ardhurave vendore për vitin 2022, sipas llojit tyre, paraqitet sipas tabelës nr.10

Tabela nr. 10

000/lekë

Nr	Lloji i takses	2022		
		Plan	Fakt	%
I.	ARDHURA NGA TAKSAT(1-9)	56000	69318	123.8
1	Tatimmbi ardhurat personale (2%)	5400	6171	114.3
2	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin	50	203	406
3	Taksa mbi ndertesat	2350	2794	118.9
	a)Ndertesa banimi	400	425	106.3
	b)Ndertesa te tjera (biznesi)	1950	2369	121.5
4	Taksa mbi token bujqesore	400	75	18.8
5	Taksa Trualli	350	546	156
6	Taksa e hotelit	800	1081	135.1
7	Taksa ndik.infras.nga ndert.reja	13000	13737	105.7
8	Taksa kalimit te drejtes pronesis PP	50	4	8
9	Taksa e rregjistrimit pervi.mjeteve	9880	11553	116.9
10	Taksa e Rentes minerare	50	0	0
11	Taksa e Tabeles dhe Reklames	1100	1536	139.6
12	Taksa te tjera	50	0	0
II	TE ARDHURAT NGA TARIFAT	18970	26075	137.5
1	Tarifa sherbim publike(pastrim, gjelbrim, ndricim, largime mbetjeve)	12800	16072	125.6
	a) Familjet	1000	1873	187.3
	b) Institucionet	1900	1198	63.1
	c)Biznesi	9900	13001	131.3
2	Tarifa e sherbimit administrativ	3320	3384	101.9
	a)Vertetime, autorizime, dok.tjera	120	158	131.7
	b)Tarife veterinere bageti te therura	50	0	0
	c)Tarife licencimi veprimtari transporti, autorizime	2000	2118	105.9
	d)Tarife parkimi per mjete	350	546	156
	e)Tarifa ne sektorin e pyjeve	800	562	70.3
3	Tarifa sherbimi institucionet e arsimit, kultures dhe sportit	2850	6619	232.2
	a)Pallati i kultures	50	0	0
	b)Pallati i Sportit	50	0	0
	c)Kopshtet	750	1020	136
	d)Çerdhet	150	174	116
4	Tarifa zenien hapësirave publike	350	320	91.4
5	Te ardhura te tjera	1500	5105	340.3
III.	Gjobat	700	687	98.1
IV	TE ARDHURA JOTATIMORE	2850	4856	170.4
	a)Qira mbi ndertesa dhe troje	2850	4856	170.4
	GJITHSEJ I+II+III+IV)	56,000	69,318	123.8

Për vitin 2022 numri i subjekteve biznesit vogël ka ardhur ne rritje nga 278 ne 280.

Ndërsa e kundërta ka ndodhur me subjektet e biznesit madh te cilët janë ne ulje nga 110 ne 103 subjekte.

Mbyllja e aktivitetit te bizneseve prej 52 ka qene me e madhe se regjistrimi i tyre prej 47 subjekte, sipas tabelës:

Evidenca e gjendjes së numrit të bizneseve për 2022.

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime të Reja	Mbyllur Aktiviteti	Gjendja ne fund
1	Biznesi Vogël	2022	278	39	37	280
2	Biznesi Madh	2022	110	8	15	103
	Gjithsej	2022	388	47	52	383

Vlera progresive e pa arkëtuar nga debitorët për detyrimet nga taksat e tarifate vendore më 31.12.2022 paraqitet për 31,787,531 lekë, nga të cilat:

-Taksa/Tarifa nga Biznesi 2012-2022	për	23,389,028 lekë
-Kamatëvonesa (0.06%) për biznesin 2012-2019	“	2,351,899 lekë
-Taksa/Tarifa Institucione/Ente	“	468,960 lekë
-Tarife shërbimesh (Operator ekonomik)	“	204,000 lekë
-Tarife licencimi 5 vjeçar tregtim karburanti	“	4,600,000 lekë
-Takse ndikimi infrastrukture	“	773,645 lekë

Vlera pa arkëtuar nga debitorët për vitin 2022 paraqitet 7,275,474 lekë, nga të cilat:

- taksa/tarifa nga biznesi 5,275,474 leke,
- tarifa licencimi 5-vjeçar tregtim karburanti 2,000,000 lekë.

Subjektet debitorë për taksa e tarifa te pa likuiduara për vitin 2022 si dhe detyrime progresive deri 31.12.2022, paraqiten sipas tabelës nr. 11, bashkëlidhur.

Me vendimin vendimit KB nr. 103 date 03.12.2021 është miratuar paketa fiskale për vitin 2022. Taksa e tregut dhe reklamës janë tregues i punës së dobët të sektorit të tatim taksave. Vlerësimi tatimor i disa subjekteve fizike nuk ka qenë në nivelin e duhur, ka patur mos diferencim të ngarkesës tatimore për disa subjekte në qendër dhe atyre në periferi, me aktivitet dhe me pak aktivitet si dhe me aktivitet të njëjtë, kontrolli në vend për xhiron e subjekteve dhe shfrytëzimi i të dhënave të bankës, thesarit dhe importeve ka qenë minimal. Për subjektet e pa licensuara në asnjë rast nuk u dokumentua bllokimi apo pezullimi i aktiviteti për gjithë periudhën e auditimit. Disa nga dosjet e subjekteve nuk janë të plota, nuk janë përditësuar dhe nuk janë të plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm. Për mbledhjen e taksës së reklamës nuk disponohet inventar fizik për reklamat e vendosura brenda territorit të qytetit Bajram Curri me të dhëna për numërin e përgjithshëm të reklamave, përmasat dhe sipërfaqet e tyre. Për një pjesë të debitorëve që nuk kanë paguar në afat nuk është aplikuar dënim me gjobë për pagesat e vonuara, gjithashtu ndaj tyre nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore.

Ngarkohen me përgjegjësi punonjësit e sektorit taksave dhe tarifave vendore: E.B me detyrë specialiste për administrimin e regjistrimit të territorit, K.B me detyrë specialist i menaxhimit të borxhit, H.S. me detyrë specialist tatim taksa, F.D specialiste për kadastrën fiskale, R.V specialiste e menaxhimit të tasksave familjare, për rezerva ne planifikim pasi mungon llogaritja për planifikimin e vlerës për çdo takse ne fillim te vitit, për mos vjeljen e

debitorëve, për mungese të marrjes gjitha hapave ligjore me qëllim arkëtimin e debitorëve, për mungese rakordimi me institucionet tjera, për punë të dobët në këtë sektor etj.

b. Asete me qira (35 kontrata).

Kontratat e qerasë për objektet në pronësi/përdorim të Bashkisë Tropojë, numri i tyre dhe vlera qerasë vjetore përkatëse, të lidhura gjatë periudhës 2022-2023 dhe para kësaj periudhe, janë si më poshtë:

1. Kontrata e Qirasë, me palë Bashkia Tropojë në cilësinë e Qiradhënësit dhe Personi Fizik I.M në cilësinë e Qiramarrësit, nr. 3872/3 prot., date 24.1.2022 me afat 10 vjeçare nga data 24.01.2022 deri 23.01.2032, është 15,000 lekë/vit. (përdoret për rrugë kalimi për tek aktiviteti tjetër)

2. Kontrata e qerasë, me palë bashkia Tropojë në cilësinë e Qiradhënësit dhe Shoqërisë “B” shpk në cilësinë e Qiramarrësit, nr. 3360/2, datë 1.8.2022, me afat 9 vjeçare nga 01.08.2022 deri me 31.7.2031, vlera vjetore e qerasë 206,800 (vendosur një impiant të lëvizshëm asfalto-beton).

3. Kontrata e Qirasë, me palë Bashkia Tropojë në cilësinë e Qiradhënësit dhe Personi Fizik B.T në cilësinë e Qiramarrësit, nr. 1224/5 prot., date 9.8.2022, me afat 10 vjeçarë nga 09.08.2022 deri 08.08.2032, vlera vjetore e qerasë 47,422.5 leke leke/vit, (përdoret për veprimtari turistike).

4. Kontrata e Qirasë, me palë Bashkia Tropojë në cilësinë e Qiradhënësit dhe Personi Fizik A.D në cilësinë e Qiramarrësit, nr. 992 prot., date 14.2.2023, me afat 1 vjeçarë nga 16.6.2023 deri me 15.6.2024, vlera vjetore e qerasë 242,400 leke ne vit, përdoret “Bar-Kafe”.

5. Kontrate Qiraje, me palë Bashkia Tropojë në cilësinë e Qiradhënësit dhe Personi Fizik A.H në cilësinë e Qiramarrësit, nr. 1291/9 prot., datë 20.3.2023, me afat 1 vjeçarë nga datë 19.03.2023-18.03.2024, vlera e qerasë vjetore 26,400 leke ne vit, përdoret “Bar-Kafe”.

6. Kontrata e Qirasë, me palë Bashkia Tropojë në cilësinë e Qiradhënësit dhe Shoqëria “F”sh.p.k NIPT J.....P në cilësinë e Qiramarrësit, nr.1896/5 date 27.06.2022 per periudhe 1 vjecare, nga data 26.06.2022 deri 25.06.2023 , vlera e qerasë 65,280 leke ne vit, përdoret për ambiente zyre.

7. Kontrata e Qirasë, nr. 1024/1 prot., datë 1.3.2022- me palë Bashkia Tropojë në cilësinë e Qiradhënësit dhe Shoqatës “T.Nj.D” NIPT K.....P date 1.3.2022-28.3.2023, vlera e qersë vjetore 139,200 leke vit, përdoret për ambiente zyre.(Kjo kontrate ka përfunduar).

Kontratat e qerasë për sipërfaqet e dhënies në përdorim të fondit pyjor/kullosor, janë të ndara për subjektet minerare, subjektet të komunikimit telefonik dhe internetit, me subjektet për ndërtim të HEC-ve dhe të tjera.

Për kontratat e qerasë për subjektet minerare:

1. Subjekti “L” shpk, me NIPT K.....L kontrata nr.1672 prot., date 20.4.2017, me afat nga 11.04.2017-10.04.2026, me afat 9 vjecare me objekt dhenie me qera një sip.prej 0.15 ha shesh depozitimi dhe 2 km rrugë kalimi në ekonomine pyjore/kullosore “Lugina e T’Planit” “Kam 2”, vlera e qerases 181,000 leke ne vit, *ka paguar 2017-2018 vleren prej 181,000, sipas MA R.-bank date 20.04.2017, ndersa nuk ka paguar per periudhen pas vitit 2018-2022. Zyra juridike nuk ka marre masa ndaj subjektit per mos pagesen e qirase detyrim kontraktor, pra nuk*

ka ndjekur gjitha hapat ligjore deri ne nderprerjen e kontrates, por eshte mjaftuar vetem me nje njoftim te subjektit ne vitin 2018.

2. Subjekti "S.A", shpk me NIPT L.....Q me afat 9 vjecare, me objekt "Dhenie me qera nje sip.prej 2500 m shesh depozitimi dhe 0.5 km rruge kalimi ne ekonomine pyjore "Kam 2", kontratë qiraje për dhënie në përdorim të fondit pyjore/kullosor me nr. 2965/2 prot., date 27.08.2019, vlera e qerasë 117,000 leke ne vit.

3. Subjekti "M" shpk, me NIPT L.....A me afat 9 vjeçare nga data 18.9.2018 deri me 17.9.2027, për dhënie me qira te një sipërfaqe 0.08 ha shesh depozitimi dhe 0.3 km rrugë kalimi në ekonominë pyjore "Staberdë" ngastra 10, vlera e qerases 55,700 leke ne vit, i cili nuk ka paguar per vitin 2021-2022 sepse ka pezulluar aktivitetin me 19.9.2019, miratuar nga institucioni epror sipas shkresës nr. 8176/3/2019.

4. Subjekti "A.L" shpk, me NIPT K.....T me afat 9 vjeçare nga data 01.11.2018-31.10.2027, për dhënie me qira një sipërfaqe 0.24 ha shesh depozitimi dhe 0.45 km rrugë kalimi në ekonominë pyjore "Berishë-Bytyç", ngastra 269, vlera e qerasë 121,350 leke në vit..

5. Subjekti "S.XH", shpk me NIPT L.....P ka kontratë për dhënie me qira të një sipërfaqe 1.2 km rrugë kalimi në ekonominë pyjore "Stroberdë" ngastra 54, 102, 103 dhe ekonominë pyjore "Berishë-Bytyç" ngastra 209, me afat 9 vjeçare nga data 30.04.2017 deri 29.04.2026, vlera e qirasë 52,920 leke në vit.

6. Subjekti "M.F" shpk, me NIPT L.....I kontratë qiraje me objekt dhënie me qira e një sipërfaqe 0.08 ha shesh depozitimi dhe 0.8 km rrugë kalimi në ekonominë pyjore "Zogaj", ngastra 11, me afat 9 vjeçare nga data 12.07.2017 deri 11.07.2026, vlera e qerasë 71,200 leke në vit.

7. Subjekti "B.A" shpk, me NIPT L.....P me objekt dhënie me qira të nje sip. Prej 1000 m2 shesh depozitimi në ekonominë pyjore "Berishë-Bytyç, me afat 9 vjeçare nga data 16.05.2017 deri 15.05.2026, vlera e qerasë 68000 leke në vit. Ka pezulluar aktivitetin ne vitin 2018.

8. Subjekti "A" shpk, me NIPT K.....V me objekt dhënie me qira të një sip. Prej 0.12 ha shesh depozitimi dhe 0.65 km në ekonominë pyjore "Berishë-Bytyç", me afat 9 vjeçare nga data 28.07.2016 deri 27.07.2025, vlera e qerases 75,550 leke në vit.

9. Subjekti "V.M.A" shpk, me NIPT L.....L me objekt dhënie me qira të një sipërfaqe 0.2 shesh depozitimi dhe 0.3 km rrugë kalimi në ekonominë pyjore "Berishë-Bytyç", ngastra 289, me afat 9 vjeçare nga data 12.07.2017 deri 11.07.2026, vlera e qerasë është 98,500, ka **pezulluar aktivitetin ne vitin 2019** miratuar nga organi epror MIE, sipas shkresës nr. 3700, date 21.09.2020

10. Subjekti "M" shpk, me NIPT K.....T me objekt dhënie me qira të një sipërfaqe 0.2 ha shesh depozitimi dhe km rruge kalimi në ekonominë pyjore " Lugina e T'Planit, ngastra 10b. Me afat 9 vjeçare nga data 20.04.2017 deri 19.04.2025., vlera e qerasë 115,000 leke në vit.

11. Subjekti "A.G" shpk, kontrata nr.4333/1 date 22.12.2017 me afat 9 vjecare, nga 30.12.2016 deri me 29.12.2025, por sipas shkreses nr.17 prot., date 07.09.2018 e protokolluar prane bashkisë Tropojë me nr.3616 prot., date 10.9.2018 "*Për pezullimin e aktivitetit minerar në objektin "Lugu i Zanit", Zogaj Tropojë, leja minerare nr.1506 date 14.10.2010*", aktivitetin ky subjekt e ka te **pezulluar**.

Për kontratat e qerasë për subjektet të komunikimit telefonik dhe internetit;

1. Shoqëria “ T.A” sha, me afat 9 vjeçare nga data 20.12.2016 deri 19.12.2025, me objekt dhënie me qira të një sipërfaqe 0.12 ha për vendosje antene dhe 0.09 km për kalim rruge në ekonominë pyjore “Valbonë-Çerem”, vlera 600,000 leke në vit.
 2. Shoqëria “ T.A” sha, me afat 9 vjeçare nga data 18.10.2019 deri 17.10.2028, me objekt dhënie me qira të një sipërfaqe 0.0025 ha për vendosje antene dhe 0.1 km për kalim rruge në ekonominë pyjore “Nj-Mertur 1, vlera 25,000 leke/vit.
 3. Shoqëria “V.A” sha, me afat 5 vjeçare nga data 01.08.2018 deri 31.07.2023, me objekt dhënie me qira të një sipërfaqe 20 m2 për vendosje antene në tarracën e Muzeut Historik të Rrethit , qytetit Bajram Curri, vlera 500,000 leke/vit.
 4. Shoqëria “V.A” sha, me afat 5 vjetarë nga data 15.11.2019 deri 14.11.2024, me objekt dhënie me qira të një sipërfaqe 30 m2 për vendosje antene në ZKe 427 me nr. pasurie 427, vlera 300,000 leke/vit (paguar deri 15.11.2021).
 5. Shoqëria “V.A” sha, me afat 9 vjetarë nga data 31.05.2019 deri 30.05.2024, me objekt dhënie me qira të një sipërfaqe 500 m2 për vendosje antene në LEibaj”Logu i Shkozës”, kontrata nr. 1574 date 16.5.2019, vlera 300,000 leke/vit.
 6. Shoqëria “T.A” sha, me afat 9 vjeçare nga data 20.11.2016 deri 19.11.2025, me objekt dhënie me qira të një sipërfaqe 0.022 ha për vendosje antene dhe 400 ml rrugë kalimi në ekonominë pyjore “Berishë-Bytyç”, vlera 190,000 leke ne vit. *Ka paguar për vitin 2021 deri me date 24.5.2021.*
 7. Shoqëria “AT” sha, me afat 9 vjeçare nga data 24.05.2019 deri 23.05.2028, me objekt dhënie me qira të një sipërfaqe 0.006565 ha për vendosje antene dhe 0.25 km rrugë në ekonominë pyjore “Çerem-Dragobi”, ngastra 65 b vlera 61,270 leke/vit..
 8. Shoqëria “AT” sha, me afat 5 vjeçare nga data 15.04.2018 deri 14.04.2023, me objekt dhënie me qira të një sipërfaqe 0.00612 ha për vendosje antene dhe 0.15 km rrugë në ekonominë pyjore “Nj Mertur 1”, ngastra 38a, vlera qirasë 56,460 leke/vit.
 9. Shoqëria “I.N” shpk, me afat 9 vjeçare nga data 21.06.2017 deri 20.06.2026, me objekt dhënie me qira të një sipërfaqe 0.0042 ha për vendosje antene dhe 0.7 km rrugë në ekonominë pyjore “Berishë-Bytyç”, ngastra 206 b, vlera 58,100 leke/vit.
- Për kontratat e qerasë me subjektet për ndërtim të HEC-ve dhe të tjera, për sipërfaqe të fondit pyjore/kullosor ne pronësi bashkisë.*
1. A.E.E” shpk, me afat 9 vjeçare nga data 24.08.2017 deri me 23.08.2026, me objekt dhënie me qira të një sipërfaqe 1.2286 ha për ndërtim dhe shfrytëzim HEC-I në ekonominë pyjore “Lugina e T’Planit”, vlera 473,495 leke/vit.
 2. Subjekti “SH.A” shpk me afat 10 vjeçare nga data 06.12.2018 deri me 05.12.2028, me objekt dhënie me qira të një sipërfaqe 0.29 ha për ndërtim dhe shfrytëzim HEC-I në ekonominë pyjore “Lugina e Kolgecaje, vlera 151,730 leke/vit. *Nuk ka paguar për vitin 2021 por ka bere kërkesë këto kohe për pezullimin e kontratës se qerasese deri ne momentin e marrjes se lejes ndërtimit dhe momentalisht jemi duke shqyrtuar këtë mundësi.*
 3. Subjekti “B.R” shpk me NIPT K.....E me afat 10 vjeçare nga data 18.12.2018 deri me 17.7.2028, me objekt dhënie me qira të një sipërfaqe 0.59 ha për ndërtim dhe shfrytëzim HEC-I në ekonominë pyjore “Lugina e Tropojës”, vlera 294,925 leke/vit.

4. Subjekti “H.V” shpk me afat 10 vjeçare nga data 18.12.2018 deri me 17.7.2028, me objekt dhënie me qira të një sipërfaqe 0.59 ha për ndërtim dhe shfrytëzim HEC-I në ekonominë pyjore “Lugina e Tropojës”, 965,900 leke/vit.

Nuk ka paguar pasi nuk ka filluar aktivitetin pasi nuk ka marre lejen e ndërtimit dhe këto kohe ka paraqitur një kërkesë pranë Bashkisë Tropoje ku ka kërkuar pezullimin e kontratës së qerases deri ne marrjen e lejes si dhe mundësinë e shlyerjes me këste te detyrimeve te prapambetura qe rrijedhin nga kontrata e qerases, momentalisht jemi duke e shqyrtuar kërkesën e subjektit.

5. Subjekti Personi Fizik P.Gj me afat 10 vjecare nga data 25.06.2018 deri me 24.06.2028, me objekt dhënie me qira të një sipërfaqe 0.7763 ha për Shfrytëzim veprimtari turistike në ekonominë pyjore “Lugina e Kolgecaje”, vlera 34,934 leke/vit.

6. Subjekti person Fizik I.M me afat 10 vjecare nga 4.11.2020-3.11.2030, me objekt dhënie me qera për përdorim sipërfaqe 6 ha për ushtrim aktiviteti “Veprimtari turistike”, e cila është pjesë e fondit pyjorë kullësorë bashkiak, ekonomia pyjore “Lugina e Kolgecaje” shtrihet në ngastrat 15a; 16a, vlera 450,000 leke/vit.

7. Subjekti person Fizik I.M me afat 10 (dhjetë) vjeçar, nga data 24.01.2022 deri në datën 23.01.2032, objekti për përdorim sipërfaqen prej 300 ml (0.3 km) që shtrihet në parcelën pyjore 17a të ekonomisë pyjore “Lugina e Kolgecaje”, për qëllim përdorimin e saj si rrugë kalimi ne funksion te aktivitetit e veprimtarisë turistike objekt i “Kontratës së qirasë për dhënien ne përdorim te fondit pyjor/kullësor, me nr. 3415/7 date 5.11.2022”.,vlera e qirasë vjetore është 15,000 lekë/vit.

8. Subjekti “B.R” shpk me afat 5 vjeçare nga data 2.4.2021 deri me 1.4.2026, me objekt dhënie me qira për përdorim sipërfaqe 0.32 ha ose (0.85 km gjatësi), për shtrirje të tubacionit të HEC-2ER në ekonominë pyjore “Lugina e Tropojës”, vlera e qerasë vjetore për vitin e pare është 159,600 leke/vit, ku pjese e kësaj vlere është përfshire pagesa me vlerën prej 10,000 leke për hartimin e raportit teknik qe paguhet vetëm vitin e pare, dhe vlera për linjat gjatësore qe përben vlerën vjetore është 149,600 leke. Pasqyruar në tabelën nr. 13(**Pasqyra e qirave te subjekteve 2021-2022 si dhe debitoret deri me 31.12.2022**) bashkëlidhur.

Konkluzion Perfundimtar:

Nga auditimi i dokumentacionit te kontratave qirave te asetëve dhe objekteve te bashkisë për vitin 2021-2022, rezulton se:

A. Nuk kane shlyer 3,835,358 leke, detyrimet kontraktore qira asetëve nga 15 subjekte ($a=2,227,077 + 1,608,281 = b$), nga këto:

a. 6 subjekte nuk kane likuiduar vlerën **2,227,077 leke**, për vitin 2021-2022, sipas te dhëna te bashkisë, sa vijon:

1. Sh.A shpk =151,730 leke, detyrim qiraje për vitin 2022,
2. V.A sha =255,000 leke, detyrim qiraje për vitin 2022,
3. A.E.E =473,495 leke, detyrim qiraje për vitin 2022,
4. “H.V” shpk= 1,050,852 leke, detyrim qiraje për vitin 2022,
5. M shpk =115,000 leke, detyrim qiraje për vitin 2021,
6. “L” shpk=181,000 leke, detyrim qiraje për vitin 2021,

b. 9 subjekte nuk kane likuiduar qiranë për=1,608,281 leke, për vitin 2021-2022, sipas auditimit te kryer, sa vijon:

1. I.M =465,000 leke qira (450,000 +15,000) për vitin 2021-2022, për 2 kontratat, përkatësisht: 450,000 leke per vitin 2021 (04.11.2020-04.11.2021) dhe 15,000 lekë per vitin 2022 (24.01.2022-23.01.2023),

2. P.Gj= 34,934 leke qira per vitin 2022 dhe nuk pasqyrohet ne tabelën e arkëtimeve,

3. “B.R” shpk= 294,925 leke qira për vitin 2022,

4. “T.A” sha, =190,000 leke qira për vitin 2022 (ka paguar deri me date 24.5.2021).

5. “B” shpk, =206,800 leke per vitin 2022,

6. B.T =47,422 leke për vitin 2022,

7. “L” shpk, =181,000 leke per vitin 2022, (paguar 2017-2018 vleren 181,000).

8. “S.A”, shpk= 117,000 leke per 2022,

9. “M.I” shpk, =71,200 leke per 2022,

c. disa subjekte kane detyrime te prapambetura para periudhës 2021 te pasqyruara nga sektori i taksave e tarifave vendore qe ndjekin zbatimin e kontratave.

B. Disa dosje te qirave te asetete paraqesin mangësi dokumentare, pasi:

- mungojnë dokumentet bankare te likuidimit qirave,

- mungojnë njoftimet ndaj subjektit për mos-pagesat ne afat,

- mungojnë procedurat ligjore deri ne zgjidhjen e kontratës për subjektet e parregullta,

- mungojnë kamat vonesat,

- mungojnë inventarët për secilën dosje ne vitin 2022, por është mjaftuar me inventarin e dosjeve deri ne vitin 2019 kryer nga juristja B.I, ndërsa pas kësaj periudhe nga 2019 deri 2022 nuk ka vazhduar inventari i dokumenteve nga juristja J.C, konkretisht:

* dosja e subjektit qiramarrës “V.M.A” shpk është mbyllur inventari saj me date 02.12.2019, ndërsa shkresat e mëvonshme e MIE nr. 6770/1 date 14.10.2020 dhe nr. 3700 date 21.09.2020 nuk janë te inventarizuara megjithëse ndodhen ne dosje.

* dosja e subjekteve qiramarrëse me kontrata te lidhura ne vitin 2022 “B.T” , “B.” , “I.M” nuk janë të inventarizuara dhe nuk kane flete inventari me numerizim dokumenteve.

Asete te marra me qira nga bashkia deri 31.12.2022, paraqiten 2 raste, përkatësisht:

1. G.Gj, 54 m2, banese, kontrata 4976 date 30.12.2021, tarifa 6,000 leke/muaj ose 72,000 leke/vit, paguar nr. 47 date 23.02.2022.

2. A sha, 220 m2, zyre, kontrata date 01.01.2022, tarifa 22,000 leke/muaj ose 264,000 leke/vit, paguar me dokumentin nr. 113 date 05.05.2022 dhe nr. 381 date 27.12.2022.

Sa sipër, Veprime ne kundërshtim me kushtet e kontratave respektive, me VKM nr. 391 date 21.06.2006 ndryshuar me VKM nr. 1064 date 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave ne sektorin e pyjeve dhe kullotave”, me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, me VKM nr. 693, datë 05.10.2016 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, me VKB nr. 86 date 24.10.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, me ligjin 9385 date

04.05.2005 “Për pyjet e shërbimin pyjor” ndryshuar me ligjin 9693 date 19.03.2077 “Për fondin kullor” ndryshuar me VKM nr. 433 date 03.06.2016 “ Për transferimin ne pronësi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike sipas inventarit MM...” me ligjin 7850 date 29.07.1994 “Kodi Civil i RSH”, me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Ngarkohet me përgjegjësi juristja e aseteve J.Q dhe sektori i taksa dhe ardhurave vendore, për mos ndjekjen e zbatimit kontratave dhe mos marrjen e gjitha hapave ligjore për arkëtimin e detyrimeve kontraktore ose ndërprerjen e kontratave për subjektet e parregullta.. Nga Kryetari i Bashkisë nuk është raportuar për çdo muaj në Këshillin e Bashkisë me raporte për të ardhurat dhe shpenzimet, por është mjaftuar me raporte 3 mujore, në mospërputhje me nenin 44 ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2018 “Për financat vetëqeverisjes vendore”, citohet:

Neni 44: Pas datës 30 prill të çdo viti buxhetor, Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit, çdo muaj, raport të përmbledhur mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas planit vjetor dhe planit të periudhës. Ky raport përmban të dhënat faktike të regjistruara në vitet e mëparshme për të njëjtët tregues dhe vlerësimin për pritshmërinë për nivelin e realizimit deri në fund të vitit buxhetor. Raporti i dërgohet për informim këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më vonë se data 10 e muajit pasardhës dhe bëhet publik.

Sa sipër, lidhur me buxhetin, ngarkohen me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë R.B, Z.I me detyrë Zv. Kryetar Bashkie, E.D me detyrë përgjegjëse Sektori Buxhet Financë, K.A me detyrë përgjegjës Sektori i Burimeve Njerëzore.

Pretendimi i subjektit:

- *Observacionet e subjektit bën fjale për shpërblimet dhe lejet e zakonshme dhe fyerjen e organikes.*
- *Observacioni i juristes J.C bën fjale për vendimet gjyqësore, lidhur me përgjegjësit se pjese e saj është dhe drejtoria ekonomike etj.*
- *Observacioni i F.D lidhur me takat vendore,*
- *Observacioni i kryetares KB Sh.B bën fjale për miratimin e vendimeve te KB pa plotësuar kufirin ligjor.*
- *Observacionet e subjektit qe bëjnë fjale për fyerjen e organikes,*

Qëndrimi i grupit auditimit:

- *Observacionet e subjektit bën fjale për shpërblimet dhe lejet e zakonshme merren parasysh pjesërisht, pasi disa jane jane zjarrfikës qe u takon shpërblim 20,000 leke/secili, disa nuk kane shprese arketimi dhe disa jane larguar ne pension, sipas ballafaqimit ne KLSH .*
- *Observacioni i juristes J.C bën fjale për vendimet gjyqësore, lidhur me përgjegjësit se pjese e saj është dhe drejtoria ekonomike etj eshte sqaruar njehere ne projektvendim.*
- *Observacioni i F.D lidhur me takat vendore, merret parasysh dhe do te reflektohet tek rekomandimet.*

- *Observacioni i kryetares KB Sh.B bën fjale për miratimin e vendimeve të KB pa plotësuar kufirin ligjor, merret parasysh pjesërisht dhe është reflektuar tek projektraporti dhe i takon së ardhmes permiresimi i mangësive të konstatuara.*
- *Observacionet e subjektit që bëjnë fjale për fyerjen e organikes qëndron pjesërisht për kopshtet dhe merret parasysh, të tjerat janë objekt i planifikimi të numrit punonjësve dhe buxhetit për vitin 2024.*

Titulli i gjetjeve: Nga auditimi i buxhetit, organikes, shpenzimeve, faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, debitorët e taksave vendore, qiratë për asetet etj, u konstatua se:

Situata:

- Ne 7 raste, vendimet e KB nuk janë marre me shumicën e votave të anëtareve, pasi kanë votuar dhe nënshkruar nën 50 % të tyre, nën 3/5 e 21 anëtareve, në kundërshtim me nenin 48/4 dhe nenin 17/3 të ligjit nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Në disa raste u konstatuan fyerje të organikes në raport me ngarkesën e punës, pasi nuk justifikohet puna e tyre me dokumente dhe programe pune, për efekt të uljes shpenzimeve dhe rritjes aftësisë paguese si dhe dalja nga vështirësia financiare.
- Në 9 raste, specialistet e gjendjes civile nuk janë emëruar dhe paguar si “përgjegjës”, në zbatim të VKM nr. 1299 date 16.12.2009, pasqyra 2..
- Zëri i ndihmës ekonomike dhe paaftësisë zënë peshën kryesore për 386 milion lekë ndaj shpenzimeve gjithsejtë 825 milion leke ose 47 % për vitin 2022, çka kanë munguar politikatat sociale për të zbutur papunësinë.
- Normat mujore të karburantit janë të larta për disa automjete të renda, pasi ato janë të vjetra mbi 30 vjet dhe kanë mbushur kuotën e plotë amortizimit sipas normave të amortizimit.
- Faturat e pa likuiduara të prapambetura paraqiten në nivel të lartë prej 86 milion leke, çka do të rëndojë në fondet e viteve në vazhdim krahas likuidimeve të radhës të vitit ushtrimor.
- Vendimet gjyqësore paraqiten për vlerën 3,7 milion leke dhe vendimet gjyqësore të fituara nga ish-punonjësit për largime nga puna për vlerën 935,000 lekë, çka ka shkaktuar dublim pagese për të njëjtin vend pune dhe ka dhënë ndikim negativ në buxhetin e bashkisë, për të cilën të dalë përgjegjësia dhe nuk ka masa administrative, në zbatim të kërkesave ligjore.
- Debitorët progresiv të taksave e tarifave vendore të krijuara deri më 31.12.2022, paraqiten në vlerën 31,787,531 lekë.
- Detyrimet kontraktore të qirave të aseteve paraqiten problematike për vlerën 3,835,358 leke nga 15 subjektet. Dosjet e qirave kanë mungesa dokumentare dhe nuk janë inventarizuar, në zbatim të kërkesave ligjore.

Kriteri:

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ndryshuar, të ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, të UMF nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afat mesëm vendor 2023-2025”, UMF nr. 23, datë 30.07.2018, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, VKM nr. 1064 date 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, me VKM nr. 54, datë

05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, me VKM nr. 693, datë 05.10.2016 “, VKB nr. 86 date 24.10.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, me ligjin 7850 date 29.07.1994 “Kodi Civil i RSH”, me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, UMF 5 datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, me Udhëzimin plotësues, pikat 82-91 “Detyrimet prapambetura Njësive Vetëqeverisjes Vendore”.

Efekti: Ndikim negativ në rritjen e shpenzimeve, dhe në rritjen e borxhit progresiv (fatura pa likuiduara, vendime gjyqësore dhe debitorë të tjerë, çka kanë krijuar vështirësi financiare të bashkisë Tropoje, pasi ato zënë mbi 25 % të shpenzimeve vjetore gjithsej, sipas nenit 56 të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Shkaku: Neglizhenca, mungesa e përvojës dhe mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit ligjor.

Rendesia: E Mesme.

Rekomandim: Këshilli Bashkiak Tropojë të marrë masa që në çdo rast votimi i vendimeve të bëhet me shumicë votash, në zbatim të kërkesave ligjore, me qëllim që vendimi kolegjial të ketë zbatueshmëri, në interes të komunitetit, brenda juridiksionit që mbulon.

Rekomandim: Bashkia Tropojë të marrë masa:

- Për të vendosur një raport të drejtë midis numrit të punësuarve me ngarkesën e punës, sipas drejtorive, sektorëve përkatës, me qëllim arritjen e objektivave dhe kryerjen e shërbimeve ndaj qytetarëve.

- Krijimin e kushteve për nxitjen e punësimit dhe përmirësimin e politikave sociale me qëllim zbutjen e papunësinë.

- Të rishikojë emërtesën dhe pagesën për 9 specialistë të gjendjes civile, të cilët nuk janë emëruar dhe paguar si “përgjegjës”, sipas përcaktimeve ligjore.

Rekomandim: Bashkia Tropoje të marrë masa për kontrollin e gjendjes teknike të disa mjeteve të renda nëse janë rentabël ose jo, pasi paraqesin jetëgjatësi mbi 30 vjet dhe kanë mbushur kuoten e plotë të amortizimit sipas normave të amortizimit, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 8841, date 11.12.2001 dhe VKM nr. 401, datë 23.10.1989 “Për normat e amortizimit”, për efekt të shmangies shpenzimeve të larta karburantit dhe pjeseve këmbimit, konkretisht:

1. Autobot benx 47 vjeçar viti i prodhimit 1976.
2. Kamioni benx 40 vjeçar, viti i prodhimit 1983.
3. Kamion benx 37 vjeçar, viti i prodhimit 1986.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve pa likuiduara të prapambetura prej 86 milion leke, duke normalizuar situatën në drejtim të rishikimit buxhetit, rritjes taksimit, ulje shpenzimeve, rishikimit të organikes, përdorimin e fondit veçante, etj. Gjithashtu të likuidojnë vendimet gjyqësore për vlerën 3,7 milion leke dhe vendimet gjyqësore të fituara nga ish-punonjësit për largime nga puna për vlerën 935,000 lekë dhe të arkëtoje vlerën 31,787,531 lekë, nga debitorë progresivë, të taksave e tarifave vendore të krijuara deri më 31.12.2022, si dhe të analizojë duke nxjerrë përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës.

2.3- Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

Përmbledhje e konstatimeve:

Bilanci 2022.

-Nuk janë mbajtur partitarët analitik.

-Nuk është mbajtur libri i madh apo centralizatori.

-Nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për sistemimet e llogarive.

Nga verifikimi i disa llogarive të aktivitetit të bilancit 2022, rezultoi se:

- **Ilog. 215 mjete transporti** paraqet mungesa 3,4 milion dhe **Ilog. 218 orendi zyrash** paraqet mungesa 0,06 milion, cituar tek sqarime rreth bilancit 2022 si diferenca moskuadrimi.

- **Ilogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”**, përfaqëson shumën e drejtave arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2021 paraqitet 42,876,907 lekë, ndërsa gjatë vitit 2022 është rritur dhe në mbyllje të 2022 pasqyrohet 44,710,681 leke. Ndikim kanë pasur rritja e debitorëve të taksave dhe qirave të aseteve si dhe detyrimet e lëna nga KLSH dhe detyrime tjera të prapambetura, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet, në kundërshtim me ligjin 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi Procedurave Administrative në RSH” nenet 98 dhe 102, ligjin 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21 dhe 33 dhe UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve njësitë sektorit publik”, pika 93.

Banka 2022.

Shpenzime ndihma menjëhershme (vështirësi ekonomike dhe arsye shëndetësore).

1. Ne 8 raste, janë dhënë ndihma të menjëhershme nga fondi rezerve, për vështirësi ekonomike dhe arsye shëndetësore, me nga 10,000 deri 100,000 secili, nën mungesën e dokumentacionit justifikues (*diagnoza, raporti mjekësor, vërtetim për të ardhurat bujqësore-blegtorale, vërtetim nëse trajtohen me ndihme ekonomike, vërtetim që nuk janë të punësuar në shtet dhe në privat, vërtetim ose kërkesë nga kryeplaku i fshatit ose administratori i lagjes qytetit etj*), në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Shpenzime prapambetura: (punonjës larguar, leje vjetore, vjetërsi pune, fatura, kamat).

2. Ne 1 rast, bashkia Tropoje ka paguar vlerën **603,872 leke** për **6 ish-punonjës** të saj të larguar në vitin 2015, për pushime vjetore të pakryera dhe vjetërsi në pune, sipas urdhër shpenzimit nr. 352 datë 01.04.2022. PAGESA është kryer pa asnjë baze ligjore pas 7 viteve me pare dhe duke renduar padrejtësisht fondet e vitit ushtrimor 2022, në vend që të ishin zgjidhur në periudhën e largimit tyre ose të ishin objekt ankimi në gjykatë.

3. Ne 1 rast, bashkia Tropoje ka likuiduar OSHE për vlerën **65,233 leke kamat vonesa për energjinë** elektrike për periudhën **janar- mars 2022**, sipas urdhër shpenzimeve nr. 104, 104, 105 datë 15.04.2022. Gjithashtu para kësaj periudhe nga viti 2010 deri 2021 disponohen fatura të OSHE ku pasqyrohet vlera totale 21 milion leke kamat vonesa të pa likuiduara, çka do të

ndikojë në dem të buxhetit të bashkisë në të ardhmen, si rezultat i mos likuidimit të faturave të energjisë elektrike në kohën e duhur.

Shpenzime për vendime gjyqësore

4. Në 3 raste, paraqiten vonesa të pajustificuara në likuidimin e vendimeve gjyqësore të formës prere, nga bashkia Tropoje. Për vitin 2022 vendimet gjyqësore paraqiten për vlerën 3,7 milion leke, me efekt negativ në buxhet. Nga titullari i bashkisë nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative, në kundërshtim me kërkesat e pikës 62 të udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, me ndryshime.

-Bashkia Tropoje në 1 rast nëpërmjet zyrës juridike ka **apeluar vendimet e shkallës së parë, por pa dale vendimi i formës prere ka vazhduar likuidimi**, çka e bën të pavlere apelimin.

Shpenzime për blerje me vlera të vogla.

5. Në 1 rast u konstatuan shkelje në procedurat e prokurimit me vlera vogla për vitin 2022, në kundërshtim me VKM 47 datë 23.01.2013 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike” të ndryshuar, me Udhëzimin 2 datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera vogla”, ndryshuar me udhëzimin 5 datë 16.07.2013.

Shpenzime për pagesën e lejeve zakonshme.

Pritje-përcjellje.

6. Bashkia Tropoje për vitin 2022 ka kryer **960,000 leke shpenzime të paligjshme**, sipas urdhër shpenzimit nr. 234 datë 16.08.2022 dhe nr. 315 datë 10.11.2022, për **pritje-përcjellje (dreka)** me pjesëmarrjen e personave vendas, në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999.

Shpenzime për TVSH.

7. Në 4 raste, u konstatua vlera **560,600 leke, likuidim 2 here TVSH**, pasi vlera në situacionin, zëri “Pajisje elektrike e hidraulike” subjekti i ka llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh dhe vihet në fund të situacionit, për rrjedhojë TVSH është përfituar 2-herë nga subjektet.

Shpenzime për qira banese

8. Bashkia Tropoje ka marrë Ait sha ambiente me **qira** me sipërfaqe 220 m² për vlerën 20,000 leke në muaj, sipas kontratës datë 11.02.2022 me afat 2 vjeçar, rezulton se ka **likuiduar tepër vlerën 26,000 leke**, për periudhën Janar – Qershor 2022, konkretisht::

a. Bashkia ka likuiduar me tepër diferencën 6000 leke për 3 muaj ose tepër 2000 leke/muaj, në kundërshtim me kushtet e nenit 2 të kontratës datë 11.02.2022.

b. Bashkia ka likuiduar padrejtësisht edhe muajin janar 2022 për vlerën 20,000 leke, pasi kontrata datë 11.02.2022, nenit 12/12.1 nuk ka fuqi prapavepruese.

Shpenzime me mangësi në dokumentacion

9. Bashkia Tropoje ka kryer likuidim sipas urdhër shpenzimeve nr. 69, datë 24.03.2022 dhe nr. 76 datë 29.03.2022, për **rikonstruksionin kompleksit sportiv lojërave me dore**, rezulton se **nuk disponohen dokumentet baze dhe justifikuese si:** fatura, situacione, fotografimi para dhe pas

meremetimit të objektit për efekt të justifikimit të shpenzimit, pasi objekti është rikonstruktuar edhe me pare (2012). Ndryshe është vepruar me riparimin e urës drurit “Beli” LEibaj sipas urdhër shpenzimit nr. 74, datë 29.03.2022, ku disponohen dokumente foto para dhe pas rregullimit të objektit. Pra me 2 standarde. Veprime ne kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

10. Bashkia Tropoje **ne 4 raste** ka kryer likuidime, sipas urdhër shpenzimeve nr. 367, datë 22.12.2022, nr. 210 datë 02.08.2022 dhe nr. 236 datë 23.08.2022, nr. 262 datë 28.09.2022, për **shërbim makinave bashkisë**, për blerje goma dhe bateri dhe pjese këmbimi, për automjetet e sa, rezulton se:

- **ne asnjë dokument nuk citohet identiteti i makinës, nuk ka procesverbal nga specialisti i fushës** për dëmtimin dhe nevojën e zëvendësimit të këtyre pjesëve këmbimit apo gomave,
- **nuk ka procesverbal për marrjen ne dorëzim** të pjesëve këmbimit dhe gomave.
- **nuk disponohet fletëhyrje për pjesët e këmbimit, ndryshe nga rasti tjetër** për blerjen e vajrave lubrifikante, ujë antifrizë, alkool ku janë administruar sipas hyrjes nr. 11 date 8.03.2022 dhe proces verbalit marrjes ne dorëzim komisionit blerjeve date 08.03.2022, sipas urdhër shpenzimit nr. 370, datë 23.12.2022, pra **komisioni ka vepruar me 2 standarde.**
- **nuk disponohet fletëhyrje rikupel e gomave, pjesëve këmbimit të vjetra** dhe baterive të skaduar, në kundërshtim me nenin 13 pika c të ligjit 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Inventarizimi i pasurise.

11. Për vitin 2022 për inventarizimin e institucionit Bashkia Tropoje, njësisive administrative, shkollave, kopshteve, qendrës kulturore, nga auditimi rezultuan edhe mangësi, sa vijon:

a. Nuk përcaktohet numëri rendor i fletëhyrjes dhe fletëdaljes ne procesverbalet e komisionit para fillimit të inventarizimit (nuk ka procesverbal), po kështu nuk përcaktohet fletëhyrja dhe fletëdalja e fundit, në kundërshtim me pikën 83 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

b. mungon pasqyra përmbledhje e inventarizimit të mjeteve transportit, për numrin dhe vlerën kontabël e fizike të tyre, siç është kryer tek zëri “rruge, rrjete e vepra ujore”.

c. nuk janë nënshkruar nga përgjegjësi material flet inventarizimi i njësisë Fierze për zyrën e këshillit, veprim në kundërshtim me pikën 82 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

d. Në përfundim të inventarizimit komisioni nuk ka bërë relacion dhe miratim në Këshillin Bashkiak, sipas kërkesave të pikës 87,88,89,90,91 dhe 92 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

e. Nuk është kryer inventarizimi fizik i pasurisë për vitin 2022, përkatësisht: për shkollën e mesme, shkollën 9-vjeçare, konviktin çerdhen, dekorin, në kundërshtim me pikën 81,82, 83, 84, 85, 86,87,88,89 dhe 90 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Nxjerrjet jashte perdorimit.

12. Komisioni për vlerësimin e materialeve për nxjerrjet jashtë përdorimit në punën e tij paraqet këto mangësi dhe shkelje:

a. nuk disponon procesverbalin e specialistit fushës (ing. Elektronik) që verteton humbjen e vlerës përdorimit të paisjeve dhe aparaturave elektronike si: kompjutra, printera, laptop, kompjuter fotografik, veprime në kundërshtim me pikën 95 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

b. nuk ka pasqyruar vitin e blerjes ose prodhimit të aparaturave elektronike , për të saktësuar amortizimin e plotë sipas tarifave ligjore. Mungesa e përcaktimit të vitit blerjes shmang afatin e amortizimit dhe krijon shteg për nxjerrje jashtëpërdorimi të tyre para kohe dhe në gjendje pune. Amortizimi si element costojë nuk i sos paisjet kompjuterike, pasi mund të jenë funksionale nga riparimet e tyre. Veprime në kundërshtim me pikën 95 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Për vitin 2022 për asgjësimin e materialeve jashtë përdorimit, komisioni ka nxjerre jashte përdorimit materialet në qender, njësi administrative, shkolla, kopshte e cerdhe etj per vleren 1,497,752 leke, sipas procesverbalit të asgjësimit date 17.03.2023. Komisioni i nxjerrës dhe asgjësimit të materialeve jashte përdorimit paraqet këto mangësi dhe shkelje:

a. nuk përcaktohet vendi i asgjësimit dhe mënyra e asgjësimit të materialeve, sipas llojit të tyre në procesverbalin e asgjësimit date 17.03.2023, por është mjaftuar me kopjen e procesverbalit të vlerësimit të materialeve.

b. nuk disponohet fletëdalja për materialet e pajisjet e asgjësuarat në vlerën 1,497,762 leke, për efekt të shkarkimit nga magazina dhe kontabiliteti. Sqarohet se: shkarkimi në kontabilitet është kryer ekstra/kontabel për vlerën 1,497,762 tek zëri inventar ekonomik, sipas formatit 7/a tek kolona paketimet (asgjësime) të bilancit 2022.

Veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Më hollësisht sipas nëndarjeve të pikave të programit, trajtohen si më poshtë:

2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:

Për vitin 2022 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Tropojë” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Tropojë si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

**Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.*

Bashkia Tropojë për vitin 2022 ka hartuar Pasqyrat Financiare vetëm njësinë shpenzuese Bashkia Tropojë pasi nuk ka në varësi njësi të tjera shpenzuese.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Tropojë për vitin ushtrimor 2022 me shkresë përcjellëse nr. 1823 datë 31.03.2023

konfirmuar nga dega e thesarit Tropojë me datë 23.05.2023. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari Bashkisë Tropojë dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori i Financës. *Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.*

Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (*dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj*) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (*çeljet*) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

Regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me: mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara për vlefshmërinë për t'u pranuar në kontabilitet (*vlerësimi kontabël*); mos ndryshueshmëria e regjistrimeve të kryera dhe e mbartësve të tyre; tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet: shqyrtimit vlefshmërisë regjistrimit fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues; kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur; verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (*barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive*) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë.

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se: Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues. Kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”. Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin. Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj.

Nuk janë mbajtur partitarët analitik.

Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël.

Nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël.

Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues ne pergjithesi është bërë i plotë, pasi përshkruajnë me vertetesi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhenat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës.

Janë mbartur saktë tepricat e llogarive 2021 në celjen vti paraardhës për bilancin vitin 2022 dhe rakordojnë.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022 rezulton se,

Llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e Pasqyrave Financiare, (pasqyruar në tabelen nr. 14, bashkëlidhur).

Nga verifikimi i disa llogarive të aktivitetit të bilancit 2022, rezultoi se:

1. Financa e bashkisë ka cituar tek sqarime rreth bilancit 2022 diferenca mos kuadrimit në 2 llog, konkretisht:

-llog. 215 *mjete transporti*, mungesa prej 3,4 milion.

- llog 218 *orendi zyresh*, mungese 0,06 milion.

2. llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 42,876,907 lekë, ndërsa gjate vitit 2022 është rritur dhe në mbyllje të 2022 pasqyrohet 44,710,681 leke.

Ndikim kane pasur rritja e debitorëve të taksave dhe qirave të aseteve si dhe detyrimet e lëna nga KLSH dhe detyrime tjera të prapambetura, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet, në kundërshtim me ligjin 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98 dhe 102, ligjin 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21 dhe 33 dhe UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve njësitë sektorit publik”, pika 93.

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr. 2 “Pasqyra e përformancës financiare” të PF të vitit 2022 paraqitet (pasqyruar në tabelen nr. 15, bashkëlidhur).

Sa sipër, shpenzimet janë pasqyruar sakte tek pasqyra shpjeguese për raportimin e PF vjetore 2022.

Numri i punonjësve dhe fondi i pagave, ne leke.

Tabela nr. 16

KATEGORIT	Nr. pun	Te rinj	Larguar	Gjend.Fund	Fondi pagave gjithes	Kontrib. sig.shoq. shend	Tatim mbi ardhurat
b	1	2	3	4	5	8	10
Nr. pun. gjithes	383			361	194,110,484	30,455,169	6,429,057
(1+2+3+4+5)							
Drejtues	16			16	13,474,236	5,436,084	1,049,652
Spec.larte	142	10	11	141	88,797,828	14,829,216	4,906,632
Teknike	10	3	4	9	2,822,880	471,432	28,824
Nep thjeshte	167	28	28	167	70,384,116	7,301,424	372,900
Punetore	28	5	5	28	16,832,220	2,417,013	71,049
Punon perkoh	20	20	20	0	1,799,204		

Pasqyra e lëvizjes fondit pagave rekordon me pasqyrën e shpenzimeve për paga dhe kontribute sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për 2022.

2.3.3. Rregullshmëria e veprimeve te kryere nëpërmjet bankës dhe arkës.

BANKA 2022.

Auditimi mbi veprimet e bankës kryhet për vitin 2022, bazuar në programin e auditimit, rezultoi: Veprimet e bankës janë kontabilizuar, azhurnuar periodikisht në ditarin përkatës. Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si: urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Likuidimet në përgjithësi janë të shoqëruara me dokumentacion justifikues. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. Llogaritë janë në pozicionin e duhur në përputhje me kërkesat ligjore, sipas kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin” ndryshuar me ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar dhe me Udhëzimet Ministrisë Financave. Nga auditimi i veprimeve me bankën për vitin 2022 **u konstatuan disa mangësi dhe shkelje ligjore me efekte financiare 2,131,555 leke**, konkretisht:

Shpenzime ndihma menjëhershme (vështirësi ekonomike dhe arsye shëndetësore).

1. Ne 8 raste, u konstatua se janë dhëne ndihma te menjëhershme nga fondi rezerve i planifikuar, për vështirësi ekonomike dhe arsye shëndetësore, nën **mungesën e dokumentacionit justifikues** (diagnoza, raporti mjekësor, vërtetim për te ardhurat bujqësore-blegtorale, vërtetim nëse trajtohen me ndihme ekonomike, vërtetim që nuk janë të punësuar në shtet dhe në privat, vërtetim ose kerkese nga kryeplaku i fshatit ose administratori i lagjes qytetit etj), në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, konkretisht:

- Sipas urdhër shpenzimit nr. 11 datë 24.01.2022 është likuiduar vlera 295,000 lekë për 5 persona (nga 15,000 deri 100,000 secili), me objekt dhënie ndihme te menjëhershme për vështirësi ekonomike dhe arsye shëndetësore.

- Sipas urdhër shpenzimit nr. 12 datë 24.01.2022 është likuiduar vlera 285,000 lekë për 13 persona (nga 10,000 deri 100,000), me objekt dhënie ndihme te menjëhershme për vështirësi ekonomike dhe arsye shëndetësore.

- Sipas urdhër shpenzimit nr. 24 datë 04.02.2022 është likuiduar vlera 70,000 lekë për 4 persona (nga 10,000 deri 30,000), me objekt dhënie ndihme te menjëhershme për vështirësi ekonomike dhe arsye shëndetësore.

- Sipas urdhër shpenzimit nr. 43 dhe nr. 44 datë 16.02.2022 është likuiduar vlera 85,000 lekë dhe 20,000 leke për 6 persona (nga 15,000 deri 30,000), me objekt dhënie ndihme te menjëhershme për vështirësi ekonomike dhe arsye shëndetësore.

- Sipas urdhër shpenzimit nr. 71 datë 24.03.2022 është likuiduar vlera 400,200 lekë për 22 persona gjithsejtë (nga 15,000 deri 110,000), me objekt dhënie ndihme te menjëhershme për vështirësi ekonomike dhe arsye shëndetësore.

- Sipas urdhër shpenzimit nr. 253 datë 14.09.2022 është likuiduar vlera 320,000 lekë për 5 persona gjithsejtë (4 veta nga 30,000 deri 200,000 1 rast), me objekt dhënie ndihme te menjëhershme për vështirësi ekonomike dhe arsye shëndetësore.

- Sipas urdhër shpenzimit nr. 288 datë 25.10.2022 është likuiduar vlera 40,000 lekë për 5 persona gjithsejtë (nga 20,000 deri 40,000), me objekt dhënie ndihme te menjëhershme për vështirësi ekonomike dhe arsye shëndetësore.

- Sipas urdhër shpenzimit nr. 289 datë 25.10.2022 është likuiduar vlera 100,000 lekë për 5 persona gjithsejtë (nga 10,000 deri 50,000), me objekt dhënie ndihme te menjëhershme për vështirësi ekonomike dhe arsye shëndetësore.

Theksojmë se disponohet Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 108 date 13.12.2021, nr. 114 date 24.12.2021, nr. 27 date 28.02.2022 “ Për miratimin e ndihmës financiare..” si dhe VKB nr. 167 date 24.12.2020 dhe nr. 111 date 24.12 2021“Për miratimin e buxhetit 2021 dhe 2022”.

Shpenzime prapambetura: (punonjës larguar, leje vjetore, vjetërsi pune, fatura, kamat vonesa).

1. Ne 1 rast, bashkia Tropoje ka paguar vlerën **519,722 leke** për **5 ish-punonjës** te saj te larguar ne vitin 2015, për pushime vjetore te pakryera dhe vjetërsi ne pune, sipas urdhër shpenzimit nr. 352 datë 01.04.2022. Pagesa është kryer pa asnjë baze ligjore pas 7 viteve me pare dhe duke

renduar padrejtesisht fondet e vitit ushtrimor 2022, ne vend qe te ishin zgjidhur ne periudhen e largimit tyre ose te ishin objekt ankimi ne gjykate.

1. M.S 105,400 leke, vendim i kryetarit bashkisë nr. 115 date 05.09.2016.
2. K.R 117,300 leke, vendim i kryetarit bashkisë nr. 36 date 08.03.2017.
3. J.J 61,478 leke, mungon vendim i kryetarit bashkisë për largim nga puna.
4. A.H 56,657 leke, mungon vendim i kryetarit bashkisë për largim nga puna.
5. A.G 178,888 leke, mungon vendimi i kryetarit bashkisë për largim nga puna.

Ngarkohen me përgjegjësi ish-kryetari i Bashkisë B.D për largimin e 6 punonjësve pa ju likuiduar detyrimet financiare qe u takojnë dhe kryetarin aktual z. R.B si dhe përgjegjësen e financës E.D, për pagesën e prapambetur prej 6 - 7 vitesh pa baze ligjore ne dem te fondeve te vitit ushtrimor 2022.

2. Ne 1 rast, bashkia Tropoje ka likuiduar 3 vjet me vonese vlerën 179,040 leke, sipas urdhër shpenzimit nr. 101 datë 11.04.2022, për riparimin e fadromes bashkisë te kryer ne vitin 2019 me faturën nr. 6 date 08.04.2019, ne vend qe te likuidohej brenda vitit 2019.

3. Ne 1 rast, bashkia Tropoje ka likuiduar OSHE për vlerën **65,233 leke kamat vonesa për energjinë** elektrike për periudhën **janar- mars 2022**, sipas urdhër shpenzimeve nr. 104, 104, 105 datë 15.04.2022.

Gjithashtu para kësaj periudhe nga viti 2010 deri 2021 disponohen fatura te OSHE ku pasqyrohet vlera totale 21 milion leke kamat vonesa te pa likuiduara, çka do te ndikojte ne dem te buxhetit te bashkisë ne te ardhmen, si rezultat i mos likuidimit te faturave te energjisë elektrike ne kohen e duhur, çka bën përgjegjës punonjësit e financës bashkisë sipas periudhave përkatëse.

Shpenzime për vendime gjyqësore

1. Ne 1 rast, paraqiten vonesa prej 10 vite te pajustificuara ne likuidimin e vendimeve gjyqësore te formës prere, konkretisht:

-Sipas urdhër shpenzimit nr. 45 dhe datë 17.02.2022 Bashkia Tropoje ka likuiduar vlerën 1,500,000 lekë detyrime për 1 vendim gjyqësor të formës prere nr. 214 date 25.11.2013 fituar nga subjekti “K” shpk me përfaqësues ligjor H.I, për detyrime te prapambetura te vitit 2010 te ish-komunës Tropoje, duke dhënë vlerën **1,500,000 lekë ndikim negativ në buxhetin e bashkisë** për vitin 2022, për të cilën nuk ka dalë përgjegjësia ndaj personave fajtor dhe nuk ka masa administrative, për vonesën 10 vjeçare te moszbatimit te këtij vendimi.

Detyrimi bën fjale për projektin e rrugës Sopot-Kernaje sipas kontratës 12.10.2010 ndaj ish-komunës Tropoje e cila nuk ka kryer likuidimin deri ne vitin 2015 me shkrirjen e tyre, ndërsa bashkia ka zgjatur edhe 7 vjet tjera likuidimin e detyrimit gjyqësor, **pa shpjeguar arsyet** ne një kohe qe likuidimi i detyrimeve te prapambetura ka qene parësore.

Veprime në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne R.SH”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, neni 40 (4)- “e drejta për të kryer shpenzime”.

-UMF nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.

-Udhëzimin plotësues të MF nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.

-UMF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

2. Ne 1 rast, Bashkia Tropoje ka likuiduar 1 vendim gjyqësor nr. 104 date 21.09.2020 të fituar nga ish-punonjësi i saj ne njësinë administrative Fierze R.D, për **largim nga puna** sipas urdhrit kryetarit bashkisë 472 date 10.02.2022, çka ka **shkaktuar dublim pagese** për të njëjtin vend pune dhe ka dhënë **ndikim negativ në buxhetin e bashkisë për vlerën 831,286 leke** nga kjo likuiduar 331,286 lekë, sipas urdhër shpenzimit nr. 68 datë 16.03.2022.

Bashkia Tropoje ka apeluar vendimin e shkallës së parë me shkresën nr. 2361/8 date 28.10.2020, por mungon vendimi Apelit i formës prere, ndërsa bashkia ka vazhduar likuidimin sipas urdhër shpenzimit nr. 68 datë 16.03.2022, madje ka bere edhe aktmarrëveshjen date 27.05.2021 me subjektin, pra bie kërkesa e bere ne apel. Gjithashtu dhe nuk ka dalë përgjegjësia ndaj personave fajtor dhe nuk ka masa administrative. Veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e buxhetit” pika 6.1 ”Vendimet gjyqësore” dhe pika 62 e UMF nr. 2 datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” dhe ngarkon me përgjegjësi ish-kryetarin e Bashkisë B.D dhe kryetarin aktual z. R.B.

Shpenzime për blerje me vlera te vogla.

Për vitin 2022 procedurat e prokurimit te blerjeve vogla ne përgjithësi janë ne përputhje me dispozitat ligjore. Është ngritur komisioni i blerjeve te vogla qe do te operojnë gjatë vitit kalendarik 2022, me Urdhrin e Kryetarit te Bashkisë dhe është pajisur me llogari përdoruesi personi i autorizuar i sistemit elektronik. Janë kryer blerje me procedurën e prokurimit elektronik ne në bazë të Vendimit nr. 47 date 23.01.2013 te Këshillit te Ministrave “Për kryerjen e procedurave te prokurimit publik ne mënyrë elektronike” të ndryshuar, Udhëzimin nr. 2 date 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera te vogla”, ndryshuar me udhëzimin nr. 5 date 16.07.2013. Procedurat janë kryer konform Urdhrit te Ministrit te Financave nr. 92 date 29.12.2011 “Për gjurmët standarte te auditit per prokurimet me vlere te vogël dhe te larte,” dhe me Urdhrin nr. 33 date 11.07.2013 “Për gjurmët standarde te auditit për prokurimet me vlere te vogël dhe te larte.”

Dokumentacioni i bashkëlidhur urdhrave të shpenzimit të bankës për blerjet me vlera të vogla përbëhej nga: kërkesa për blerjen e mallit ose kryerjen e shërbimit nga Drejtoritë përkatëse të miratuar nga NA (nëpunësi autorizues), urdhër Prokurimi nga Titullari i entit kontraktor, ftesa për ofertë me mallin apo shërbimin me specifikimet teknike, procesverbali i vlerësimit të ofertës i firmosur nga KVO, faqja e APP me vlerësimin përfundimtar dhe listën e ofertave, -fletë-hyrja dhe fatura e operatorit ekonomik, oferta fituese, formulari i çmimit të ofertës për të gjithë ofertuesit dhe deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike.

Është përcaktuar fondi limit në bazë të testimit të tregut. Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, ka hartuar Urdhër Prokurimin sipas formatit standart te përcaktuar ne Udhëzimin APP

nr. 2 date 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” i cili është miratuar nga Nëpunësi Autorizues. Ftesa për oferte është publikuar në sistemin elektronik të prokurimeve nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla (KPVV), duke ftuar të paktën 3 ofertues. Ofertuesit kanë paraqitur ofertën e tyre brenda 24 orëve nga shpallja e saj. KPVV ka bërë vlerësimet në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), sipas çmimit më të ulët dhe kanë kryer blerjen e mallit. Hapat e procesit janë formalizuar në formë narrative në procesverbalin e mbajtur nga KPVV, si dhe njoftimi i fituesit është gjeneruar nga SPE. KPVV ka hartuar procesverbalin përfundimtar pasi ka marrë në dorëzim faturën dhe mallin, i cili është bërë hyrje. **Nga auditimi i dokumentacionit për blerjet e vogla në 2022**, rezultoi se:

Karburanti.

1. Sipas urdhër shpenzimit nr. 48 dhe datë 23.02.2022 Bashkia Tropoje ka likuiduar “K”shpk vlerën 1,003,200 lekë, për blerjen e 5500 litra **karburant** me çmimin 182 leke për nevoja të bashkisë, sipas fletëhyrjes 39 date 20.12.2021. Disponohet urdhri i titullarit nr. 286 date 18.11.2021, për krijimin e komisionit për blerjet e vogla, bazuar në ligjin nr. 9643 date 20.11.2006 ndryshuar me ligjin 162/2020 “për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i përbërë nga A.H kryetare, M.V dhe P.R anëtare. Është llogaritur e krijuar fondi limit 1,000,000 leke pa TVSH (1,200,000 leke me TVSH). Urdhër prokurimi nr. 290 date 22.11.2021 i nënshkruar nga z. A.K. Ftesa për oferte date 23.11.2021, ku është paraqitur me 24.11.2021 vetëm operatori ekonomik K shpk fitues, i cili ka afuar vlerën 836,000 leke ose 152 leke/litri, sipas kontratës 26.11.2021.

- **komisioni ka pranuar nga operatori ekonomik K shpk dokument të pjesshëm dhe të pavlefshëm**, vërtetimi 7319 date 17.6.2021 i drejtorisë taksave Durrës flet për shlyerjen taksave vendore 5 muaj para tenderit, në vend shlyerjes deri në periudhën tenderimit.

Ndryshe ka ndodhur për shlyerjen e energjisë elektrike, e cila është likuiduar deri në periudhën e tenderimit, sipas vërtetimit të OSHE nr. 9830/1 date 12.11.2021.

Ndryshe ka ndodhur për shlyerjen e tatimit fitimit, detyrim i cili është likuiduar deri në periudhën tenderimit 10.11.2021, sipas vërtetimit të Tatimpaguesve DTM date 10.11.2021.

Ndryshe ka ndodhur për shlyerjen e detyrimeve kontributeve sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe tatimit mbi ardhurat, detyrime të cilat janë likuiduar deri në periudhën e tenderimit date 10.11.2021, sipas vërtetimit të Tatimpaguesve DTM date 10.11.2021.

Ndryshe është vepruar edhe në rastet për artikuj tjerë për shlyerjen e detyrimeve ku vërtetimet janë lëshuar deri në periudhën e tenderimit.

Pra komisioni ka vepruar me **2 standarde**, lidhur me pranimin e dokumenteve për shlyerjen e detyrimeve deri në periudhën e tenderimit.

Shpenzime për pagesën e lejeve zakonshme.

1. **Ne 7 raste, u konstatua se janë paguar lejet e zakonshme, në vend të kompensimit tyre me pushime deri në fund të 3-mujorit për vitin 2022**, në kundërshtim me VKM nr. 568 date 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtese dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, kap III, pika 8 dhe pika 9, konkretisht: Sipas urdhër shpenzimit nr. 40 datë 14.02.2022 dhe nr. 261 datë 28.09.2022, urdhrit kryetarit bashkisë nr.

42 date 11.02.2022 dhe nr. 256 date 12.09.2022 është likuiduar 110,448 lekë për 4 persona dhe vlera 87,404 lekë për 3 persona, pagese shpërblimi për pushime vjetore, përkatësisht:

- * *I.I, 13 dite, vendimi i largimit nr. 116 date 21.10.2021.*
- * *S.H, 22 dite, vendimi i largimit pension nr. 5 date 03.02.2022.*
- * *K.M, 22 dite, vendimi i largimit pension nr. 4 date 03.02.2022.*
- * *D.G, 21 dite, vendimi i largimit nr. 160 date 07.12.2021.*
- * *M.B 13 dite, vendimi i largimit nr. 76 date 29.06.2022.*
- * *J.K, 14 dite, vendimi i largimit nr. 85 date 21.07.2022.*
- * *B.S, 15 dite, vendimi i largimit nr. 93 date 03.08.2022.*

Pagesa është kryer padrejtësisht, ne vend te kompensimit me pushime, pasi janë brenda periudhës se lejuar për kryerjen ditëve te lejes zakonshme te pakryer për 2022 (*brenda 8-mujorit 2022*).

Ngarkohen me përgjegjësi specialiste financës **A.M**, përgjegjësja e finance-buxhetit **E.D**, zv/kryetarja dhe drejtoresha finance-buxhetit **Z.I** dhe kryetari **R.B**.

Shpenzime për TVSH

1. Sipas urdhër shpenzimit nr. 408 datë 30.12.2022 është likuiduar për vlerën 18,282,097 lekë “Sh.A” shpk, për **rikonstruksionin e shkollës mesme Llugaj**, rezulton se:

a. Vlera në situacionin nr. 1, zëri “*Pajisje mbrojtjese nga zjarri dhe elektrike e hidraulike*” subjekti i ka llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003, “*Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit*”, nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh dhe vihet në fund të situacionit, për rrjedhojë është përfituar padrejtësisht nga subjekti “**Sh.A shpk**” dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit për vlerën **77,200 lekë** (386,000 x20%), sipas zërave ne situacionin nr. 1.

b. zeri grope septike V 8 m3 1x 120,000 leke nuk ehte e zberthyer ne zera analitik.

2. Sipas urdhër shpenzimit nr. 281 datë 13.10.2022 është likuiduar për vlerën 6,832,832 lekë “Sh.A” shpk, për **rehabilitim i shëtitores qytetit Bajram Curri**, rezulton se:

a. Vlera në situacionin nr. 1, zëri “*Pajisje sinjalistike 160,280 leke, elektrike 350,000 leke*” subjekti i ka llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003, “*Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit*”, nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh dhe vihet në fund të situacionit, për rrjedhojë është përfituar padrejtësisht nga subjekti “**Sh.A shpk**” dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit për vlerën **102,000 lekë** (510,280 x20%), sipas zërave ne situacionin nr. 1.

b. subjekti ka përfituar padrejtësisht **3 %** nga fondi rezerve për vlerën **2,790,039 leke**, pasi kjo vlerë nuk është e zberthyer analitikisht sipas zërave te punës, **për pasoje nuk justifikohet me dokumente.**

3. Sipas urdhër shpenzimit nr. 203 dhe datë 21.07.2022 dhe nr. 258 date 21.09.2022 është likuiduar për vlerën 1,500,000 lekë dhe 2,409,463 leke “**K.B + V**”, për **mirëmbajtje shkolla, çerdhe, kopshte**, bashkia Tropoje, rezulton se: zëri “*Pajisje elektrike dhe hidraulike*” subjekti i ka llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003, “*Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit*”, nuk është ndarë veças vlera e

“montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh dhe vihet në fund të situacionit, për rrjedhojë është përfituar padrejtësisht nga subjekti vlera **131,400 lekë** (657,000 x20%), sipas zërave ne situacion.

4. Sipas urdhër shpenzimit nr. 205 datë 01.08.2022 është likuiduar për vlerën 8,813,987 lekë “**4**” shpk, për ***Ujësjetllës fshati Dragobi***, rezulton se:

a. Vlera në situacionin nr. 1 dhe 2, zëri “*Pajisje hidraulike ne cope*” subjekti i ka llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003, “*Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit*”, nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh dhe vihet në fund të situacionit, për rrjedhojë është përfituar padrejtësisht nga subjekti “**4**” shpk dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit për vlerën **120,000 lekë** (600,000 x20%), sipas zërave ne situacionin nr. 1 e 2.

b. zeri ndertim pusete betoni 3 x 100,000 leke dhe porte metalike 3x 6000 leke nuk eshte e zberthyer ne zera analitik.

5. Sipas urdhër shpenzimit nr. 228 datë 12.08.2022 është likuiduar për vlerën 6,493,552 lekë “**N**” shpk, për ***Rikualifikim urban blloku 1 dhe 2 lagjia Partizani***, rezulton se:

a. Vlera në situacionin nr. 1 dhe 2, zëri “*Pajisje elektrike dhe pajisje lodra femijesh*” subjekti i ka llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003, “*Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit*”, nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh dhe vihet në fund të situacionit, për rrjedhojë është përfituar padrejtësisht nga subjekti “**N**” shpk dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit për vlerën **130,000 lekë** (650,000 x20%), sipas zërave ne situacionin nr. 1 e 2.

Shpenzime për qira banese

Bashkia Tropoje ka marre Ait sha ambiente me qira me sipërfaqe 220 m2 për vlerën 20,000 leke ne muaj, sipas kontratës date 11.02.2022 me afat kohor 2 vjeçar dhe ka kryer likuidimin: Sipas urdhër shpenzimit nr. 47 dhe datë 23.02.2022 likuiduar vlera 61,200 lekë dhe sipas urdhër shpenzimit nr. 113 dhe datë 05.05.2022 likuiduar vlera 66,000 lekë.

a. Bashkia ka likuiduar me tepër diferencën 6000 leke për 3 muaj (*likuiduar 66,000 leke - 60,000 leke qe duhej*) ose tepër 2000 leke/muaj ($22,000-20,000=2000$ leke/muaj x 3 muaj= 6000 leke), ne kundërshtim me kushtet e nenit 2 te kontratës date 11.02.2022 (*Theksojmë se mbi kontratën e lidhur ka korrjime mbi vlerën 20,000 leke është bere 22,000 leke*).

b. Bashkia ka likuiduar padrejtësisht edhe muajin janar 2022 për vlerën 20,000 leke, pasi kontrata date 11.02.2022, neni 12/12.1 nuk ka fuqi prapavepruese.

Përfundimisht, bashkia ka likuiduar tepër vlerën **26,000 leke** ne adrese të Ait sha, për periudhën Janar – Qershor 2022.

Pritje-përcjellje.

Bashkia Tropoje për vitin 2022 ka kryer **shpenzime të paligjshme**, sipas urdhër shpenzimit nr. 234 date 16.08.2022 dhe nr. 315 date 10.11.2022, nga të ardhurat (llog: 602), për **pritje-përcjellje (dreka dhe aktivitete për hapjen e sezonit turistik 11.06.2022, mungon lista e pjesëmarrëseve)**, sipas urdhrit 151 date 02.06.2022 nënshkruar nga zv/kryetarit **A.K** dhe kontratës nr. 11 date 09.06.2022 me vlere totale **960,000 leke** bashke me TVSH me subjektin

E.Z, nënshkruar nga kryetari i bashkisë **R.B** .Veprime në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999.

Shpenzime me mangësi në dokumentacion

1. Bashkia Tropoje ka kryer likuidim pjesor për vlerën 3,000,000 lekë dhe 245,617 leke, sipas urdhër shpenzimeve nr. 69, datë 24.03.2022 dhe nr. 76 date 29.03.2022, për rikonstruksion i kompleksit sportiv lojërave me dore, rezulton se nuk disponohen **dokumentet baze dhe justifikuese si:** fatura, situacione, fotografimi para dhe pas meremetimit të objektit për efekt të justifikimit të shpenzimit, pasi objekti është rikonstruktuar edhe me pare (2012). Ndryshe është vepruar me riparimin e urës drurit “ Beli” LEibaj sipas urdhër shpenzimit nr. 74, datë 29.03.2022, ku disponohen dokumente foto para dhe pas rregullimit te objektit. Pra me 2 standarde.Veprime ne kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik , me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

2. Bashkia Tropoje ka kryer likuidimi për vlerën 99,500 lekë, sipas urdhër shpenzimeve nr. 367, datë 22.12.2022, për **shërbim makinës bashkisë**, rezulton se:

- **ne asnjë dokument nuk citohet targa e makinës si:**

* *ne urdhër prokurimin nr. 350 date 16.12.2022 nënshkruar nga A.K,*

* *ne procesverbalin 16.12.2022 te komisionit blerjeve vogle **A.H, E.D, B.G,***

- **nuk ka procesverbal nga specialisti i fushës për dëmtimin dhe nevojën** e zevendesimit te këtyre pjesëve këmbimit, përkatësisht: 1 Radiator, 2 Kushinete, 2 Permistop, 1 Pompe freni, 4 Kryq trasmesioni, 8 cope Semiblllok shpatull tab 105.

- **nuk ka procesverbal për marrjen ne dorëzim** te pjesëve këmbimit,

- **nuk disponohet fletëhyrje për pjesët e këmbimit, ndryshe nga rasti tjetër** për blerjen e vajrave lubrifikante, ujë antifrizë, alkool ku janë administruar sipas hyrjes nr. 11 date 8.03.2022 dhe proces verbalit marrjes ne dorëzim komisionit blerjeve date 08.03.2022, sipas urdhër shpenzimit nr. 370, datë 23.12.2022, pra **komisioni ka vepruar me 2 standarde**. Veprim në kundërshtim me nenin 13 pika c të ligjit 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Përfundimisht, shpenzimi 99,500 lekë është i pajustificuar me dokumente, ne kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik , me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, të ndryshuar, si dhe udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, me Urdhrin MF 92 date 29.12.2011“Për gjurmët standarde te auditit për prokurimet me vlere te vogël dhe te larte,”dhe me Urdhrin nr. 33 date 11.07.2013 “Për gjurmët standarte te auditit për prokurimet me vlere te vogël dhe te larte.”

3. Bashkia Tropoje ka kryer **shpenzime jo efçente për materiale dekorative ne zbulurimin me rastin e vitit ri 2023 në vlerën 885,600 leke**, sipas urdhër shpenzimit nr. 378, datë

27.12.2022, pasi duhej të shfrytëzonte materialet e viteve të mëparshme të administruara me pare nga bashkia. Komisioni blerjeve vogla **A.H, E.D, B.G.**

4. Bashkia Tropoje ka kryer likuidim subjektin S për vlerën 630,000, sipas urdhër shpenzimit nr. 210 datë 02.08.2022, për blerje 11 goma dhe 8 bateri për automjetet e saj, rezulton:

- **nuk disponohen dokumente qe justifikojnë zëvendësimin e gomave dhe baterive,** konkretisht **mungon procesverbali i komisionit për mbarimin e normës se konsumit gomave dhe garancia e baterive për afatin e skadimit tyre,** 2 dokumente kryesore qe i hapin rrugën ndërrimit dhe blerjes tyre, por është mjaftuar vetëm me procedurat e prokurimit.

- **nuk disponohet fletëhyrje rikupel e gomave dhe baterive te skaduar.**

Veprim në kundërshtim me nenin 13 pika c të ligjit 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

5. Bashkia Tropoje ka kryer likuidim subjektin E.V për vlerën 98,100, sipas urdhër shpenzimit nr. 236 datë 23.08.2022, për shërbime e mirëmbajtje automjetit saj (*disqe freksioni, koke paralele, fasheto, guzhineta, tub fresibel valvul, feroto, etj për Reno*), rezulton se:

- **nuk disponohet procesverbali i komisionit dhe specialistit te fushës për defektet,** për efekt te ndërrimit dhe mirëmbajtjes tyre, por është mjaftuar vetëm me procedurat e prokurimit.

- **nuk disponohet fletëhyrje rikupel e pjesëve këmbimit te dëmtuara.**

-- **nuk disponohet fletëhyrje e pjesëve këmbimit te reja.**

Veprime në kundërshtim me nenin 13 pika c të ligjit 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

6. Bashkia Tropoje ka kryer likuidim subjektin E.V për vlerën 99,000, sipas urdhër shpenzimit nr. 262 datë 28.09.2022, për shërbime e mirëmbajtje automjetit saj (*ndërrim grup timoni, mbajtëse kamie, pompe freksioni, koke paralele, freksioni, diferenciali, feroto, amortizatori, koke zbare, koke paralele, mbajtëse motori*), rezulton se:

- **nuk disponohet procesverbali i komisionit dhe specialistit te fushës për defektet,** për efekt te ndërrimit dhe mirëmbajtjes tyre, por është mjaftuar vetëm me procedurat e prokurimit.

- **nuk disponohet fletëhyrje rikupel e pjesëve këmbimit te dëmtuara.**

-- **nuk disponohet fletëhyrje e pjesëve këmbimit te reja.**

Veprime në kundërshtim me nenin 13 pika c të ligjit 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Komisioni K.S, E.D dhe N.Gj.

ARKA.

Nga arkëtarja V.D nuk u vendos ne dispozicion te grupit auditimit asnjë dokument i arkës te bashkisë, gjate periudhës se auditimit, pavarësisht kërkesave te përsëritura nga ana jone, për rrjedhoje u be e pamundur auditimi i kësaj n/pike te programit.

2.3.4. Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre ne Agjencinë Shtetërore Kadastrës (ASHK).

Veprimet nëpërmjet magazinës

Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë. Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara. Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

a. Nuk janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre si: viti i krijimit, shtesat dhe pakësimit për to, pra nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara, sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30, të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga magazinierja B.S dhe financa.

Inventarizimi i pasurisë.

-Për vitin 2022 për inventarizimin e institucionit, njësisive administrative, shkollave, kopshteve, qendrës kulturore, titullari i institucionit me urdhrin nr. 319, datë 18.11.2022 ka ngritur komisionet e inventarizimit fizik, përkatësisht për bashkinë Qendër me kryetare S.M, J.Q dhe R.O dhe komisionet e njësisive administrative etj. Komisionet kanë kryer inventarizimet, fletët e inventarizimit ishin plotësuar në gjithë ekstremitetet e tyre, dhe ishin nënshkruar nga anëtarët e komisionit dhe personi përgjegjës që i kishte në ngarkim, sipas kërkesave të pikës 82 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Por nga auditimi rezultuan edhe mangësi, sa vijon:

a. Nuk përcaktohet numëri rendor i fletëhyrjes dhe fletëdaljes ne procesverbalet e komisionit para fillimit të inventarizimit (nuk ka procesverbal), po kështu nuk përcaktohet fletëhyrja dhe fletëdalja e fundit, në kundërshtim me pikën 83 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

b. mungon pasqyra përmbledhje e inventarizimit te mjeteve transportit, për numrin dhe vlerën kontabël e fizike tyre, siç është kryer tek zëri “ rruge, rrjete e vepra ujore”.

c. nuk janë nënshkruar nga përgjegjësi material flet inventarizimi i njësisë Fierze për zyrën e këshillit, veprim në kundërshtim me pikën 82 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

d. Në përfundim të inventarizimit komisioni nuk ka bërë relacion dhe miratim në Këshillin Bashkiak, sipas kërkesave të pikës 87,88,89,90,91 dhe 92 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

e. Nuk është kryer inventarizimi fizik i pasurisë për vitin 2022, përkatësisht: për shkollën e mesme, shkollën 9-vjeçare, konviktin çerdhen, dekorin, në kundërshtim me pikën 81,82, 83, 84, 85, 86,87,88,89 dhe 90 te udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Ngarkohen me përgjegjësi komisionet e inventarizimit dhe sektori i financës.

Nxjerrjet jashtë përdorimit.

-Për vitin 2022 për vlerësimin e materialeve për nxjerrjet jashtë përdorimit, sipas urdhrin titullarit nr. 319/1, datë 19.11.2022 është ngritur komisioni i përbërë nga 3 veta, përkatësisht: B.B, Sh.Y dhe F.B. Komisioni ka vlerësuar dhe evidentuar materialet ne qender dhe njesi administrative, të cilat kanë humbur vlerën e përdorimit, për disa paisje zyresh, shkollash, aparaturo,tavolina, karrike, dollape, kompjutra, printera, laptop, kompjuter fotografi, e tjere, per vleren 1,497,752 leke.

Komisioni për vlerësimin e materialeve për nxjerrjet jashtë përdorimit ne punën e tij paraqet këto **mangësi dhe shkelje:**

a. nuk disponon procesverbalin e specialistit fushës (ing. Elektronik) që verteton humbjen e vlerës përdorimit të paisjeve dhe aparaturove elektronike si: kompjutra, printera, laptop, kompjuter fotografik, veprime në kundërshtim me pikën 95 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

b. nuk ka pasqyruar vitin e blerjes ose prodhimit te aparaturove elektronike, për të saktësuar amortizimin e plotë sipas tarifave ligjore. Mungesa e përcaktimit të vitit blerjes shmang afatin e amortizimit dhe krijon shteg për nxjerrje jashtëpërdorimi të tyre para kohe dhe në gjendje pune. Amortizimi si element costoje nuk i sos paisjet kompjuterike, pasi mund të jenë funksionale nga riparimet e tyre. Veprime në kundërshtim me pikën 95 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Ngarkohen me përgjegjësi komisioni i vlerësimit te pajisjeve dhe aparaturove elektronike për nxjerrje jashtë përdorimit, përkatësisht: B.B, Sh.Y dhe F.B.

-Për vitin 2022 për asgjësimin e materialeve jashtë përdorimit, sipas urdhrin titullarit nr. 319/1, datë 18.11.2022 është ngritur komisioni i përbërë nga 5 veta, përkatësisht: A.M, F.M, A.I, R.M dhe Sh.Gj.

Komisioni ka nxjerre jashte perdorimit materialet ne qender, njesi administrative, shkolla, kopshte e cerdhe etj per vleren 1,497,752 leke, sipas procesverbalit te asgjesimit date 17.03.2023.

Komisioni i nxjerres dhe asgjesimit te materialeve jashte perdorimit ne punën e tij paraqet këto **mangësi dhe shkelje:**

a. nuk përcaktohet vendi i asgjësimit dhe mënyra e asgjësimit te materialeve, sipas llojit te tyre ne procesverbalin e asgjësimit date 17.03.2023, *por është mjaftuar me kopjen e procesverbalit te vlerësimit te materialeve.*

b. nuk disponohet fletëdalja për materialet e pajisjet e asgjësuar ne vlerën 1,497,762 leke, për efekt te shkarkimit nga magazina dhe kontabiliteti. *Sqarojmë se: shkarkimi ne kontabilitet është kryer ekstra/kontabël për vlerën 1,497,762 tek zëri inventar ekonomik, sipas formatit 7/a tek kolona paketimet (asgjësime) te bilancit 2022.*

Veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, çka ben pergjegjes komisionin e asgjësimit **A.M, F.M, A.I, R.M, Sh.Gj dhe magazinieren B.S dhe përgjegjësen e financës E.D.**

Rregjistrimi asetëve e sipërfaqeve në zonat mbrojtur në Agjencinë Shtetërore Kadastrës (ASHK).

Rregjistrimi i sipërfaqeve të zonave të mbrojtura (Valbone) nuk është kryer, pasi janë në proces inventarizimi dhe saktësimi dhe sipas VKM 59 datë 28.07.2023 do të kalojnë “Zonave të mbrojtura”, me të cilin do regjistrohen në zbatim të kërkesave të nenit 55 “Regjistrimi i sipërfaqeve të zonave mbrojtura” të ligjit 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”.

Pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë.

Bashkia Tropojë për vitin 2022 nuk ka hartuar pasqyrat financiare të konsoliduar në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë pasi në periudhën e auditimit Konstatohet se Bashkia Tropojë është njësi shpenzuese e vetme. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të nën njësisë. Për mënyrën e plotësimit të pasqyrave financiare, për saktësinë dhe analizën e llogarive të pasqyruara dhe të paraqitura në aktiv dhe në pasiv të bilancit janë trajtuar hollësisht në pikën një të programit, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike. Për vlerësimin dhe dhënien e opinionit të pasqyrave financiare për vitin 2022, u analizuan të gjithë treguesit e aktivitetit të veprimtarisë ekonomiko-financiare dhe në mënyrë përmbledhëse do të paraqitet së bashku me opinionin në projekt raportin dhe raportin përfundimtar të auditimit.

II. Baza ligjore.

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe zbatimi i rregullores “Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore”.

VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;

UKM 3 datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin punimeve ndërtimit” ndryshuar.

UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”.

UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

E.D., përgjegjëse e sektorit të financës-buxhetit, **A.M** përgjegjëse e sektorit kontabilitetit, **A.S** specialiste kontabilitetit (*Hartuese e bilancit 2022*), komisioni blerjeve vogla **A.H, M.V, P.R, B.G, K.S, N.Gj, V.D** arketare, **B.S** magazinierë, **E.H, S.V, J.D, F.M, A.I, R.M, Sh.Gj, A.K** nëpunës autorizues, **Z.I** Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe buxhetit dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues si dhe **R.B** kryetar bashkie.

Pretendimi i subjektit:

- *Observacioni i subjektit nr. 275/24 datë 28.07.2023 lidhur me akt konstatimin nr. 2, bën fjalë për mos regjistrimin e sipërfaqeve të zonave mbrojtura (Valbone) në ASHK.*

- *Observacioni i subjektit nr. 275/1 datë 28.07.2023 lidhur me akt konstatimin nr. 2, bën fjalë për mos kundrimin e llogarisë 213.*

- *Observacioni i subjektit nr. 275/37 datë 28.07.2023 lidhur me akt konstatimin nr. 2, bën fjalë për veprimet e arkës dhe bankës dhe inventarizimet.*

Qëndrimi i grupit auditimit:

- *Observacioni 275/24 date 28.07.2023 për akt konstatimin nr. 2 **qëndron dhe merret parasysht**, duke u reflektuar ne projekt raport auditimit, pasi regjistrimi i sipërfaqeve te zonave mbrojtura (Valbone) nuk është kryer ne ASHK, sepse janë ne proces inventarizimi dhe saktësimi dhe sipas VKM 59 date 28.07.2023 do ti kalojnë “Zonave te mbrojtura”, me tej do te regjistrohen ne zbatim te kërkesave te nenit 55 te ligjit 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”.*
- *Observacioni i subjektit 275/1 date 28.07.2023 lidhur me akt konstatimin 2, bën fjale për mos kundrimin llogarisë 213 **qëndron dhe merret parasysht**, duke u reflektuar projekt raport auditimit, pasi diferenca përfaqëson amortizimin e pa zbritur nga vlera bruto kontabël.*
- *Observacioni i subjektit nr. 275/37 date 28.07.2023 për akt konstatimin nr. 2 **qëndron pjesërisht dhe merret parasysht pjesërisht**, duke u reflektuar ne projekt raport auditimit, konkretisht hiqet konflikti i interesit (pensionist) dhe veshjet kombëtarë pasi nuk janë blere por janë marre me qira, ndërsa nuk merren parasysht pretendimet tjera lidhur me arkën e banke dhe inventarët, pasi i qëndrojmë trajtimeve tona ne akt konstatimin nr. 2.*
- *merret parasysht pjesërisht pagesa e lejeve zakonshme te pakryera te vitit 2022, te cilat padrejtësisht janë paguar ne vend te kompensimit me pushime, duke mos u rekomanduar.*
- 1.** - *Lidhur me observimet e punonjësve me nga 1 ose 2 shkelje teknike pa peshe do te merren parasysht tek rekomandimet.*

Titulli i gjetjeve:

Pika 3 e programit të auditimit: Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022 japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi, ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Udhëzimi i MFE 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë Qeverisjes Përgjithshme”, i ndryshuar.

Situata:

Nga auditimi i pikës Raportimit Financiar, pasqyrat financiare për vitin 2022 pozicionit financiar llogarive, performancës financiare dhe kontabilitetit etj, u konstatua se:

Bashkia Tropoje paraqet shkelje me veprimet e bankës te vitit 2022, për vlerës totale 2,131,555 leke, konkretisht:

- 5 raste pagesa për vlerën 519,722 leke, leje zakonshme paligjshme te vitit 2015 dhe pa një dokument gjyqësor për fitimin e te drejtës pagesës.
- kamat vonesa për energjinë elektrike për vlerën 65,233 leke.
- 1 rast, shpenzime të paligjshme, për pritje-përcjellje dreka, për vlerën 960,000 leke.
- 1 rast, likuidim tepër qira banese për vlerën 26,000 leke Ait sha.
- 4 raste, likuidim 2 here i TVSH, ne situacionet e investimeve për vlerën 560,600 leke.
- mangësi ne mbajtjen e librave te kontabilitetit si: mungon partitarive analitik i magazines, centralizatori dhe libri i veprimeve të ndryshme për sistemime llogarish.
- rritje te llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” gjate vitit 2022 dhe ne mbyllje te 2022 pasqyrohet 44,710,681 leke.
- Ne 6 raste, për blerjet dhe shërbimet me vlera te vogla mungojnë dokumentet justifikuese, fletëhyrjet, normativat ligjore dhe 1 rast shpenzim pa efektivitet dhe aplikim me 2 standarde.

- Për 1 rast, me shkelje ne procedurat e prokurimit me vlera vogla për vitin 2022, ne kundërshtim me kërkesat ligjore, ne “blerjen e karburantit “dhe ne investimin “punime rikonstruksion rrugës Markaj- Zllame” përlogaritje fondit limit me rezerva, pranim nga OE dokumente pjesshëm me 2 standarde si dhe konkurrim me oferta nen fondin limit.
- shkelje ne inventarizimet dhe nxjerrjet jashtë përdorimit te vitit 2022, lidhur me dokumentacionin e munguar sipas rasteve trajtuara, dhe mos kryerjen e inventarizimit ne disa sektorët e institucione me vartësi te bashkisë.

Kriteri:

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin” ndryshuar me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;

UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe zbatimi i rregullores “Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore”.

VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999.

VKM nr. 285 date 19.05.2021” Për miratimin e rregullave te prokurimit publik”.

-UMF nr. 5, datë 27.02.2014 ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014, Udhëzimin plotësues MF 2 datë 10.01.2018 “Për buxhetin2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura Njësive Vetëqeverisjes Vendore”.

UKM nr. 2, datë 08.05.2003 ,“Për klasifikimin dhe strukturën kostos punimeve ndërtimit”,

VKM nr. 568 date 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe te pushimit, orët shtese dhe kompensimin e tyre ne institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

Efekti: Efekte financiare për vlerën totale 2,315,705 leke, për vitin 2022 dhe te meta e mangësi ne 2 procedura me vlera vogla, mungesa ne dokumentet justifikuese ne 6 raste si dhe shkelje teknike ne inventarizimet dhe nxjerrjet jashtë përdorimit te vitit 2022.

Shkaku: Neglizhenca, mungesa përvojës dhe mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit ligjore.

Rëndësia: E Mesme.

Rekomandimi: Drejtoria ekonomike e Bashkisë Tropoje te marre masa, për mbajtjen e partitarëve analitik, centralizatorit dhe librit veprimeve të ndryshme, sipas kërkesave ligjore, si dhe të marrë masa për uljen e vlerës se llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila rezulton e rritur gjatë vitit 2022.

Rekomandimi: Bashkia Tropojë, të marrë masa, që në vijimësi, për çdo rast për ndihma te menjëhershme për vështirësi ekonomike dhe arsye shëndetësore, përpara se të procedojë me dhënien e tyre, të verifikojë plotësimin e dokumentacionit përkatës, duke siguruar gjendjen e dokumentacionit justifikues, në përputhje me kërkesat ligjore.

Rekomandimi: Bashkia Tropojë, të marrë masa, që për çdo procedurë me blerje dhe shërbime me vlera te vogla, si dhe në rastet si më sipër, të plotësohen me dokumente justifikuese, fletëhyrjet, normativat ligjore, për të bërë të mundur eliminimin e shpenzimeve pa efektivitet dhe aplikimin me standard të njëjtë.

Rekomandimi: Bashkia Tropojë të marrë masa për plotësimin dhe sigurimin e dokumentacionit të munguar në inventarizimin e pasurisë dhe nxjerrjeve jashtë përdorimit të mallrave e materialeve, sipas rasteve për shkeljet e konstatuara në inventarizimet dhe nxjerrjet jashtë përdorimit të vitit 2022. Gjithashtu të kryejë inventarizimin në të gjithë sektorët për të bërë të mundur përfundimin e këtij procesi.

2.2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

Nga auditimi ka rezultuar se, janë hartuar regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022. Mbas miratimit në sistem të regjistrat nga APP, me shkresa përcjellëse janë dërguar në Degën e Thesarit, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi mbështetur në VKB përkatëse "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Tropojë". Gjithashtu në të gjitha rastet e shtesave dhe pikësimeve është dërguar regjistri përkatës. Në këto regjistra janë pasqyruar shtesat dhe ndryshimet e bëra sipas VKB –ve përkatëse, në përputhje me VKM, nenin 4 "Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik", pika 1. Dërgimi i regjistrat të parashikimeve në APP, është bërë brenda afateve të përcaktuara në VKM nr. 914, neni 4, pika 3, e ndryshuar me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrat të prokurimeve

Në dosjet e prokurimit nuk administrohen dokumente që të vërtetojnë që nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për vitet ushtrimore. Programi i nevojave nuk është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësi vendore për punë e shërbime mallra, por në dosje administrohen listat prioritare për investime, të cilat janë miratuar me Vendim të KB vitit 2021 dhe 2022 bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si vijon:*

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Tropojë (regjistrat e parashikimit dhe realizimit), për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Lloji i procedurës	Nr. Proc	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Fondi total i kursyer TVSh	% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit
Viti 2021					
<i>Procedurë e hapur;</i>	4	80,180,900	73,476,300	6,704,600	
<i>Kërkesë për propozime;</i>	1	4,500,500	4,443,900	56,600	0
<i>Prokurim me vlerë të vogël.</i>	44	16,330,000	12,463,700	3,866,300	
SHUMA	49	101,011,400	90,383,900	10,627,500	
Viti 2022					
Lloji i procedurës	Nr.	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Fondi total i kursyer TVSh	% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit
<i>Procedurë e hapur;</i>	10	102,841,900	90,847,900	11,994,000	
<i>Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;</i>	1	2,570,000	2,570,000	-	-
<i>Prokurim me vlerë të vogël.</i>	33	18,561,400	13,690,700	4,870,700	
SHUMA	44	123,973,300	107,108,600	16,864,700	

Burimi i të dhënave: Bashkia Tropoje, punoi grupi i Auditimit.

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.01.2022– 31.12.2022, janë iniciuar gjithsej 16 procedura me vlera të larta me fond limit 190,093 mijë lekë pa TVSH, janë realizuar 16 procedura me fond limit 190,093 mijë lek dhe vlerë kontrate 171,336 mijë lekë pa TVSH, me një diferencë për vlerën 18,757 mijë lekë ose 9.86 %.

Referuar 6 procedurave të audituara, rezulton se kanë marrë pjesë në procedura **17** OE/B dhe janë s'kualifikuar **7** OE/B ose 41%.

Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **4** procedura ose 75 % e procedurave të zhvilluara.

Mbi bazën e materialitetit dhe riskut të bërë nga Grupi i KLSH, nga **16** procedura me vlera të larta me fond limit 190,093 mije lekë janë vlerësuar për auditim **6** procedura me fond limit 143,120 mijë lekë ose 75.3% e fondit limit, ku shkeljet sipas procedurave dhe problematikave paraqitet si më poshtë vijon:

Titulli i gjetjes: KLSH-ja, konstatoj së në procedurat e zhvilluara për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, janë konstatuar kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST, të miratuar nga AK-ja.

Situata: Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, janë iniciuar gjithsej **16** procedura me vlera të larta me fond limit 190,093 mijë lekë pa TVSH, janë realizuar 16 procedura me fond limit 190,093 mijë lek dhe vlerë kontrate 171,336 mijë lekë pa TVSH, me një diferencë për vlerën 18,757 mijë lekë ose 9.86 %.

Grupi i KLSH-së, referuar vlerësimit të dhënave të materialitetit dhe riskut nga **16** procedura me vlera të larta me fond limit 190,093 mijë lekë, ka vlerësuar për auditim 6 procedura me fond limit 143,120 mijë lekë ose 75.3% e fondit limit.

Nga auditimi i **6** procedurave me fond limit **143,120** mijë lekë, janë konstatuar në 5 raste kritere jo në përputhje me kuadrin rregullator, në **5** procedura OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK, në vlerën **143,120 mijë lekë** pa TVSH, veprime në kundërshtim me ligji nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenet 2, 36, 39, 77, 82, 92, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet 26, 39, 40, 42, 82, 88,” konkretisht sipas periudhave: **Kriteri:** Ligji nr. 162, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: Neni 2, “Parimet e përzgjedhjeje”; Neni 36, “Specifikimet teknike”, Neni 39, “Ndarja e kontratave në lote”, Neni 77, “Kërkesat për kualifikim”, Neni 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Neni 92, Shqyrtimi i ofertave”: VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 26, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, Neni 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave, Neni 42 “Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote”, Neni 82, pika 5 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, Neni 88, pika 3, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”.

Shkaku: Mos vlerësimi i drejtë i kritereve dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar dhe aplikimi i kritereve jo në përputhje me kuadrin rregullator.

Ndikimi: Aplikimi i kritereve jo në përputhje me kuadrin rregullator, si dhe shpallja fitues e OE me mangësi në plotësimin e kritereve të DST.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Tropojë, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet, ndërsa në shpalljen fitues të OE të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën risk real për shpenzimet e njësisë publike.

-Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit).

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, Janë audituar procedura e prokurimit si më poshtë:

Nr.	Objekti	Fondi limit	Operatori fitues	Shënime
1	“Blerje Kamioni”	6,400,000	OE “T” SHPK	Me shkelje
2	“Rikualifikimi urban Lagja “Partizani”, Blloku 1&2, Qyteti Bajram Curri”	60,338,235	B.N SHPK&”R.C” ShPK	Me shkelje
3	“Blerje dru zjarri”,	5,442,722	Person Fizik “N.M”	Me shkelje
4	“ Rikonstruksion i Shkollës “Oso Dauti”, Njësia Administrative Llugaj”	47,167,647	OE “Sh.A” ShPK	Me shkelje

5	“Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë - Lekurtaj”,	10,986,652	B.V shpk & G ShPK	Me shkelje
6	“Rikonstruksion thertorja Shudenicë+ Ndërtim i tregut të bagëtime”,	12.786.238	B.O shpk & T ShPK	Me shkelje

1. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje Kamioni”, Bashkia Tropojë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Kamioni”, Nr. REF-00961 datë 14-07-2021.		
1. Hartuesit e fondit limit dhe specifikimeve teknike Urdher nr. 158, datë 06.07..2021 1. E.K , administrim biznes 2. P.R ekonomist i mesëm 3. Sh.Gj ekonomist	3. Njësia e Prokurimit, Urdher nr. 161, datë 09.07.2021 1. K.B, jurist 2. F.D, ekonomist 3. E.D, ekonomist	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 162, datë 09.07.2021 1. P.R, Kryetar 2. A.Z 3. E.M inxhinier arkitekt
2. Lloji i Procedurës – “E hapur e thjeshtuar”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 6,400,000 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “T” SHPK me ofertë 6,360,000 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 3405 prot, dt. 28.09.2021 me afat 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 0 lekë ose 0 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 09.08.2021	9. Burimi Financimit Donacion nga Qeveria Japoneze Buxheti i bashkisë Tropojë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/B b) S’kualifikuar 0 OE/B, c) Kualifikuar 1 OE/B
11. Ankimime; nuk ka ankesë	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Tropojë
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E hapur e thjeshtuar”, me vlerë 6,400,000 lekë pa TVSH, i cili është financuar nga qeveria Japoneze

Mbi hartimin e dokumentave të tenderit dhe ngritjen e grupeve të punës

- Me Urdhërin nr. nr. 158, datë 06.07.2021 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor(i Autorizuar), është ngritur grupi i hartimit të dokumenteve të tenderit, hartimi i fondit limit dhe specifikimet teknike, ku pjesë e grupit të punës rezulton P.R, i cili është edhe anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, sipas Urdhërit nr. nr. 162, datë 09.07.2021, pjesëmarrja e një personi njëkohësisht në 2 komisione bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 75, pika 2 ku citohet: “*Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave*” dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Autoritetit Kontraktor dhe vetë punonjësën, i cili ka deklaruar në të dy rastet.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike:

Kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike janë përcaktuar nga njësia e përkatëse e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 08.07.2021.

- Nga verifikimi i specifikimeve teknike, rezulton se ato janë të cingura dhe nuk qartësohet procedura për përcaktimin e fondit limit. Hartimi i specifikimeve teknike, nga komisioni i ngritur me Urdhërin nr. 158, datë 06.07.2021, nuk është i argumentuar dhe nuk është i detajuar në funksion të proceseve specifike të punës (e pa argumentuar kërkesa për shpejtësinë maksimale 180 km/h për kamion për grumbullim dhe transport plehrash), duke mos vendosur asnjë specifikim lidhur me kërkesat që duhet të plotësojnë kutia e plehrave, pajisja e sistemit të frenimit emergjent, apo pajisjet e kopresimit të plehrave, etj. Gjithashtu mungojnë skicat për përcaktimin e përmasave të kamionit;

Përsa sipër, kriteret e kualifikimit dhe specifikimet e vendosura kanë krijuar mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me përcaktime ligjore të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e Njesisë e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit, P.R, Ekonomist mesëm (Personi përgjegjës), E.K ekonomist, Sh.Gj ekonomist.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit

Fondi limit nuk është i argumentuar, duke mos testuar tregun për të marrë oferta nga shoqëri të ndryshme që kanë në objektin e veprimtarisë shitjen e automjeteve të ndryshme. Nga ana e grupit preventivues nuk është analizuar asnjë kontratë precedente nga vetë AK apo AK të tjerë, apo edhe nga site zyrtarë të shitjes së mjeteve. Sa sipër përcaktimi i fondit limit në këtë vlerë, nuk është i qartë dhe transparent.

Situata 2.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur e thjeshtuar”. Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 09.08.2021. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe ka marrë pjesë në procedurë OE, me ofertën e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	“T” ShPK	6,360,000

Burimi i të dhënave: SPE

Punoi: KLSH

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën nr. 2438/1 prot, datë 16.08.2021, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor(i Autorizuar) z. A.K dhe është hedhur në sistem.

Sipas KVO-së, ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DT dhe është kualifikuar:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	“T” ShPK	6,360,000

Burimi i të dhënave: SPE

Punoi: KLSH

Nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të Operatori Ekonomik fitues “T” ShPK, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:

- Në deklaratën e garancisë për mallin e ofruar, nuk janë përcaktuar dhe përshkruar qartë të gjithë termat dhe kushtet e garancisë teknike që mbulon ofertuesi.

- specifikimet teknike, nuk kanë përputhshmëri me ato të përcaktuara në dokumentet standarde, lidhur me peshën e mjetit, aftësinë mbajtëse, pesha aksiale, lloji i materialit të kazanit, shpejtësia e lëvizjes, si dhe opsionet ekstra (Xhama elektrik , airbag , radio CD);

- Operatori ekonomik nuk plotëson tek Kriteret e përgjithshme “i”, pasi nuk ka deklaruar lidhur me: “Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi”. Nga verifikimi i buletinit zyrtar të APP-së, rezulton se drejtuesi ligjor i kompanisë ofertuese, rezulton i përjashtuar nga procedurat e tenderimit, si drejtues ligjor i OE “T” shpk. Për rrjedhojë duhet të skualifikohej nga tenderi, dhe nuk duhet të lidhej kontrata e zbatimit nr. 3405 prot, datë 28.09.2021.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 09.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 6,360,000 lekë pa TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së P.R, Kryetar, A.Z dhe E.M, anëtarët e Njësisë së prokurimit F.D, me detyrë ekonomist, K.B, E.D dhe Titullarin e AK-së z. R.B

Ndikimi: Vendosija e kriterëve të kualifikimit dhe vlerësimi i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Tropojë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kriterëve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

2. Procedura e prokurimit me objekt “Rikualifikimi urban Lagja “Partizani”, Blloku 1&2, Bashkia Tropojë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikualifikimi urban Lagja “Partizani”, Blloku 1&2, Qyteti Bajram Curri”, Nr. Ref. 10981-11-10-2021.		
Urdhër Prokurimi Nr. 243, datë 22.10.2021, hartuesit e dokumentave, specifikime teknike dhe fondi limit	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 265, datë 02.11.2021 Njësia e Prokurimit 1. K.B, (Personi përgjegjës)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 266, datë 02.11.2021 4. B.B, Kryetar, tek. Nd. 5. Sh.Gj ekonomiste

1. H.I inxh. 2. M.V tek. Nd. 3. Sh.Gjekonomiste	2. E.M, Inxhinier 3. S.M, inxhinier pyjesh	6. K.S ekonomist
2. Lloji i Procedurës – “E hapur”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 60,338,235 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) B “N” SHPK&”R.C” ShPK me ofertë 53,717,333 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 977 prot, dt. 24.02.2022 me afat 90 ditë nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 6,620,902 lekë ose 10.97 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 13.12.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Tropojë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 4 OE/B b) S’kualifikuar 3 OE/B, c) Kualifikuar 1 OE/B
11. Ankimime; nuk ka ankesë	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Tropojë
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E hapur”, me vlerë 60,338,235 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet asnjë dokument për iniciimin e kryerjes së këtij investimi.

Mbi projektpreventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga shoqëria “D.E” ShPK sipas kontratës dhurimit dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Tropojë, z. R.B.

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...**”. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, Titullari i Bashkisë Tropojë, z. R.B.

Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Fondi limit dhe preventivi përkatës, janë hartuar nga projektuesi i objektit shoqëria “D.E” ShPK, por rezulton se nuk janë verifikuar dhe argumentuar nga njësia e hartimit të fondit limit dhe specifikimeve teknike. Rezulton se në 2 zëra punimi ka gabime në llogaritje, lidhur me përcaktimin e volumeve, konkretisht: Tek seksioni1-2, nr. rendor 5, An. 164/1a+An. zëri i punës “Mbushje me çakull t=30 cm..” dhe tek nr. rendor 11, An. 3.243, zëri i punës “Beton” C16/20 për fiksime kunete...”. Grupi punës i ngritur me Urdhër Prokurimi Nr. 243, datë 22.10.2021, i përbërë H.I, M.V dhe Sh.Gj, nuk kanë bërë verifikimet përkatëse.

Nga verifikimi i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 05.03.2021.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 02.11.2021, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 2, “Dokumentimi i procesit”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura (edhe në shtojcën nr. 1 dhe nr. 2), u konstatua se:

1- Në pikën 2.3.8 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 1 punonjës i pajisur me certifikatë Ekspert për ndihmën e pare dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, gjithashtu në pikën 2.3.9 është vendosur kriteri si staf mbështetës me përbërje: 1 inxhinier ndërtimi(profili strukturë), 1 punonjës i pajisur me certifikatë Ekspert për ndihmën e pare dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi është përsëritur i njëti kriter për “Ekspertin për ndihmën e parë”, si dhe është kërkuar inxhinier ndërtimi(profili strukturë), nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me volumin dhe naturën e punimeve në objektin që prokurohet.

2- Në pikën 2.3.10 të KVK është vendosur kriteri “Operatori Ekonomik të ketë licencë profesionale nga QKL, Kodi 1.2.A. për “Mbrojtjen nga Zjarri”, ose të paraqesë kontratë me konsulentë të licensuar në këtë drejtim. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me volumin dhe naturën e punimeve në objektin që prokurohet.

3- Në pikën 2.3.11 të KVK është vendosur kriteri “Operatori Ekonomik të ketë licencë profesionale nga QKL, Kodi III.2.A. për “Grumbullimin, Transportin, Ruajtjen e mbetjeve urbane”. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me volumin dhe naturën e punimeve në objektin që prokurohet.

4- Është kërkuar në pikën 2.3.17, OE/B duhet të ketë kontratë noterale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtare ose ndërkombëtare, sipas standardeve SSH EN 12390-3:2009, etj. Kjo kërkesë është e panevojshme, pasi kjo plotësohet nga kërkesat e specifikimeve teknike dhe kontrollon nga mbikëqyrësi i punimeve. Kjo ndikon duke ndikuar në ngushtimin e konkurrencës dhe nuk garanton trajtim të barabartë.

5- Është kërkuar në pikën 2.3.18, OE/B duhet të paraqesë

- Analizë Teknike për të gjithë zërat e preventivit të ofertës. Mos paraqitja në formën e kërkuar(sipas VKM) përbën kusht për skualifikim

Kjo kërkesë është e panevojshme pasi për të gjithë zërat e preventivit, vendosja e çmimeve i kryhet sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

6- Është kërkuar qe operatori ekonomik të ketë të punesuar “Mjekun e shoqërisë”, e vërtetuar kjo me listpagesat e paraqitur nga operatori ekonomik. Kontrate pune te vlefshme brenda periudhes se realizimit te kontrates, diploma, license ushtrim profesioni si dhe te figuroje ne listepagesat e shoqerise te pakten per tre muajt e fundit.. Ky kriter është argumentuar nëpërmjet një VKM-je të shfuqizuar, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe marrjen pjesë të një numri më të madh ofertuesish. Përsa më sipër, është vepruar në kundërshtim me nenin 25 dhe nenin 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e Njësisë së Prokurimit, K.B, E.M, S.M.

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”. Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE/B, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	B “N” SHPK&”R.C” ShPK “” ShPK	53,717,333
2	“L.V” ShPK	57,800,026
3	“K” ShPK	55,546,159
4	“N” ShPK	60,310,558

Burimi i të dhënave: SPE

Punoi: KLSH

Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe vlerësimit të ofertave pa nr. prot, datë 13.12.2021.

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën nr. 4044/1prot, datë 24.12.2021, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor(i Autorizuar) z. F.K dhe është hedhur në sistem.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DT dhe është kualifikuar:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	B.NSHPK&”R.C” ShPK “” ShPK	53,717,333

Burimi i të dhënave: SPE

Punoi: KLSH

Me deklaratë noterale nr. 12164/8010, datë 10.12.2021, është bërë marrëveshja(për bashkim të përkohshëm), ndërmjet Shoqërisë “N” ShPK dhe shoqërisë “R.C” ShPK, duke ndarë edhe volumin e punës, ku 90 % e punimeve të preventivit do të kryhen nga “N” ShPK dhe 10 % nga shoqëria “R.C” ShPK, duke ndarë edhe volumet sipas zëraver të preventivit.

Nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të Operatori Ekonomik fitues B.N. SHPK&”R.C” ShPK, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura ne DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:

1. Shoqëria “N” ShPK, nuk plotëson kriterin nr. 2.3.6, ku referuar volumit të punës që zë sipas preventivit, nuk plotëson numërin e punonjësve të kualifikuar sipas pozicioneve të kërkuara(në këtë rast nuk është plotësuar deklarata në formë tabele, ku sipas rubrikave përkatëse plotësohet me të dhënat e stafit që ka në dispzicion të realizimit të kontratës), konkretisht:

- mekanik mungojnë 3 punonjës(ka vetëm 1 punonjës nga 4 të kërkuar);
 - elektrikist mungon 1 punonjës, nga 2 të kërkuar(ndërsa 2 punonjës ka paraqitur shoqëria R.C” ShPK, referuar volumit dhe zërave të punimeve, duhet te paraqesin secili OE nga nje elektrikist);
 - Saldator mungon 1 punonjës, nga 2 të kërkuar(ndërsa 2 punonjës ka paraqitur shoqëria R.C” ShPK, kjo shoqëri referuar volumit dhe zërave të punimeve dhe ndarjes së tyre duhet te paraqiste 1 punonjës, ndërsa 1 duhet të ishte staf i shoqërisë “N”);
 - Hekurkthyes mungojnë 2 punonjës, nga 3 të kërkuar(ndërsa 3 punonjës ka paraqitur shoqëria R.C” ShPK, kjo shoqëri referuar volumit dhe zërave të punimeve dhe ndarjes së tyre duhet te paraqiste 1 punonjës, ndërsa 2 duhet të ishin staf i shoqërisë “N”);
 - Karpentier mungojnë 2 punonjës, nga 3 të kërkuar(ndërsa 3 punonjës ka paraqitur shoqëria R.C” ShPK, kjo shoqëri referuar volumit dhe zërave të punimeve dhe ndarjes së tyre duhet te paraqiste 1 punonjës, ndërsa 2 duhet të ishin staf i shoqërisë “N”);
 - Pllaka shtrues mungojnë 2 punonjës, nga 3 të kërkuar(ndërsa 1 punonjës plotësohet nga R.C” ShPK, referuar volumit dhe zërave të punimeve);
 - Manovrator mungon 1 punonjës, nga 3 të kërkuar, rezultojnë 2 të plotësuar me dokumente përkatëse(nga këto 1 punonjës plotësohet nga R.C” ShPK, referuar volumit dhe zërave të punimeve);
2. Nuk plotësohet kriteri nr. 2.3.10, ku kërkohet që “Operatori Ekonomik të ketë licencë profesionale nga QKL, Kodi 1.2.A. për “Mbrojtjen nga Zjarri”, ose të paraqesë kontratë me konsulentë të licensuar në këtë drejtim, pasi në dokumentet e paraqitura nuk rezulton të jetë paraqitur nga B;
3. Nuk plotësohet kriteri nr. 2.3.11, ku kërkohet që “Operatori Ekonomik” të ketë licencë profesionale nga QKL, Kodi III.2.A. për “Grumbullimin, Transportin, Ruajtjen e mbetjeje urbane”, pasi në dokumentet e paraqitura nuk rezulton të jetë paraqitur nga B;
4. Nuk plotësohet kriteri nr. 2.3.15, ku kërkohet që në momentin e hapjes së ofertave, ofertuesit të dorëzojnë pranë bashkisë në Zyrën e Prokurimeve, pranë KVO, mostrat e mallit: Tuba të brinjëzuar HDPE SN 8; F.v. ndriçues Smart .. ; pusëtë plastike 40x40x40 me kapakë kompozot; F.v. kabëll XYNM 0.6/1Kv.. ; F.v. kabëll FG 70R 3G*2.5 mm, pasi mungon kutia që përmban këtrë mostra sëbashku me procesverbalin përkatës ku B të këtë listuar artikujt.
5. Nuk plotësohet kriteri nr. 2.3.16, lidhur me disponimin e mjeteve dhe kapacitetev teknike nga OE, ku kërkohet që kontratat e qirasë së mjeteve, duhet të mbuojnë afatin e përfundimit të zbatimit të punimeve. Referuar volumit të punës sipas zërave të preventivit, nuk plotësohet me numërin e mjeteve të nevojshme për përfundimin e kontratës, konkretisht:
- Kamion me vinç 5-8 ton, kërkohen 2 copë, nuk ka paraqitur shoqëria “N” ShPK, ndërsa ka paraqitur shoqëria R.C” ShPK për kamionin me targa AA835ME, I cili eshte ne rregull me dokumentacionin dhe për kamionin me targa AA 918 DO të marrë me qira, që rezulton se mjeti nuk plotësohet me dokumentacionin përkatës të mjetit(kanë përfunduar afatet, kontrolli teknik me datë 22.06.2021 dhe siguracioni i mjetit me datë në Maj.2021);
 - Minieskavator, kërkohen 2 copë, nuk ka paraqitur shoqëria “N” ShPK, ndërsa ka paraqitur 2 copë shoqëria R.C” ShPK, në fakt duke ju referuar volumit të punës sipas zërave të preventivit

të ndarë ndërmjet B, këto 2 mjete duhet ti dispononte shoqëria “N” ShPK, në pronësi posë me qira;

- Autobetonier, kërkohen 3 copë, ka paraqitur shoqëria “N” ShPK, kontratat e qirasë për 3 copë, por referuar dokumentacionit përkatës (Leje qarkullimi, Certifikatë pronësie dhe Leje transporti), poseduesi i këtyre mjeteve i ka “Për përdorim vetjak”, ndaj nuk mund ti japë me qira për të tretë.

Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë **53,717,333 pa TVSH** me një B, i cili është shpallur fitues jo në përputhje me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO, B.B, Sh.Gj, K.S, dhe Titullarin e AK-së të Autorizuar z. A.K.

Ndikimi: Vendosja e kriterëve të kualifikimit dhe vlerësimi i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Tropojë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kriterëve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

3. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje dru zjarri”, Bashkia Tropojë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje dru zjarri”, Nr. REF-01610 datë 26.07-2021.		
1. Hartuesit e fondit limit dhe specifikimeve teknike Urdher nr. 135, datë 21.06..2021 1. A.H , 2. S.M 3. Sh.Gj ekonomist	3. Njësia e Prokurimit, Urdher nr. 153, datë 05.07.2021 1. K.B, jurist (Personi përgjegjës) 2.B.B, teknik ndërtimi 3. M.V, Teknik ndertimi	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 154, datë 05.07.2021 1. K.S, Kryetar 2. E.H 3. F.D
2. Lloji i Procedurës – “E hapur e thjeshtuar”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 5,442,722 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “N.M” SHPK me ofertë 5.398.785 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 3405 prot, dt. 28.09.2021 me afat 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 43,937 lekë ose 8 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 16.08.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë Tropojë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/B b) S’kualifikuar 0 OE/B, c) Kualifikuar 1 OE/B
11. Ankimime; nuk ka ankesë	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Tropojë

Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E hapur e thjeshtuar”, me vlerë 5,442,722 lekë pa TVSH, i cili është financuar nga Bashkia Tropojë.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet asnjë dokument për inicimin e kryerjes së këtij investimi.

Mbi përlogaritjen e fondit limit

Fondi limit nuk është i argumentuar, duke mos testuar tregun për të marrë oferta nga shoqëri të ndryshme që kanë në objektin e veprimtarisë shitjen e automjeteve të ndryshme. Nga ana e grupit preventivues nuk është analizuar asnjë kontratë precedente nga vetë AK apo AK të tjerë, apo edhe nga site zyrtarë të shitjes së mjeteve.

Situata 1.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur e thjeshtuar”. Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 16.08.2021. Referuar të dhënave në faqen e APP-së, rezulton se hapja e ofertave nuk është bërë në të njëjtën kohë nga 3 punonjësit, rezulton: me datë 16.08.2021, hapur nga njëri anëtarë, ndërsa me datë 17.08.2021, është hapur nga 2 anëtarët e tjerë. Gjithashtu edhe mbyllja e procedurës së vlerësimit është bërë në kohë të ndryshme nga anëtarët e KVO, me datë 20.08.2021 mbyllur nga njëri anëtar, ndërsa me datë 23.08.2021 është mbyllur nga 2 anëtarët e tjerë.

Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe ka marrë pjesë në procedurë OE, me ofertën e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	“N.M” person fizik	5,398,785

Burimi i të dhënave: SPE

Punoi: KLSH

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën nr. 2349/1 prot, datë 24.08.2021, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor(i Autorizuar) z. A.K dhe është hedhur në sistem.

Sipas KVO-së, ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DT dhe është kualifikuar:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	“N.M”	5,398,785

Burimi i të dhënave: SPE

Punoi: KLSH

Nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të Operatori Ekonomik fitues N.M, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura ne DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:

1. nuk plotëson kriterin nr. 2.2.b., pasi nuk ka paraqitur kopje të vërtetuar të bilanceve të 2 viteve të njëpas njëshme 2019-2020;

2. Nuk plotësohet kriteri nr. 3. “të tjera”, lidhur me disponimin e mjeteve dhe kapaciteteve teknike nga OE, ku kërkohet që kontratat e qirasë së mjeteve, duhet të mbulojnë afatin e përfundimit të zbatimit të kontratës si dhe mjetet duhet të jenë me dokumentacion të rregullt. Rezulton se për kamionin me targa AA 873 JK, lidhur kontrta e qirasë nr. 2205/787, datë 23.09.2020 dhe kamionin me targa AA 643 SM të marrë me qira, lidhur kontrta e qirasë nr. 2204/786, datë 23.09.2020, afatet e kontratave janë 1 vit, ndërsa nuk përfshijnë periudhën e zbatimikt të kontratës. Gjithashtu rezulton se mjetet nuk plotësohen me dokumentacionin

përkatës të mjetit (Afati i kontrollit teknik për mjetin e dytë kanë përfunduar afatet, kontrolli teknik me datë 28.01.2021);

Gjithashtu rezulton se lidhja e kontratës, është bërë me datë 09.09.2021, Njoftimi i fituesit është bërë me datë 24.12.2021, gjithashtu edhe publikimi i kontratës është bërë me datë 24.12.2021, duke shkelur të gjitha afatet, veprime në kundërshtim me nenin 119 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 32, pikën 5 neni 7 të VKM nr. 285, datë 09.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku citohet: ..”Autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim, njoftimin e fituesit, në përputhje me parashikimet e nenit 97, të LPP-së, dhe njoftimin e lidhjes së kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të kontratës”. Për mosveprimin në kohë dhe brenda afteve ngarkohet me përgjegjësi Personi përgjegjës për prokurimet.

Ky mosveprim ka sjellë mungesë trasnsaparence në procedurën e prokurimit dhe ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë **5,398,785 pa TVSH** me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së K.S, Kryetar, E.H, F.D dhe Titullarin e AK-së të Autorizuar z. A.K

Ndikimi: Vendosja e kriterëve të kualifikimit dhe vlerësimi i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Tropojë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kriterëve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

4. Procedura e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Shkollës “Oso Dauti”, Njësia Administrative Llugaj”, Bashkia Tropojë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ Rikonstruksion i Shkollës “Oso Dauti”, Njësia Administrative Llugaj”, Nr. Ref. 42339-09-19-2022.		
Urdhër Prokurimi Nr. 243, datë 04.08.2022, hartuesit e dokumentave, specifikime teknike dhe fondi limit 1.E.M inxh. 2. M.K 3. A.D ekonomist	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 234, datë 04.08.2022 Njësia e Prokurimit 1. E.N, 2. E.S, 3. S.M, inxhiner pyjesh	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 266, datë 02.11.2021 1. J.Q, Kryetar, 2. E.B ekonomiste 3. S.A ekonomist
2. Lloji i Procedurës – “E hapur”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 47,167,647 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “Sh.A” ShPK me ofertë 37,728,928 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 416/53 prot, dt. 23.12.2022 me afat 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 9,438,719 lekë ose 20 %

8. Data e hapjes së tenderit Datë 12.10.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Tropojë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 8 OE/B b) S'kualifikuar 4 OE/B, c) Kualifikuar 4 OE/B
4. Ankimime; - B "V" shpk&"G" shpk - B "O" shpk &"M" shpk	12. Përgjigje Ankesës nuk	13. Përgjigje Ankesës Nuk pranohet për mos zbatim procedurash

Burimi i të dhënave: Bashkia Tropojë
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është "E hapur", me vlerë 47,167,647 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet asnjë dokument për iniciimin e kryerjes së këtij investimi.

Mbi projektpreventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga shoqëria "A.E.E" ShPK dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Tropojë, z. R.B. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 12 muaj nga fillimi i punimeve. Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 120/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike**, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...". Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Tropojë, z. R.B.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 17.09.2022.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbali pa nr. prot, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 2, "Dokumentimi i procesit" dhe neni 78, pika 2 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit".

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura (edhe në shtojcën nr. 1 dhe nr. 2), u konstatua se:

1- Në pikën 2.3.2 të kërkesave të aftësive TP, nuk është vendosur te kriteri i licencave profesionale të OE, kërkesa për kategorinë NS-1-Punime prishje, pasi kjo kategori bën pjesë në zërat e punimeve referuar preventivit të punimeve;

2. Në pikën 2.3.2 të kërkesave të aftësive TP, nuk është vendosur kërkesa "Operatori Ekonomik të ketë licencë profesionale nga QKL, Kodi 1.2.A. për "Mbrojtjen nga Zjarri", ose të paraqesë kontratë me konsulentë të licensuar në këtë drejtim. Ky kriter është i nevojshëm, pasi nisur nga

preventivi i punimeve, është në përpjesëtim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me nenin 25 dhe nenin 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e Njësisë së Prokurimit, E.N, E.S, jurist, S.M, inxhinier pyjesh.

Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga projektuesi i objektit shoqëria “A.E.E” ShPK, dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Tropojë, z. R.B. Nga verifikimi i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se volumet e punës për disa zëra punimesh nuk janë të argumentuara, pasi në projekt mungojnë detajet përkatëse mbi bazën e të cilave llogariten volume. Çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Veprime në kundërshtim me pikën 2 neni 76 të VKM nr. 285, datë 09.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”. Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE/B, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	B “Rr.G” SHPK&”B.K” ShPK	39,659,172
2	“Sh.A” ShPK	37,728,928
3	“C” ShPK	55,546,159
4	“N” ShPK	42,920,757
5	B “O”shpk&”M”	42,330,026
	B “V”shpk &”G”	46,437,662
	OE “A.K” shpk	45,726,634
	OE “Z” shpk	40,426,307

Burimi i të dhënave: SPE

Punoi: KLSH

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën nr. 3414/2 prot, datë 26.10.2022, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor(i Autorizuar) z. F.K dhe është hedhur në sistem.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DT dhe është kualifikuar:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	OE “Sh.A” ShPK	37,728,928
2	OE “Z”	40,426,307
3	OE “A.K”	45,726,634
4	OE “C”	55,546,159

Burimi i të dhënave: SPE

Punoi: KLSH

Me Vendimin nr. 3419 prot, datë 12.10.2022 Titullari i AK ka miratuar klasifikimin e ofertave dhe shpalljen e fituesit “Sh.A” ShPK, si oferta më e ulët e paraqitur.

Nga B ofertues, B “O”&”M” dhe B “V”&”G”, është paraqitur ankesë, pranë Autoritet Kontraktkor, lidhur me procedurën e vlerësimit të ofertave, të cilët kanë paraqitur pretendimet e tyre. AK me Urdhrin nr. 3416/5 prot, datë 07.11.2022, ka ngritur një komision për shqyrtimin e ankesave, i përbërë nga K.B, A.M dhe R.V. Anëtarët e komisionit kanë mbajtur procesverbalin nr. 4685/3, datë 09.11.2022 për shqyrtimin e ankesave, dhe me Vendimin nr. 4685/1, datë 09.11.2022 është vendosur “refuzim i ankesës” së paraqitur nga B “V”&”G”, si dhe Vendimin nr. 4685/2, datë 09.11.2022 është vendosur “refuzim i ankesës” së paraqitur nga B “O”&”M”, me argumentimin se ankesat përkatëse nuk janë paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik. Veprura sipas përcaktimeve ligjore në pikën 1 të nenit 112 të ligjit nr. të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Ndikimi: Vendosija e kriterëve të kualifikimit në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Tropojë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kriterëve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

5. Procedura e prokurimit me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë-Lekurtaj”, Bashkia Tropojë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë -Lekurtaj”, Nr. REF-23089-03-25-2022		
Urdhër Prokurimi Nr. 1269, datë 16.03.2022, hartuesit e dokumentave, specifikime teknike dhe fondi limit 1.H.I, inxh. ndert. 2.M.V tek. Nd. 3.E.M inxhinier ndërtimi	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 1334 prot, datë 23.03.2022 Njësia e Prokurimit 1. K.B, (kryetar) 2. M.Gj, 3. S.M, inxhiner pyjesh	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 1366 prot, datë 23.03.2022 1. M.K, Kryetar, 2. J.Gj 3. B.B
2. Lloji i Procedurës – “E hapur”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 10,986,652 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) B.V shpk & G ShPK me ofertë 10,079,883 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 1336/3 prot, dt. 17.05.2022 me afat 3 muaj nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 906,769 lekë ose 8.2 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 12.10.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Tropojë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/B
5. Ankimime nuk ka;	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Tropojë

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E hapur”, me vlerë 10,986,652 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet asnjë dokument për inicimin e kryerjes së këtij investimi.

Mbi projektpreventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga punonjësit e bashkisë dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Tropojë, z. R.B. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 3 muaj nga fillimi i punimeve. Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...**”. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Tropojë, z. R.B.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 25.03.2022.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr. prot, datë 25.03.2022, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 2, “Dokumentimi i procesit” dhe neni 78, pika 2 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura (edhe në shtojcën nr. 1), u konstatua se:

1- Në pikën 2.3.2 të kërkesave “Licenca profesionale e shoqërisë për realizmin e punimeve”, nuk është vendosur, kërkesa për kategorinë NP- 9-A-Punime mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikimi, pasi kjo kategori bën pjesë në zërat e punimeve referuar preventivit të punimeve(f.v. tombino, f.v. tub drenazhi, tuba çeliku, etj);

2. Në pikën 2.3.6 të kërkesave të aftësive TP, është vendosur kërkesa “Operatori Ekonomik të paraqesë certifikatë cilësë të punimeve, sipas standardeve: për “ISO 3834-2:2006-Sistemi i menaxhimit të cilësisë në saldim”. Ky kriter nuk është i nevojshëm, pasi nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjesëtim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me nenin 25 dhe nenin 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e Njesisë së Prokurimit, S.M, inxhinier pyjesh, M.Gj, K.B,

Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga grupi i punës së Bashkisë Tropojë. Nga verifikimi i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur e thjeshtuar”. Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 07.05.2022.

Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe ka marrë pjesë në procedurë OE, me ofertën e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	B.V shpk & G ShPK	10,079,883

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën nr. 1336/1 prot, datë 14.04.2022, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor(i Autorizuar) z. A.K dhe është hedhur në sistem. Ky Raport përmbledhës, është nënshkruar nga 2 anëtarët e KVO, respektivisht M.K dhe B.B, ndërsa nuk është nënshkruar nga J.Gj, gjithashtu edhe njoftimi datë 14.04.2022 “Për mbyllje vlerësimi përfundimtar”.

Sipas KVO-së, ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DT dhe është kualifikuar:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	B.V shpk & G ShPK	10,079,883

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Me deklaratë noterale nr. 2891/, da1954 datë 05.04.2022, është bërë marrëveshja(për bashkim të përkohshëm), ndërmjet Shoqërisë “V” ShPK dhe shoqërisë “G” ShPK, duke ndarë edhe volumin e punës, ku 52 % e punimeve të preventivit do të kryhen nga “V” ShPK dhe 48 % nga shoqëria “G” ShPK, ndërsa nuk kanë ndarë edhe volumet sipas zërave të preventivit përkatës që do të realizojë sejcili operator.

Nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të Operatori Ekonomik fitues B.V shpk & G ShPK ShPK, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura ne DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:

- Nuk ka një ndarje të zërave të punimeve që do të kryejë sejcili operator, sipas preventivit të punimeve

2. B.V shpk & G ShPK ShPK, nuk plotëson tek KT kriterin nr. 2.3.4, ku operatorët ekonomikë duhet të ketë një punësim të paktën 40 punonjës, për 2 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit(zhvilluar datë 7.04.2022), sipas vërtetimit të lëshuar nga administrata tatimore, rezulton për muajin Janar dhe shkurt, ndërsa duhet të vërtetohej për muajin mars;

3. B.V shpk & G ShPK nuk plotëson tek KT kriterin nr. 2.3.6, ku operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, ndër të tjera edhe certifikatën ISO 3834-

2:2006(Sistemi i menaxhimit të cilësisë në saldim), me gjithëse ky kriter nuk është i argumentuar është vendosur, rezulton se nuk është paraqitur nga operatorët;

4. Nuk plotësohet kriteri nr. 2.3.5, ku referuar volumit të punës që zë sipas preventivit, nuk plotëson numërin e punonjësve të kualifikuar sipas pozicioneve të kërkuara, konkretisht:

- nga 8 manovratorë të kërkuar, ka paraqitur kontratë dhe dokumentacion G ShPK vetëm për një manovrator, ndërsa operatori V. shpk, nuk ka paraqitur kontratë dhe dokumentacion përkatës për asnjë manovrator;

- nga 5 shoferë të kërkuar, nuk ka paraqitur dokumentacion përkatës asnjëri nga operatorët ekonomikë

5. Nuk plotësohet kriteri nr. 2.3.7, lidhur me disponimin e mjeteve dhe kapaciteteve teknike nga OE. Referuar volumit të punës sipas zërave të preventivit, nuk plotësohet me numërin e mjeteve të nevojshme për përfundimin e kontratës, konkretisht:

- Kamion me kapacitet mbajtës minimumi 5 ton, kërkohen 5 copë, ka paraqitur shoqëria “V” ShPK, ndërsa nuk ka paraqitur asnjë shoqëria “G” ShPK, referuar ndarjes së volumit të punës çdo operator duhet të ketë në dispozicion mjetet e nevojshme;

- Eskavator me çekiç, kërkohen 1 copë, ka paraqitur shoqëria “V” ShPK, ndërsa nuk ka paraqitur shoqëria “G” ShPK, referuar ndarjes së volumit të punës çdo operator duhet të ketë në dispozicion mjetet e nevojshme;

- Kamion autovinç 5 ton, kërkohet 1 copë, nuk ka paraqitur asnjëri nga operatorët ekonomik;

- Grejder, Vibrator, Rul me vibrim, kërkohen nga 1 copë, ka paraqitur shoqëria “V” ShPK, ndërsa nuk ka paraqitur shoqëria “G” ShPK, referuar ndarjes së volumit të punës çdo operator duhet të ketë në dispozicion mjetet e nevojshme;

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim, është vepruar në kundërshtim me nenin 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e KVO.

Ky mosveprim ka sjellë mungesë transparence në procedurën e prokurimit dhe ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 10,079,883 pa TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së M.K, Kryetar dhe B.B dhe Titullarin e AK-së të Autorizuar z. A.K

Ndikimi/efekti: Vendosja e kriterëve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Tropojë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kriterëve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

6. Procedura e prokurimit me objekt “ Rikonstruksion thertorja Shudenicë+Ndërtim i tregut të bagëtive”, Bashkia Tropojë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ Rikonstruksion thertorja Shudenicë+Ndërtim i tregut të bagëtimeve”, Nr. REF-28926-05-13-2022		
Urdhër Prokurimi Nr. 1406, datë 29.03.2022, hartuesit e dokumentave, specifikime teknike dhe fondi limit 1.H.I, inxh. ndert. 2.M.V tek. Nd. 3.E.M inxhinier ndërtimi	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 2172 prot, datë 13.05.2022 Njësia e Prokurimit 1. K.B, (kryetar) 2. Sh.Gj, 3. S.M, inxhinier pyjesh	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 2173 prot, datë 13.05.2022 1. A.M, Kryetar 2. M.K , 3. F.D, ekonomiste
2. Lloji i Procedurës – “E hapur”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 12,786,238 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) B.O shpk & T Shpk me ofertë 12,678,100 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 1336/3 prot, dt. 17.05.2022 me afat 3 muaj nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 108,138 lekë ose 0.8 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 31.05.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Tropojë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/B
2. Ankimime nuk ka;	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Tropojë
Punoi: KLSH

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E hapur”, me vlerë 12,786,238 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet asnjë dokument për iniciimin e kryerjes së këtij investimi.

Mbi projektpreventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga punonjësit e bashkisë dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Tropojë, z. R.B. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 3 muaj nga fillimi i punimeve. Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...**”. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Tropojë, z. R.B.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 13.05.2022.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr. prot, datë 13 .05.2022, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 2, “Dokumentimi i procesit” dhe neni 78, pika 2 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”.

Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga grupi i punës së Bashkisë Tropojë. Nga verifikimi i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur e thjeshtuar”. Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 31.05.2022.

Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe ka marrë pjesë në procedurë OE, me ofertën e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	B.O shpk & T Shpk	12,678,100

Burimi i të dhënave: SPE

Punoi: KLSH

Me kontratën noterale nr. 2024/904, datë 31.05.2022, është bërë marrëveshja (për bashkim të përkohshëm), ndërmjet Shoqërisë T Shpk dhe shoqërisë “O” ShPK, duke ndarë edhe volumin e punës, ku 30 % e punimeve të preventivit do të kryhen nga T Shpk dhe 70 % nga shoqëria “O” ShPK, duke ndarë edhe volumet sipas zërave të preventivit përkatës që do të realizojë secili operator.

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën nr. 913/1 prot, datë 27.06.2022, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor (i Autorizuar) z. A.K dhe është hedhur në sistem. Rezulton se ky raport nuk është nënshkruar nga anëtari i tretë i KVO, znj. F.D, duke refuzuar me pretendimin se nuk plotësohen kriteret e kualifikimit. Me shkresën nr. 2605 prot, datë 09,06,2022, “”Sqarim procedurë prokurimi”, të tre anëtarët e KVO, kanë vënë në dijeni Kryetarin e Bashkisë z. R.B dhe Nënkryetaren e Bashkisë Znj. Z.I, lidhur me konstatimin e mungesës së dokumentacionit të paraqitur nga B.O shpk & T Shpk, ofertë e vetme që ka marrë pjesë në këtë procedurë

Me shkresën nr. 2605 prot, datë 09,06,2022, “”Sqarim procedurë prokurimi”, të 2 anëtarët e KVO, M.K dhe F.D, kanë vënë në dijeni Kryetarin e Bashkisë z. R.B, lidhur me arsyet që kanë çuar në s’kualifikimin e B.O shpk & T Shpk. Gjithashtu anëtarët e KVO, i janë drejtuar me email Agjencisë së Prokurimit, duke i vënë në dijeni, si dhe duke kërkuar mendim për vijimin e procedurës, ndërsa në përgjigjen e saj APP-ja, ju ka bërë me dije se është e drejtë e AK-së për të shqyrtuar ofertat dhe marrjen e vendimeve përkatëse. Njëkohësisht me datë 16.06.2022, 2 anëtarët e KVO, M.K dhe A.M, kanë deklaruar se pasi u refreskua dokumentacioni nga B, dakordësohen për të vijuar vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur, ndërsa anëtari tretë znj.

F.D, nuk ka pranuar. Theksojmë deklarata është bërë në të njëjtën datë me shkresën nr. 2605 prot, të cilat kanë qëndrime të kundërta nga anëtri i KVO z. M.K, për të njëjtën çështje.

Lidhur sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit fizik në dosje dhe dokumentacionit të ngarkuar elektronikisht në faqen e APP-së, rezulton, rikthimi i 2 anëtarëve të KVO, për vijimin e procedurës së vlerësimit të ofertës dhe përfundimi i saj duke kualifikuar B.O shpk & T Shpk, është bërë në kushtet e mosplotësimit të kushteve për të cilat ishte s'kualifikuar më parë, pasi:

- Mungon vërtetimi i likuidimit të taksave vendore për periudhën 01.01.2021 deri 31.12.2021, nga OE ofertues T. Shpk;

- Mungon certifikata rifreskuar OH SAS 18001;2007, të cilës i ka përfunduar afati, ndërsa janë rifreskuar vetëm 2 certifikata.

Sipas KVO-së, ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DT dhe është kualifikuar:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	B.O shpk & T Shpk	12,678,100

Burimi i të dhënave: SPE

Punoi: KLSH

Gjithashtu nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të Operatori Ekonomik fitues B.O shpk & T Shpk, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:

1. OE T Shpk, nuk plotëson tek Kriteret e Përgjithshme, pikën i, pasi nuk ka paraqitur deklaram apo vërtetimin përkatës, për mos përjashtim nga procedurat e prokurimit të anëtrëve në cilësinë e drejtuesëve, apo kompetenca përfaqësuese.....

2. OE T Shpk, nuk plotëson tek KV kriterin nr. 2.2.1, ku operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për 3 vite(2019-2021), të shoqëruara me Akt Ekspertizë nga eksperti kontabël, rezulton se nuk është paraqitur bilanci për vitin 2020 dhe rezultojnë të pa shoqëruar me Akt Ekspertizë nga eksperti kontabël;

3. OE T Shpk, nuk plotëson tek KT kriterin nr. 2.4.1, ku operatorët ekonomikë duhet të Përcaktojnë me anë të një deklarate Drejtuesin teknik, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, shoqëruar me kontratë punë dhe diplomë.

4. OE T Shpk, nuk plotëson tek KT kriterin nr. 2.4.3, ku operatorët ekonomikë duhet të ketë një punësim të paktën 26 punonjës, për 2 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, sipas vërtetimit të lëshuar nga administrata tatimore. Rezulton se ka paraqitur vetëm për muajin prill vetëm për 6 persona të stafit drejtues dhe teknik, përfshirë edhe drejtuesin ligjor;

4. OE T Shpk, nuk plotëson kriterin nr. 2.7, lidhur me disponimin e mjeteve dhe kapaciteteve teknike nga OE, referuar volumit të punës sipas zërave të preventivit, nuk ka paraqitur asnjë mjet të disponueshëm për realizimin e pjesës takuese të kontratës.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim, është vepruar në kundërshtim me nenin 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Ky mosveprim ka sjellë mungesë trasnsaparence në procedurën e prokurimit dhe ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë **12,678,100 pa TVSH** me një OE, i cili është shpallur fitues në

papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së M.K, Ariola Madani dhe Titullarin e AK-së të Autorizuar z. A.K.

Ndikimi/efekti: Vendosja e kriterëve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Tropojë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kriterëve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Për sa trajtuar në faqet 57-95 të Raportit Përfundimtar të auditimit(derguar subjektit me shkresën nr. 518/4, datë 31.08.2023, protokolluar në Bashkinë Tropojë me nr. 2751/44, datë 08.09.2023), janë paraqitur observacione në rrugë elektronike dhe me shkresën nr. 2751/58, datë 06.10.2023, protokolluar në KLSH me nr. 518/6, datë 09.10.2023.

Pretendimi subjektit:

I-Në obeservacionin e paraqitur me shkresën nr. 2751/54, datë 06.10.2023, nga B.B, Sh.Gj dhe K.S, në cilësinë e anëtarit të KVO. Lidhur me konstatimet për procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikim i Lagjes “Partizani””, pretendohet:

Lidhur me konstatimin se nuk plotësohet kriteri 2.3.6, për numërin e punonjësve të kualifikuar, ku nga 2 teknikë rezulton 1 teknik ndërtimi, sqarojmë: Referuar shtojcës nr. 8(Vetëdeklarimi), rezulton se B ka paraqitur 4 punonjës teknikë ndërtimi(njëri ndër to është inxhinier Hidroteknik, i cili është nivel më i lartë se Teknik ndërtimi)....

Lidhur me konstatimin se mungojnë 3 punonjës mekanikë, sqarojmë se, Referuar shtojcës nr. 8(Vetëdeklarimi), rezulton se B ka paraqitur 5 punonjës mekanikë....

Lidhur me konstatimin se mungon 1 punonjës hidraulik, sqarojmë se, Referuar shtojcës nr. 8(Vetëdeklarimi), rezulton se B ka paraqitur 2 punonjës hidraulikë....

Lidhur me konstatimin se mungon 1 punonjës Gjeometër, sqarojmë se, Referuar shtojcës nr. 8(Vetëdeklarimi), rezulton se B ka paraqitur 1 teknik gjeometer....

Lidhur me konstatimin se mungon 1 punonjës elektrikist, sqarojmë se, Referuar shtojcës nr. 8(Vetëdeklarimi), rezulton se B ka paraqitur 2 punonjës elektrikist....

Lidhur me konstatimin se mungojnë 2 punonjës saldator, sqarojmë se, Referuar shtojcës nr. 8(Vetëdeklarimi) (këto 2 punonjës shoqëria R.C, e cila nuk ka punime saldimiti, ndaj duhet të ishin staf I shoqërisë N), rezulton se B ka paraqitur 2 punonjës saldimiti....

Lidhur me konstatimin se mungojnë 3 punonjës hekur kthyes, sqarojmë se, Referuar shtojcës nr. 8(Vetëdeklarimi) (këto 3 punonjës I ka paraqitur shoqëria R.C, e cila nuk ka punime të tilla, ndaj duhet të ishin staf I shoqërisë N), rezulton se B ka paraqitur 3 punonjës hekurkthyes....

Lidhur me konstatimin se mungojnë 3 punonjës karpentier, sqarojmë se, Referuar shtojcës nr. 8(Vetëdeklarimi) (këto 3 punonjës I ka paraqitur shoqëria R.C, e cila nuk ka punime të tilla, ndaj duhet të ishin staf I shoqërisë N), rezulton se B ka paraqitur 3 punonjës kerpentier....

Lidhur me konstatimin se mungojnë 2 punonjës pallaka shtrues nga 3 të kërkuar, sqarojmë se, Referuar shtojcës nr. 8(Vetëdeklarimi), rezulton se B ka paraqitur 3 punonjës plaka shtrues.... Lidhur me konstatimin se mungojnë 1 punonjës manovrator nga 3 të kërkuar, sqarojmë se, Referuar shtojcës nr. 8(Vetëdeklarimi), rezulton se B ka paraqitur 3 punonjës plaka shtrues.... Sa më sipër sqarojmë se referuar marrveshjes së bashkimit të përkohshëm të shoqërive nr. 12164 Re. nr. 8010 Kol. , shoqëritë kanë rënë dakort të hyjnë në raporte juridike bashkëpunimi....., referuar kësaj marrveshje B do të konsiderohet si subject I vetëm juridik për këtë object prokurimi...

Lidhur me konstatimin se nuk plotësohet kriteri 2.3.4, ku kërkohet që administratori me anë të një deklaratë të përcaktojë Drejtuesin Teknik, sqarojmë se nga shoqëria N është përcaktuar Drejtuesi Teknik, ndërsa nga shoqëria R.C, nuk është bërë deklarata.

Sqarojmë se në Shtojcën nr. 1, të ndryshimit të kriterëve të veçanta nuk përmendet pika 2.3.4, rrjedhimisht është hequr nga Komisioni I hartimit të dokumentave. Referuar shtojcës nr. 8(Vetëdeklarimi), rezulton se B i I ka plotësuar kërkesat për stafin teknik.

Lidhur me konstatimin se nuk plotësohet kriteri 2.3.10, ku kërkohet që OE të ketë licencë profesionale kodi I.2.A për “Mbrojtjen nga zjarri” dhe s nuk plotësohet kriteri 2.3.11, ku kërkohet që OE të ketë licencë profesionale kodi II.2.B për “grumbullim, transport, ruajtje e mbetjeve urane” Nga verifikimi I dokumenteve, konstatojmë se janë paraqitur këto licenca nga OE R.C, rezulton se B i I ka plotësuar kërkesat.

Lidhur me konstatimin se nuk plotësohet kriteri 2.3.15, për paraqitjen e mostrave nga B duke ja vënë në dispozicion KVO, sqarojmë se janë paraqitur mostrat nga B, në momentin e hapjes së ofertave.

Lidhur me konstatimin se nuk plotësohet kriteri 2.3.16, lidhur me disponimin e mjeteve dhe kapaciteteve teknike, konkretisht:

Kamion vinç 5-8 ton, kerkuar 2 copë,... sqarojmë se për plotësimin e kësaj këkese kanë paraqitur 2 kamionë vinç, nga N mjete me targa AA 078YC, me dokumentacion shoqërues deri 23.07.2022, ndërsa nga R.C mjete me targa AA 853ME, me dokumentacion shoqërues deri 29.08.2022;

Minieskavator, kerkuar 2 copë,... sqarojmë se, Referuar shtojcës nr. 8(Vetëdeklarimi), rezulton se B ka paraqitur 3 punonjës manovrator....., si dhe janë paraqitur minieskavator, 2 nga shoqëria N dhe 1 nga shoqëria R.C..

Autobetonier, kerkuar 3 copë,... sqarojmë se janë paraqitur 3 autobetonier nga shoqëria N... referuar të dhënave B I ka plotësuar kërkesat për makineri.

2-Në obeservacionin e paraqitur me shkresën nr. 2751/52, datë 29.09.2023, nga nga anëtarët e njësisë së prokurimit(K.B, E.D, F. D., E. M., S.M, M.Gj, M.V, B.B, Sh.Gj, E.K),

- lidhur me konstatimet për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kamioni”, **Bashkia Tropojë**, sqarohet: Ne baze te Urdherit nr.161 date 09.07.2021 ka dale urdheri prokurimit per krijimin e Njesise prokurimit ne baze te Neni 77, pas përllogaritjes së fondit limit sipas nenit 76,, i cili duhet të përmbajë: _objektin e prokurimit; _fondin e përllogaritur të vitit buxhetor,

emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit, duke evidentuar personin/at përgjegjës, dhe nëse është rasti edhe specialistin e fushës, sipas parashikimeve të nenit 74, të këtyre rregullave.

Ky urdher hartohet nga personi përgjegjës për prokurimin ne baze te nenit 74,te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Per miratimin e rregullave prokurimit publik.

Me ngritjen e komisionit te njesise prokurimit duke ditur elementet e nenit 77 te VKM nr.285 date 19.05.2021dhe dokumentacioni i marre nga komisioni i hartimit te specifikimeve teknike dhe fondit limit i ngritur me Urdher nr. 158,date 06.072021, kemi hartuar kriteret e pjesmarrjes per kete proçedure pas shpalljes per tender sipas përcaktimeve ligjore. Kordinimi APP ka nderhyre per dhenje asistence ne vendosjen e kriterëve duke u marre per baze nga ana e jone ne masesn 100 % dhe duke hartuar shtojcen perkates sipas sygjërimeve. (bashkëlidhur Njoftim i shkurter i kontrates; Specifikimet teknike, asistenca e APP, shtojcat 1 dhe 2)

*- lidhur me konstatimet për procedurën e prokurimit me **objekt “Rikualifikim urban Lagja Partizani, Blloku 1&2”**, sqarohet:*

Ne baze te Urdherit nr.265 date 02.11.2021 ka dale urdheri prokurimit per krijimin e Njesise prokurimit ne baze te Neni 77, pas përllogaritjes së fondit limit sipas nenit 76,, i cili duhet

të përmbajë: objektin e prokurimit; _fondin e përllogaritur të vitit buxhetor,

emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit, duke evidentuar personin/at përgjegjës, dhe nëse është rasti edhe specialistin e fushës, sipas parashikimeve të nenit 74, të këtyre rregullave.

Ky urdher hartohet nga personi përgjegjës për prokurimin ne baze te nenit 74,te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Per miratimin e rregullave prokurimit publik

Me ngritjen e komisionit te njesise prokurimit duke ditur elementet e nenit 77 te VKM nr.285 date 19.05.2021dhe dokumentacioni i marre nga komisioni i hartimit te specifikimeve teknike dhe fondit limit i ngritur me Urdher nr. 243,date 22.10.2021, kemi hartuar kriteret e pjesmarrjes per kete proçedure pas shpalljes per tender sipas përcaktimeve ligjore. Kordinimi APP ka nderhyre per dhenje asistence ne vendosjen e kriterëve duke u marre per baze nga ana e jone ne masesn 100 % dhe duke hartuar shtojcen perkates sipas sygjërimeve. (bashkëlidhur Njoftim i shkurter i kontrates; Specifikimet teknike, asistenca e APP, shtojcat 1 dhe 2)

*- lidhur me konstatimet për procedurën e prokurimit me **objekt “Blerje dru zjarri, Bashkia Tropojë”**, sqarohet:*

Ne baze te Urdherit nr.153 date 05.07.2021 ka dale urdheri prokurimit per krijimin e Njesise prokurimit ne baze te Neni 77, pas përllogaritjes së fondit limit sipas nenit 76,, i cili duhet

të përmbajë: objektin e prokurimit; _fondin e përllogaritur të vitit buxhetor,

emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit, duke evidentuar personin/at përgjegjës, dhe nëse është rasti edhe specialistin e fushës, sipas parashikimeve të nenit 74, të këtyre rregullave.

Ky urdher hartohet nga personi përgjegjës për prokurimin ne baze te nenit 74,te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Per miratimin e rregullave prokurimit publik.

Me ngritjen e komisionit te njesise prokurimit duke ditur elementet e nenit 77 te VKM nr.285 date 19.05.2021dhe dokumentacioni i marre nga komisioni i hartimit te specifikimeve teknike dhe fondit limit i ngritur me Urdher nr. 135, date 21.06.2021, kemi hartuar kriteret e pjesmarrjes per kete proçedure pas shpalljes per tender sipas përcaktimeve ligjore. Kordinimi APP ka nderhyre per dhenje asistence ne vendosjen e kriterëve duke u marre per baze nga ana

e jone ne masesn 100 % dhe duke hartuar shtojcen perkates sipas sygjerimeve. (bashkëlidhur Njoftim i shkurter i kontrates; asistenca e APP, shtojca 1).

- lidhur me konstatimet për procedurën e prokurimit me **objekt "Rikonstruksion rruga Blini I Grise Lekurtaj"**, sqarohet:

Ne baze te Urdherit nr. 82, datë 23.03.2022 ka dale urdheri prokurimit per krijimin e Njesise prokurimit ne baze te Neni 77, pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 76,, i cili duhet

të përmbajë: objektin e prokurimit; _fondin e përlllogaritur të vitit buxhetor, emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit, duke evidentuar personin/at përgjegjës, dhe nëse është rasti edhe specialistin e fushës, sipas parashikimeve të nenit 74, të këtyre rregullave.

Ky urdher hartohet nga personi përgjegjës për prokurimin ne baze te nenit 74,te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Per miratimin e rregullave prokurimit publik.

Me ngritjen e komisionit te njesise prokurimit duke ditur elementet e nenit 77 te VKM nr.285 date 19.05.2021dhe dokumentacioni i marre nga komisioni i hartimit te specifikimeve teknike dhe fondit limit i ngritur me Urdher nr. 1269, date 16.03.2022, kemi hartuar kriteret e pjesmarrjes per kete procedure pas shpalljes per tender sipas përcaktimeve ligjore. Kordinimi APP ka nderhyre per dhenje asistence ne vendosjen e kriterëve duke u marre per baze nga ana e jone ne masesn 100 % dhe duke hartuar shtojcen perkates sipas sygjerimeve. (bashkëlidhur Njoftim i shkurter i kontrates; asistenca e APP, shtojca 1);

- lidhur me konstatimet për procedurën e prokurimit me **objekt "Rikonstruksion thertorja Shudenice + ndertim i tregut të bagëtime"**, sqarohet:

Në bazë të Urdhërit nr. 96 date 31.03.2022 të prokurimit per krijimin e Njesise prokurimit ne baze te Neni 77, pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 76,, i cili duhet të përmbajë:

objektin e prokurimit; _fondin e përlllogaritur të vitit buxhetor, emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit, duke evidentuar personin/at përgjegjës, dhe nëse është rasti edhe specialistin e fushës, sipas parashikimeve të nenit 74, të këtyre rregullave.

Ky urdher hartohet nga personi përgjegjës për prokurimin ne baze te nenit 74,te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Per miratimin e rregullave prokurimit publik.

Per cdo raste ne DST ,dhe njoftimin e kontrates shkruhen adresa e AK, personi pergjegjes i prokurimit. te dhenat e kontaktit, adresa e e-mail.numri telefonit,emer mbiemer.

Me ngritjen e komisionit te njesise prokurimit duke ditur elementet e nenit 77 te VKM nr.285 date 19.05.2021dhe dokumentacioni i marre nga komisioni i hartimit te specifikimeve teknike dhe fondit limit i ngritur me Urdher nr. 1406, date 29.03.2022, kemi hartuar kriteret e pjesmarrjes per kete procedure pas shpalljes per tender sipas përcaktimeve ligjore. Kordinimi APP ka nderhyre per dhenje asistence ne vendosjen e kriterëve duke u marre per baze nga ana e jone ne masesn 100 % dhe duke hartuar shtojcen perkates sipas sygjerimeve. (bashkëlidhur Njoftim i shkurter i kontrates; asistenca e APP, shtojca 1).

Theksojmë se në të gjitha keto procedura kemi qene ne rolin e anëtarit të komisionit dhe jo të përgjegjësit te prokurimit. Në aktin e konstatimit është vendosur nr. 2172, datë 13.05.2022 i urdhërit të njësisë së prokurimit, i cili nuk ekziston për objektin "**Rikonstruksion thertorja Shudenice + ndertim i tregut të bagëtime**". Nuk ekziston Vkm nr. 258, date 19.05.2021, cituar

ne material, si dhe pika 5 e nenit 25 te VI<M(ne fakt është VKM) nr.285,date 19.05.2021 nuk ekziston. Gjithashtu ka pasaktësi në emërtimin e emrave të anëtarëve te komisionit !

3-Në obeservacionin e paraqitur me shkresën nr. 2751/50, datë 28.09.2023, nga anëtarët e KVO-së, pretendohet:

- lidhur me konstatimet për procedurën e prokurimit me objekt **“Blerje kamioni”, Bashkia Tropojë**, sqarohet:

KVO e ngritur me Urdhërin nr. 162, datë 09.07.2021, ka studiuar dosjen e inventarit të firmës T shpk, ndër to edhe Formulari I ofertës njehsuar me origjinalin, bashkelidhur foto, specifikimet teknike dhe deklarata e garancisë. Pas rekomandimit të APP janë bërë ndryshime të specifikimeve teknike sipas shtojcës nr. 2, Sqarojmë se sipas kriterëve specifikimet teknike konsiderohen të plotësuar edhe kur janë ekuivalente me kriteret e vendosura nga NJP, dhe mos plotësimi I opsioneve ekstra është konsideruar se nuk përbën arsye për skualifikim.....

Lidhur me mosplotësimin e kriterit për paraqitjen e bilanceve të 2 viteve të fundit 2019-2020, me qenëse se OE T, është krijuar në vitin 2020, e kemi konsideruar sit ë plotësuar, pasi në vitin 2019 nuk ka ekzistuar... kjo shoqëri ka dorëzuar pranë Bashkisë Tropojë pasqyrat financiare të vitit 2020, të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e tatimeve.

Lidhur me konstatimin se OE nuk plotëson tek Kriteret e Përgjithshme pikën “i”, pasi nuk ka deklaruar, se OE apo personeli vendimmarrës i tij, nuk janë përjashtuar nga APP për të marrë pjesë në tendera, sqarojmë; nga KVO është kryer verifikimi në faqen zyrtare të APP-së dhe deri në buletin nr. 142, datë 27.09.2021 ky operator nuk ka qenë në listën e operatorëve të ekonomik të përjashtuar nga e drejta për fituar kontrata publike..... administratorja A.P. nuk është dënuar si administrator për të mos marrë pjesë në pocedurat e prokurimit sipas përcaktimeve të nenit 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, kjo referuar edhe devetdeklarimit dhe vertetimeve nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Tiranë .

4-Në obeservacionin e paraqitur me shkresën nr. 2751/46, datë 28.09.2023, nga F.D, në cilësinë e anëtarit të KVO. Lidhur me konstatimet për procedurën e prokurimit me objekt “Blerja Kamioni Bashkia Tropojë”, pretendohet:

-Kam zbatuar Urdherin e Prokurimit nr.161 date 9.7.2021 nr.2437/prot.’’Per Proceduren e Prokurimit ku,unë zj/F.D sipas ketij urdheri jam anëtare e komisionit të njesise së prokurimit dhe nuk jam **personi pergjegjes** ,siç thuhet ne Faqen 62 të Raportit Përfundimtar nga ana juaj. Ky urdher prokurimi përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarët e komisionit , unë jam anëtar komisioni dhe jo personi pergjegjes apo kryetar komisioni.Ju bashkëngjes një kopje të urdhërit për ngritjen e njësise së **prokurimit nr.161, dt. 9.07.2021 shkresa nr.2437/ prot, dhe nuk disponoj ndonjë tjetër që të jem person pergjegjes apo kryetar/kvo.**

Në faqen 67, për procedurën “Blereje dru zjari”, në cilësinë e anëtarit të KVO, kam qenë e sëmure dhe nuk kam qenë e pranishme në ditën e hapjes së tenderit, ndaj hapja dhe mbyllja është kryer në data të ndryshme nga anëtarët e tjerë, por kam firmosur procesverbalin, ku kishte marrë pjesë vetëm një subjekt. Duke qenë se në rrethin tonë është i vetmi subjekt që ka në aktivitetin e tij furnizimin me dru zjarri, kam firmosur procesverbalin.

5- Në obeservacionin e paraqitur me shkresën nr. 2751/51, datë 28.09.2023, nga anëtarët e njësisë së prokurimit, lidhur me konstatimet për procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Shkollës “Oso Dauti”, Njësia Administrative Llugaj”, Bashkia Tropojë, pretendohet;

- Lidhur me konstatimin se nuk është vendosur kriteri i licencave profesionale të OE, për kategorinë NS-1 “Punime prishje”, sqrojmë se: tek këto punime bëjnë pjesë heqje dyesesh, dritaresh, prishje suvaje, etj, të cilat janë punime plotësuese, që në bazë të VKM nr. 943, datë 28.12.2016, mbulohen nga NP-2 “Ndërtime civile dhe industriale”.... Dhe NP-3 “Rikonstruksion dhe mirmbajtje godinash civile dhe industriale”.

- Lidhur me konstatimin se nuk është vendosur kriteri “Operatori ekonomik duhet të ketë licencë profesionale nga QKL, Kodi 1.2.A për “Mrojtjen nga zjarri”, sqarojmë se, ne kemi kërkuar që OE duhet të të ketë certifikata ISO 45001-2018 për menaxhimin e shëndetit dhe sigurinë dhe certifikata ISO 14001:2018, për menaxhim mjedisi. Në bazë të ligjit nr. 8766, datë 05.04.2001, I ndryshuar dhe VKM nr. 538, datë 26.05.2009, kjo kërkesë mund të mbulohet nga certifikata ISO 45001-2018.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me observacionet e paraqitura të sipërcituar, sqarojmë:

Lidhur me pretendimet të përcjella me shkresën nr. nr. 2751/54, datë 06.10.2023, nga anëtarët e KVO-së, sqarojmë se:

Pranohet pjeërisht observacioni juaj, lidhur me konstatimin tonë për pikën 2.3.6, duke konsideruar të plotësuar personelin e kërkuar për 2 Teknikë Ndërtimi, për 2 hidraulikë, për 1 elektrikist dhe për një teknik gjeometer, ndryshimet përkatëse do të refletohen në Raportin Përfundimtar. Ndërsa nuk pranohen objeksionet tuaja për pjesën tjetër të konstatimeve tona, pasi nuk janë të argumentuara dhe nuk janë të mbështetura në fakte dhe dokumente argumentuese, si dhe nuk përputhen me kërkesat ligjore të përcaktuara në pikën 3 neni 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021. Sqarojmë se një pjesë e personelit në dispozicion të realizimit të kontratës, referuar dokumentacionit të paraqitur, kryejnë më shumë se një process pune, gjë e cila nuk është në përputhje me kërkesat e kërkuara.

- Lidhur me pretendimet të përcjella me shkresën nr. 2751/46, datë 28.09.2023, nga F.D, në cilësinë e anëtarit të KVO, sqarojmë se, observacioni juaj është i njëjtë më atë të paraqitur në fazën e hartimit të Raportit Përfundimtar të auditimit, për të cilin jemi shprehur, duke e pranuar, ndërsa riparaqitja e këtij observacioni, tregon mungesë vëmendje në shqyrtimin të materialit të pasqyruar në projekt raportin e auditimit.

- Lidhur me pretendimet të përcjella me shkresën nr. 2751/52, datë 29.09.2023, nga anëtarët e njësisë së prokurimit, sqarojmë se nuk pranohen nga grupi i auditimit, pasi ju nuk keni paraqitur prova apo dokumentacion argumentues. Objeksionet tuaja janë të njëjta me ato të paraqitura në fazën e hartimit të Raportit Përfundimtar të auditimit. Gjithashtu sqarojmë pëseseri se;

Lidhur me pretendimin se anëtarët e njësive së prokurimit, nuk janë në rolin përgjegjës të prokurimit, sqarojmë se në konstatimet tona, për ndarjen e përgjegjësive për veprimet e kryera, jemi referuar pikërisht në përcaktimet ligjore, neni 74, pika 3 dhe pika 4, ku përcaktohen detyrat

përkatëse për përgjegjësin e prokurimeve dhe anëtrin e njesisë prokurimit. Lidhur me procedurën e kryer nga Njësia e prokurimit për objektin "Rikonstruksion thertorja Shudenice + ndertim i tregut të bagëtime", sqarojmë se nuk janë konstatuar shkelje lidhur me veprimet e njesisë së prokurimit. Gjithashtu konsiderohet i realizuar kriteri për 1 Teknik topograf në procedurën "Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë -Lekurtaj", pasi e ka paraqitur OE "V" që ka % më të madhe në kryerjen e punimeve(52%).

- Lidhur me pretendimet të përcjella me shkresën nr. 2751/50, datë 29.09.2023, nga anëtarët e KVO-së, sqarojmë se: nuk janë të argumentuara dhe nuk janë të mbështetura në fakte dhe dokumente argumentuese. Objeksionet tuaja janë të njëjta me ato të paraqitura në fazën e hartimit të Raportit Përfundimtar të auditimit. Gjithashtu sqarojmë pëseseri se;

Lidhur me pretendimin se keni kryer verifikimin në faqen zyrtare të APP-së dhe deri në buletin Nr. 142, datë 27.09.2021 ky operator nuk ka qenë në listën e operatorëve të ekonomik të përjashtuar nga e drejta për fituar kontrata publike, ju sqarojmë se pretendimi juaj nuk qëndron pasi në konstatimin tonë ne nuk jemi shprehur për OE, por për drejtuesin ligjor të OE, që rezulton drejtues ligjor i një kompanie tjetër përjashtuar nga APP, për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

- Lidhur me pretendimet të përcjella me shkresën nr. 2751/51, datë 29.07.2023, nga anëtarët e njesisë së prokurimi, sqarojmë se pretendimet nuk pranohen nga grupi i auditimit, pasi konsiderohen të pa argumentuara me fakte dhe dokumente dhe janë të njëjta me ato të paraqitura në fazën e hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- **Prokurimet me vlera të vogla**

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Dokumentacioni: "Regjistri i realizimeve të procedurave të prokurimit publik" viti 2021 dhe viti 2022.

Nga dokumentacioni dhe të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit, si dhe nga verifikimi i procedurave me zgjedhje në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik" dhe VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet:

Nga verifikimi rast pas rasti, i 44 procedurave të llojit të prokurimit "Blerje me vlerë të vogël" në shumën 12,463,700 lekë (per vitin 2021) dhe 33 procedurave të llojit të prokurimit "Blerje me vlerë të vogël" në shumën 13.690,700 lekë (per vitin 2022) rezulton se në disa raste nga Autoriteti Kontraktor është kryer ndarja e procedurave të prokurimit duke sjellë si pasojë shmangien nga fusha e zbatimit të ligjit, për shkak të ndryshimit artificial të kufirit monetar, pa arsye objektive të cilat do të justifikonin veprimin konkret.

Autoriteti Kontraktor, gjatë planifikimit të nevojave të tij, ka përdorur procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat standarte të prokurimit.

Për sa konstatuar më sipër, veprimet e AK-së bien në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe VKM-në nr. 258, datë 19.05.2021 "Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, e cila konkretisht në nenin 11 pika 5 të saj përcakton se: “Asnjë kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP-ja”.

Referuar sa më sipër, Autoritetet Kontraktore për mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përlllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, është më e madhe se 100,000 (njëqind mijë) lekë, duhet të zbatonte procedurat standarde të prokurimit, ndërsa nuk jemi në kushtet e zbatimit të procedurave me vlerë në kufirin 100,000 lekë.

Të dhëna mbi Regjistrin e Realizimeve të Prokurimit Publik:

Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.07.2021 deri 31.12.2021		
<i>Lloji i procedurës së prokurimit të përdorur nga AK</i>	<i>Procedura gjithësej të realizuara nga data 01.07.2021 deri 31.12.2021</i>	<i>Totali i fondit limit (në lekë pa tvsh) për procedurat përkatëse.</i>
“blerje me vlerë të vogël”	44 procedura	12,463,700
Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.07.2022 deri 31.12.2022		
“blerje me vlerë të vogël”	33 procedura	13,690,700
TOTALI	77	26,154,400

Auditimi i procedurave të prokurimit

Nga verifikimi, rast pas rasi, i procedurave të sipërcituara, rezulton se në disa raste nga Autoriteti Kontraktor është kryer ndarja e procedurave të prokurimit duke sjellë si pasojë shmangien nga fusha e zbatimit të ligjit, për shkak të ndryshimit artificial të kufirit monetar, pa arsye objektive të cilat do të justifikonin veprimin konkret.

Autoriteti Kontraktor, duke periodizuar momentin e planifikimit të nevojave të tij, ka përdorur procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat standarde të prokurimit.

Nga auditimi i të dhënave për procedurat e prokurimit, përkatësisht për periudhën nga data 01.01.2021 deri në datën 31.12.2022, rezultoi se, nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Tropojë, janë kryer procedura prokurimi duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit, konkretisht:

Rasti 1:

Të dhëna mbi Realizimin e Procedurave të Prokurimit:

Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2021 deri 31.12.2021		
<i>Objekti i procedurës së prokurimit.</i>	<i>Lloji i procedurës sipas SPE.</i>	<i>Fondi limit (në lekë pa tvsh) për procedurën përkatëse.</i>
1-Blerje lëndë drusore(për mirmbajtje rruga Markaj)	“blerje me vlerë të vogël”	800,000
2-Blereje produkte drusore(riparim ura e Belit)	“blerje me vlerë të vogël”	800,000

TOTALI	2 procedura	1,600,000
---------------	--------------------	------------------

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktor ka kryer procedura prokurimi duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit. Konkretisht, duke u nisur nga ngjajshmëria apo funksionaliteti i tyre, objektet duhet të prokuroheshin bashkë nëpërmjet procedurës “E hapur e thjeshtuar”.

Për sa konstatuar më sipër, veprimet e AK-së bien në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e cila konkretisht në nenin 56 “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël”, pika 2, përcakton se: “Autoriteti/enti kontraktor planifikon natyrën, sasi të dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi.

Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup - mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure”.

Rasti 2:

Të dhëna mbi Realizimin e Procedurave të Prokurimit:

Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2021 deri 31.12.2021		
<i>Objekti i procedurës së prokurimit.</i>	<i>Lloji i procedurës sipas SPE.</i>	<i>Fondi limit (në lekë pa tvsh) për procedurën përkatëse.</i>
1-Sherbim per mirmbajtje makinash(pjese, aksesore)	“blerje me vlerë të vogël”	800,000
2- Shërbim për makineri(pjesë mjetesh).	“blerje me vlerë të vogël”	800,000
TOTALI	2 procedura	1,600,000

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktor ka kryer procedura prokurimi duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit. Konkretisht, duke u nisur nga ngjajshmëria apo funksionaliteti i tyre, objektet duhet të prokuroheshin bashkë nëpërmjet procedurës “e hapur e thjeshtuar”.

Për sa konstatuar më sipër, veprimet e AK-së bien në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e cila konkretisht në nenin 56 pika 2 të saj përcakton se: “Autoriteti/enti kontraktor planifikon natyrën, sasi të dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi.

Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup - mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure”.

Rasti 3:

Të dhëna mbi Realizimin e Procedurave të Prokurimit:

Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2021 deri 31.12.2021
--

<i>Objekti i procedurës së prokurimit.</i>	<i>Lloji i procedurës sipas SPE.</i>	<i>Fondi limit (në lekë pa tvsh) për procedurën përkatëse.</i>
1-Shërbim, për makina	“blerje me vlerë të vogël”	800,000
2- Shërbim, për fadroma	“blerje me vlerë të vogël”	1,000,0000
TOTALI	2 procedura	1,800,000

Në lidhje me dy procedurat e sipërcituara prokurimi duhet të kryhej në një procedure të vetme nisur edhe nga fakti i afërsisë kohore të nevojës për shërbimin e kërkuar. Konkretisht, duke u nisur nga ngjajshmëria apo funksionaliteti i tyre, objektet duhet të prokuroheshin bashkë nëpërmjet procedurës “E hapur e thjeshtuar”.

Për sa konstatuar më sipër, veprimet e AK-së bien në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e cila konkretisht në nenin 56 pika 2 të saj përcakton se: “Autoriteti/enti kontraktor planifikon natyrën, sasinë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi.

Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup - mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure”.

Rasti 4:

Të dhëna mbi Realizimin e Procedurave të Prokurimit:

Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2021 deri 31.12.2021		
<i>Objekti i procedurës së prokurimit.</i>	<i>Lloji i procedurës sipas SPE.</i>	<i>Fondi limit (në lekë pa tvsh) për procedurën përkatëse.</i>
1-Rikonstruksion kanali ujites gashi pjesa 1	“blerje me vlerë të vogël”	800,000
2-Transport i materilae per Kanali i Gashit pjesa trete	“blerje me vlerë të vogël”	667,000
3-Rikonstruksion kanali ujites gashi pjesa 2	“blerje me vlerë të vogël”	760,000
TOTALI	3 procedura	2,227,000

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktor ka kryer procedura prokurimi duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit.

Në lidhje me tre procedurat e sipërcituara prokurimi duhet të kryhej në një procedure të vetme nisur edhe nga fakti i afërsisë kohore të nevojës për shërbimin e kërkuar. Konkretisht, duke u nisur nga ngjajshmëria apo funksionaliteti i tyre, objektet duhet të prokuroheshin bashkë nëpërmjet procedurës “e hapur e thjeshtuar”.

Për sa konstatuar më sipër, veprimet e AK-së bien në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e cila konkretisht në nenin 56 pika 2 të saj përcakton se: “Autoriteti/enti kontraktor planifikon natyrën, sasinë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi.

Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup - mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure”.

Rasti 5:

Të dhëna mbi Realizimin e Procedurave të Prokurimit:

<i>Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2021 deri 31.12.2021</i>		
<i>Objekti i procedurës së prokurimit.</i>	<i>Lloji i procedurës sipas SPE.</i>	<i>Fondi limit (në lekë pa tvsh) për procedurën përkatëse.</i>
1-Blerje kompjutera dhe printera	“blerje me vlerë të vogël”	700,000
2-Blerje kompjutera dhe printera	“blerje me vlerë të vogël”	333,334
<i>TOTALI</i>	<i>2 procedura</i>	<i>1,033,334</i>

Të dhëna mbi Realizimin e Procedurave të Prokurimit për vitin 2022:

Rasti 6:

Të dhëna mbi Realizimin e Procedurave të Prokurimit:

<i>Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2021 deri 31.12.2021</i>		
<i>Objekti i procedurës së prokurimit.</i>	<i>Lloji i procedurës sipas SPE.</i>	<i>Fondi limit (në lekë pa tvsh) për procedurën përkatëse.</i>
1-Blerje leter format	“blerje me vlerë të vogël”	300,000
2-Bojra printer per fotokopje	“blerje me vlerë të vogël”	300,000
3-Blerje kancelari	“blerje me vlerë të vogël”	500,000
<i>TOTALI</i>	<i>3 procedura</i>	<i>1,100,00</i>

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktor ka kryer procedura prokurimi duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit.

Në lidhje me 3 procedurat e sipërcituara prokurimi duhet të kryhej në një procedure të vetme nisur edhe nga fakti i afërsisë kohore të nevojës për shërbimin e kërkuar. Konkretisht, duke u nisur nga ngjajshmëria apo funksionaliteti i tyre, objektet duhet të prokuroheshin bashkë nëpërmjet procedurës “e hapur e thjeshtuar”.

Për sa konstatuar më sipër, veprimet e AK-së bien në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e cila konkretisht në nenin 56 pika 2 të saj përcakton se: “Autoriteti/enti kontraktor planifikon natyrën, sasinë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi.

Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup - mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure”.

Rasti 7:

Të dhëna mbi Realizimin e Procedurave të Prokurimit:

Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2022 deri 31.12.2022		
<i>Objekti i procedurës së prokurimit.</i>	<i>Lloji i procedurës sipas SPE.</i>	<i>Fondi limit (në lekë pa tvsh) për procedurën përkatëse.</i>
1-Blerje vaj dhe filtra	“blerje me vlerë të vogël”	650,300
2-Sherbimeper mirmbajtje makinash - Blerje vajra per mjetet	“blerje me vlerë të vogël”	1,000,000
TOTALI	2 procedura	1,650,300

Rasti 8:

Të dhëna mbi Realizimin e Procedurave të Prokurimit:

Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2021 deri 31.12.2021		
<i>Objekti i procedurës së prokurimit.</i>	<i>Lloji i procedurës sipas SPE.</i>	<i>Fondi limit (në lekë pa tvsh) për procedurën përkatëse.</i>
1- Furnizim dhe vendosje te materialeve per mjetin tip JCB eskavator varings	“blerje me vlerë të vogël”	1,000,000
2-Shërbim fadrome	“blerje me vlerë të vogël”	1,000,000
TOTALI	5 procedura	2,000,000

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktor ka kryer procedura prokurimi duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit.

Në lidhje me 4 procedurat e sipërcituara prokurimi duhet të kryhej në dy procedure të vetme nisur edhe nga fakti i afërsisë kohore të nevojës për shërbimin e kërkuar. Konkretisht, duke u nisur nga ngjajshmëria apo funksionaliteti i tyre, objektet duhet të prokuroheshin bashkë nëpërmjet procedurës “e hapur e thjeshtuar”.

Për sa konstatuar më sipër, veprimet e AK-së bien në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e cila konkretisht në nenin 56 pika 2 të saj përcakton se: “Autoriteti/enti kontraktor planifikon natyrën, sasinë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi.

Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup - mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure”.

Për sa konstatuar më sipër, veprimet e AK-së bien në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e cila konkretisht në nenin 11 pika 5 të saj përcakton se: “Asnjë kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP-ja”.

Si konkluzion, në rrethanat e sipërcituara, veprimet dhe mosveprimet e AK-së, konkretisht, copëzimi i fondeve (ndarja e vlerës së kontratës) dhe për pasojë devijimi nga aplikimi i LPP-së për shkak të mosaplikimit të rregullt të llojit të procedurës, në kundërshtim me mënyrën e parashikuar, ka ndikuar **negativisht** në mirëpërdorimin e fondeve publike.

Për sa më sipër:

- Kur copëzimi i fondeve (ndarja e vlerës së kontratës) sjell për pasojë aplikimin e metodës (llojit) të “prokurimit me vlerë të vogël”, në rastin kur nisur nga rrethanat duhej të aplikohej procedura “e hapur e thjeshtuar”, mosaplikimi i rregullt i llojit të procedurës në këtë rast, referuar rregullave të ekonomisë së tregut të lirë (rritja e sasisë ndikon në uljen e çmimit), përbën një risk eventual për prokurimin e objektit me një vlerë më të lartë.

Për sa më sipër, rekomandohet që: AK, komisioni i prokurimit me vlera të vogëla si dhe personi përgjegjës për prokurimin publik, në asnjë rast, nuk duhet të pjesëtojë (ndajë) vlerën e kontratës me qëllim për të shmangur procedurat standarte të prokurimit publik. Gjithashtu AK, gjatë përllogaritjes së vlerës limit të kontratës, duhet të ketë si qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Për sa më sipër, janë veprime të cilat **ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e AK, komisionin e prokurimit me vlera të vogëla si dhe personi përgjegjës për prokurimin publik**. Përgjegjësia në rastin konkret diktohet nga: Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 21, pika 5 sipas të cilës: “Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij. Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.”; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 74, pika 1 sipas të cilës: “Titullari i autoritetit/entit kontraktor, në fillim të vitit, cakton me urdhër të veçantë personin/personat përgjegjës për prokurimin...Personi/at përgjegjës për prokurimin duhet të administrojë/jnë në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit.”.

Në përfundim për sa konstatuar më sipër, veprimet e AK-së bien në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Neni 2 i Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” ku përcaktohet se: “Qëllimi i këtij ligji është... a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit

publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Neni 21, pika 1 e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

Neni 11 pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 ku përcaktohet se: “Asnjë kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP-ja”.

Neni 12 pika 3 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 ku përcaktohet se: “Përzgjedhja e metodës që përdoret për përllogaritjen e vlerës së prokurimit nuk bëhet me qëllim për ta përjashtuar atë nga fusha e zbatimit të LPP-së dhe këtyre rregullave, apo për të copëzuar kontratën me qëllim shmangien e procedurave sipas kufijve monetarë”.

Neni 56 pika 2 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 ku përcaktohet se: “...Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup - mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure”.

Për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohen me përgjegjësi personat si vijon:

1. Z. A. K., në cilësinë e Titullarit të AK-së i Autirizuar.
2. Z. Z.I, në cilësinë e Personit përgjegjës për prokurimet, për vitet 2021, 2022.
3. Z. **K.B**, në cilësinë e Personit përgjegjës për prokurimet, për vitet 2021 dhe 01.01.2022-30.06.2022
4. Z. H.I, në cilësinë e Personit përgjegjës për prokurimet, për vitin 2021,
5. Znj. A.H, në cilësinë e Personit përgjegjës për prokurimet, për vitin 2022

Për sa trajtuar në faqet 57-95 të Raportit Përfundimtar të auditimit(derguar subjektit me shkresën nr. 518/4, datë 31.08.2023, protokolluar në Bashkinë Tropojë me nr. 2751/44, datë 08.09.2023), janë paraqitur observacione në rrugë elektronike dhe me shkresën nr. 2751/58, datë 06.10.2023, protokolluar në KLSH me nr. 518/6, datë 09.10.2023, nga punonjësit: Z.I, K.B H.I dhe A.I

Pretendimi i subjektit

Rasti nr. 1

-Blerje lende drusore (per mirembajatje rruga Markaj),blerje me vlere te vogel me fond limit 800,000

- Blerje produkte drusore (riparim ura Beli), blerje me vlere të vogël me fond limit 800,000. Sqarim: Blerje lende drusore (per mirembajatje rruga Markaj) i perkete periudhes se vitit 2022 dhe fondit limit i regjistrit eshte 800,000 por vlere per kete procedure eshte 392,000 pa tvsh sipas prventivit, ndersa blerje produkte drusore (riparim ura Beli) i perkele periudhes se

vitet 2021 dhe vlera e regjistrit është 800,000 por fondi limit i kësaj procedure është 468,181 pa tvsh.

Rasti 2.

- Sherbim për mirembajtje makinash (pjesë, aksesore), blerje e vogël me fond limit 800,000 lekë.

- Sherbim për makineri (pjesë mjetesh), blerje e vogël me fond limit 800,000 lekë;

Sqarojmë se : Sipas vkm nr.285 datë 19/05/2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik neni 56 pika 2. Autoriteti/enti kontraktor planifikon natyrën, sasinë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi. Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure.

Sipas kërkesave të ardhura në periudhë të ndryshme gjatë vitit 2021, pasi nuk mund ta parashikojmë në fillim të vitit se çfarë defektesh mund të na ndodhin me makinerit. Dhe pasi nuk janë të njëjta zë emertimesh për procedurat e sipercituara

Kërkesa 1395 prot datë 30.04.2021 për objektin Sherbim për makineri (pjesë mjetesh), blerje e vogël me fond limit 800,000 dhe kërkesë nr. 2018 prot dt. 10.06.2021 për objektin Sherbim për mirembajtje makinash (pjesë, aksesore), blerje e vogël me fond limit 800,000, Në këto kushte komisioni ka realizuar procedurat pasi nuk ka të drejtë të behet shkak për pezullimin e punës.

Rasti 3

1. Sherbim për makina, blerje e vogël me fond limit 800,000

2. Sherbim për fadroma, blerje e vogël me fond limit 1,000,000

Sqarim : Kërkesa për sherbim për makina me blerje të vogël me fond limit 800,000 është me nr 311/ 1 prot datë 02.09.2021, ndërsa kërkesa për Sherbim për fadroma me fond limit 1 është me datë 16.10.2021. Duke u bazuar në kërkesat në periudhë të ndryshme janë kryer procedurat e prokurimit pasi kërkesat nuk janë paraqitur pranë komisionit të blerjeve të vogla që në fillim të vitit. Ndodhur në këto kushte , komisioni është i detyruar të bëjë procedurat e prokurimit për mos pengesën e vijueshmërisë së punës. Defektet nuk mund të parashikohen. Bashkangjitur kërkesat përkatëse.

Rasti 6.

1 -Blerje leter format — blerje me vogël me fond limit 300,000

2- Bojra printer për fotokopje — blerje me vlerë të vogël me fond limit 300,000

3- Blerje kancelari — blerje me vlerë të vogël me fond limit 500,000

Sqarim: Sipas vkm nr.285 datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 pika 2. Autoriteti/enti kontraktor planifikon natyrën, sasinë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi. Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup - mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure. Bazuar në nenin e sipercituar nësi komisioni nuk mund të bashkojmë zerin e bojrave me leter format dhe kancelari pasi natyra e bojes bashkuar në kancelari bashkuar në një procedurë të vetme mund të pezullojë pjesëmarrjen e OE të cilat mund të kenë vetëm një natyrë të këtyre shërbimeve.

Rasti 7.

1-Blerje vajra dhe filtra, blerje me vlere te vogel me fond limit 650,300

2-Goma dhe bateri, blerje me vlere te vogel me fond limit 800,000

3-Furnizim dhe vendosje te materialeve per mietin tip JCB eskavator varings, blerje me vlere te vogel me fond limit 1,000,000

4-Sherbim per mirembajtje makinash, blerje me vlere te vogel me fond limit 1,000,000

5-Sherbim fadrome, blerje me vlerë të vogël, me vlere te vogel me fond limit 1,000,000

Sqarim: Sipas vkm nr.285 date 19/05/2021 Per miratimin e rregulave te prokurimit publik neni 56 pika 2. Autoriteti/enti kontraktor planifikon natyrën, sasitë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi, Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë Ilogariten grup - mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure.

Sipas kerkesave te ardhura ne periudha te ndryshme giate vitit 2022 pasi nuk mund ta parashikojme ne fillim te vitit se cfare difektesh mund te na ndodhin me makinerit. Dhe pasi nuk jane te njejta ze emertimesh per procedurat e sipercituara dhe nuk ka as procedure te realizuar 2 here brenda nje viti.

Gjithashtu theksojme se nuk mund te futim ne nje objekt prokurimi vajra dhe filtra me gomate dhe bateri apo sherbim per mirembajtje makinash apo furnizim dhe vendosje te materialeve per mjetin tip JCB eskavator varings apo sherbim fadrome pasi nuk janë i njejti zë prokurimi.

- Me shkresën nr. 2751/53, datë 29.09.2023, nga K.B dhe H.I, ku pretendohet:

... Persa i perket auditimit te procedurave te prokurimit "Blerje me vlere te vogeli" dhe konkretisht ne 44 procedura ne vitin 2021 dhe 33 procedura ne vitin 2022, ne ftesen per oferte jane te dhenat e kontaktit per cdo procedure dhe ne asnje raste deklarojm me pergjegjesi te plote nuk kemi qene ne cilsin e pergjegjsit te prokurimit dhe ase te antarit te komisionit kjo e vetetuar me dokumentin ftese per oferte ne te gjitha rastet,ku shenohen te dhenat e kontaktit si adresa e e-mail.numri telefonit,emer mbiemer. Ju kujtojmë se nga ana e institucionit tuaj jemi 6 punonujës të kallëzuar penalisht, dhe për vitin 2022 kemi qenë të pezulluar për pjesmërrje në procedura prokurimi, ndaj nuk ka saktësi në konstatimin tuaj.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me observacionet e paraqitura të sipërcituar, sqarojmë: Pretendimet tuaja nuk pranohen, pasi janë të pa argumentuara dhe të pa mbështetura në prova dhe fakte, rastet të cilat në kemi identifikuar i përkasin të njëjtit vit të cilat janë planifikuar dhe realizuar nga Bashkia Tropojë, për rrjedhojë pretendimi juaj se i përkasin periudhave dhe viteve të ndryshme nuk qëndron. Grupi i auditimit merr në konsideratë vetëm prokurimin me vlerë të vogël "Blerje goma dhe bateri", por edhe në këtë rast zërat e tjerë duhet të grupoheshin nga katër prokurime në dy prokurim me vlerë të vogël(sipas korrigjimit në projekt raport). Lidhur me pretendimin sipas shkresës nr. 2751/22, datë 21.07.2023, sqarojmë se bazuar në urdhërin e Titullarit të AK nr. 33 prot, datë 07.01.2021 dhe nr. 41 prot, datë 10/01/2022, jeni caktuar si persona përgjegjës për administrimin e procedurave të prokurimit. Për sa sqaruar konstatimet tona mbeten të pandryshuar.

Titulli i gjetjes: Auditimi i të dhënave për procedurat e prokurimit, lidhur me planifikimin e nevojave pasqyruar në regjistrin e palnifikimit të prokurimeve, përkatësisht për periudhën nga data 01.01.2021 deri në datën 31.12.2022.

Situata:

Në disa raste nga Autoriteti Kontraktor është kryer ndarja e procedurave të prokurimit duke sjellë si pasojë shmangien nga fusha e zbatimit të ligjit, për shkak të ndryshimit artificial të kufirit monetar, pa arsye objektive të cilat do të justifikonin veprimin konkret, pasi janë kryer procedura prokurimi duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit.

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Ndikimi/efekti: Mosaplikimi i rregullt i llojit të procedurës dhe devijimi nga aplikimi i LPP-së, ka ndikuar **negativisht** në mirëpërdorimin e fondeve publike dhe përbën një risk eventual për prokurimin e objektit me një vlerë më të lartë.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK Bashkia Tropojë dhe strukturat përgjegjëse të krijuara për administrimin dhe menaxhimin e procesit të prokurimit të fondeve publike, të marrin masa për të shmangur çdo ndryshim artificial të kufirit monetar, pa arsye objektive, duke krijuar kushte për kryerjen e prokurimeve në përputhje me procedurat standarde të prokurimit publik. Gjithashtu AK, gjatë përlllogaritjes së vlerës limit të kontratës, duhet të ketë si qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes të sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2.2.4/1 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.

Në Bashkinë Tropojë, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizua regjistri i investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit. Nga kjo analizë, është përzgjedhur për auditim në bazë të vlerës së kontratës objekti:

Nr	Objekti	Vlera e kontratës	Kontraktori	Shenime
1	“Rikonstruksion i 5(pesë) segmenteve rrugore, Fshati Gri, Bujan, Cernik, Tropoje	408,506,281	B “F&”V”&” “4” ShPK	Me shkelje
2	“Ndërtim ujsjellësi Fshati Dragobi”	68,269,460	B“F&”4” ShPK	Me shkelje
3	“Rikualifikim urban Lagja”Partizani” blloku1 dhe 2. Qyteti Bajram Curri”	64,460,799	B.N& “R.C” ShPK	Me shkelje

1. -Mbi realizimin e kontratës me objekt “Rikonstruksion i 5(pesë) segmenteve rrugore, fshati Gri, Buljan, Cernikë, Tropojë”.

-Kontrata midis B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK dhe Bashkisë Tropojë, është me nr. 3814/3 Prot., datë 18.12.2020 dhe objekt “Rikonstruksion i 5(pesë) segmenteve rrugore, fshati

Gri, Buljan, Cernikë, Tropojë”. Është me afat 12 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit ose me datë përfundimi datën 29.12.2021. Vlera e kontratës është 408,506,281.2 lekë me TVSH.

-Akt dorëzimi i sheshit të ndërtimit është mbajtur në datën 29.12.2020.

-Procesverbali i fillimit të punimeve është mbajtur në datën 29.12.2020.

Si rrjedhojë, punimet kanë filluar në datën 29.12.2020 dhe duhet të përfundojnë pas 12 muajsh ose në datën 29.12.2021.

-Me shkresën nr. 4767/5 Prot., datë 29.12.2020, nënshkruhet kontrata midis mbikqyrësit të punimeve “E.G” SHPK me përfaqësues z. G.I dhe Bashkisë Tropojë me përfaqësues Kryetarin z. R.B.

-Me shkresën nr. 3814/7 Prot., datë 05.01.2021, mbikqyrësi punimeve, njofton Bashkinë Tropojë për pezullimin e punimeve për shkak të kushteve të vështira atmosferike.

-Me shkresën nr. 3814/9 Prot., datë 05.04.2021, mbikqyrësi punimeve, njofton Bashkinë Tropojë për rifillimin e punimeve.

-Me shkresën nr. 3814/12 Prot., datë 10.11.2021, nënshkruhet amendamenti i parë i kontratës bazë dhe zgjatet afati i ekzekutimit të punimeve edhe 3 muaj kalendarik nga data e përfundimit të kontratës bazë ose me datë përfundimi datën 29.05.2022. Arsyeja e zgjatjes së afatit të punimeve, është moti ekstrem me ngrica.

-Me shkresën nr. 3814/15 Prot., datë 08.04.2022, nënshkruhet amendamenti i dytë i kontratës bazë dhe zgjatet afati i ekzekutimit të punimeve edhe 3 muaj kalendarik nga data e përfundimit të kontratës bazë ose me datë përfundimi datën 29.07.2022. Arsyeja e zgjatjes së afatit të punimeve, është përsëri moti ekstrem me ngrica.

-Me shkresën nr. 3237 Prot., datë 21.07.2022, Kryetari i Bashkisë Tropojë, i kërkon sipërmarrësit, informacion për ecurinë, cilësinë dhe përfundimin e punimeve.

-Me shkresën nr. 3814/17 Prot., datë 25.07.2022, mbikqyrësi punimeve, njofton Bashkinë Tropojë për pezullimin e punimeve për shkak të kushteve të vështira atmosferike.

-Me shkresën nr. 3814/19 Prot., datë 29.07.2022, nënshkruhet amendamenti i tretë i kontratës bazë dhe zgjatet afati i ekzekutimit të punimeve deri në datën 29.10.2022. Arsyeja e zgjatjes së afatit të punimeve, është mungesa e furnizimit me lëndë të parë (binder/asfaltobeton).

-Me shkresën nr. 3673 Prot., datë 01.08.2022, Kryetari i Bashkisë Tropojë, kërkon nga sipërmarrësi, përfundimin urgjent të punimeve. Tek kjo kërkesë, Bashkia Tropojë, cilëson se punimet duhej të përfundonin në datën 29.07.2022. Kjo datë, është data e përfundimit të punimeve sipas amendamentit të dytë. Pra Kryetari i Bashkisë Tropojë, me këtë kërkesë, nuk ka në konsideratë që është nënshkruar nga zv.kryetari A.K, një amendament i tretë me datë 29.07.2022. Si rezultat, amendamenti i tretë, është i pavlefshëm.

-Me shkresën nr. 3814/20 Prot., datë 25.08.2022, mbikqyrësi punimeve, njofton Bashkinë Tropojë për rifillimin e punimeve.

-Procesverbali i përfundimit të punimeve është mbajtur në datën 29.10.2022.

-Me shkresën nr. 3814/24 Prot., datë 09.03.2023, është mbajtur akti i kolaudimit.

-Certifikata e marrjes së përkohëshme në dorëzim, është mbajtur në datën 06.03.2023.

-Sa më sipër:

1- Justifikimi i zgjatjes së afatit të ekzekutimit të punimeve i cilësuar në amendamentin e tretë atë me nr. 3814/19 Prot., datë 29.07.2022, nuk duhej të merrej në konsideratë nga Bashkia Tropojë pasi ofertuesi ose kontraktori nuk ka paraqitur paraprakisht ndonjë marrëveshje bashkëpunimi me operatorë të tjerë furnizues të lëndës së parë por mbi të gjitha, nuk është kërkuar në DST dhe as në kriteret e kualifikimit që operatori ekonomik ofertues, të dorëzojë marrëveshje bashkëpunimi me prodhues të lëndës së parë binder/asfaltobeton dhe në vazhdim të kërkohej që kontraktuesi të dorëzonte gjatë ekzekutimit të kontratës edhe dokumentacionin vërtetues nga furnizuesi në kohën e furnizimit me lëndë të parë binder/asfaltobeton. Vetëm në këtë mënyrë ky amendament do të ishte plotësisht i arsyetuar dhe bindës. Kontrata bazë është nënshkruar nga Bashkia Tropojë dhe B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK e si e tillë, Bashkia Tropojë nuk mund të mbajë përgjegjësi për vonesat që vijnë nga palë të treta jashtë kësaj marrëveshjeje/kontrate për më tepër që Bashkia Tropojë nuk ka qenë paraprakisht në dijeni të ekzistencës së ndonjë marrëveshjeje midis B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK dhe ndonjë prodhuesi binder/asfaltobeton.

1- Amendamenti i tretë me nr. 3814/19 Prot., datë 29.07.2022, është i pavlefshëm juridikisht pasi është nënshkruar me justifikime/argumentime të cilat nuk qëndrojnë dhe konkretisht, justifikimi/argumentimi i zgjatjes së afatit të ekzekutimit të punimeve i cilësuar në amendamentin e tretë atë me nr. 3814/19 Prot., datë 29.07.2022 *“ku cilësohet se shtyrja kërkohej pasi kontraktori ka mugesat të furnizimit me lëndë të parë dhe konkretisht për lëndën e parë binder/asfaltobeton”*, nuk duhej të merrej në konsideratë nga Bashkia Tropojë pasi ofertuesi ose kontraktori nuk ka paraqitur paraprakisht ndonjë marrëveshje bashkëpunimi me operatorë të tjerë furnizues të lëndës së parë por mbi të gjitha, nuk është kërkuar në DST dhe as në kriteret e kualifikimit që operatori ekonomik ofertues, të dorëzojë marrëveshje bashkëpunimi me prodhues të lëndës së parë binder/asfaltobeton dhe në vazhdim të kërkohej që kontraktuesi të dorëzonte gjatë ekzekutimit të kontratës edhe dokumentacionin vërtetues nga furnizuesi në kohën e furnizimit me lëndë të parë binder/asfaltobeton. Vetëm në këtë mënyrë amendamenti i tretë do të ishte plotësisht i arsyetuar dhe bindës. Kontrata bazë është nënshkruar nga Bashkia Tropojë dhe B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK e si e tillë, Bashkia Tropojë nuk mund të mbajë përgjegjësi për vonesat që vijnë nga palë të treta jashtë kësaj marrëveshjeje/kontrate për më tepër që Bashkia Tropojë nuk ka qenë paraprakisht në dijeni të ekzistencës së ndonjë marrëveshjeje midis B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK dhe ndonjë prodhuesi binder/asfaltobeton.

2- Kontrata bazë dhe amendamentet e saj, janë nënshkruar midis B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK dhe Bashkisë Tropojë me përfaqësues Nënkryetarin e saj z. A.K. Z. A.K, nuk ka atributet e Kryetarit aktual në detyrë të Bashkisë Tropojë pasi vetëm Kryetari i zgjedhur i Bashkisë Tropojë përfaqëson institucionin në marrëdhënie me të tretë. I cilësuar ky përcaktim tek Ligji nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, neni 64, *“Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë”*, gërma (gj) ku cilësohet se Kryetari Bashkisë, midis të tjerash *“Ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët”*. Gjithashtu, tek rregullorja *“Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Bashkisë Tropojë”*, e miratuar me urdhrin nr. 41, datë 06.03.2018 të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, tek neni 33, Kryetari i

Bashkisë, cilësohet se: “Kryetari i Bashkisë, përfaqëson institucionin në marrëdhënie me organe shtetërore, me organet e Njësive të Vetqeverisjes Vendore, me persona fizikë/juridikë vendas ose të huaj”. Si rezultat, në të gjitha rastet që në marrëdhënie me të tretët, dokumenti/akti përkatës nuk është nënshkruar nga Kryetari Bashkisë si përfaqësuesi ligjor i saj, e bën këtë dokument/akt, të pavlefshëm dhe një akt i tillë administrativ, i pavlefshëm juridikisht, nuk ka asnjë fuqi ligjore.

-Nga auditimi i dokumentacionit të ndodhur tek grupi i auditimit lidhur me delegimin e kompetencave nga Kryetari i Bashkisë Tropojë tek Nën Kryetari, u konstatuan dy urdhra të cilët në gjykimin e grupit të auditimit, nuk janë në konformitet me ligjin. Konkretisht, urdhri nr. 229 sipas shkresës me nr. 5123 Prot., datë 31.12.2020, të konceptuar nga znj.K.Adhe urdhri nr. 01 sipas shkresës me nr. 11 Prot., datë 05.01.2022 të konceptuar nga A.H. Të dy këto urdhra, janë nxjerr në bazë të ligjeve dhe neneve të gabuar. Konkretisht janë nxjerr bazuar tek nenet 8/2, 59/3 dhe nenit 64 të ligjit 139/2015 Për vetqeverisjen vendore kur në fakt duhej të bazoheshin tek neni 8, neni 64 dhe neni 66 gërma (h) e këtij ligji. Gjithashtu, këta urdhra janë nxjerr bazuar edhe tek kreu VII, neni 56 të Vkm nr. 914, datë 29.12.2014, Për miratimin e rregullave të prokurimeve publike kur në fakt duhej të cilësohej neni 28 dhe neni 29 i ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë. Në të dy aktet e delegimit, mungon përcaktimi i saktë i detyrave që do ketë i deleguari. Nuk cilësohet se çfarë do ketë të drejtë të nënshkruajë në emër të Kryetarit të Bashkisë. Nuk cilësohet as se ku do të publikohet akti i delegimit të kompetencave për transaprencë për publikun. Të dy aktet cilësojnë se i deleguari do të angazhohet për organizimin dhe realizimin e procedurave të prokurimit por pa përcaktuar se çfarë dokumentash ose urdhrash do ketë të drejtë për të nënshkruar. Veprimet e mësipërme, ngarkojnë me përgjegjësi konceptuesit e këtyre urdhrave dhe Kryetarin e Bashkisë Tropojë pasi janë veprime jo në përputhje me: Ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 8, neni 64 gërma (gj) dhe neni 66 gërma (h); Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 28 dhe neni 29; Neni 33 i Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Bashkisë Tropojë” të miratuar me urdhrin nr. 41, datë 06.03.2018 të Kryetarit të Bashkisë Tropojë dhe Neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave” të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

-Sa më sipër, punimet pas datës 29.07.2022, datë e cila është përcaktuar tek amendamenti i dytë si datë përfundimi punimesh (duke marrë në konsideratë rregullshmërinë ligjore të amendamentit të parë dhe jo fuqinë e nënshkruarit si përfaqësues i Bashkisë), deri në datën 29.10.2022, datë në të cilën kanë përfunduar punimet, konsiderohen punime të kryera jashtë afateve ligjore e si të tilla duhej që Bashkia Tropojë të kalkulonte penalitetin që i duhej mbajtur B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK për 90 ditë vonesa në ekzekutimin e punimeve.

Rruga	Periudha	Nr.An	Përshkrimi	Ditë pune në total sipas ditarit të objektit	Ditë pune jashtë afatit	Vlera Totale	Vlera koresponduese e punimeve jashtë afatit
-------	----------	-------	------------	--	-------------------------	--------------	--

Kërnaaj	30.05.2022 26.08.2022	3.212/c	Shtresë Stabilizanti t=15cm	89	29	12,025,200	3,918,323.6
	10.10.2022 13.10.2022	An1	Guardrail N2 anësore me 2 valëz	4	4	4,656,000	4,656,000
	22.10.2022 29.10.2022	An 122	Vijëzim shirita gjatësorë e anësorë me gjerësi 12 cm	7	7	1,600,800	1,600,800
	22.10.2022 29.10.2022	An 105	Tabela trekëndore e vogël me A=60	7	7	240,000	240,000
	22.10.2022 29.10.2022	An 105	Tabela rrethore Ø=60	7	7	240,000	240,000
	30.05.2022 26.08.2022	3.212/b	Shtresë Stabilizanti t=10cm	89	29	6,268,400	2,042,512.4
	18.10.2022 21.10.2022	An1	Guardrail N2 anësore me 2 valëz	4	4	2,496,000	2,496,000
	22.10.2022 29.10.2022	An 122	Vijëzim shirita gjatësorë e anësorë me gjerësi 12 cm	7	7	1,160,000	1,160,000
	22.10.2022 29.10.2022	An 105	Tabela trekëndore e vogël me A=60	7	7	180,000	180,000
	22.10.2022 29.10.2022	An 105	Tabela rrethore Ø=60	7	7	180,000	180,000
Cërnice	04.05.2022 01.06.2022	3.An/ksh	Krahë një degësh 100x150cm	35	12	12000	4115
	01.07.2022 11.07.2022 10.09.2022 15.09.2022	3.212/b	Shtresë Stabilizanti t=10cm	36	6	163,800	27300
	22.10.2022 29.10.2022	An 122	Vijëzim shirita gjatësorë e anësorë me bojë	7	7	150,500	150,500
	22.10.2022 29.10.2022	An 122	Vijëzim shirita gjatësorë e anësorë me gjerësi 12 cm	7	7	618,200	618,200
	22.10.2022 29.10.2022	An 105	Tabela trekëndore e vogël me A=60	7	7	10000	10000
	22.10.2022 29.10.2022	An 105	Tabela rrethore Ø=60	7	7	130,000	130,000
	30.05.2022 26.08.2022	3.212/b	Shtresë Stabilizanti t=10cm me makiner+vendndrrimet	89	29	12,996,400	4,234,782
Bujan	18.10.2022 21.10.2022	An1	Guardrail N2 anësore me 2 valëz	4	4	6,954,000	6,954,000
	22.10.2022 29.10.2022	An 122	Vijëzim shirita gjatësorë e anësorë me gjerësi 12 cm	7	7	2,185,200	2,185,200
	22.10.2022 29.10.2022	An 105	Tabela trekëndore e vogël me A=60	7	7	300,000	300,000

	22.10.2022 29.10.2022	An 105	Tabela rrethore Ø=60	7	7	300,000	300,000
	30.05.2022 26.08.2022	3.212/b	Shtresë Stabilizanti t=10cm	89	29	8,196,800	2,670,867.42
	15.10.2022 17.10.2022	An1	Guardrail N2 anësore me 2 valëz	2	2	9,024,000	9,024,000
Muhejan	22.10.2022 29.10.2022	An 122	Vijëzim shirita gjatësorë e anësorë me gjerësi 12 cm	7	7	1,505,000	1,505,000
	22.10.2022 29.10.2022	An 105	Tabela trekëndore e vogël me A=60	7	7	290,000	290,000
	22.10.2022 29.10.2022	An 105	Tabela rrethore Ø=60	7	7	290,000	290,000
Totali							45,407,600.42
TVSH							9,081,520.084
Totali me TVSH							54,489,120.5

-Vlera e punimeve të kryera me 3 muaj vonesë (90 ditë), është 54,489,120.5 lekë. Për këtë vlerë, referuar gërmës (c) të nenit 36, “Dëmet e likujdueshme për vonesën në mbarimin e punimeve” të kontratës me nr. 3814/3 Prot., datë 18.12.2020, me afat ekzekutimi punimesh më shumë se 12 muaj, Bashkia Tropojë, duhej të aplikonte formulën sipas përcaktimit të gërmës (c).

-Si rezultat, vlera e penalitetit me efekte negative për Bashkinë Tropojë, është: $54,489,120.5(\text{lekë}) * 90(\text{ditë vonesë}) * 1/1000 = 4,904,020.845$ lekë. **Këto vonesa kanë ardhur si pasojë e amendamenteve të pavlefshme të konceptuara dhe miratuara nga Bashkia Tropojë pa përjashtuar këtu përgjegjësinë e sipërmarrësit në nënshkrimin e tyre.**

-Nga auditimi i zërave të preventivit dhe zërave të situacionit përfundimtar të punimeve sipas kontratës së lidhur, u konstatua se nuk është ekzekutuar zëri “An. 3.226/1 Shtresë asfaltobetoni”. Ky zë nuk është ofertuar dhe nuk është situacionuar pra faturuar. Mos ekzekutimi i këtij zëri, pra i tapetit mbi binder, e bën investimin të jetë më shumë i ekspozuar ndaj fenomeneve natyrore. Binderit në vetvete, ka tendencën që të ngurtësohet me kalimin e kohës prandaj rolin e amortizuesit ose të materialit më të përshtatshëm ndaj kushteve atmosferike si në dimër dhe në verë, e kryen tapeti ose shtresa e asfaltit e cila hidhet mbi shtresën e binderit. Kjo shtresë, jo vetëm që mbron nga shkatërrimi ndaj kushteve natyrore të shtresës së binderit por mbi të gjitha, garanton sigurinë në lëvizjen e mjeteve rrugore për arsye të mbajtjes nivelin e duhur të forcave të fërkimit midis sipërfaqeve të gomave të mjeteve dhe shtresës së asfaltit. Në këto kushte që është kryer investimi, shtresa e binderit dhe vijëzimet mbi të, janë të destinuara të shkatërrohen me kalimin e kohës nëse nuk merren masa për hedhjen e asfaltit mbi binder. Vlera e binderit të investuar dhe vlera e vijëzimeve mbi binder, mund të sjellin dëm ekonomik në të ardhmen pasi për hedhjen e asfaltit duhet një frezim i binderit në rastin më të mirë ose shtresë e re binderi në rastin më të keq. Si rezultat, në gjykimin e grupit të auditimit, vlera në total prej 129,181,200 lekë, e detajuar në tabelën më poshtë për cdo rrugë lidhur me zërat shtresë binderit dhe vijëzime me bojë, konsiderohet si dëm ekonomik i mundshëm në të ardhmen nëse Bashkia Tropojë nuk merr masat sa më shpejt për hedhjen e asfaltit/tapetit mbi binder.

Rruga	Nr.An	Përshkrimi	Sasia	Vlera
Bujan-Tplan	3.222/2	Shtresë Bideri	20707 m ²	33,131,200 Lek
	An. 122	Vijëzime	10926 ml	2,185,200 Lek
Rosujë-Lëkurtaç	3.222/1	Shtresë Bideri	10158 m ²	14,221,200 Lek
	An. 122	Vijëzime	5800 ml	1,160,000 Lek
Cërnicë	3.222/2	Shtresë Bideri	6123 m ²	9,796,800 Lek
	An. 122	Vijëzime	107.5 ml	150,000 Lek
Kernaj-Zhenaj	3.222/1	Shtresë Bideri	14419 m ²	20,186,600 Lek
	An. 122	Vijëzime	8004 ml	1,600,800 Lek
Myhejan	3.222/2	Shtresë Bideri	14821 m ²	23,713,600 Lek
	An. 122	Vijëzime	7528 ml	1,505,600 Lek
Totali				107,651,000 Lek
TVSH				21,530,200 Lek
Totali me TVSH				129,181,200 Lek

-Nga auditimi në terren i zërave të punimeve me zgjedhje referuar dhe kohës në dispozicion për auditimin, u konstatuan diferenca në zëra punimesh si në tabelën në vijim.

Rruga	Nr.An	Përshkrimi	Sasia e munguar	Vlera
Bujan-Tplan	An.105	Tabela trekëndore të vogla me A=60	8 copë	80.000 Lek
	An. 103	Tabela rrethore Ø=60	12 copë	120,000 Lek
Kernaj-Zhenaj	An.105	Tabela trekëndore të vogla me A=60	4 copë	40.000 Lek
	An. 103	Tabela rrethore Ø=60	8 copë	80.000 Lek
Totali				320,000 Lek
TVSH				64.000 Lek
Totali me TVSH				384,000 Lek

-Në situacionin përfundimtar, janë pasqyruar 30 tabela trekëndore dhe 30 tabela rrethore për rrugën Bujan-Tplan. Nga verifikimet në terren, u konstatuan se tek kjo rrugë, ishin vendosur 22 tabela trekëndore ose 8 tabela trekëndore më pak dhe 18 tabela rrethore ose 12 tabela rrethore më pak. Gjithashtu janë pasqyruar 24 tabela trekëndore dhe 24 tabela rrethore për rrugën Kernaj-Zhenaj. Nga verifikimet në terren, u konstatuan se tek kjo rrugë, ishin vendosur 20 tabela trekëndore ose 4 tabela trekëndore më pak dhe 16 tabela rrethore ose 8 tabela rrethore më pak. Në total, vlera e faturuar më tepër, është 384,000 lekë.

Sqarim: Vlera e penalitetit, ka ndryshuar në raport me vlerën e penalitetit të kalkuluar në akt-konstatimin e mbajtur për arsye se gjatë shqyrtimit të akt-konstatimit nr. 6, datë 21.07.2023, u evidentuan disa gabime lidhur me datat dhe kontratat shtesë të cilat u korrigjuan nga grupi i auditimit në hartimin e këtij materiali.

Sa më sipër, është mbajtur akt-konstatimi nr. 6, datë 21.07.2023.

Titulli i Gjetjes:	Zëra punimesh të kryera me vonesë jashtë afatit të kontratës.
Situata:	-Kontrata midis B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK dhe Bashkisë Tropojë, është me nr. 3814/3 Prot., datë 18.12.2020 dhe objekt “Rikonstruksion i 5(pesë) segmenteve rrugore, fshati Gri, Buljan, Cernikë, Tropojë”. Është me afat 12 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit ose me datë përfundimi datën 29.12.2021. Vlera e kontratës është 408,506,281.2 lekë me TVSH. Procesverbali i fillimit të punimeve është mbajtur në datën 29.12.2020. Punimet kanë filluar në datën 29.12.2020 dhe përfundojnë pas 12 muajsh ose në datën

29.12.2021. Me shkresën nr. 3814/12 Prot., datë 10.11.2021, nënshkruhet amendamenti i parë i kontratës bazë dhe zgjatet afati i ekzekutimit të punimeve edhe 3 muaj kalendarik nga data e përfundimit të kontratës bazë ose me datë përfundimi datën 29.05.2022. Arsyeya e zgjatjes së afatit të punimeve, është moti ekstrem me ngrica. Me shkresën nr. 3814/15 Prot., datë 08.04.2022, nënshkruhet amendamenti i dytë i kontratës bazë dhe zgjatet afati i ekzekutimit të punimeve edhe 3 muaj kalendarik nga data e përfundimit të kontratës bazë ose me datë përfundimi datën 29.07.2022. Arsyeya e zgjatjes së afatit të punimeve, është përsëri moti ekstrem me ngrica. Me shkresën nr. 3814/19 Prot., datë 29.07.2022, nënshkruhet amendamenti i tretë i kontratës bazë dhe zgjatet afati i ekzekutimit të punimeve deri në datën 29.10.2022. Arsyeya e zgjatjes së afatit të punimeve, është mungesa e furnizimit me lëndë të parë (binder/asfaltobeton).

1. Amendamenti i tretë me nr. 3814/19 Prot., datë 29.07.2022, është i pavlefshëm juridikisht pasi është nënshkruar me justifikime/argumentime të cilat nuk qëndrojnë dhe konkretisht, justifikimi/argumentimi i zgjatjes së afatit të ekzekutimit të punimeve i cilësuar në amendamentin e tretë atë me nr. 3814/19 Prot., datë 29.07.2022 *“ku cilësohet se shtyrja kërkohet pasi kontraktori ka mungesa të furnizimit me lëndë të parë dhe konkretisht për lëndën e parë binder/asfaltobeton”*, nuk duhej të merrej në konsideratë nga Bashkia Tropojë pasi ofertuesi ose kontraktori nuk ka paraqitur paraprakisht ndonjë marrëveshje bashkëpunimi me operatorë të tjerë furnizues të lëndës së parë por mbi të gjitha, nuk është kërkuar në DST dhe as në kriteret e kualifikimit që operatori ekonomik ofertues, të dorëzojë marrëveshje bashkëpunimi me prodhues të lëndës së parë binder/asfaltobeton dhe në vazhdim të kërkohej që kontraktuesi të dorëzonte gjatë ekzekutimit të kontratës edhe dokumentacionin vërtetues nga furnizuesi në kohën e furnizimit me lëndë të parë binder/asfaltobeton. Vetëm në këtë mënyrë amendamenti i tretë do të ishte plotësisht i arsyetuar dhe bindës. Kontrata bazë është nënshkruar nga Bashkia Tropojë dhe B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK e si e tillë, Bashkia Tropojë nuk mund të mbajë përgjegjësi për vonesat që vijnë nga palë të treta jashtë kësaj marrëveshjeje/kontrate për më tepër që Bashkia Tropojë nuk ka qenë paraprakisht në dijeni të ekzistencës së ndonjë marrëveshjeje midis B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK dhe ndonjë prodhuesi binder/asfaltobeton.

2. Kontrata bazë dhe amendamentet e saj, janë nënshkruar midis B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK dhe Bashkisë Tropojë me përfaqësues Nënkryetarin e saj z. A.K. Z. A.K, nuk ka atributet e Kryetarit aktual në detyrë të Bashkisë Tropojë pasi vetëm Kryetari i zgjedhur i Bashkisë Tropojë përfaqëson institucionin në marrëdhënie me të tretë. I cilësuar ky përcaktim tek Ligji nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, neni 64, *“Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë”*, gërma (gj) ku cilësohet se Kryetari Bashkisë, midis të tjerash *“Ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i*

janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët”. Gjithashtu, tek rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Bashkisë Tropojë”, e miratuar me urdhrin nr. 41, datë 06.03.2018 të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, tek neni 33, Kryetari i Bashkisë, cilësohet se: “Kryetari i Bashkisë, përfaqëson institucionin në marrëdhënie me organe shtetërore, me organet e Njësive të Vetqeverisjes Vendore, me persona fizikë/juridikë vendas ose të huaj”. Si rezultat, në të gjitha rastet që në marrëdhënie me të tretët, dokumenti/akti përkatës nuk është nënshkruar nga Kryetari Bashkisë si përfaqësuesi ligjor i saj, e bën këtë dokument/akt, të pavlefshëm dhe një akt i tillë administrativ, i pavlefshëm juridikisht, nuk ka asnjë fuqi ligjore. Nga auditimi i dokumentacionit të ndodhur tek grupi i auditimit lidhur me delegimin e kompetencave nga Kryetari i Bashkisë Tropojë tek Nën Kryetari, u konstatuan dy urdhra të cilët në gjykimin e grupit të auditimit, nuk janë në konformitet me ligjin. Konkretisht, urdhri nr. 229 sipas shkresës me nr. 5123 Prot., datë 31.12.2020, të konceptuar nga znj.K.Adhe urdhri nr. 01 sipas shkresës me nr. 11 Prot., datë 05.01.2022 të konceptuar nga A.H. Të dy këto urdhra, janë nxjerr në bazë të ligjeve dhe neneve të gabuar. Konkretisht janë nxjerr bazuar tek nenet 8/2, 59/3 dhe neni 64 të ligjit 139/2015 Për vetqeverisjen vendore kur në fakt duhej të bazoheshin tek neni 8, neni 64 dhe neni 66 gërma (h) e këtij ligji. Gjithashtu, këta urdhra janë nxjerr bazuar edhe tek kreu VII, neni 56 të Vkm nr. 914, datë 29.12.2014, Për miratimin e rregullave të prokurimeve publike kur në fakt duhej të cilësohej neni 28 dhe neni 29 i ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë. Në të dy aktet e delegimit, mungon përcaktimi i saktë i detyrave që do ketë i deleguari. Nuk cilësohet se çfarë do ketë të drejtë të nënshkruajë në emër të Kryetarit të Bashkisë. Nuk cilësohet as se ku do të publikohet akti i delegimit të kompetencave për transparencë për publikun. Të dy aktet cilësojnë se i deleguari do të angazhohet për organizimin dhe realizimin e procedurave të prokurimit por pa përcaktuar se çfarë dokumentash ose urdhrash do ketë të drejtë për të nënshkruar. Gjithashtu, kontrata bazë është nënshkruar nga Nën Kryetari i Bashkisë Tropojë z. A.K, në datën 18.12.2020 dhe urdhri për delegimin e kompetencave (nëse do ishte i rregullt ligjërisht) është nxjerrë në datën 31.12.2020 e si i tillë, nuk mund të ketë fuqi prapavepruese. Veprimet e mësipërme, janë veprime jo në përputhje me: Ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 8, neni 64 gërma (gj) dhe neni 66 gërma (h); Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 28 dhe neni 29; Neni 33 i Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Bashkisë Tropojë” të miratuar me urdhrin nr. 41, datë 06.03.2018 të Kryetarit të Bashkisë Tropojë. Si rezultat, punimet pas datës 29.07.2022, datë e cila është përcaktuar tek amendamenti i dytë si datë përfundimi punimesh (duke marrë në konsideratë rregullshmërinë ligjore të amendamentit të parë dhe të dytë dhe jo fuqinë e nënshkruarit si përfaqësues i

	Bashkisë), deri në datën 29.10.2022, datë në të cilën kanë përfunduar punimet, në gjykim të grupit të auditimit, konsiderohen punime të kryera jashtë afateve ligjore e si të tilla duhej që Bashkia Tropojë të kalkulonte penalitetin që i duhej mbajtur B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK për 90 ditë vonesa në ekzekutimin e punimeve për zërat e punimeve të ekzekutuara jashtë afateve ligjore. Vlera e punimeve të kryera me 3 muaj vonesë (90 ditë), referuar ditarit të punimeve të gjendur në dosjen teknike të procedurës, është 54,489,120.5 lekë. Për këtë vlerë, referuar gërmës (c) të nenit 36, “Dëmet e likujdueshme për vonesën në mbarimin e punimeve” të kontratës me nr. 3814/3 Prot., datë 18.12.2020, me afat ekzekutimi punimesh më shumë se 12 muaj, Bashkia Tropojë, duhej të aplikonte formulën sipas përcaktimit të gërmës (c). Vlera e penalitetit me efekte negative për Bashkinë Tropojë, është: 54,489,120.5(lekë) * 90(ditë vonesë) * 1/1000 = 4,904,020.845 lekë.
Kriteri:	-Kontrata me nr. 3814/3 Prot., datë 18.12.2020, neni 36 “Dëmet e likujdueshme për vonesën në mbarimin e punimeve ”. -Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë”, gërma (gj). -Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Bashkisë Tropojë”, e miratuar me urdhrin nr. 41, datë 06.03.2018 të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, neni 33. -Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 28 dhe neni 29. Neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave” të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
Ndikimi/Efekti:	-Ekzekutimi i punimeve jashtë afateve të përcaktuara. -Veprime administrative, me pasoja negative në menaxhimin e institucionit në kundërshtim me ligjet dhe rregullat në fuqi.
Shkaku:	Mos respektimi i ligjeve dhe rregullave në fuqi.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandim:	Bashkia Tropojë, të marrë masat për të kryer verifikimet e duhura lidhur me vonesat e konstatuara nga grupi i auditimit gjatë zbatimit të punimeve sipas kontratës me objekt “Rikonstruksion i 5(pesë) segmenteve rrugore, fshati Gri, Buljan, Cerrnikë, Tropojë”, si rezultat i amendimeve të cilësuar nga grupi i auditimit, me mangësi ligjore, dhe nëse rezultojnë të pa bazuara në ligjet dhe rregullat në fuqi, atëherë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 4,904,021 lekë, nga B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK, si vlerë që i përket penalitetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve të përcaktuara në kontratë.
Rekomandim:	Kryetari i Bashkisë Tropojë, të marrë masat që në të ardhmen, në rastet e delegimit të kompetencave tek vartësit e tij, të përcaktojë të gjitha të drejtat dhe

	detyrimet e të deleguarit konform ligjeve dhe rregullave në fuqi, duke kryer dhe njoftimet e duhura në transparencë për publikun por dhe duke monitoruar njëkohësisht vendimet e marra nga i deleguari.
Rekomandim:	Bashkia Tropojë, Drejtori i Kabinetit, Sektori Juridik, të marrin masa që në të ardhmen, përpara konceptimit të shkresave për delegimin e kompetencave të Kryetarit të Bashkisë tek cilido nga vartësit e tij, të argumentohet dhe dokumentohet arsyeja e delegimit të kompetencave duke respektuar njëkohësisht ligjin për formën dhe përmbajtjen e dokumentit të delegimit të kompetencave por dhe për afatin e delegimit.

Titulli i Gjetjes:	Përdorim i fondeve pa efektivitet
Situata:	Kontrata midis B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK dhe Bashkisë Tropojë, është me nr. 3814/3 Prot., datë 18.12.2020 dhe objekt “Rikonstrukcion i 5(pesë) segmenteve rrugore, fshati Gri, Buljan, Cerrnikë, Tropojë”. Është me afat 12 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit ose me datë përfundimi datën 29.12.2021. Vlera e kontratës është 408,506,281.2 lekë me TVSH. Nga auditimi i zërave të preventivit dhe zërave të situacionit përfundimtar të punimeve sipas kontratës së lidhur, u konstatua se nuk është ekzekutuar zëri “An. 3.226/1 Shtresë asfaltobetoni”. Ky zë nuk është ofertuar dhe nuk është situacionuar pra faturuar. Mos ekzekutimi i këtij zëri, pra i tapetit mbi binder, e bën investimin të jetë më shumë i ekspozuar ndaj fenomeneve natyrore. Binderit në vetvete, ka tendencën që të ngurtësohet me kalimin e kohës prandaj rolin e amortizuesit ose të materialit më të përshtatshëm ndaj kushteve atmosferike si në dimër dhe në verë, e kryen tapeti ose shtresa e asfaltit e cila hidhet mbi shtresën e binderit. Kjo shtresë, mbron nga shkatërrimi shtresën e binderit si dhe garanton sigurinë në lëvizjen e mjeteve rrugore për arsye të mbajtjes në nivelin e duhur të forcave të fërkimit midis sipërfaqeve të gomave të mjeteve dhe shtresës së asfaltit. Në këto kushte që është kryer investimi dhe nuk është hedhur shtresa e asfaltit, shtresa e binderit dhe vijëzimet mbi të, janë të destinuara të shkatërrohen me kalimin e kohës nëse nuk merren masa për hedhjen e asfaltit mbi binder. Vlera e binderit të investuar dhe vlera e vijëzimeve mbi binder, mund të sjellin dëm ekonomik në të ardhmen pasi për hedhjen e asfaltit duhet një frezim i binderit në rastin më të mirë ose shtresë e re binderit në rastin më të keq. Si rezultat, në gjykimin e grupit të auditimit, vlera në total prej 129,181,200 lekë, që korespondon për cdo rrugë lidhur me zërat shtresë binderit dhe vijëzime me bojë, konsiderohet si dëm i mundshëm në të ardhmen, nëse Bashkia Tropojë nuk merr masat sa më shpejt për hedhjen e asfaltobetonit mbi binder.

Kriteri:	Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Mangësi në projektimin dhe zbatimin e standardeve teknike për kryerjen me cilësi të punimeve me pasojë dëm ekonomik në të ardhmen.
Shkaku:	Mos parashikim me korrektësi i punimeve sipas kushteve dhe standarteve teknike.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandim:	Bashkia Tropojë, të marrë masat për hedhjen e shtresës së asfaltbetonit me qëllim shmangien e kthimit të investimit me vlerë 121,181,200 lekë, në një investim me pasoja negative financiare në të ardhmen, në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, eficientës dhe efektivitetit të përdorimit të fondeve publike.
Rekomandim:	Bashkia Tropojë, të marrë masat që në të ardhmen, në të gjitha procedurat e prokurimit me objekt “Kryerje punimesh”, të përfshihen në preventivat e tyre, të gjitha zërat e domosdoshëm për garantimin e sigurisë dhe standarteve teknike me qëllim, shmangien e dëmtimit të investimit në të ardhmen.

Titulli i Gjetjes:	Zëra punimesh të pa kryera.
Situata:	Kontrata midis B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK dhe Bashkisë Tropojë, është me nr. 3814/3 Prot., datë 18.12.2020 dhe objekt “Rikonstruksion i 5(pesë) segmenteve rrugore, fshati Gri, Buljan, Cerrnikë, Tropojë”. Është me afat 12 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit ose me datë përfundimi datën 29.12.2021. Vlera e kontratës është 408,506,281.2 lekë me TVSH. Nga auditimi në terren i zërave të punimeve, u konstatuan diferenca në zëra punimesh. Në situacionin përfundimtar, janë pasqyruar 30 tabela trekëndore dhe 30 tabela rrethore për rrugën Bujan-Tplan. Nga verifikimet në terren, u konstatuan se tek kjo rrugë, ishin vendosur 22 tabela trekëndore ose 8 tabela trekëndore më pak dhe 18 tabela rrethore ose 12 tabela rrethore më pak. Gjithashtu janë pasqyruar 24 tabela trekëndore dhe 24 tabela rrethore për rrugën Kërnaj-Zhenaj. Nga verifikimet në terren, u konstatuan se tek kjo rrugë, ishin vendosur 20 tabela trekëndore ose 4 tabela trekëndore më pak dhe 16 tabela rrethore ose 8 tabela rrethore më pak. Në total, vlera e faturuar më tepër, është 384,000 lekë.
Kriteri:	Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Mangësi në kryerjen me cilësi të punimeve me pasojë dëm ekonomik.
Shkaku:	Mos pasqyrimi me korrektësi i volumeve të kryera.
Rëndësia:	E Mesme.

Rekomandim:	Bashkia Tropojë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës 384,000 lekë , nga B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar, faturuar dhe likuiduar por të pa kryer.
--------------------	--

Pretendimi subjektiv

Janë paraqitur observacione në rrugë elektronike dhe fizikisht në ballafaqimin e kryer në KLSH.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Observacionet e ardhura, merren në konsideratë nga grupi i auditimit, në aspektin e dhënies së rekomandimit Bashkisë Tropojë, për kryerjen e verifikimeve të thelluara lidhur me ekzistencën ose jo të dëmit ekonomik të konstatuar nga grupi i auditimit ardhur si pasojë e amendamenteve të pavlefshme të nënshkruara nga të dy palët. Gjykojmë që në vazhdim, Bashkia Tropojë të rishqyrtojë dokumentacionin lidhur me amendamentet dhe në vijim të vendosë nëse ekzistojnë penalitetet, ti kërkojë ato në rrugë ligjore nga OE. Lidhur me delegimin e kopetencave, observacionet e dorëzuara fizikisht gjatë ballafaqimit të kryer në KLSH, nuk përbëjnë prova dhe dokumenta që të kenë lidhje me delegimin e kopetencave.

2. -Mbi realizimin e kontratës me objekt “Ujësjellësi Fshatit Dragobi”.

-Kontrata midis B “F” SHPK & “4” SHPK dhe Bashkisë Tropojë, është me nr. 3360/3 Prot., datë 08.12.2020 dhe objekt “Ujësjellësi Fshatit Dragobi”. Është me afat 6 muaj nga dita e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, sipas nenit 3 të kontratës së lidhur midis palëve “Afati i realizimit të punimeve”. Vlera e plotë e kontratës është 68,269,460.11 lekë me TVSH.

-Kontrata midis Mbikqyrësit të punimeve “E.G” SHPK përfqësuar nga G.I me nr. License MK.1015/12 dhe Bashkisë Tropojë, është me nr. 4356/5 Prot., datë 29.12.2020.

-Procesverbali i fillimit të punimeve, është me nr. 5098 Prot., datë 29.12.2020 dhe nënshkruar nga sipërmarrësi, investitori dhe mbikqyrësi.

-Akt dorëzimi i sheshit të ndërtimit, është me nr. 5098/1 Prot., datë 29.12.2020.

-Sa më sipër, punimet kanë filluar në datën 29.12.2020 dhe përfundojnë pas 6 muajsh ose në datën 28.06.2021 konform nenit 3 të kontratës së lidhur.

-Me shkresën nr. 5098/2 Prot., datë 04.01.2021, mbikqyrësi i punimeve, njofton Bashkinë Tropojë për pezullimin e punimeve për arsye të ngricave.

-Me shkresën nr. 5098/3 Prot., datë 15.02.2021, mbikqyrësi i punimeve, njofton Bashkinë Tropojë për rifillimin e punimeve.

-Me shkresën nr. 5098/4 Prot., datë 16.02.2021, Kryetari i Bashkisë, kërkon nga mbikqyrësi i punimeve, rishikimin e projektit nisur nga konstatimet gjatë inspektimit në terren. (Mungojnë relacionet e inspektimit në terren. Mungon urdhri i grupit për kryerjen e inspektimeve në terren dhe arsyeja e kryerjes së këtyre inspektimeve).

-Me shkresën nr. 5098/5 Prot., datë 16.02.2021, mbikqyrësi i punimeve, njofton pezullimin e punimeve pas kërkesës së ardhur nga Kryetari i Bashkisë Tropojë cilësuar më lart.

-Me shkresën nr. 5098/6 Prot., datë 19.03.2021, mbikqyrësi i punimeve kërkon nga Bashkia Tropojë, miratimin e ndryshimeve të projektit të propozuara pas konsultimeve me sipërmarrësin dhe projektuesin.

-Me shkresën nr. 5098/7 Prot., datë 19.03.2021, mbikqyrësi i punimeve kërkon nga Bashkia Tropojë, miratimin e përdorimit të fondit rezervë. Vlera e fondit rezervë e miratuar është 2,709,106 lekë me TVSH dhe procesverbali i miratimit është nënshkruar nga mbikqyrësi, sipërmarrësi dhe investitori.

-Me shkresën nr. 5098/8 Prot., datë 23.03.2021, mbikqyrësi i punimeve, njofton Bashkinë Tropojë për rifillimin e punimeve, pas pezullimit të tyre në datën 16.02.2021 për rishikimin e projektit.

-Me shkresën nr. 5098/9 Prot., datë 23.03.2021, mbikqyrësi i punimeve kërkon nga Bashkia Tropojë, miratimin për shtyrjen e afatit të ekzekutimit të punimeve pas ndërprerjes së tyre për arsye të rishikimit të projektit dhe ngricave.

-Me shkresën nr. 5098/10 Prot., datë 23.03.2021, sipërmarrësi i punimeve kërkon nga Bashkia Tropojë, miratimin për shtyrjen e afatit të ekzekutimit të punimeve pas ndërprerjes së tyre për arsye të rishikimit të projektit dhe ngricave.

-Me shkresën nr. 5098/11 Prot., datë 24.03.2021, është nënshkruar amendamenti nr.1 i kontratës bazë. Ky amendament i referohet nenit 3 të kontratës bazë dhe zgjat afatin e ekzekutimit të punimeve edhe 3 muaj të tjerë ose në total 9 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit ose me datë përfundimi datën 29.09.2021. Arsyeja e zgjatjes së afatit të punimeve, sic cilësohet tek amendamenti, janë ngricat dhe rishikimi i projektit. Nga dokumentat e cilësuar më lart, justifikohen vonesa vetëm nga data 16.02.2021 deri në datën 23.03.2021 pra justifikohen vetëm 36 ditë vonesë për arsye të pezullimit të punimeve. Në fakt, Bashkia Tropojë, ka miratuar një shtyrje afati për më shumë kohë pra për tre muaj kur vonesat janë vetëm një muaj. Veprim ky në kundërshtim me nenin 33, “Ndryshimi i ligjeve dhe rregulloreve” dhe nenin 38 “Ndryshimi i porosisë” të kontratës nr. 3360/3 prot., datë 08.12.2020.

-Me shkresën nr. 341 Prot., datë 06.09.2021, “4” SHPK i dërgon Bashkisë Tropojë përgjigjen e kërkesës së Bashkisë Tropojë të dërguar tek “4” SHPK me shkresën nr. 2983 Prot., datë 02.09.2021.

-Me shkresën nr. 515 Prot., datë 09.12.2021, “4” SHPK njofton Bashkinë Tropojë për ndërprerje të punimeve për shkak të ngricave.

-Me shkresën nr. 4939 Prot., datë 28.12.2021, është nënshkruar amendamenti nr.2 i kontratës bazë. Ky amendament i referohet nenit 3 të kontratës bazë dhe zgjat afatin e ekzekutimit të punimeve edhe 20 ditë nga data e njoftimit për rifillimin e punimeve. Amendamenti i mëparshëm ai me nr. 5098/11 Prot., datë 24.03.2021, përcakton se afati i punimeve zgjatet deri në datën 29.09.2021. Në këto kushte, amendamenti me nr. 4939 Prot., datë 28.12.2021, është nënshkruar pas skadimit të afatit të punimeve e si i tillë, është nënshkruar nga Bashkia Tropojë, në kundërshtim me ligjin.

-Me shkresën nr. 2169 Prot., datë 12.05.2022, Kryetari i Bashkisë Tropojë, i dërgon mbikqyrësit dhe sipërmarrësit të punimeve, një kërkesë për përsheptimin e punimeve për vendosjen e matësive nëpër banesa dhe të galixhanëve nëpër depot e ujit.

-Me shkresën nr. 1 Prot., datë 19.05.2022 protokolluar tek B “F” SHPK & “4” SHPK dhe nr. 2938/4 Prot., datë 19.05.2022 protokolluar tek Bashkia Tropojë, sipërmarrësi i punimeve B “F” SHPK & “4” SHPK, njofton Bashkinë Tropojë për rifillimin e punimeve pas përmirësimit të kushteve atmosferike. (Punimet ishin pezulluar në datën 09.12.2021 sipas shkresës me nr. 515 Prot., datë 09.12.2021 protokolluar tek sipërmarrësi).

-Me shkresën nr. 272 Prot., datë 20.05.2022 protokolluar tek B “F” SHPK & “4” SHPK, sipërmarrësi i punimeve njofton Bashkinë Tropojë për ndërprerje të punimeve pasi banorët e lagjes Demiraj në Fshatin Dragobi Tropojë, nuk lejojnë zhvillimin e projektit. (Në dosje, s’ka asnjë dokumentacion që të vërtetohet një fakt i tillë).

-Me shkresën nr. 2348 Prot., datë 25.05.2022, është nënshkruar amendamenti nr.3 i kontratës bazë. Ky amendament i referohet nenit 3 të kontratës bazë dhe zgjat afatin e ekzekutimit të punimeve edhe 20 ditë nga data e njoftimit për rifillimin e punimeve.

-Shkresat në vazhdim janë pa numër protokollit të Bashkisë Tropojë.

-Shkresa nr. 357 Prot., datë 01.07.2022, njoftim për Bashkinë Tropojë lidhur me problematikën e lagjes Demiraj.

-Shkresa nr. 357/2 Prot., datë 12.07.2022, sipërmarrësi kthen përgjigje shkresës së Bashkisë me nr. 2938/7 Prot., datë 06.07.2022.

-Punimet janë pezulluar shumë herë për shkak të problemeve të shfaqura nga banorët sidomos në lagjen Demiraj. Për këtë lagje, punimet kanë qenë të pezulluara për shumë kohë dhe kanë rifilluar në datën 14.02.2023. Kjo është data që i referohet afatit të përcaktuar në amendamentin e tretë. Procesverbali i rifillimit të punimeve, është i nënshkruar nga Bashkia Tropojë, sipërmarrësi dhe mbikqyrësi i punimeve.

-Me shkresën nr. 1441 Prot., datë 09.03.2023, mbikqyrësi i punimeve, njofton Bashkinë Tropojë se punimet kanë përfunduar në datën 07.03.2023. Procesverbali i përfundimit të punimeve, është mbajtur në datën 07.03.2023.

-Akti i kolaudimit të objektit, është me nr. 5098/12 Prot., datë 27.04.2023.

-Dosja e zbatimit të procedurës së mësipërme, nuk është e inventarizuar dhe nuk është marrë në dorëzim konform rregullave dhe ligjeve në fuqi. Për këtë arsye, korespondenca e gjendur në dosjen e zbatimit, nuk ka hierarki në mbajtjen e protokollit. Janë pa numër protokollit njoftimet e pezullimit të punimeve dhe të rifillimit të tyre. Problemet e hasura në terren nga banorë të zonës sipas shkresave të gjendura në dosjen teknike, nuk janë të bazuara në fakte apo prova por vetëm të deklaruara se sipërmarrësi ka hasur kundërshtime për zbatimin e projektit nga banorë të zonës. Këto mangësi e bëjnë të vështirë gjurmën e auditimit e cila pothuajse nuk ekziston tek dosjet e audituara. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 19 ku cilësohet se “19. Gjurma e auditimit” përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve”, neni 16, pika 2 dhe pika 3 ku cilësohet se “2. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të

jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. 3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”, neni 23 pika 5 ku cilësohet se “Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi, që sigurojnë: 5. Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin”.

-Nga auditimi në terren i punimeve të kryera, u konstatuan diferenca në zëra punimesh të cilat paraqiten në tabelën në vijim.

Lagjia	Nr.An	Përshkrimi	Njësi a	Sasia e situacionu ar tepër	Çmimi	Vlera
Metaliaj	II	Linja Kryesore e Furnizimit me Ujë deri në depo				
	4.167	F.V Valvul sigurie ½' P=3 bar, DN 80	copë	2	15000	30000
	III	Linja Shpërndarëse e Furnizimit me ujë të banesave				
	II	Linja Kryesore e Furnizimit me Ujë deri në depo				
	4.126/4	Ajrues linja kryesore me 3 funksione DN80/100 PN10	copë	1	20000	20000
Sokolaj	III	Linja Shpërndarëse e Furnizimit me ujë të banesave				
Totali						50000
TVSH						10000
Totali me TVSH						60000

Për sa trajtuar në akt konstatimin nr. 7 dhe në faqet 95-115 të Raportit Përfundimtar të auditimit (derguar subjektit me shkresën nr. 518/4, datë 31.08.2023, protokolluar në Bashkinë Tropojë me nr. 2751/44, datë 08.09.2023), janë paraqitur observacione në rrugë elektronike.

Pretendimi subjektit

Janë paraqitur observacione në rrugë elektronike.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Observacionet e ardhura, merren në konsideratë nga grupi i auditimit, në aspektin e ndryshimit të vlerës së dëmit ekonomik të konstatuar. Gjykojmë që zëri “transport dheu”, të mos kalkulohet si zë i paekzekutuar nga OE pasi edhe sipas observacionit të ardhur, punimet kryhen në zonë të mbrojtur dhe materiali i gërmuar, kryesisht shkëmbor, është transportuar nga Bashkia Tropojë.

Titulli i Gjetjes:	Favorizim i BOE duke zgjatur afatin e punimeve më shumë se koha që ato ishin pezulluar.
---------------------------	--

Situata:	-Kontrata midis B “F” SHPK & “4” SHPK dhe Bashkisë Tropojë, është me nr. 3360/3 Prot., datë 08.12.2020 dhe objekt “Ujësjiellësi Fshatit Dragobi”. Është me afat 6 muaj nga dita e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, sipas nenit 3 të kontratës së lidhur midis palëve “Afati i realizimit të punimeve”. Vlera e plotë e kontratës është 68,269,460.11 lekë me TVSH. Me shkresën nr. 5098/11 Prot., datë 24.03.2021, është nënshkruar amendamenti nr.1 i kontratës bazë. Ky amendament i referohet nenit 3 të kontratës bazë dhe zgjat afatin e ekzekutimit të punimeve edhe 3 muaj të tjerë ose në total 9 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit ose me datë përfundimi datën 29.09.2021. Arsyeja e zgjatjes së afatit të punimeve, sic cilësohet tek amendamenti, janë ngricat dhe rishikimi i projektit. Nga dokumentat e cilësuar më lart, justifikohen vonesa vetëm nga data 16.02.2021 deri në datën 23.03.2021 pra justifikohen vetëm 36 ditë vonesë për arsye të pezullimit të punimeve. Në fakt, Bashkia Tropojë, ka miratuar një shtyrje afati për më shumë kohë pra për tre muaj kur vonesat janë vetëm një muaj. Veprim ky në kundërshtim me nenin 33, “ Ndryshimi i ligjeve dhe rregulloreve” dhe nenin 38 “Ndryshimi i porosisë” të kontratës nr. 3360/3 prot., datë 08.12.2020. Me shkresën nr. 4939 Prot., datë 28.12.2021, është nënshkruar amendamenti nr.2 i kontratës bazë. Ky amendament i referohet nenit 3 të kontratës bazë dhe zgjat afatin e ekzekutimit të punimeve edhe 20 ditë nga data e njoftimit për rifillimin e punimeve. Amendamenti i mëparshëm ai me nr. 5098/11 Prot., datë 24.03.2021, përcakton se afati i punimeve zgjatet deri në datën 29.09.2021. Në këto kushte, amendamenti me nr. 4939 Prot., datë 28.12.2021, është nënshkruar pas skadimit të afatit të punimeve e si i tillë, është nënshkruar nga Bashkia Tropojë, në kundërshtim me ligjin.
Kriteri:	-Neni 33, “ Ndryshimi i ligjeve dhe rregulloreve” dhe neni 38 “Ndryshimi i porosisë” të kontratës nr. 3360/3 prot., datë 08.12.2020.
Ndikimi/Efekti:	-Favorizim i OE në kundërshtim me kriteret e kualifikimit në procedurën e prokurimit.
Shkaku:	Mos respektimi i ligjeve dhe rregullave në fuqi.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandim:	Bashkia Tropojë, të marrë masat që në të ardhmen, të respektojë afatet dhe kushtet e vendosura në kontratën bazë, duke nënshkruar amendamente kontratash vetëm nëse ato i referohen kushteve/kritereve mbi të cilat, OE është shpallur fitues i një procedure.
Rekomandim:	Kryetari i Bashkisë Tropojë, të marrë masat që në të ardhmen, në rastet e nënshkrimit të amendamenteve të kontratave bazë, ato të nënshkruhen përpara përfundimit të kontratës bazë ose të amendamentit të mëparshëm.

Titulli i Gjetjes:	Mos respektimi i ligjit për gjurmën e auditimit.
Situata:	-Kontrata midis B “F” SHPK & “4” SHPK dhe Bashkisë Tropojë, është me nr. 3360/3 Prot., datë 08.12.2020 dhe objekt “Ujësjetllësi Fshatit Dragobi”. Është me afat 6 muaj nga dita e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, sipas nenit 3 të kontratës së lidhur midis palëve “Afati i realizimit të punimeve”. Vlera e plotë e kontratës është 68,269,460.11 lekë me TVSH. Dosja e zbatimit të procedurës së mësipërme, e dorëzuar pranë grupit të auditimit, nuk është e inventarizuar dhe nuk është marrë në dorëzim konform rregullave dhe ligjeve në fuqi. Për këtë arsye, korespondenca e gjendur në dosjen e zbatimit, nuk ka hierarki në mbajtjen e protokollit. Janë pa numër protokollit njoftimet e pezullimit të punimeve dhe të rifillimit të tyre. Problemet e hasura në terren nga banorë të zonës sipas shkresave të gjendura në dosjen teknike, nuk janë të bazuara në fakte apo prova por vetëm të deklaruara se sipërmarrësi ka hasur kundërshtime për zbatimin e projektit nga banorë të zonës. Këto mangësi e bëjnë të vështirë nxjerrjen e një konkluzioni të saktë nga grupi i auditimit mbi rregullshmërinë e dokumentacionit për arsye të mungesës së gjurmës së auditimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 19 ku cilësohet se “19. Gjurma e auditimit” përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve”, neni 16, pika 2 dhe pika 3 ku cilësohet se “2. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. 3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”, neni 23 pika 5 ku cilësohet se “Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi, që sigurojnë: 5. Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin”.
Kriteri:	-Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4 pika 19, neni 16 pika 2 dhe pika 3, neni 23 pika 5 .
Ndikimi/Efekti:	-Humbja e hierarkisë shkresore me pasojë shmangien e gjurmës së auditimit.
Shkaku:	Mos respektimi i ligjeve dhe rregullave në fuqi.
Rëndësia:	E Lartë

Rekomandim:	Bashkia Tropojë, të marrë masat që në të ardhmen, të miratohen gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të Bashkisë, me qëllim dokumentimin e të gjitha veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.
--------------------	--

Titulli i Gjetjes:	Zëra punimesh të pa kryera.
Situata:	-Kontrata midis B “F” SHPK & “4” SHPK dhe Bashkisë Tropojë, është me nr. 3360/3 Prot., datë 08.12.2020 dhe objekt “Ujësjiellësi Fshatit Dragobi”. Është me afat 6 muaj nga dita e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, sipas nenit 3 të kontratës së lidhur midis palëve “Afati i realizimit të punimeve”. Vlera e plotë e kontratës është 68,269,460.11 lekë me TVSH. Nga auditimi në terren i zërave të punimeve, u konstatuan diferenca në zëra punimesh. Konkretisht në lagjen Metaliaj dhe Sokolaj, u konstatua mungesa e një cajruesi dhe një valvule sigurie përkatësisht në Sokolaj dhe Metaliaj. Në total, vlera e faturuar më tepër në situacionin përfundimtar, është 60.000 lekë.
Kriteri:	Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Mangësi në kryerjen me cilësi të punimeve me pasojë dëm ekonomik.
Shkaku:	Mos pasqyrimi me korrektësi i volumeve të kryera.
Rëndësia:	E Mesme.
Rekomandim:	Bashkia Tropojë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 60.000 lekë , nga B “F” SHPK & “4” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar, faturuar dhe likuiduar por të pa kryer.

3. -Mbi realizimin e kontratës me objekt “Rikualifikim urban “Lagja Partizani” Blloku 1&2, Bajram Curri”.

Për auditimin e kësaj pike të Programit të Auditimit, Grupi i auditimit është bazuar në ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjin për “Prokurimin Publik”, VKM mbi “Miratimin e rregullave për prokurimin publik”, ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe ligjeve/rregullave specifike të institucionit që auditohet.

Dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti:

- Dosja e zbatimit të punimeve.

Mbi auditimin e zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt: “Rikualifikim urban “Lagja Partizani” Blloku 1&2, Bajram Curri”, të lidhur midis Bashkisë tropojë dhe B.N& “R.C”, u konstatua:

-Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 977 Prot., datë 24.02.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tropojë, përfaqësuar nga Nën Kryetari Z. A.K, (person i autorizuar nga Kryetari i Bashkisë Tropojë z. R.B) dhe sipërmarrësit të punimeve B “N”&“R.C” SHPK me licencë NZ.1981/19, me administrator z. Xh. N dhe z. R. P.Vlera e kontratës është 53,717,333 lekë pa TVSH ose 64,460,799 lekë me TVSH. Afati i realizimit të kontratës është 6 (gjashtë) muaj e përllogaritur nga data e lirimt të shëshit dhe garancia e punimeve është 12 (dymbëdhjetë) muaj.

-Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit për “Rikualifikim urban ‘Lagja Partizani’ Blloku 1&2, Bajram Curri” është lidhur kontratë shërbimi me nr. 866/2 Prot, datë 03.03.2022, ndërmjet Bashkisë Tropojë përfaqësuar nga Nën Kryetari Z. A.K, (person i autorizuar nga Kryetari i Bashkisë Tropojë z. R.B) dhe OE “V.E” SH.P.K me administrator z. M.Sh, me Lic. MK.3835. Kontrata e mbikëqyrjes ka vlerën 613.307 lekë me TVSH me afat realizimi sipas afatit të zbatimit të punimeve.

-Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është lidhur kontratë kolaudimi punimesh ndërtimi ndërmjet Bashkisë Tropojë dhe OE “E.G” SHPK me administrator Z. G.I, me nr. lic. MK. 1015/16. Vlera e kontratës së kolaudimit 268,947.60 lekë me TVSH. Leja infrastrukturore për objektin e kontraktuar është lëshuar nga Kryetari Bashkisë Tropojë, me datë 01.06.2022, me afat 1 vit. Punimet kanë filluar në datën 02.06.2022, ndërsa Njoftimi për përfundimin e punimeve është me shkresën nr. 5111 Prot., datë 23.11.2023 nga mbikëqyrësi i punimeve. Akti i kolaudimit është realizuar me nr. 5626/1 Prot., datë 21.12.2022.

Certifikata e Perkohshme e marrjes në dorëzim është hartuar në datën 21.12.2022, nga grupi i marrjes në dorëzim, A.D, S.B dhe F.M dhe miratuar nga Nën Kryetari i Bashkisë z. A.K.

-Me shkresën nr. 2735/4 Prot., datë 20.06.2022, dërguar në Bashkinë Tropojë nga OE dhe shkresën nr. 2735/5 Prot., datë 08.07.2022, dërguar në Bashkinë Tropojë nga mbikëqyrësi i punimeve, është kërkuar të rishikohet preventivi i punimeve i miratuar nga palët në zbatim të nenit 38 të kontratës.

-Në procesverbalin e rishikimit të volumeve vlera e punimeve më tepër rezulton të jetë 23,323,244 lekë me TVSH dhe vlera e punimeve më pak 23,323,244 lekë me TVSH. Procesverbali i përdorimit të fondit rezervë të miratuar nga Autoriteti Kontraktor është realizuar më datë 02.11.2022, me nr. 4672/1 Prot., datë 02.11.2022. Ditari i punimeve fillon nga data 01.06.2022 deri më datë 21.11.2022. Dosja e punimeve përmban procesverbale të ndryshme mbi zbatimin e punimeve, procesverbale për punimet e maskuara dhe testimet të ndryshme mbi rezistencën kubike të betoneve.

Situata 1

Lidhur me afatin e zbatimit të kontratës.

Kontrata për punë publike me nr. 977 Prot., datë 24.02.2022, ka hyrë në fuqi 100 ditë pas datës së nënshkrimit, kjo për shkak të vonesave të pajustificuara të krijuara nga Autoriteti Kontraktor, pasi në mënyrë të pa argumentuar nuk ka lëshuar lejen e ndërtimit infrastrukturore për objektin e kontraktuar, brenda afatit të nënshkrimit të kontratës së zbatimit, duke krijuar vonesa të pajustificuara. Mosveprime nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. R.B.

Seksioni rrugor	Nr.An	Përshkrimi	Sasia e munguar	Çmimi	Vlera
1-2	Punime në trup të rrugës + kuneta + bordura p/f 20x25				
	An. 164/1 a +An	Mbushje me cakull t=30cm në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri	58.5 m ³	1500	87,850 Lek
2-1	Punime në rrjetin K.U.B				
	3.89/a	Gërmim në kanale, gjerësi deri në 2 m, me makineri tokë e zakonshme b*h*l	184 m ³	400	73600 Lek
	3.47/1a	Mbushje e ngjeshje dheu	101.4 m ³	250	25.360 Lek
Totali			(Pa TVSH)		186,810 Lek

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **186,810 lekë pa tvsh.**

Më hollësisht trajtuar si më poshtë:

1-Zëri “Mbushje me cakull t=30cm në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri”, në situacionin përfundimtar është deklaruar 2608.4 m³. Referuar të dhënave të pasqyruara në librezën e masave dhe projektit teknik të zbatimit, rezulton se vëllimi real është 2549.9 m³. Ky ndryshim në volum lidhet me përfshirjen në librezën e masave, si volum pune i kryer edhe volumi që zë tubacioni me diametër 250 mm, i llogaritur në volumin prej 58.5 m³[1193m(gjatësia e tubacionit)*0.0004906 m²(seksioni i tubit)], i cili duhet të zbritet nga volumi total i mbushjes. Për rrjedhojë sasia prej 58.5 m³ mbushje me cakull në KUB, konsiderohet si volum pune i pakryer.

2-Zëri “Gërmim në kanale, gjerësi deri në 2 m, me makineri tokë e zakonshme b*h*l”, në situacionin përfundimtar është deklaruar 531.8 m³. Referuar të dhënave të pasqyruara në librezën e masave dhe projektit teknik të zbatimit(planimetria dhe skicat përkatëse), rezulton se vëllimi real është 347.8 m³. Ky ndryshim volumi i referohet të dhënave në librezën e masave dhe skicave përkatëse, ku rezulton se për thellësinë 40 cm, ky volum pune është situacionuar si i kryer sipas zërit nr. 1 “ Gërmin dheu me eskvator me zinxhir, 1 m³ ” tek seksioni 1-2 “Punime në trup rrugës+kunetë+bordura”, situacionuar me volum 2805 m³. Pra duke qenë se është gërmuar e gjithë sipërfaqja në lartësinë 40 cm, për rrjedhojë do të konsiderohet e gërmuar për KUB vetëm për lartësinë 60 cm, që i përket vëllimi real prej 347.8 m³. Pra janë deklaruar 184 m³ gërmim në kanal, më tepër në situacionin përfundimtar.

3. Zëri nr. 3 “Mbushje e ngjeshje dheu” tek seksioni 1-2 “Punime në trup rrugës+kunetë+bordura”, i situacionuar në volumin prej 101.4 m³, konsiderohet i pa realizuar, pasi ky volum pune është përfshirë tek zëri “Mbushje me cakull t=30cm në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri”(trajtuar më sipër), ndaj konsiderohet si volum pune i pakryer.

Zëri “Puseta b/a shiu 40*40, h=100cm, me kapak gize”, në situacionin përfundimtar janë deklaruar 60 copë puseta të vendosura, gjithashtu edhe në librezën e masave janë pasqyruar 60 copë puseta. Nga verifikimi vizual në terren, nuk ka përpuethsmëri me numërin e pusetave të

situacionuara dhe të paraqitura në planimetritë e vendosjes së pusetave (në *observacionin e paraqitur*), për këtë kërkohet një riverifikim i plotë i linjes së KUB, lidhur me vendosjen e pusetave, për të arritur në një përfundim të argumentuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: Z. M.Sh, në cilësinë e administratorit të subjektit “**V.E**” SH.P.K, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;

Titulli i Gjetjes: Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “*Rikualifikim urban “Lagja Partizani” Blloku 1&2, Bajram Curri*”, Bashkia Tropojë, nga zbatuesi i punimeve B.N& “R.C” ShPK, për zërat e punimeve I-2.5, II-1.1, II-1.3;

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “*Mbushje me cakull $t=30\text{cm}$ në trupin e rrugës, perhapur e ngjeshur me makineri*”, “*Gërmim në kanale, gjerësi deri në 2 m, me makineri tokë e zakonshme $b*h*l$* ”; “*Mbushje e ngjeshje dheu*”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 866/2 Prot, datë 03.03.2022,.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 977 Prot., datë 24.02.2022.

Ndikimi: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Tropojë, në shumën **186,810 lekë pa tvsh**.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit, si dhe gjatë koaludimit dhe marrjes në dorëzim të objektit.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Nga Bashkia Tropojë të merren masa, të ndiqen të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës prej **186,810 lekë pa tvsh** nga B.N& “R.C” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 866/2 Prot, datë 03.03.2022, me objekt “*Rikualifikim urban “Lagja Partizani” Blloku 1&2, Bajram Curri*”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera. Gjithashtu të kryhet verifikimi në objekt me grup pune, në prezencë të mbikëqyrësit dhe subjektit kontraktues, lidhur me numërin e pusetave të shiut të vendosura në objekt, dhe në varësi të diferencave me ato të situacionuara, të procedohet me likuidimin financiar të tyre.

Për sa trajtuar në faqet 116-120 të Raportit Përfundimtar të auditimit (derguar subjektit me shkresën nr. 518/4, datë 31.08.2023, protokolluar në Bashkinë Tropojë me nr. 2751/44, datë 08.09.2023), janë paraqitur observacione në rrugë elektronike dhe me shkresën nr. 274, datë 16.09.2023, protokolluar në KLSH me nr. 518/5, datë 18.09.2023, shkresën nr. 2751/55, datë 06.10.2023, protokolluar në KLSH me nr. 518/6, datë 09.10.2023 dhe me nr. 518/7, datë 12.10.2023.

Pretendimi i subjektit

..... Referuar Raportit Përfundimtar të auditimit, ku grupi I auditimit ka konstatuar që B në zbatim të kontratës së sipërmarrjes nr. 977 Prot, datë 24.02.2022 dhe kontratës së mbikëqyrjes nr. 866/2, datë 03.03.2022, nuk kanë kryer punimet për disa zëra pune, sqarojmë se B “N” & “R.C” është i gatshëm të kryejë këto zëra punimi: “F.v. krah me dy degë për shtylla metalike për ndriçim” gjithsej 18 copë, “F.v. ndriçues smart VPCLICRM-S 250E....., me llampë 250Ë, 230V ” gjithsej 36 copë.

Lidhur me Zërin e punimit “Mbushje me çakëll $t=30$ cm, në trupin e rrugës përhapur e ngjeshur me makineri”, janë këto volume të kryera: sheshi $S_1=382.2$ m³; sheshi $S_2=229.8$ m³; sheshi $S_3=1323.3$ m³; sheshi $S_4=195.9$ m³; sheshi 1 dhe 2(KUB D 250 mm)=477.2 m³, gjithsej volume 2608.4 m³. Sqarojmë se këtu është përfshirë mbushja me çakëll edhe e kanalit të UB, mbi të cilin do të vendosen shtresat e rrugës. Ky zë nuk ka qenë I parashikuar në prevëntivin fillestar tek nëndarja II-1 Punime në rrjetin KUB, Ndaj për të siguruar shtresat afaltike, është bërë kjo mbushje me çakëll. Mendojmë që është për tru zbritur sipërfaqja që zë tubi 250 mmm, $v=58.5$ m³, që vjen nga një gabim njerëzor. Gjithashtu theksojmë se në aksin 1, referuar projektit të azhornuar, janë bërë ndërhyrje edhe në ujrat e zeza, etj, për të cilat nuk ka patur pretendimi financiare nga kontraktori që ka kryer punimet.

Lidhur me Zërin e punimit “Puseta b/a shiu 40x40, h=100 cm, me kapak gize”. Realizimi i këtij zëri është plotësisht i verifikueshëm, gjatë konstatimeve në terren për një identifikim më të saktë.

Në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH dhe në zbatim të detyrimit të zbatimit të kontratës, ju vëmë në dijeni që B “N” & “R.C”, është i gatshëm të kryejë punimet(bashkëlidhur librezat e masave, foto, palnimetr e vendosjes së pusetave).

Për faktimin e realizimit të tyre, është mbajtur Procesverbali me datë 03.10.2023, nga Sipërmarrësi i punimeve, Mbikëqyrësi, Kolaudatori dhe Grupi i marrjes në dorëzim nga Bashkia Tropojë, konfirmuar nga Titullari i Bashkisë Tropojë(Personi i Autorizuar), dërguar në KLSH me shkresën nr. 2751/55, datë 06.10.2023.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me observacionet e paraqitura të sipërcituar, sqarojmë: lidhur me realizimin e zërave “F.v. krah me dy degë për shtylla metalike për ndriçim” gjithsej 18 copë, “F.v. ndriçues smart VPCLICRM-S 250E....., me llampë 250Ë, 230V ” gjithsej 36 copë, pretendimet tuaja pranohen, duke i konsideruar të kryera si punime, pasi kjo argumentohet me Procesverbalin mbajtur me datë 03.10.2023, nga Sipërmarrësi i punimeve, Mbikëqyrësi, Kolaudatori dhe Grupi i marrjes në dorëzim nga Bashkia Tropojë, i konfirmuar nga Titullari i Bashkisë Tropojë, dërguar në KLSH me shkresën nr. 2751/55, datë 06.10.2023. Lidhur me zërin “Mbushje me cakull $t=30$ cm në trupin e rrugës”, pranohet pjesërisht observacioni juaj, kjo referuar dokumentacionit argumentues të paraqitur bashkëlidhur observacionit, ndërsa nuk do të konsiderohet i realizuar zëri nr. 3 “ mbushje e ngjeshje dheu” tek seksioni 1-2 “Punime në trup rrugës+kunetë+bordura”, i situacionuar në volumin prej 101.4 m³, pasi ky volum është përfshirë si i realizuar tek zëri mbushje me çakëll për të gjithë seksionin e kanalit, nuk mund të pranohet që ka edhe mbushje me dhe, ndaj ndryshimet përkatëse do të pasqyrohen në Raportin përfundimtar të auditimit.

Lidhur me zërin e punimit “Puseta b/a shiu 40x40, h=100 cm, me kapak gize”, ku bashkëlidhur keni paraqitur dokumentacion argumentues(planimetritë e vendosjes së pusetave), pranohet me rezervë nga grupi I auditimit, ndaj do ti lihet në rekomandimin përkatës, riverifikim nga Bashkia Tropojë, e cila të shprehet me një akt procesverbal konstatimi. Lidhur me zërat e tjerë të konstatuar me mangësi në realizimin e tyre, sqarojmë se ato mbeten të pandryshuara.

2.2.5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Zyra e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Tropojë ka ushtruar funksionet dhe detyrat e saj bazuar në ligjin Nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar si dhe V.K.M.-së Nr.408, Datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar me V.K.M.-në Nr.271 Datë 06.04.2016 “Për një ndryshim në V.K.M.-në Nr. 408 Datë 13.05.2015”.

Nga auditimi u konstatua se, gjatë viteve 2021-2022 në Bashkinë Tropoj nuk është miratuar Leje Ndërtimi për subjekte private në pronë shtetërore. Të gjitha Lejet e miratuara kanë qënë në truall privat të personave apo subjekteve që kanë aplikuar dhe janë pajisur me leje ndërtimi.

Leje të ndërtimit për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2 për vitin 2020-31.12.2022

Në zbatim të kësaj programit të auditimit, u krye vlerësim me zgjedhje i proceseve administrative në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Për periudhën 2021 – 2022 janë realizuar 32 procedura për leje ndërtimi, zhvillimi, deklarata për kryerje punimesh, leje për ndryshime projekti, rikonstruksione dhe certifikata përdorimi, përkatësisht: për vitin 2021 janë dhënë 12 leje dhe për vitin 2022 janë dhënë 18 leje ndërtimi. Lejet e ndërtimit kryesisht janë dhënë për llojet e objekteve: Shtesë kati në objekte ekzistues; Ndërtim çatie në objekte ekzistuese; Shtesa anësore; Godina banimi 2 kat; Godina shërbimi; Objekte magazinimi; rikonstruksione dhe shtesa; Ndërtim kapanone industriale; Rikonstruksione dyqane dhe lokale; ndërtim vila; Mure rrethues; Magazina, etj.

Nga këto janë zgjedhur për t’u audituar procedura të aplikimit dhe miratimit të lejeve të zhvillimit e ndërtimit, bazuar në madhësinë e objekteve, vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë si edhe vend ndodhjes së objekteve duke mbajtur në fokus veçanërisht lejet e dhëna në zonën historike e të mbrojtura të Bashkisë Tropojë.

Baza ligjore:

- Ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar.
- Ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.
- VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.
- Vendimi Nr. 2 Date 09.12.2017 i KKT-së, “Për Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Tropojë”, ndryshuar.
- Vendimi Nr.5, datë 29.12.2014 për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë Territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave Bashkia Tropojë.
- Ligji nr. 115/2014 “Për ndarjen Administrativo-territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”.

- Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”.

Mbi zbatimin e procedurave ligjore në hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor dhe plani i detajuar vendor.

Zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjin Nr.107/2014, “Për Planifikimin e Territorit”, të ndryshuar, VKM Nr.408, datë 13.5.2015 ”Për Miratimin e Rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar me V.K.M-në Nr. 672, datë 29.07.2015 për “Një ndryshim në vendimin nr. 408, date 13.5.2015” neni 45 pika a);

Me ligjin nr.115/2014 “Për ndarjen Administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” .

Për reformën e re territoriale për çdo bashki duhet të miratohet Plani i Përgjithshëm Vendor. Për Bashkinë Tropojë është miratuar dhe është në zbatim Plani i Përgjithshëm Vendor i miratuar me Vendimin nr. Nr. 2 Date 09.12.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit. Miratimi i lejeve të ndërtimit për periudhën 2021 -2022 nga Bashkia Tropojë, është bazura në Plani i Përgjithshëm Vendor të miratuar.

Me të gjithë Dokumentacionin përkatës të PPV-së Bashkia Tropojë

- Analiza e thelluar
- Politika e zhvillimit të territorit;
- Rregullorja e planit
- Hartat në pdf
- Harta e nën njësive strukturore (Harta e përdorimit të tokës)
- Vlerësimi Strategjik Mjedisor për PPV

I. Aplikimi për lloj leje "Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²", me nr. regjistri/protokolli 4858 për objektin “Objekt banimi dhe shërbimi 6 kat dhe 1 kat nëntokë”, Qyteti Bajram Curri.

Dokumente të aplikimit për leje.

Për aplikimin me numër AN71220200041, **protokolluar me nr. 4858, datë 07.12.2020** "Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²", dorëzuar elektronikisht nga aplikanti dhe projektuesi shoqëria “S” shpk me NUIS J.....U **për objektin:** “Godine banimi dhe shërbimi 1-6 kat dhe 1kat nëntokë”, **Qyteti Bajram Curri, dhe zhvillues shoqëria "Enti Kombëtar i Banesave” dhe subjekt ndërtues**

Për sa i përket procedurës së kryer për zbardhjen e lejes ndërtimit me dokumentacionit përkatës: Lista e dokumenteve të ngarkuara elektronikisht:

- projekti arkitektonik.pdf ; relacion arkitektonik.pdf
- projekti konstruktiv.pdf ; relacion konstruktiv.pdf; Studimi sizmik
- projekti elektrik.pdf ; relacion elektrik.pdf
- projekti hs.pdf ; relacion hs.pdf
- projekti ac.pdf ; relacion ac.pdf
- preventivi.pdf
- planvendosja.pdf; - deklaratë përgjegjësie - topografi.pdf
- licencat firme dhe individuale.pdf ;
- siguracioni geoproject.pdf ; - planvendosja-model.pdf;
- grafiku i punimeve.pdf

- vnm paraprake signed.pdf
- fatura ukk.pdf ; - osshe.pdf
- leje_zhvillimi_ppv.... (1).pdf
- projekti mkz.pdf; - relacion mkz.pdf; - deklarata eksperti zjarrfikes.pdf;
- licensa_inxh_mjedisi; qkl_mkz.pdf; qkr.pdf; prokura.pdf
- deklarata arkitekti.pdf; deklarata eksperti zjarrfikes.pdf; deklarata inxh elektrik.pdf
- deklarata inxh hidroteknik.pdf; deklarata inxh mekanik.pdf; deklarata konstruktori.pdf
- deklarata e gjeologut.pdf
- licence projektimi S.4.pdf; licensa e mk zjarrit_.pdf
- licensa_inxh_elektrik_.pdf; licensa_inxh_konstruktor_.pdf
- license_arkitekt_.pdf, qkl_mkz.pdf
- qkr.pdf; polica e sigurimit S shpk, datë 20.10.2017 deri 19.10.2018.pdf
- dokument pronësie për truallin.pdf ; dok e pronës.pdf

Mbi Lejen e zhvillimit

- Në aplikimin me numër AN71220200041, protokolluar me nr. **4858, datë 07.12.2020** "Leje zhvillimi", dorëzuar elektronikisht nga aplikanti dhe projektuesi shoqëria "S" shpk me NUIS J.....U, është miratuar leje zhvillimi me nr. 3503/1, datë 16.10.2020 prot Leja e zhvillimit për objektin: "Godine banimi dhe shërbimi 1-6 kat dhe 1kat nëntokë", në Qytetin Bajram Curr Bashkia Tropojë, dhe zhvillues **Enti Kombëtar i Banesave**, në pasurinë me nr. pasurie 4/189, ZK 1347, në pronësi të zhvilluesit, me kufij (V/J/L/P), sipërfaqe 1020 m² kushtet zhvillimore janë:

Kategoria/të e përdorimit të tokës:	Banim
Përdorimi i lejuar:	(Banim + Shërbim) Zona A.3.1-1
Sipërfaqja minimale sipas ppv e tokës :	1020 m ²
Koeficienti maksimal i shfrytëzimit të tokës (%):	40%
Intensiteti maksimal i ndërtimit të pasurisë:	2.4
Lartësia maksimale në kate:	6.5

Përdorimi i lejuar është: Rezidenciale; Aktivitete të nevojshme përfshirë zyra dhe shërbime

Në aplikimin me numër AN301020180083, protokolluar me nr.**678, datë 30.10.2018** "Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²", dorëzuar elektronikisht nga aplikanti dhe projektuesi, është dërguar në institucione për mendim me datë 13.01.2021, në: OSHEE Kukës, nuk është konfirmuar; nga PMNZSH Tropojë nuk është konfirmuar Nga Ujësjellës kanalizime Tropojë nuk është konfirmuar. Është kthyer përgjigje nga 2 institucione"; Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Instituti i Gjeoshkencës, Energjisë, Ujrave dhe Mjedisit(IGJEUM). Nuk është kryer Oponenca teknike pranë fakultetit të inxhinierisë së Ndërtimit.

Raporti i vlerësimit pozitiv të lejes është bërë me datë 02.02.2021 e firmosur në mënyrë elektronike nga Ing. M.K (Përgjegjës Sektori i Pronave dhe hartografisë PKZHT-se) M.V (specialiste PKZHT-se), M.B (pergjegjes PKZHT-se), V.P (specialiste PKZHT-se), Ing.. H.I (Drejtor PKZHT-se).

Njoftimi për vlerësimin pozitiv dhe pagesën e taksës së infrastrukturës është bërë me datë 04.02.2020 , të bashkangjitur me treguesin e pagesës së taksës dhe tarifës si dhe faturën e arkëtimit.

Vendimi i lejes së ndërtimit me Nr. 2, date 09.02.2021, për objektin: “Godine banimi dhe shërbimi 1-6 kat dhe 1kat nëntokë”, në Bajram Curri dhe zhvillues shoqëria "E" dhe subjekt ndërtues , zona kadastrale 1347, numër pasurie 4/189, sipërfaqja e pronës 1020 m², sipërfaqja e gjurmës së strukturës është 399 m², sipërfaqja totale e ndërtimit 2442 m², koeficienti i shfrytëzimit të strukturës është 39 %, intensiteti i ndërtimit 2.4. Bashkangjitur formulari lejes së ndërtimit dhe planvendosja e sheshit.

The plan shows a rectangular building footprint in orange, surrounded by parking spaces and landscaping. Red labels indicate 'ZONA TROPOSJE' (Tropical Zone) in several areas. The site is bounded by cadastral zones 4/21, 4/22, 4/23, 4/24, 4/25, 4/26, and 4/27. An inset map shows the location within a larger urban grid.

NE KODIN "BC-3", TROPOSJE, NE PRONEN E ENJTT KOMESTYR TE BAJRAME, NE ZHVILLUES ENTT KOMESTYR TE BAJRAME.
KRYETARI I BASHKISE SE TROPOJES
REKXE BYBERI

MIRATOHET

TRONDHJET E ZHVILLIMIT
 SHPERKOHJE TRONDHJET OG ZHVILLONET
 SHPERKOHJE TRONDHJET OG ENDOSTRUKTURA,
 SHPERKOHJE E PËRITUR BASHKJE TRONDHJET OG
 KËRKHEDHENTI SHPERVIZHENTI TRONDHJET
 NANNI TRONDHJET OG TËRË
 NANNI TRONDHJET OG TËRË

DETAJLIT TË NËNTRONIT:
 VITI: 2021
 LINDJE: 2021
 PËRSONAL: 2021
 AJO: 2021

ORIENTIM TË NËNTRONIT:
 LINDJE: 2021
 PËRSONAL: 2021
 AJO: 2021

ORIENTIM TË NËNTRONIT:
 VITI: 2021
 LINDJE: 2021
 PËRSONAL: 2021
 AJO: 2021

SHKALLA: 1:200	SHKALLA: 1:200
SHKALLA: 1:200	SHKALLA: 1:200
SHKALLA: 1:200	SHKALLA: 1:200
SHKALLA: 1:200	SHKALLA: 1:200

TRONDHJET E ZHVILLIMIT	TRONDHJET E ZHVILLIMIT
TRONDHJET E ZHVILLIMIT	TRONDHJET E ZHVILLIMIT
TRONDHJET E ZHVILLIMIT	TRONDHJET E ZHVILLIMIT
TRONDHJET E ZHVILLIMIT	TRONDHJET E ZHVILLIMIT

Nga verifikimi i dokumentacionit të sipërcituar rezulton, se ka parregullsi dhe mungesë dokumentacioni, konkretisht:

-polica e sigurimit të shoqërisë projektuese S shpk, rezulton për periudhën nga datë 20.10.2017 deri 19.10.2018, jashtë aftëve të lejes së miratuar.

- Gjithashtu mungojnë konfirmimet e institucioneve përkatëse, të cilave ju është drejtuar për mendim Bashkia Tropojë,

Të firmosura në mënyre elektronike nga Ing. M.K (Përgjegjës Sektori i Pronave dhe hartografisë PKZHT-se) M.V (specialiste PKZHT-se), M.B (pergjegjes PKZHT-se), V.P (specialiste PKZHT-se), Ing.. H.I (Drejtor PKZHT-se), Kryetar R.B.

II. Aplikimi për lloj leje "Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²" , me nr. regjistri/protokollu 108 për objektin “Objekt në funksion të përpunimit, dhe magazinimit të produkteve bujqësorë”, Fshati Bujan, Bashkia Tropojë.

Dokumente të aplikimit për leje.

Për aplikimin me numër AN130120210032, protokolluar me nr. 108, datë 13.01.2021 "Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²", dorëzuar elektronikisht nga aplikanti I.H dhe projektuesi shoqëria “I” shpk me NUIS L.....R për objektin: “Magzinë në funksion të përpunimit, dhe magazinimit të produkteve bujqësorë 1 kat”, Fshati Bujan, Bashkia Tropojë dhe zhvillues Sh.M dhe subjekt ndërtues.

Për sa i përket procedurës së kryer për zbardhjen e lejes ndërtimit me dokumentacionit përkatës: Lista e dokumenteve të ngarkuara elektronikisht:

- projekti arkitektonik.pdf ; relacion arkitektonik.pdf
- projekti konstruktiv.pdf ; relacion konstruktiv.pdf; Studimi sizmik
- projekti elektrik.pdf ; relacion elektrik.pdf
- projekti hs.pdf ; relacion hs.pdf
- projekti ac.pdf ; relacion ac.pdf
- preventivi.pdf
- planvendosja.pdf; - deklaratë përgjegjësie - topografi.pdf
- licencat firme dhe individuale.pdf ;
- siguracioni geoproject.pdf ; - planvendosja-model.pdf;
- grafiku i punimeve.pdf
- vnm paraprake signed.pdf
- fatura ukk.pdf ; - osshe.pdf
- leje_zhvillimi_ppv.... (1).pdf
- projekti mkz.pdf; - relacion mkz.pdf; - deklarata eksperti zjarrfikës.pdf; qkl_mkz.pdf; qkr.pdf, prokura.pdf
- deklarata arkitekti.pdf; deklarata eksperti zjarrfikës.pdf; deklarata inxh elektrik.pdf
- deklarata inxh hidroteknik.pdf; deklarata inxh mekanik.pdf; deklarata konstruktori.pdf
- licence projektimi “I” 4.pdf; licensa e mk zjarrit_.pdf
- licensa_inxh_elektrik_.pdf; licensa_inxh_konstruktor.pdf
- licensa_inxh_mjedisi_.pdf; license_arkitekt_.pdf ; qkl_mkz.pdf

qkr.pdf; polica e sigurimit Inceptoi shpk, datë 21.09.2020 deri 21.09.2021.pdf
dokument pronësie për truallin.pdf lëshuar datë 10.09.2019 ; dok e pronës.pdf

Mbi Lejen e zhvillimit

- Në aplikimin me numër AN130120210032, **protokolluar me nr. 108, datë 13.01.2021** "Leje zhvillimi", dorëzuar elektronikisht nga aplikanti dhe projektuesi shoqëria "I" shpk me NUIS L.....R , është miratuar leje zhvillimi me nr. 3932/1, datë 16.10.2020 prot Leja e zhvillimit për objektin: "Magazinë në funksion të përpunimit, dhe magazinimit të produkteve bujqësorë 1 kat", Fshati Bujan, Bashkia Tropojë, dhe zhvillues Sh.M, në pasurinë me nr. pasurie 6/43, ZK 3197, në pronësi të zhvilluesit, me kufij (V/J/L/P), sipërfaqe 1200 m² kushtet zhvillimore janë:

Kategoria/të e përdorimit të tokës:	Banim
Përdorimi i lejuar:	(Banim + Bujqësi) Zona BA.3.1-81
Sipërfaqja minimale sipas ppv e tokës :	1200 m ²
Koeficienti maksimal i shfrytëzimit të tokës (%):	12%
Intensiteti maksimal i ndërtimit të pasurisë:	0.13
Lartësia maksimale në kate:	1

Përdorimi i lejuar është: Tokë bujqësore, aktivitete bujqësore ndihmëse; Banim dhe struktura ndihmëse përkatëse

Në aplikimin me numër AN130120210032, **protokolluar me nr. 108, datë 13.01.2021** "Leje zhvillimi", dorëzuar elektronikisht nga aplikanti dhe projektuesi shoqëria "I" shpk. Lidhur me shprehjen e institucioneve përkatëse nuk ka shkresë të dërguar nga Bashkia Tropojë, për të kërkuar konfirmim apo shprehje mendimi nga institucionet:

OSHE Kukës, nuk është konfirmuar; nga PMNZSH Tropojë nuk është konfirmuar

Nga Ujësjellës kanalizime Tropojë nuk është konfirmuar, etj.

Ka shprehur dakordësinë Ministria e Bujqësisë me shkresën nr. 1922 prot, datë 01.03.2022

Me vendimin nr. 108/1 prot, datë 08.02.2021, Kryetari i Bashkisë Tropojë ka refuzuar dhënien e lejes për mungesë dokumnetacioni.

Më pas Raporti i vlerësimit pozitiv të lejes është bërë e firmosur në mënyrë elektronike nga Ing. M.K (Përgjegjës Sektori i Pronave dhe hartografisë PKZHT-se) M.V (specialiste PKZHT-se), M.B (pergjegjes PKZHT-se), V.P (specialiste PKZHT-se), Ing.. H.I (Drejtor PKZHT-se).

Vendimi i lejes së ndërtimit me Nr. 478/1 prot, date 05.05.2021, për objektin "Magazinë në funksion të përpunimit, dhe magazinimit të produkteve bujqësorë 1 kat", Fshati Bujan.

PLANI I VENDOSJES SE STRUKTURES 01-1.000

OBJEKTI : "OBJEKT NE FUNKSION TE MAGAZINIMIT DHE PERPUNIMIT TE PRODUKTEVE BUJQESORE"

INVESTITOR : SHERIF MALIA

VENDODHJA : BIJAN-TROPOJE

MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISE SË TROPOJËS

REXHË BYBERI

TREGUESIT E ZHVILLIMIT TE STRUKTURES


SIFERFALIA E PRONËS QË ZHVILLOHET	16988 m ²
SIFERFALIA E GJERMËS SË STRUKTURES	1290 m ²
INTENSITETI I NDËRTIMIT	8.13
KOEFICIENTI I SHFRITËZIMIT TE TRUALLIT	13 %
LARTESIA MAKSIMALE E STRUKTURES	9.3m
NUMRI I KATËVE MË TËNDE	16
VËLLIMI I OBJEKTIT	1200m ² x8.3m=9960m ³

TREGUESIT KADASTRALE

ZONA KADASTRALE	2197
NUMRI I PASURISE	043
INDEKSI I HARTES	K-34-03-Q43-C)


DISTANCAT E OBJEKTIT NGA KUFIRI I PRONËS QË DO TË ZHVILLOHET:

VERIU	15m dhe 10.7m
JETË	8.0 m, 20.3m dhe 30.3m
LINDJE	15m
PËRQENDRIM	88.3m dhe 77.7m




POZICIONI ORTOGRAFIK (ORTOFOTO)


SHKALLA 1:2000



POZICIONI KADASTRAL

ZONA KADASTRALE Nr. 3197 Nr.ii.043 SHKALLA 1:2000



 <p>REPUBLIKA E SHQIPËSË BASHKIA E TROPOJËS</p> <p>DREJTORIA E PËRGJITHSHMË E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT</p>	ARKITEKTI	Inëri HAMITI	
	Ing. TOPOGRAF	Zdrisi DAMA	
<p>OBJEKTI:</p> <p>PLANI I VENDOSJES SË STRUKTURES : "OBJEKT NE FUNKSION TE MAGAZINIMIT DHE PERPUNIMIT TE PRODUKTEVE BUJQESORE"</p> <p>ADRESA : BIJAN-TROPOJE</p> <p>INVESTITOR : SHERIF MALIA</p>	DREJTOR I DREJTORISE SË PLANIFIKIMIT E TERRITORIT	Haxhi ISUFUJI	
	PËRGJEGJËS I SEKTORIT TE SHQYRTIMIT TE APLIKIMEVE	Mehmet BRICANI	
	SPECIALIST I SEKTORIT TE SHQYRTIMIT TE APLIKIMEVE	Vijana PLAKA	
	SPECIALIST I SEKTORIT TE SHQYRTIMIT TE APLIKIMEVE	Muhamet VATOZI	
	SPECIALIST I Z.A.M. T-06	Muhamet MUCANA	

Nga verifikimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultojnë, se ka parregullsi dhe mungesë dokumentacioni, konkretisht:

- Polica e sigurimit për prsonelin inxhinierik projektues, rezultojnë për periudhën nga data 21.09.2020 deri 21.09.2021, jashtë afateveve të lejes së miratuar.
- Mungon deklarat e projektuesit sipas formatit të përcaktuar në sistemin elektronik.
- Gjithashtu mungojnë konfirmimet e institucioneve përkatëse, si dhe kërkesa për informacion dhe për mendim nga Bashkia Tropojë.

Të firmosura në mënyre elektronike nga Ing. M.K (Përgjegjës Sektori i Pronave dhe hartografisë PKZHT-se) M.V (specialiste PKZHT-se), M.B (pergjegjes PKZHT-se), V.P (specialiste PKZHT-se), Ing.. H.I (Drejtor PKZHT-se), Kryetar R.B

III. Aplikimi për lloj leje "Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²" , me nr. regjistri/protokolli 5032 për objektin "Thertore dhe përpunim mishi+prodhim nën produktesh mishi", Qyteti Bajram Curri, Bashkia Tropojë.

Dokumente të aplikimit për leje.Për aplikimin me numër AN221220200012, protokolluar me nr. 5032, datë 22.12.2020 "Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²", dorëzuar elektronikisht nga aplikanti M.H dhe projektuesi shoqëria "B.L" shpk me

NUIS K.....L për objektin “Thertore dhe përpunim mishi+prodhim nën produktesh mishi”, Qyteti Bajram Curri, Bashkia Tropojë dhe zhvillues M.H.

Për sa i përket procedurës së kryer për zbardhjen e lejes ndërtimit me dokumentacionit përkatës:

Lista e dokumenteve të ngarkuara elektronikisht:

- projekti arkitektonik.pdf ; relacion arkitektonik.pdf
 - projekti konstruktiv.pdf ; relacion konstruktiv.pdf;
 - projekti elektrik.pdf ; relacion elektrik.pdf
 - projekti ac.pdf ; relacion ac.pdf
 - preventivi.pdf
 - planvendosja.pdf; - deklaratë përgjegjësie - topografi.pdf
 - licencat firme dhe individuale.pdf ;
 - siguracioni geoproject.pdf ; - planvendosja-model.pdf;
 - grafiku i punimeve.pdf
 - vnm paraprake signed.pdf
 - leje_zhvillimi_ppv.... (1).pdf
 - projekti mkz.pdf; - relacion mkz.pdf; - deklarata eksperti zjarrfikës.pdf; qkl_mkz.pdf; qkr.pdf, prokura.pdf
 - deklarata arkitekti.pdf; deklarata eksperti zjarrfikës.pdf; deklarata inxh elektrik.pdf;
 - deklarata inxh mekanik.pdf; deklarata konstruktorit.pdf
 - licence projektimi “B.L” 4.pdf; licensa e mk zjarrit_.pdf
 - licensa_inxh_elektrik_.pdf; licensa_inxh_konstruktor_.pdf
 - license_arkitekt_.pdf; inxh mekanik
 - qkl_mkz.pdf; polica e sigurimit B.L shpk, datë 21.09.2020 deri 21.09.2021.pdf
- dokument pronësie për truallin.pdf lëshuar datë 10.09.2019 ; dok e pronës.pdf

Mbi Lejen e zhvillimit

- Në aplikimin me numër AN221220200012, **protokolluar me nr. 5032, datë 22.12.2020** "Leje zhvillimi", dorëzuar elektronikisht nga aplikanti dhe projektuesi shoqëria “B.L” shpk me NUIS K.....L është miratuar leje zhvillimi me nr. 3029/1, datë 07.07.2020 prot Leja e zhvillimit për objektin: për objektin “Thertore dhe përpunim mishi+prodhim nën produktesh mishi”, Qyteti Bajram Curri dhe zhvillues M.H, në pasurinë me nr. pasurie 9/1/2 ZK 1347, në pronësi të zhvilluesit, me kufij (V/J/L/P), sipërfaqe 8350 m² kushtet zhvillimore janë:

Kategoria/të e përdorimit të tokës:	Natyrë
Përdorimi i lejuar:	(natyrë, mbarështim bimësie) Zona N.7-3
Sipërfaqja minimale sipas ppv e tokës :	1408 m ²
Koeficienti maksimal i shfrytëzimit të tokës (%):	16.8 %
Intensiteti maksimal i ndërtimit të pasurisë:	0.17
Lartësia maksimale në kate:	1

Përdorimi i lejuar është: Nr.55 te rregullores se PPV, njesia strukturore N7 - 3: Fidanishte; Natyrë; Mbarështim bimësisë vendase


Në aplikimin me numër AN221220200012, **protokolluar me nr. 5032, datë 22.12.2020** "Leje zhvillimi", dorëzuar elektronikisht nga aplikanti dhe projektuesi shoqëria "B.L" shpk. Nga Bashkia Tropojë është kërkuar në institucione për mendim me datë 29.12.2020, në:

Agjencia e Zhvillimit të Territorit • Agjencia Kombëtare e Mjedisit • Zyra Vendore ASHK Tropojë • Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit • Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave • Ministria e Mjedisit • OSHEE Kukes • PMNZSH Tropojë • Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit • Ujësjellës Kanalizime Tropojë.

Ka shprehur dakordësinë Ministria e Bujqësisë me shkresën nr. 3633/1 prot, datë 09.06.2020. Raporti i vlerësimit pozitiv të lejes është bërë me datë 24.03.2019 e firmosur në mënyrë elektronike nga Ing. M.K (Përgjegjës Sektori i Pronave dhe hartografisë PKZHT-se) M.V (specialiste PKZHT-se), M.B (pergjegjes PKZHT-se), Ing.. H.I (Drejtor PKZHT-se).

PLANI I VENDOSJES SË STRUKTURËS SH. 1:1000


OBJEKTI: Thertore & Përpunim mishi • Prodhim Nënproduktesh mishi
INVESTITORI: Tropoja-2019.shpk





MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË
TROPOJË
REXHE BYBERI
Rexhe Byberi
Diplomë Inzhinerie Bashkia Tropojë
Nr. 00001/01/2020
12/2019

TREGUESIT URBANISTIKË TË SHESHT
Sip. e Pronës 8350.0 m²
Sip. e Gjurmës së strukturës që zhvillohet 1408 m²
Sip. e Ndërtimit të strukturës 1408.0 m²
Koefficienti i Shfrytëzimit të Territorit 16.8 %
Intensiteti i Ndërtimit 0.17
Lartësia maksimale e Strukturës 10.8 m
Numri i katëve më të larta 1

TREGUESIT KADASTRAL
Zona kadastrale: 1347
Numri i Pasurisë: 9/12
Indeksi i Hartës: K-34-53(227-D),K-34-53(228-C)
DISTANCA E STRUKTURËS NGA KUFIRI I PROMËS
Veri 21.95 m
Lindje 3.5 m
Jug 18.2 m
Perëndim 9.35 m
Distanca nga objekti më i afërt: 33m
Distanca e strukturës nga llopi i magës 18.2 m (në pikën më të afërt)
(largësia e objektit të thertores nga kufiri i pronës ≥ 20m)

Pozicion Topografik (Ortofoto), Sh. 1:2000


Pozicioni Kadastral, Sh. 1:3000


 BASHKIA TROPOJË REPUBLIKA E SHQIPËRISË DRISTORIA E PLANIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT	ARHITEKTI	STUDIO B.A.L.	Emri i Bletës
	ING. TOPOGRAFI	Enkel Lami	
	UREJTORI I DREKTORISË SË PLANIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT	Hazir Isufi	Hazir Isufi
	OBJEKTI:	Mënyra MËÇANI	Mënyra MËÇANI
	Thertore & Përpunim mishi • Prodhim Nënproduktesh mishi	Vijana Fleta	Vijana Fleta
M.E. ACRËSË: nga Çënkë, Sajran Curt, Tropojë	Mustaf Vatod	Mustaf Vatod	
INVESTITOR: Tropoja-2019.shpk	SPECIALITETI I A.N.T.-së	Muhamed Ruzani	Muhamed Ruzani

Vendimi i lejes së ndërtimit me Nr. 5032/1 prot, date 01.12.2021, për objektin "Thertore dhe përpunim .

Nga verifikimi i dokumentacionit të sipërcituar rezulton, se ka parregullsi dhe mungesë dokumentacioni, konkretisht:

- Polise sigurimi për ing. Konstruktor dhe ing. Mekanik, nuk mbulojnë afatin e zbatimit të lejes së ndërtimit, pasi përfundojnë me datë 03.03.2021 dhe datë 04.04.2021;

- Dokumenti i pronësisë nuk është i refreskuar si dhe mungon Kartela e pasurisë dhe harta treguese;

- Gjithashtu mungojnë konfirmimet e institucioneve përkatëse, si dhe kërkesa për informacion dhe për mendim nga Bashkia Tropojë,

Të firmosura në mënyre elektronike nga Ing. M.K (Përgjegjës Sektori i Pronave dhe hartografisë PKZHT-se) M.V (specialiste PKZHT-se), M.B (pergjegjes PKZHT-se), V.P (specialiste PKZHT-se), Ing.. H.I (Drejtor PKZHT-se), Kryetar R.B

Si konkluzion mbi zbatimin e procedurës për zbardhjen e lejes së zhvillimit dhe lejes së ndërtimit për aplikimin nga IV deri XI mund të themi:

Lëshimi i lejes së zhvillimit dhe lejes së ndërtimit, është në përputhje me:

- Kushtet zhvillimore sipas Planin e Përgjithshëm të Bashkisë Tropojë me Vendimi Nr. 2, Date 09.12.2017 i KKT-së, “Për Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Tropojë”, ndryshuar. janë respektuar, si: Koeficienti maksimal i shfrytëzimit, intensiteti maksimal i ndërtimit të pasurisë si dhe lartësia maksimale në kate.

- Janë zbatuar distancat nga kufiri i pronës së objektit me objektet fqinje, si: trupi i rrugës, ndërtesa, etj, sipas V.K.M nr.408, datë 13.5.2015 “Për Miratimin e Rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar” nenet 34, 35, 36.

- Projektideja e dorëzuar nga kërkuesi bashkë me kërkesën për leje zhvillimi është në përputhje me rregullat e projektimit në fuqi.

- Rezultojnë mangësi në dokumentacionin që lidhet kryesisht me licencat dhe polisë sigurimi të projektuesve, si dhe mungesë komunikimi , apo dhënie mendimi nga institucionet përkatëse;

Të firmosura në mënyre elektronike nga Ing. M.K (Përgjegjës Sektori i Pronave dhe hartografisë PKZHT-se) M.V (specialiste PKZHT-se), M.B (pergjegjes PKZHT-se), V.P (specialiste PKZHT-se), Ing.. H.I (Drejtor PKZHT-se), Kryetar R.B

Sa më sipër trajtuar, për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. R.B, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë.
- ing. H.I, (Drejtor PKZHT-së)
- Ing. M.K përgjegjës KZHT-së
- Ing. M.B (ish përgjegjës KZHT-së)
- M.V (specialiste KZHT-së)
- V.P (specialiste PKZHT-se),

Për sa trajtuar në faqet 121-133 të Raportit Përfundimtar të auditimit, janë paraqitur observacione në rrugë elektronike dhe me shkresën nr. 2751/47, datë 28.09.2023, protokolluar në KLSH me nr. 518/6, datë 09.10.2023.,

Pretendimi i subjektit

Lidhur me aplikimin me nr.regjistri/protokolli 4858 për objektin Objekt banimi dhe shërbimi 6 kat (1 11c 1 kat nëntokë, qyteti Bajram Curri”, keni konstatuar se: Polica e sigurimit e shoqërisë „S” shpk, rezulton për periudhën nga data 20.10.2017 deri 19.10.2018, pra jashtë afateve, për këtë sqarojmë se, projekti i përket E-së dhe është hartuar për disa bashki, për këtë arsye edhe polica e sigurimit është lëshuar për atë periudhë;

-lidhur me konstatimin se në stafin e shoqërisë "S" mungon inxhinieri hidroteknik. Ju sqarojmë se, licenca e Ing. A.H.D me nr.M.0229/3, datë 30.03 2017 përmban kategorinë 4 A "Projektim të instalimeve hidro-termosantare" dhe 4 B "Projektim të instalime termoteknike – kondicionimi", kategori të cilat plotësojnë kriterin për instalimet hidrosantare.

-lidhur me konstatimin se mungojnë konfirmimet e institucioneve përkatëse, të cilave ju është drejtuar për mendim Bashkia Tropojë, sqarojmë se, bazuar në VKM nr.408, datë 13.05.2015, i ndryshuar "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", neni 21, pika 6, theksohet se: Në mungesë të përgjigjes së autoriteteve publike nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit, brenda 10 (ditëve pune), kërkesa konsiderohet e miratuar në heshtje.... .

-lidhur me konstatimin se mungon oponenti teknike e ndërtimit, Ju sqarojmë se, bazuar në ligjin nr. 120/2020 "Për disa ndëshime dhe shtesa në ligjin nr.8402, datël 0.09.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 3, pika 3 dhe neni 6, pika l, germa b, për projektin në fjalë nuk është detyrim hartimi i oponentit teknike, pasi vlera e preventivuar e objektit është nën kufirin 100 milion leke. Per te vertetuar kete, bashkangjitur keni preventivin e objektit.

Lidhur me aplikimin me nr. regjistri/protokolli 108 për objektin "Objekt në funksion të përpunimit dhe magazinimit të produkteve bujqësore", fshati Bujan, Bashkia Tropojë".

-lidhur me konstatimin se përdorimi i lejuar është: Tokë bujqësore, aktivitete bujqësore ndihmëse;Banim

dhe struktura ndihmëse përkatëse, Ju sqarojmë se, bazuar në Vendimin nr. 12, datë 27.02.2019 të KKT-së "Per miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban (UB), bujqësor (B) (dhe natyror (N), pika l, shkronja "a ", jepet leje për Objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, sipas legjislacionit të posacëm se Autoritetet e zhvillimit të territorit duhet të vijoje me miratimin e kërkesave për leje zhvillimi/ndërtimi për rastet sipas pikes I të këtij vendimi, vetëm pas marrjes së konfirmimit nga Ministria e linjës dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit

-lidhur me konstatimin se, mungon licenca e rinovuar e Ing. Hidroteknik, Ing.Mekanik de MNZ si dhe policia e sigurimit, rezulton jashtë afateve të lejes së ndërtimit, sqarojmë se licenca e Ing,

B.V me nr. K. 1373/3, datë 10.04.2018 përmban kategorinë 4 A "Projektim të instalimeve hidro-termosantare" kategori të cilat plotësojnë kriterin për instalimet hidrosantare. Ing, Mekanik A.M.Z me licensë nr. M.00305/2, datë 14.04.2018, dhe 4 B "Projektim të instalime termoteknike-kondicionimi". Theksojmë se licencat dhe ploicat e sigurimit janë brenda afatit të lejes(21.09.2020 deri 21.09.2021), bashkëlidhur dokumentacioni i sipër cituar.

Lidhur me aplikimin me nr. regjistri/protokolli 5032 për objektin "Thertore dhe përpunim mishi+ prodhim nënëproduktesh mishi".

Përdorimi i lejuar është: fidanishte, natyrë, mbarështim bimesie vendase, pra hyn në kateg. (B) dhe (N), bazuar në Vendimin nr. 12, datë 27.02.2019, ku thuhet:

Bashkitë të cilat kanë plane të përgjithshme vendore të miratuar, lejohet të japin leje në njësitë UB(urban), B(bujqësor), N(natyror), për këto objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, sipas legjislacionit të posacëm sektoral. Autoritetet e zhvillimit të territorit duhet të vijoje me miratimin e kërkesave për leje

zhvillimi/ndërtimi për rastet sipas pikes I të këtij vendimi, vetëm pas marrjes së konfirmimit nga ministria e linjës dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit. Bashkëlidhur materialit janë 2 konfirmimet e këtyre institucioneve.

- lidhur me konstatimin se ka mungesë të dokumentacioni, konkretisht; Licenca e Ing. Hidroteknik, si dhe polica e sigurimit përkatëse, policë sigurimi për ing. Konstruktor dhe ing. Mekanik. Konstatimi se dokumenti pronësisë nuk është rifreskuar.

Ju sqarojmë se licencat e ing. G.B nr. M. 0140/4, datë 29.05.2017 përmban kategorinë 4 A “Projektim të instalimeve hidro-termosanitare” dhe 4 F “Projektim të sistemeve kundra zjarrit”.

Gjithashtu policat e sigurimit për projektuesit janë brenda afateve(21.09.2020-21.09.2021), leja lëshuar datë 01.12.2021. Dokumentacioni i pronësisë është i rifreskuar, data e lësllimit është brenda 90 ditëve nga data e aplikimit. Dokumentet epronësisë (kartelat e pasurisë mbajnë datën 25.09.2020. Përsa i përket pretendimit se mungojnë konfirmimet nga institucionet përkatëse, si dhe kërkesa për informacion nga Bashkia Tropojë, ju sqarojmë se nga ana jonë, përmes sistemit e-Leje është kërkuar informacioni i duhur dhe kjo vertetohet edhe nga dokumentacioni i printuar nga sistemi, bashkangjitur .

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me observacionet e paraqitura të sipërcituar, sqarojmë se observacioni juaj lidhur me licencën e për punimet hidro sanitare pranohet nga grupi I Auditimit. Gjithashtu pranohet licenca e rinovuar e ing. Konstruktor, ing. Hidroteknik, pasi në këto raste zërat përkatës mbulohen nga licencat që I janë bashkëlidhur observacionit. Lidhur me mungesën e oponecës teknike për objektin me leje ndërtimi në favor të E, sqarojmë se është marrë në konsideratë që në fazën e hartimit të project raportit të Auditimit.

Titulli i gjetjes: “Mos ushtrimi i kontrolleve dhe moszbatimi i procedurës ligjore për dhënie leje ndërtimi”.

Situata:

Nga auditimi i zbatimit të procedurave për dhënie të lejeve të ndërtimit u konstatuan mangësi në miratimin e disa lejeve si vijon:

- Aplikimi me Nr. nr. 4858 prot. , datë 07.12.2020, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: “Godine banimi dhe shërbimi 1-6 kat dhe 1kat nëntokë”, Qyteti Bajram Curri.

- Aplikimi me Nr. 5032 Prot, , datë 22.12.2020, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: “Thertore dhe përpunim mishi+prodhim nën produkteve mishi”, Qyteti Bajram Curri.

1.2021

- Aplikimi me Nr. 108 prot. , datë 13.01.2021, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt:“Ndërtim i magazinës 1 kat”. , sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: “Magazinë në funksion të përpunimit, dhe magazinimit të produkteve bujqësorë 1 kat”, Fshati Bujan, Bashkia Tropojë;

Konstatohet se në gjithë auditimin e kryer në Bashkia Tropojë për lejet e zhvillimit dhe lejet e ndërtimit ka problematika të njëjta në përgjithësi me kuptimin dhe zbatimin e ligjit në kontekst të VKM nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i

ndryshuar dhe me Ligjin Nr.107/2014“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, ku vërehet që bien ndesh me disa nga pikat e bazës ligjore sipërcituar.

*Në dosjet e lejeve mungon dokumentacioni i plotë tekniko-ligjor, specifikisht të pesë pikat si më poshtë konstatohet që nuk procedohen në kërkesën për plotësim të tyre nga subjektet përfitues të lejeve dhe miratohen pa to, duke qenë në kundërshtim me **nenin 15** të VKM nr. 408, datë 13.05.2015“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar:*

pikën e) Deklarata e projektuesit të licencuar, sipas formatit të aplikimit, të përcaktuar në sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit, nëpërmjet së cilës konfirmohet përputhshmëria e projektit me lejen e zhvillimit, dokumentet e planifikimit e kontrollit të zhvillimit, në fuqi, dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antizismike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri dhe higjieno-sanitare;

pikën ë) Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit;

pikën g) Kopje e policës së sigurimit të projektuesve, për mbulimin e përgjegjësisë profesionale; te Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, Datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar,.

Referuar sistemit e-Leje rezulton për lejet e sipërcituara, Drejtoria e Planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe IMTV me përfaqësues Z. H.I, M.K, M.B, M.V dhe V.P, në zbatim të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar, neni 16, rezulton që nuk ka mbajtur Akt Kontrolli i Piketimit të Objektit me subjektin zhvillues, nuk kemi një mbikëqyrës të punimeve inxhinierin përkatës dhe nuk kemi firmë zbatuese të punimeve të ndërtimit.

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë:-Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit” dhe VKM nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit, neni 15 (pika e,ë,g); neni 16 (pika d).

Impakti:

Mosrespektimi i rregullores së miratuar nga institucioni i cili nuk ka siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të territorit duke mos krijuar kushte të përshtatshme me, të drejta dhe shanse të barabarta për banim. Gjithashtu mosrespektim të ligjit dhe moszbatim të tij në nivel procedural duke sjell parregullsi juridike në çdo akt të prodhuar nga institucioni.

Shkaku:

Mos respektimi i përcaktimeve të Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandimi

Drejtoria e Punëve Publike, Administrimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratimit të lejeve të ndërtimit të mbahen aktet e kontrollit sipas përcaktimeve ligjore si dhe të zbatohen të gjitha pikat dhe nenet e cituara te VKM Nr.408/2015.

2.2.6 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore.

Nga auditimi konstatohet se, për vitin 2022 të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV

Titulli i gjetjes : *Mos arkëtim i gjobave të vendosura nga IMTV.*

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit që administron IMTV-ja në Bashkinë Tropojë u konstatua se për vitin 2021 janë mbajtur në total 14 proces verbale për konstatimin e kundërvajtjes. Janë dhënë 3 masa për “*Pezullim të punimeve*”, 11 masa për “*Prishje të objekteve të kundërligjshëm*”. Nuk kanë paguar disa subjekte vullnetarisht me vlerë totale të gjobave të vendosura për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 është 1,350,000 lekë. Për vitin 2021 të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale 1,350,000 lekë.

Për vitin 2022 janë mbajtur në total 6 proces verbale për konstatimin e kundërvajtjes. Janë dhënë 4 masa për “*Pezullim të punimeve*”, 2 masa për “*Prishje të objekteve të kundërligjshëm*”. Nuk kanë paguar disa subjekte vullnetarisht me vlerë totale të gjobave të vendosura për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 është 200,000 lekë. Për vitin 2021 të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale 200,000 lekë.

Kriteri: Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 ”Për kundërvajtjet administrative” neni 30 pika 1 pika 3 dhe pika 4, neni 9, neni 22, pika 1, neni 3, pika 5.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Tropojë në vlerën 7,450,000 lekë.

Shkaku: Mos ndjekja e hapave ligjore për arkëtimin e gjobave të IMTV.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: IMTV dhe Drejtoria e të Ardhurave në Bashkisë Tropojë të ndjekin të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtime të pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën **1,550,000 lekë**.

2.7 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

Titulli gjetjes 1: Realizimi i pjesshëm i rekomandimeve sipas plan veprimit të hartuar nga subjekti, duke pasqyruar punën e bërë dhe analizuar rekomandimet e realizuara plotësisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë realizuar plotësisht.

Situata: Nga auditimi i fundit i kryer në Bashkinë Tropojë, nga KLSH janë rekomanduar masa për përmirësimin e gjendjes, të cilat janë dërguar në subjekt me shkresën nr. 572/12 prot., datë 22.09.2022.

a . Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 10 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga të pranuarat janë zbatuar 2 masa, janë zbatuar pjesërisht 5 masa organizative dhe nuk janë zbatuar 3 masa organizative.

b. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike. (të ardhura të munguara) janë rekomanduar 5 masa me vlerë 56,461,393 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 7,994,195 lekë, si dhe është pa arkëtuar vlera 48,467,198 lekë.

c. Masa Disiplinore i është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Tropojë t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse, nga e cila nuk është marrë asnjë masë disiplinore nga ana e titullarit.

Masat për të cilat kërkohet zbatim i tyre, paraqiten si vijon:

B. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konstatohet se nga Bashkia Tropojë, nuk ka gjetur zbatim ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, konkretisht:

- Nuk është ngritur një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, gjë e cila është reflektuar në mangësinë e plotë të rregullave të shkruara për funksionimin e institucionit.

- Nga ana e titullarit nuk është hartuar një strategji e menaxhimit të riskut për vitin 2021, manuali dhe harta e proceseve të punës, gjurma e auditimit e cila duhet të përfshinte të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë.

- Nga ana e nëpunësit autorizues, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut dhe dokumentimin e tij, si dhe nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e këtyre fenomeneve.

Gjithashtu, u konstatua se një numër i konsiderueshëm punonjësish, kanë rregulluar marrëdhënien e punës sipas dispozitave të Kodit të Punës, ndërkohë që pozicionet e tyre të punës, evidentohen si pozicione me status “Nëpunës Civil” dhe për rrjedhojë rekrutimi i tyre është bërë në kundërshtim me ligjin. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, 20, 21, 22, nenin 32 të ligjit nr. 68/2017” Për financat e vetëqeverisjes. vendore”, ligji nr. 152-2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 19-22 të Raportit të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, si dhe Kryetarit të GMS-së, duhet të marrë masa të menjëhershme për:

- Hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshtimit të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësisë dhe të drejtave të punonjësve të njësisë.

- Grupi i Menaxhimit Strategjik, të hartoj strategjia e riskut, regjistri i riskut, si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.

Situata: Pa zbatuar

1.2.Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore të marë masa për përditësimin e rregullores së brendshme, rregullimin e pozicioneve të punës për punonjësit të cilët janë trajtuar si punonjës me “Kodin e Punës” ku në fakt pozicioni i punës trajtohet sipas ligjit të “Nëpunësin Civil”.

Situata: Pa zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të veprimtarisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Tropojë, u konstatua se për vitet 2021” Bashkia Tropojë nuk ka Njësi të Auditit të Brendshëm dhe nuk ka lidhur kontratë me institucion tjetër për realizimin e këtij shërbimi. Me shkresën nr.2027 prot., datë 15.05.2020 me lëndë “Informacion për sektorin e Auditimit të Brendshëm”, është vënë në dijeni Ministria e Financave dhe Ekonomisë për shkrirjen e Sektorit të Auditimit të Brendshëm për shkak se nga Titullari është konstatuar performancë e dobët në punë dhe është arsyetuar se nëse lind nevoja do të paraqitet projekt-vendim në Këshillin Bashkiak, sipas rasteve për të marrë audit të specializuar nga jashtë.

Shkrirja e Njesisë së Auditit të Brendshëm nga Kryetari i Bashkisë është në kundërshtim me nenin 49 të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe pikën 1 të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të brendshëm në sektorin publik”, ku përcaktohet se në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore krijohet Njësia e Auditimit të Brendshëm. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 19-22 të Raportit të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë të marrë masa për organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm në bashki, duke krijuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm brenda strukturës organizative të Bashkisë Tropojë. Në përzgjedhjen e punonjësve të kihet në konsideratë fakti se audituesi i brendshëm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e “Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Situata: Pa zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Bashkia Tropojë në datën 01.01.2021 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta në vlerën 75,620,737 lekë. Gjatë vitit 2021 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 1,614,240 lekë, duke e çuar në 77,234,977 vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e vet në datën 31.12.2021. Peshën kryesore të detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta e zënë ato për investime në vlerën 66,930,347 lekë, të ndjekura nga detyrime për mallra në vlerën 3,574,046 lekë, detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore në vlerën 6,730,584 lekë. Sa më sipër konstatohet se Bashkia Tropojë ka marrë angazhime buxhetore pa pasur fonde në dispozicion dhe krijimi i detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 22-31 të Raportit të Auditimit)*

4.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Gjithashtu të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme.

Situata: Pjesërisht

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2020 është në vlerën 31,262,840 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 42,876,907 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2021 në krahasim me vitin 2020 ka pësuar një rritje prej 11,614,067 lekë, në të cilën ka ndikuar rritja e debitorëve të taksave. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar edhe gjendja e debitorëve për detyrimet shpërblim dëmi të lëna nga KLSH në vite, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat e duhura ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, në kundërshtim me Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93 (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3 faqe 40-61 të Raportit të Auditimit*)

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës/Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Taksave Vendore dhe Inspektoratin Vendore Mbrojtjes Territorit (IVMT), të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën 42,876,907 lekë, të paraqitura në fund të periudhës 31.12.2021, kjo për të ulur nivelin e borxhit dhe rritur nivelin e të ardhurave të Bashkisë Tropojë.

Situata: Pjesërisht

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se llogaritë e aktiveve në datën 31.12.2021 rezultojnë me gjendjen si më poshtë; 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 22,460,270 lekë; 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën neto 10,017,959 lekë; 212 “Ndërtesa Konstruksione” paraqitet në vlerë neto 1,113,618,582 lekë; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqitet në vlerën neto 1,695,583,073 lekë; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerë neto 16,651,963 lekë.

Për aktivet e mësipërme nuk është kryer inventarizimi si dhe nuk është ngritur grup i posaçëm pune për vlerësimin e gjendjes aktuale të pronës, përgatitjen e dokumentacionit për verifikimin dhe regjistrimin e të gjitha pronave të paluajtshme pranë Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ish ZRPP). Gjithashtu nuk është krijuar regjistri i aktiveve në formë shkresore, gjendja ekzistuese e këtij regjistri është vetëm në formë elektronike. Sa konstatuar më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 3 -Përkufizime, pika 1,2, neni 7 - Dokumenti kontabël, neni 11 – Qëllimi i pasqyrave financiare, neni 15-Inventari i aktiveve dhe detyrimeve; UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë

e sektorit publik”, kapitulli IV. pika 74, UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3 faqe 40-61 të Raportit të Auditimit)

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë të ngrëjë grup pune me specialist të fushës për evidentimin e të gjitha aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (AQT) të cilat janë pasuri e Bashkisë, duke evidentuar statusin dhe gjendjen e tyre faktike në teren.

6.2.Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me strukturat e tjera të bashkisë të plotësojë regjistrin e të gjitha aktiveve sipas llogarive përkatëse, i cili të jetë elektronikë dhe shkresor dhe të marrë masa për regjistrimin e pronave në ASHK dhe kontabilitet. Për çdo vit, të kryhet inventarizimi i këtyre aktiveve.

Situata: Pjesërisht

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Bashkia Tropojë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31/12/2021 paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjetllës Kanalizime Tropojë Sha me NUIS “J.....Ë” e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemimeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre”. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 764,579.8 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 764,579,800 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Tropojë në “Ujësjetllës Kanalizime Tropojë Sha, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël të vitit 2021, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrin nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3 faqe 40-61 të Raportit të Auditimit)

7.1.Rekomandimi: Nëpunësit zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek “Ujësjetllës Kanalizime Tropojë Sha me vlerë 764,579,800 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Situata: Pa zbatuar

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive kreditore në pasiv të bilancit rezultoi se:
- llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Kjo gjendje në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 108,423,719 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 108,423,719 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie paraqitur nga drejtoria ekonomike kjo llogari përbëhet nga detyrimet e njësisë vendore për 44 subjekte. Ky borxh është krijuar nga tetori i vitit 2017 deri në dhjetor të vitit 2021 sipas bilancit, në mënyrë të detajuar paraqitet sipas aneksit nr. 7 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

- llogarisë 467“Kreditorë të ndryshëm” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 13,038,473 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 12,284,662 lekë. Për këtë gjendje të llog. 467 është sipas rakordimit me degën e Thesarit Tropojë në mënyrë analitike, e cila paraqitet sipas aneksit nr. 9 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Nga analiza e llogarive të sipërcituara konstatohet se Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vitin 2021 ka analizën e saj të detajuar, por një pjesë e të dhënave nuk është e plotë për një numër të konsiderueshëm subjektësh, si numri faturës, data e faturës dhe objekti i prokurimit si dhe llogaria.467 –Kreditor të ndryshëm nuk është e plotësuar me historikun e krijimit të këtyre detyrimeve që njësia vendore ka ndaj të tretëve. Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 3; pika 1,2, neni 7, 11, 15, UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kushtet e kontratës të lidhur midis palëve, si dhe ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12, pika 3, germë “gj”. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3 faqe 40-61 të Raportit të Auditimit)

8.1.Rekomandim: Drejtoria Ekonomike të marrë masa për plotësimin e listës së kreditorëve me të gjithë elementët e duhur, si objektin e prokurimit, numrin e faturës, datën e faturës, etj., elementë të cilët identifikojnë plotësisht llojin, kohën e lindjes së detyrimit, arsyen e detyrimit që Bashkia Tropojë ka ndaj të tretëve.

Situata: Pjesërisht

10. Gjetje nga auditimi: Në bazë të programit të auditimit nr. 361/1, datë 06.04.2021 të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Bashkia Tropojë është audituar për periudhën nga data 01.01.2019 deri në datën 31.12.2020. Me shkresën nr. nr. 361/20 datë. 15.09.2021 është dërguar raporti përfundimtar i auditimit. - Nga auditimi aktual u konstatua se

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 32 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 32 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 5 masa dhe janë në proces zbatimi 14 masa organizative dhe nuk janë zbatuar 13 masa organizative.

Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 3 masa me vlerë 9,587,836 lekë, deri me datë 15.07.2022, nuk është arkëtuar asnjë lekë, si dhe është në proces vlera 9,587,836 lekë.

Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të arkëtohet vlera 26,081,442 lekë si dhe të analizohet vlera 4,750,000 lekë. deri në momentin e verifikimit është arkëtuar vlera 7,752,632 lekë duke mbetur pa u arkëtuar vlera 18,328,810 lekë si dhe është analizuar një masë në vlerën 4,750,000 lekë, e pranuar dhe e zbatuar.

Masë Administrative, i është rekomanduar APP të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë për 9 persona si dhe përjashtimin e 3 OE nga procedurat e prokurimit publik. Nga verifikimi rezultoi se: APP me Vendimin nr. 30 datë 08.04.2022 ka vendosur masë administrative më gjobë për 9 persona në vlerën 1,020,000 lekë dhe kryetari i Bashkisë me urdhrin nr. 143 date 25.05.2022 ka njoftuar persona personat për vendimin e APP. Deri në momentin e verifikimit nuk është arkëtuar asnjë lekë. Paralelisht me vendimin e APP është duke u zhvilluar dhe procesi penal ndaj 9 personat e poshtëpërmendur. Gjithashtu APP me Vendimin nr. 53 datë 10.06.2022 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 584 datë 13.06.2022 ka vendosur “Mos marrjen e masës administrative” ndaj ka OE “SH” SHPK. -

APP me Vendimin nr. 52 datë 10.06.2022 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 585 datë 13.06.2022 ka vendosur "Mos marrjen e masës administrative" ndaj ka OE "V" SHPK. - APP me Vendimin nr. 54 datë 10.06.2022 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 583 datë 13.06.2022 ka vendosur "Mos marrjen e masës administrative" ndaj ka OE "4" SHPK.

Masa Disiplinore i është rekomanduar Kryetarit së Bashkisë Tropojë, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për 1 punonjës që trajtohet sipas ligjit të nëpunësit. Nga verifikimi rezultoi se Z. B.T ka ndërprerë marrëdhëniet me Bashkinë Tropojë. si dhe të vendos masë disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna", për tre punonjës. Nga verifikimi rezulton se kryetari i bashkisë me urdhrin nr. 243 datë 19.10.2021 ka vendosur masë disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna", për tre punonjës respektivisht; Z. P.M, Z. F.M dhe Z. N.A, masa të cilat rezulton të zbatuara.

Sa më sipër rezulton se për disa nga rekomandimet e mësipërme, Bashkia Tropojë, nuk ka nxjerrë vendimet ekzekutive por në disa raste është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e vendimeve për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk kanë filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e mundshëm të afateve ligjore të kërimit të dëmit të përcaktuara në nenin 115, të Kodit Civil në R.SH, me ndryshime. *Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 15 germa (c) dhe (ç), si dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin" me ndryshime, (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4 faqe 61-93 të Raportit të Auditimit).*

10.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të përshpejtuara për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të pa zbatuara dhe në proces zbatimi si vijon;

Për 14 masa organizative të cilat janë konsideruar në proces zbatimi si dhe për 13 masa organizative të pa zbatuara.

Për 3 masa shpërbllim dëmi me vlerë **9,587,836 lekë**

Për 9 persona masa administrative me gjobë në vlerën 1,020,000 lekë sipas vendimit të APP.

Situata: Pjesërisht

MASA PËR ELEMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE. (TËARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga mos arkëtimi i të ardhurave nga taksat e tarifatat janë krijuar debitorë, të cilët në datën 31.12.2021 kanë vlerën progresive 43,951,182 lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore, në analizë si më poshtë:

- Taksa/tarifa nga biznesi 2012-2021 në vlerën 20,149,882 lekë

-Kamatëvonesa (0.06%) për biznesin 2012-2019 në vlerën 2,380,646 lekë

- Taksa/tarifa institucione/ente në vlerën 509,080 lekë
- Tarifë shërbimesh (operator ekonomik) në vlerën 1,613,000 lekë
- Tarifë licencimi 5 vjeçar tregtim karburanti në vlerën 4,600,000 lekë
- Taksë ndikimi infrastrukturë në vlerën 773,645 lekë
- Taksa e tokës bujqësore në vlerën 2,279,481 lekë
- Taksat/tarifat familjare në vlerën 11,765,449 lekë
- Vlera e borxhit e krijuar vetëm gjatë vitit 2021 është në vlerën 28,579,575 lekë nga të cilat;
- Taksa/tarifa nga biznesi në vlerën 6,020, 879 lekë
- Kamatëvonesa (0.06%) për biznesin 2012-2019 në vlerën 2,380,646 lekë
- Taksa/tarifa institucione/ente në vlerën 40,120 lekë
- Tarifë shërbimesh (operator ekonomik) në vlerën 1,613,000 lekë
- Tarifë licencimi 5 vjeçar tregtim karburanti në vlerën 4,480,000 lekë
- Taksa e tokës bujqësore në vlerën 2,279,481 lekë
- Taksat/tarifat familjare në vlerën 11,765,449 lekë

Mos arkëtimi i plotë i detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përveçse është mos përmbushje e detyrimeve ligjore, sipas detyrës funksionale të punonjësve të kësaj strukture, krijon mungesa financiare në buxhet dhe për pasojë ulë nivelin e investimeve dhe të shpenzimeve të tjera që njësia vendore ka parashikuar në favor të komunitetit. Mungesa e të ardhurave është ndikim i drejtpërdrejtë në mosrealizimin e buxhetit në zërin e shpenzimeve për periudhën 2021.

Nga Bashkia Tropojë nuk janë ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme ligjore në rend shteruese, për arkëtimin e debitorëve, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 89, 90, 91, 93 të ligjit nr. 9920 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe nenin 12 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 31-39 të Raportit të Auditimit)*

1.1 Rekomandimi: Sektori i Taksave e Tarifave Vendore të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve në mënyrë progresive në vlerën 43,951,182 lekë. Për këtë, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për të gjitha subjektet e private të nxjerrë njoftim vlerësimet tatimore dhe në vazhdim të merren masat për arkëtimin e këtij detyrimi, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit (ASHK) dhe Zyrën Vendore të e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRVPP), kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet Neni 93 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë 1. Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit.

c- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

Situata: Pjesërisht

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer për arkëtimin e vlerës së taksës për lëshimin e Autorizimeve / Licencave për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, u konstatua se 5 subjekte që ushtrojnë këtë aktivitet në Bashkinë Tropojë, janë debitor për taksën e licencës në vlerën totale 4,600,000 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore. Lista e subjekteve debitor dhe vlera përkatëse për secilin paraqitet në sipas listës në aneksin nr.6 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e paketës fiskale të miratuar nga këshilli bashkiak, me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 të Bashkisë Tropojë, për periudhën 01.01.2021-31.12.2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 31-39 të Raportit të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi: Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Tropojë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës 4,600,000 lekë nga 5 subjektet debitor për taksën e lëshimit të licencave për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, sipas listës në aneksin nr.6 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Situata: Pjesërisht

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të qirave, nga zyra juridike e Bashkisë Tropojë, na u vunë në dispozicion kontratat e lejeve minerale dhe hec-ve, për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor. Nga ana jonë u konstatua se nga MIE janë të pajisur me leje dhe 22 operatorë për nxjerrje dhe shfrytëzim të mineralit të kromit në bashkinë Tropojë, të cilët nuk kanë lidhur kontrata dhe duke mos arkëtuar asnjë detyrim ndaj Bashkisë Tropojë. Gjithashtu nga ana e Bashkisë, në hartimin e kontratave me operatorë të ndryshëm në nenin 3 të kontratës është cilësuar se “Afati i kontratës” ku shprehet kohëzgjatjen e saj dhe me të drejtë rinovimi për çdo vit. Në kontratat e paraqitura në aneksin nr. 3. pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit Detyrimet janë vlerësuar sipas afatit të kontratës (p.sh 10 vjet) dhe jo sipas rinovimit çdo vit të përcaktuara në kontratë, ku kemi të bëjmë me përllogaritje jo vjetore por me afat kontrate. Nga ana e zyrës juridike dhe inxhinierëve të pyjores është vepruar me dy standarde në vlerësim e tarifave me operatorë të ndryshëm, ku në shumë raste kanë bërë rinovimin e kontratave vjetore dhe vlerësimin e kanë vjetor dhe jo sipas afatit të kontratës, ndërsa në aneksin e mëposhtëm vlerësimin e kanë bërë sipas afatit (p.sh 10 vjeçar) dhe jo sipas rinovimit vjetor kjo e cilësuar dhe në kontrata, gjë që bie ndesh me lidhja 2, pika 5,6 dhe 11 e VKM nr.1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të

Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", gjë që kanë sjell të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë, në vlerën 2,201,048 lekë sipas aneksit nr. 3. pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 31-39 të Raportit të Auditimit)*

3.1 Rekomandimi: Zyra Juridike në hartimin e kontratave dhe shtesave të tyre me operatorë të ndryshëm në bashkëpunim dhe me Sektorin Pyjor i cili përpilon raportin teknik dhe me Drejtorin e Financës, të arkëtojnë detyrimin e kontraktuar në vlerën 2,201,048 lekë, aneksit nr. 10 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

3.2 Rekomandimi: Bashkia Tropojë të përdorë të gjitha mekanizmat ligjorë, për lidhjen e 22 kontratave me operatorët për nxjerrje dhe shfrytëzim të mineralit të kromit, të cilët ushtojnë aktivitetet prej disa vitesh në asetet e Bashkisë Tropojë.

Situata: Pa zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i paraqitur nga sektori tatim taksave i Bashkisë Tropojë na u paraqitën kontratat e qirave të lidhura me subjekte me aktivitet të ndryshëm në fondi pyjor e kullosor të cilët nuk kanë paguar detyrimet në vlerën 4,059,163 lekë për 5 subjekteve sipas aneksit nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit. Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me VKM nr.1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 31-39 të Raportit të Auditimit)*

4.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Tropojë të merren masa administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej **4,059,163 lekë**, gjë që ka sjell të ardhura të munguara në **Bashkinë Tropojë** për subjektet që kanë lidhur kontrata qiraje sipas aneksit nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Situata: Pa zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tropojë (IVMT), për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 ka vendosur 14 gjoba, në vlerën 1,650,000 lekë, e cila nuk është arkëtuar. Nga Bashkia Tropojë gjobat e vendosura nuk janë dërguar në Gjykatën Administrative, për shndërrimin e vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv, duke vepruar në kundërshtim me nenin 24, nenin 30 dhe 31 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 31-39 të Raportit të Auditimit).*

5.1. Rekomandim: Inspektorati Vendor i Mbrojtës Territorit (IVMT) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Tropojë, të kërkohet në Gjykatë, shndërrimi i 14 vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24 "Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv" dhe neni 30 "Arkëtimi i shumave të detyrimeve" të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" dhe arkëtimi i vlerës **1,650,000 lekë**, që kanë kryer ndërtim pa leje në territorin e Bashkisë Tropojë.

Situata: Pa zbatuar

MASA DISIPLINORE

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Tropojë t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Gjithashtu i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tropojë që bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, si dhe në kontratën e punës, të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Situata: Pa Zbatuar

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi, Z. R.B, Kryetar i Bashkisë Tropojë.

2.8. Të ndryshme të dala gjatë auditimit

-Mbi ankesën e ardhur në KLSH me e-mail me nr. 543 Prot., datë 12.06.2023 dhe ankesën e ardhur ne Webin e KLSH-së, dhe protokolluar me nr. 612, datë 04.08.2023

-Në ankesën e ardhur në KLSH, në mënyrë të përmbledhur, cilësohet si vijon: “..... Bashkia Tropojë ka shpallur për prokurim me fonde në vlerën totale 248,304,097 lekë dhe ka lidhur kontrata për këto investime pa patur zë në buxhetin e vitit 2023.

1-Rikonstruktion i rrugës së fshatit Kasaj me fond limit 95,836,076 lekë. 2- Rikonstruktion i rrugës Bylbyl Breçani, fshati Markaj me fond limit 65,402,406 lekë. 3-Rikonstruktion sistemim asfaltim rruga Bukovë-Qendër Luzhë me fond limit 38,505,155 lekë. 4-Sistemim mbushje gropa me fond limit 5,589,810 lekë. Këto procedura të publikuara nuk janë të parashikuara në buxhetin e vitit 2023 dhe as tek lista e investimeve për vitet 2023-2025..... Pra Bashkia Tropojë ka shpallur tendera dhe lidhur kontrata me fonde të cilat nuk ekzistojnë.....”.

Keto katër procedura të publikuara nuk u planifikuan në buxhetin e vitit 2023 dhe as tek lista e investimeve për vitet 2023-2025 dhe as në buxhetin afat mesëm 2023-2025. Bashkia ka shpallur tendera pa u miratuar në KB, pasi këto procedura ishin shpallur përpara se të miratoheshin me Vendimin e KB nr. 47, datë 27.02.2023.

5. “Sistemim i Lagjes “Dardania” me fond limit 42,970,650 lekë”, është miratuar me Vendim të nr. 125, datë 22.12.20022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr. 3/2, datë 13.01.2023, ndërsa kjo procedurë është shpallur në faqen ëeb të APP me datë 21..12.2022, përpara se të miratohej nga KB.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, i dërguar nga Bashkia Tropojë edhe në rrugë elektronike në KLSH, rezulton:

1- Me Vendimin nr 125, datë 22.12.2022, nga KB është miratuar

“**Tabela e investimeve viti 2023**”, ku me nr. 3 është përcaktuar “Sistemim i Lagjes “Dardania”, ky vendim është miratuar nga Prefekti me shkresën nr. 3/2, datë 13.01.2023, **rezulton se kjo procedurë është shpallur në faqen eeb të APP me datë 21.12.2022.**

Ndërsa në “**Tabelën Lista e prioriteteve për vitin 2023 si vit i parë i Buxhetit AM**”, janë përcaktuar këto investime:

-Projekti i rrugës së fshatit Kasaj me fond limit 95,836,076 lekë.

- Projëkti i rrugës së fshatit “Mic Sokoli” me fond limit 65,402,456 lekë.

- Projëkti i rrugës Geghysen-Selimaj” me fond limit 90,991,173 lekë.

2- Me Vendimin nr 47, datë 28.02.2023, protokolluar me nr. 1109/1, datë 06.03.2023, nga KB janë miratuar “Fondet e trashëguara për vitin 2023”, ku janë miratuar edhe këto investime, pasqyruar në tabelë:

- Rikonstruksioni rrugës së fshatit Kasaj , për vitin 2023 vlera 11,630,654 lekë

- Rikonstruksioni rrugës “Bylbyl Breçani”(sipas informacionit ky objekt është i njëjti me “Fshatin Mic Sokoli, tek Lista e prioriteteve”, për vitin 2023 vlera 9,976,370 lekë

- Rikonstruksioni rrugës Luzhë, për vitin 2023 vlera 4,579,074 lekë;

Sa trajtuar, rezulton se:

Vendimi i KB, nr. 47, datë 28.02.2023, është protokolluar me datë 06.03.2023, pra nuk përputhen datat;

3 investimet e miratuar me fondin e trashëguar për vitin 2023, janë publikuar në webin e APP përkatësisht në datë 17.03.2023 dhe datë 02.03.2023;

Lidhur me investimin “Sistemim asfaltim mbushje gropa në rrugët e bashkisë, me fond limit 5,589,810 lekë”, nuk rezulton të jetë i parashikuar, ndërsa është shpallur ne webin e APP me datë 09.03.2023;

Lidhur me objektin “Sistemim i Lagjes “Dardania” me fond limit 42,970,650 lekë”, është miratuar me Vendim të nr. 125, datë 22.12.20022, rezulton se kjo procedurë është shpallur në faqen web të APP me datë 21..12.2022, përpara se të miratohej nga KB.

Këto investime nuk janë parashikuar në buxhetin afatmesëm, për vitet 2023-2025.

Konstatohet se në investimet:

- Rikonstruksioni rrugës së fshatit Kasaj , për vitin 2023 vlera 11,630,654lekë;

- Rikonstruksioni rrugës “Bylbyl Breçani, për vitin 2023 vlera 9,976,370 lekë;

- Rikonstruksioni rrugës Luzhë, për vitin 2023 vlera 4,579,074 lekë;

janë pjesë e buxhetit vjetor 2023, por nuk janë pjesë e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025, veprim në kundërshtim me pikën 5 dhe pikën 123 të UMF Nr. 23, datë 30.07.2018” Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, ku thuhet:

Pika 05: Përgatitja e buxhetit vjetor është pjesë përbërëse e procesit të programit buxhetor afatmesëm, ku buxheti vjetor do të jetë viti i parë i këtij programi.

Pika 123. Shpenzimet e programit shpërndahen duke përcaktuar për çdo program dhe për çdo vit të PBA-së:

(i) Produktet e programit;

(ii) *Akvitetet e programit;*

(iii) *Investimet / projektet e investimeve nëse ka të tilla.*

Nëse njësia vendore do të bëjë ndryshime të programit buxhetor vjetor, këto ndryshime duhet të miratohen edhe në programin buxhetor afatmesëm.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 153 dhe 154 të UMF Nr. 23, datë 30.07.2018”

Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, ku thuhet:

Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike

153. Kërkesa për shpenzim paraqitet nga drejtuesi funksional i aktivitetit të çdo niveli të njësisë /nënprogramit/ programit buxhetor, përgjegjës për realizimin e objektivave të planifikuara në kuadrin e programit respektiv buxhetor. Kërkuesi i shpenzimit nuk mund të kërkojë kryerje të shpenzimeve jashtë fondeve të kërkuara prej tij dhe të miratuara në procesin e planifikimit të buxhetit të njësisë sipas programeve buxhetore ku bën pjesë.

154. Kërkesa për shpenzim i drejtohet Nëpunësit Autorizues dhe për dijëni Nëpunësit Zbatues. Në rastet kur kërkesa është e lidhur me një proces blerje apo kryerje shërbimi i dërgohet strukturës përgjegjëse për prokurimet në njësinë shpenzuese. Struktura përgjegjëse për prokurimet kryen kontrollin e nevojshme krahasuese me kërkesat e planifikuara dhe planin e prokurimit të miratuar në procesin e planifikimit të buxhetit.

Lidhur me shpalljen në sistemin elektronik të APP të procedurës së prokurimit publik me objekt “Sistemim i Lagjes “Dardania”, me fond limit 42,970,650 lekë”, në datën 21.12.2022, një ditë përpara se të miratohet buxheti vjetor nga Këshilli Bashkiak, i cili është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkia Tropojë nr. 48, datë 30.06.2022.

Për sa trajtuar, për veprimet dhe mosveprimet e tyre mban përgjegjësi Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i njësisë vendore.

Lidhur sa trajtuar, gjatë takimit ballafaques në KLSH me datë 12.10.2023, u paraqitën dokumentet lidhur me miratimin e projektit dhe fondit me objekt “Sistemim i Lagjes “Dardania”, (Vendimi i Këshillit Bashkia Tropojë nr. 48, datë 30.06.2022 dhe Vendimi nr. 2/19 prot. ,datë 15.07.2022 i Prefektit Qarku Kukës. Grupi i auditimit i mer në konsideratë, pasi referuar Vendimit të Këshillit Bashkia Tropojë nr. 48, datë 30.06.2022, rezulton i miratuar projekti dhe fondi prej 43,000,000 lekë për objektin “Sistemim i Lagjes “Dardania”.

IV GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së konstatohet se:

- Lidhur me Mjedisin e Kontrollit, rezulton se, nga ana e Titullarit të Bashkisë Tropojë, nuk janë nxjerrë urdhra me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit. Nuk janë

miratuar gjurmët e auditimit. Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm. Nuk janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë. Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Gjithashtu Bashkia Tropojë nuk kanë përditësuar Rregulloren e Brendshme, të miratuar me shkresën nr. 1143. prot., datë 06.03.2018.

- Lidhur me Menaxhimin e riskut, rezulton se Bashkia Tropojë nuk ka miratuar “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”, nuk janë identifikuar aktivitete me risk, si dhe nuk janë marrë masa për menaxhimin e tij. Megjithëse është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk janë miratuar plane zhvillimi strategjikë me afat jo më pak se sa 5 vjet. Nuk ka plan-veprime vjetore operacionale të miratuar, për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme. Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut. Nuk është hartuar një regjistër kompleks për gjithë Bashkinë, ku të identifikoheshin dhe të bëhej vlerësimi i risqeve për të gjitha Drejtoritë e NJA.

- Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për Përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm.

- Bashkia Tropojë nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”.

- Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, realizohet në mënyrë formale duke respektuar ato kritere mbi të cilat edhe raportohet pranë Ministrisë së Financave. Nuk janë përcaktuar rregulla të qarta lidhur me ndjekjen e zbatimit të kontratave të lidhura pas procedurave të prokurimit me tender.

- Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj. Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Në Rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprohej me komunikim verbal, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1 faqe 20-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Tropojë, të marren masat për zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së, duke hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, në përputhje me strukturën organizative; organizimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm; hartimin e strategjisë së riskut, regjistrin e riskut, si dhe gjurmën e auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2-Gjetje nga auditimi: Bashkia Tropojë nuk ka njësi të auditit të brendshëm dhe nuk ka lidhur kontratë me institucion tjetër për realizimin e këtij shërbimi. Rezulton se me shkresën nr.2027 prot., datë 15.05.2020 “Informacion për sektorin e Auditimit të Brendshëm”, është vënë në

dijeni Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për shkrimin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm për shkak se nga Titullari është konstatuar performancë e dobët. Shkrimi e Njesisë së Auditit të Brendshëm nga Kryetari i Bashkisë është i pa argumentuar dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore. Gjithashtu nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm”. Veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”, neni 11 dhe VKM nr. 83 datë 03/02/2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, për “*Miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditit të brendshëm në sektorin publik*” pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2 faqe 20-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Bashkia Tropojë të marrë masa për organizimin e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm, dhe të merren masa për planifikimin në programet e auditimit të fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, duke i dhënë mbështetje titullarit të njesisë publike në arritjen e objektivave, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njesisë publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

3-Gjetje nga auditimi: Ne 7 raste, Vendimet e këshillit bashkiak Tropoje nuk janë marrë me shumicën e votave të anëtarëve, pasi kanë votuar dhe nënshkruar nën 50 % e tyre, ose nën 3/5 e 21 anëtarëve, duke mos plotësuar kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 48, pika 4 dhe nenin 17, pika 3 të ligjit nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 23-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandim: Këshilli Bashkiak Tropojë të marrë masa që në çdo rast votimi i vendimeve të bëhet me shumicë votash, në zbatim të kërkesave ligjore, me qëllim që vendimi kolegjal të ketë zbatueshmëri, në interes të komunitetit, brenda juridiksionit që mbulon.

Menjëherë dhe në vijimësi

4-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve për pagat për vitin 2022, konstatohet se:
- Struktura dhe organ e Bashkisë Tropojë dhe njësive të varësisë, në disa raste paraqesin numër të lartë punonjësish (gjithsej 361 punonjës), në raport me kryerjen e detyrave sipas pozicioneve, referuar numrit real të banorëve të kësaj bashkie dhe mundësive financiare. Gjithashtu nuk justifikohet puna e kryer, me dokumente dhe programe pune. Kjo gjendje ka sjellë rritjen e vështirësive financiare, duke ndikuar në rritjen e borxhit të kësaj bashkie, Vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin MF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësive të sektorit publik” dhe VKM nr. 323, datë 14.6.1993 “*Normat për vendosjen e personelit në çerdhe*”.
- Shpenzimet për ndihmën ekonomike dhe paaftësisë zënë peshën kryesore për vlerën 386 milion lekë ndaj shpenzimeve gjithsejtë prej 825 milion leke ose 47 %, çka bën të domosdoshme nxitjen e punësimit dhe përmirësimin e politikave sociale, për të zbutur

papunësinë dhe varfërinë. Ndihma sociale në vitin 2022 për 386 milion leke paraqet tendence rritje nga viti 2021 prej 308 milion.

- U konstatua se 9 specialistet e gjendjes civile nuk janë emëruar dhe paguar si “përgjegjës”, në zbatim të VKM nr. 1299 date 16.12.2009 “Për miratimin e strukturës të organikes të numrit nëpunësve të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake sot administrative dhe në degët e Qarqeve”, e cila citon emërtimin “përgjegjës” për çdo njësi administrative dhe jo “specialist” (Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2 faqe 23-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Tropojë të merren masa:

- Për të vendosur një raport të drejtë midis numrit të punësuarve me ngarkesën e punës, sipas drejtorive, sektorëve përkatës, me qëllim arritjen e objektivave dhe kryerjen e shërbimeve ndaj qytetarëve.

- Krijimin e kushteve për nxitjen e punësimit dhe përmirësimin e politikave sociale me qëllim zbutjen e papunësinë.

- Të rishikojë emërtesën dhe pagesën për 9 specialistë të gjendjes civile, të cilët nuk janë emëruar dhe paguar si “përgjegjës”, sipas përcaktimeve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

5-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të karburantit të vitit 2022, u konstatua se normat mujore të karburantit janë të larta për disa automjete të renda, pasi ato janë të vjetra mbi 30 vjet dhe kanë mbushur kuotën e plotë amortizimit sipas normave të amortizimit konkretisht: Kamion benz me targa AA 469 BB 33 litra/100₂ viti i prodhimit 1983, 2 Fadroma 31 dhe 32 litra/100 km, Boti i ujit 28 litra/100 km, Makina mbeturinave 44 litra/100 km, Bore pastruesja 24 litra/100 km. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8. datë 09.03.2018, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 12-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Bashkia Tropojë të marrë masa për kontrollin e gjendjes teknike të disa mjeteve të renda nëse janë rentabël ose jo, pasi paraqesin jetëgjatësi mbi 30 vjet dhe kanë mbushur kuotën e plotë të amortizimit referuar normave ligjore të përcaktuara, për të bërë mundur uljen e shpenzimeve të karburantit dhe pjeseve këmbimit, për mjetet:

1. Autobot benz 47 vjeçar viti i prodhimit 1976.
2. Kamioni benz 40 vjeçar, viti i prodhimit 1983.
3. Kamion benz 37 vjeçar, viti i prodhimit 1986.

Menjëherë dhe në vijimësi

6- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit për vitin 2022, konstatohen shkelje dhe parregullsi nga Bashkia Tropojë, lidhur me fatura të palikujduara në vlerën 86 milion lekë, duke krijuar bashkisë vështirësi financiare, pasi ato zënë mbi 25 % të shpenzimeve vjetore prej 220 milion leke. Faturat e pa likuiduara sipas llojit të tyre, paraqiten: *vlera 3,7 milion leke*

detyrim për vendime gjyqësore; vlera 1.2 milion leke detyrim për shërbime; vlera 2,2 milion leke detyrim për mirëmbajtje; vlera 64 milion leke detyrim për investime; vlera 15 milion leke detyrim për investime Ministria e Infrastrukturës.

Bashkia Tropoje, ne zbatim te udhëzimit MFE nr. 37 date 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin e detyrimeve te prapambetura” dhe aktit normativ 34 date 03.12.2021, ka hartuar planin e shlyerjes te detyrimeve prapambetura prej 71 milion leke për periudhën 2022-2024 (pa përfshirë vlerën 15 milion te MI), përkatësisht: Për vitin 2022= 30 % ose 23 milion leke, i cili nuk është zbatuar i plote, pasi janë likuiduar vetëm 6,2 milion leke nga 23 milion qe duhej. Për vitin 2023= 30 % ose 23 milion leke dhe për vitin 2024= 40 % ose 3 milion leke.

Mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj operatorëve ekonomik është në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, me UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, me Udhëzimin plotësues “Për buxhetin e vitit”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore”.

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 42,876,907 lekë, ndërsa gjate vitit 2022 është rritur dhe ne mbyllje te 2022 pasqyrohet 44,710,681 leke. Ndikim kane pasur rritja e debitorëve të taksave dhe qirave te asetëve, detyrimet e lëna nga KLSH dhe detyrime tjera te prapambetura, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e tyre, duke kaluar afatet.

Bashkia Tropoje nëpërmjet zyrës juridike ka apeluar vendimet e shkallës së parë, por pa dale vendimi i formës prere ka vazhduar likuidimin.

- Vendimet gjyqësore paraqiten për vlerën 3,7 milion leke nga 6,7 milion leke ne vitin e kaluar, me efekt negativ ne buxhet, për te cilën nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me kërkesat e pikës 62 të udhëzimit nr. 2, datë 06.02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, me ndryshime. Për vitin 2022 shpenzimet për vendime gjyqësore të fituara nga ish-punonjësit për largime nga puna, paraqiten për vlerën 935,000 lekë, çka ka shkaktuar dublim pagese për të njëjtin vend pune dhe ka dhënë ndikim negativ në buxhetin e bashkisë, për të cilën nuk ka dalë përgjegjësia ndaj personave fajtor dhe nuk ka masa administrative, në kundërshtim me udhëzimin nr. 4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e buxhetit” pika 6.1 “Vendimet gjyqësore” dhe pika 62 e UMF 2 datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit buxhetit”.

- Gjendja debitorë progresive e taksave e tarifave vendore deri më 31.12.2022, paraqitet për 31,787,531 lekë, nga të cilat: Taksa/Tarifa nga Biznesi për 2012-2022, debitorë për vlerën 23,389,028 lekë, Kamatëvonesa (0.06%) për biznesin për 2012-2019 debitorë për vlerën 2,351,899 lekë, Taksa/Tarifa Institucione/Ente debitorë për vlerën 468,960 lekë, Tarife shërbimesh (Operator ekonomik) debitorë për vlerën 204,000 lekë, Tarife licencimi 5 vjeçar tregtim karburanti debitor për vlerën 4,600,000 lekë, Takse ndikimi infrastrukture debitor për vlerën 773,645 lekë (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 23-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrin masa për likuidimin e detyrimeve të pa likuiduara të prapambetura prej 86 milion leke,

duke normalizuar situatën në drejtim të rishikimit të buxhetit, rritjes së taksimit, uljes së shpenzimeve, rishikimit të organikes, përdorimit të fondit veçante, etj. Gjithashtu të likuideojë vendimet gjyqësore për vlerën 3,7 milion leke dhe vendimet gjyqësore të fituara nga ish-punonjësit për largime nga puna për vlerën 935,000 lekë, si dhe të arkëtojë vlerën 31,787,531 lekë, nga debitorë progresivë, të taksave e tarifave vendore të krijuara deri më 31.12.2022, si dhe të analizojë shkaqet që kanë krijuar këtë situatë, duke nxjerrë përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës.

Menjëherë

7-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raportimit të pasqyrave financiare, konstatohen shkelje dhe parregullsi në bilancin e vitit 2022, paraqitur si më poshtë:

- Nuk janë mbajtur partitarët analitikë, nuk është mbajtur centrilizatori për evidentimin e veprimeve kontabël sipas ditareve për efekt të nxjerrjes së saldove debitore dhe kreditore, baze kjo për plotesimin e bilancit.

-Nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme të disa llogarive. Në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 49-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Tropojë të marrë masa, për mbajtjen e partitarëve analitik, centrilizatorit dhe librit veprimeve të ndryshme, sipas kërkesave ligjore, si dhe të marrë masa për uljen e vlerës së llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, e cila rezulton e rritur gjatë vitit 2022.

Menjëherë

8-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raportimit të pasqyrave financiare, konstatohen shkelje dhe parregullsi nga Bashkia Tropojë, pasi në veprimet bankës për vitin 2022, konstatohet se:

- Në 8 raste, janë dhënë ndihma të menjëhershme nga fondi rezervë në vlerat nga 10,000 lekë deri 100,000 lekë secili, për vështirësi ekonomike dhe arsye shëndetësore, me mungesë të dokumentacionit justifikues (diagnoza, raporti mjekësor, vërtetim për të ardhurat bujqësore-blegtorale, vërtetim nëse trajtohen me ndihme ekonomike, vërtetim që nuk janë të punësuar në shtet dhe në privat, vërtetim ose kërkesë nga kryeplaku i fshatit ose administratori i lagjes qytetit etj), në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Në 1 rast Bashkia ka likuiduar subjektin kontraktor për blerjen e karburantit kur komisioni i blerjeve të vogla ka pranuar nga operatori ekonomik fitues dokumentacion të pjesshëm dhe të pavlefshëm, në kundërshtim me VKM 47 datë 23.01.2013 “Për kryerjen e procedurave prokurimit publik në mënyrë elektronike” ndryshuar, me Udhëzimin 2 datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, ndryshuar me udhëzimin nr. 5, datë 16.07.2013.

- Në 5 raste, për blerjet dhe shërbimet me vlera të vogla për nevoja të Bashkisë Tropojë, u konstatuan mungesë të dokumenteve justifikuese, mos administrim të mallrave dhe materialeve

nëpërmjet magazinës, mungese normativave ligjore, shpenzime pa efektivitet, ne kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik , me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 13, konkretisht:

-Sipas urdhër shpenzimeve nr. 69, datë 24.03.2022 dhe nr. 76 date 29.03.2022, është likuiduar vlera 3,000,000 lekë dhe 245,617 leke për “*rikonstrukcion i kompleksit lojërave me dore*”, rezulton se nuk disponohen dokumentet baze dhe justifikuese si: fatura, situacione, fotografimi para dhe pas meremetimit të objektit për efekt të justifikimit të shpenzimit.

- Sipas urdhër shpenzimeve nr. 367, datë 22.12.2022, është kryer likuidimi për vlerën 99,500 lekë, për kryerjen e shërbimeve të makinës së bashkisë, rezulton se: ne asnjë dokument nuk citohen të dhënat e makinës, nuk ka procesverbal nga specialisti i fushës për dëmtimin e shkaktuar dhe nevojën e zëvendësimit të pjesëve këmbimit, nuk ka procesverbal dhe nuk disponohet fletëhyrje për marrjen ne dorëzim te pjesëve këmbimit.

- Sipas urdhër shpenzimit nr. 210 datë 02.08.2022, është kryer likuidimi për vlerën 630,000, për të blerë 11 goma dhe 8 bateri për automjetet e bashkisë, rezulton se: nuk disponohen dokumente qe justifikojnë zëvendësimin e gomave dhe baterive, konkretisht mungon procesverbali i komisionit për përcaktimin e normës se konsumit gomave dhe garancia e baterive për afatin e skadimit tyre, në mungesë të këtij dokumentacioni janë kryer procedurat e prokurimit. Gjithashtu nuk disponohet fletëhyrje e gomave dhe baterive që rezultojnë jashtë përdorimit, si mall rikupero.

- Në 2 raste, sipas urdhër shpenzimit nr. 236 datë 23.08.2022 dhe urdhër shpenzimit nr. 262 datë 28.09.2022 është kryer likuidimi i vlerave përkatëse 98,100 leke dhe 99,000 lekë, për shërbime e mirëmbajtje automjeti, ku rezulton se nuk disponohet procesverbali i komisionit dhe specialistit te fushës, për saktësimin e defekteve të mjetit, për të bërë të mundur argumentimin dhe justifikimin e shërbimit të mirëmbajtjes, por është vepruar me kryerjen e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Gjithashtu nuk disponohet fletëhyrje e pjesëve këmbimit te dëmtuara dhe fletëhyrje e pjesëve këmbimit te reja. Vepruar në kundërshtim me VKM nr. 568 date 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe te pushimit, orët shtese dhe kompensimin e tyre ne institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësite e vetëqeverisjes vendore”, kap III, pika 8 dhe pika 9. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 49-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Bashkia Tropojë të marrë masa që në vijimësi, për çdo rast për ndihma te menjëhershme për vështirësi ekonomike dhe arsye shëndetësore, përpara se të procedojë me dhënie e tyre, të verifikojë plotësimin e dokumentacionit përkatës, duke siguruar gjendjen e dokumentacionit justifikues, në përputhje me kërkesat ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.2. Rekomandimi: Bashkia Tropojë, të marrë masa, që për çdo procedurë me blerje dhe shërbime me vlera te vogla, si dhe në rastet si më sipër, të plotësohen me dokumente justifikuese, fletëhyrjet, normativat ligjore, për të bërë të mundur eliminimin e shpenzimeve pa efektivitet dhe aplikimin me standard të njëjtë.

Menjëherë dhe në vijimësi

9-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raportimit të pasqyrave financiare, konstatohen shkelje dhe parregullsi nga Bashkia Tropojë, pasi:

1. Në inventarizimin e pasurisë paraqiten keto mangësi:

- Nuk përcaktohet numri rendor i fletëhyrjes dhe fletëdaljes ne procesverbalet e komisionit para fillimit të inventarizimit, po kështu nuk përcaktohet fletëhyrja dhe fletëdalja e fundit, në kundërshtim me pikën 83 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Mungon pasqyra përmbledhje e inventarizimit te mjeteve transportit, për numrin dhe vlerën kontabël e fizike të tyre,

- Nuk është nënshkruar nga përgjegjësi material i Njësisë Administrative Fierz, fletë inventarizimi që i përket zyrës së këshillit, veprim në kundërshtim me pikën 82 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Në përfundim të inventarizimit komisioni nuk ka hartuar relacion përkatës dhe miratimin në Këshillin Bashkiak, sipas kërkesave të pikës 87--- 92, të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” .

- Nuk është kryer inventarizimi fizik i disa pasurive për vitin 2022, përkatësisht: për shkollën e mesme, shkollën 9-vjeçare, konviktin çerdhen, dekorin, veprime në kundërshtim me pikat: 81-90 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

2. Në vlerësimin e materialeve për nxjerrjet jashtë përdorimit paraqiten këto mangësi:

- Nuk disponohet procesverbali i specialistit të fushës (ing. Elektronik) që verteton humbjen e vlerës së përdorimit të paisjeve dhe aparaturave elektronike si: kompjutera, printera, laptopë, kompjuter fotografik, veprime në kundërshtim me pikën 95 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Nuk ka pasqyruar vitin e blerjes ose prodhimit te aparaturave elektronike, për të saktësuar amortizimin e plotë sipas tarifave ligjore, duke krijuar situata për nxjerrje jashtëpërdorimi të tyre para kohe dhe në gjendje pune. Veprime në kundërshtim me pikën 95 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3. Për vitin 2022, komisioni për asgjësimin e materialeve jashtë përdorimit, ka nxjerre jashte perdorimit materialet ne qender, njesi administrative, shkolla, kopshte e cerdhe, etj, per vleren 1,497,752 leke, sipas procesverbalit te asgjesimit date 17.03.2023. Procedura e asgjesimit te materialeve është kryer me shkelje dhe parregullsi:

- Në procesverbalin e asgjësimit date 17.03.2023, nuk përcaktohet vendi i asgjësimit dhe mënyra e asgjësimit te materialeve, sipas llojit te tyre, por është mjaftuar me kopjen e procesverbalit te vlerësimit te materialeve.

- Nuk disponohet fletëdalja për materialet e pajisjet e asgjësuar ne vlerën 1,497,762 leke, për efekt te shkarkimit nga magazina dhe kontabiliteti. Sqarojmë se shkarkimi ne kontabilitet është kryer ekstra/kontabël për vlerën 1,497,762 lekë.

Veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe

pasqyrat financiare”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 49-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Bashkia Tropojë të marrë masa për plotësimin dhe sigurimin e dokumentacionit të munguar në inventarizimin e pasurisë dhe nxjerrjeve jashtë përdorimit të mallrave e materialeve, sipas rasteve për shkeljet e konstatuara në inventarizimet dhe nxjerrjet jashtë përdorimit të vitit 2022. Gjithashtu të kryejë inventarizimin në të gjithë sektorët për të bërë të mundur përfundimin e këtij procesi.

Menjëherë dhe në vijimësi

10-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në procedurat e prokurimit për periudhën objekt auditimi (periudha 01.01.2021 – 31.12.2022), janë konstatuar shkelje dhe parregullsi:

- Në 4 raste dhe konkretisht në procedurat e prokurimit për objektet “Blerje kamioni, Bashkia Tropojë”, “Rikualifikimi urban Lagja “Partizani”, Blloku 1&2, Qyteti Bajram Curri”, “Rikonstruksion i Shkollës “Oso Dauti”, Njësia Administrative Llugaj”, “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë-Lekurtaj”, zhvilluar në periudhën 2021 - 2022, janë vendosur kritere të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë. Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme në hartimin e kritereve të veçanta të DST, bien në kundërshtim me kërkesat e pikës 4 të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 77 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 69-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anome të konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kritere të veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet.

Menjëherë dhe në vijimësi

11-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në 5 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht si vijon:

1- Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kamioni”, me vlerë të fondit limit 6,400,000 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues OE “T” ShPK, me ofertë 6,360,000 lekë pa TVSH, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DST, por është kualifikuar dhe shpallur fitues.

2- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikimi urban Lagja “Partizani”, Blloku 1&2, Qyteti Bajram Curri”, me vlerë të fondit limit 60,338,235 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021”, është shpallur fitues operatori ekonomik B “N”&”R.C” ShPK, me vlerë të ofertës ekonomike 53,717,333 lekë pa TVSh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

3- Në procedurën e prokurimit me objekt, “Blerje dru zjarri”, Bashkia Tropojë, me vlerë të fondit limit 5,422,722 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2021, është kualifikuar dhe shpallur

fitues OE “N.M” person fizik, me ofertë 5,398,755 lekë pa tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.

4- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë-Lekurtaj”, Bashkia Tropojë, me vlerë të fondit limit 10,986,652 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022, është kualifikuar dhe shpallur fitues B “V”&”G” ShPK, me ofertë 10,079,883 lekë pa tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT

5- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i thertores Shudenicë+Ndërtim i treut të bagëtimeve”, Bashkia Tropojë, me vlerë të fondit limit 12,786,238 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022, është kualifikuar dhe shpallur fitues B “T.O” ShPK, me ofertë 12,678,100 lekë pa tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat ligjore sipas sipas përcaktimeve: neni 76 “Kriteret detyruese për kualifikim”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 69-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1.Rekomandim: Titullari i AK Bashkia Tropojë, të analizojë arsyet e anoma në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën risk real për shpenzimet e njësisë publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

12-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit, lidhur me planifikimin e nevojave pasqyruar në regjistrin e planifikimit të prokurimeve, për periudhën nga data 01.01.2021 deri në datën 31.12.2022, në disa raste nga Autoriteti Kontraktor janë kryer procedura prokurimi duke copëzuar fondin dhe shmangur procedurat standarde të prokurimit, për shkak të ndryshimit artificial të kufirit monetar pa arsye objektive. Mosaplikimi i rregullt i llojit të procedurës dhe devijimi nga aplikimi i LPP-së, ka ndikuar negativisht në mirëpërdorimin e fondeve publike dhe përbën një risk eventual për prokurimin e objektit me një vlerë më të lartë. Veprime në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” dhe nenin 11, nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2. 4, faqe 69-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1.Rekomandim: AK Bashkia Tropojë dhe strukturat përgjegjëse të krijuara për administrimin dhe menaxhimin e procesit të prokurimit të fondeve publike, të marrin masa për të shmangur çdo ndryshim artificial të kufirit monetar, pa arsye objektive, duke krijuar kushte për kryerjen e prokurimeve në përputhje me procedurat standarde të prokurimit publik. Gjithashtu AK, gjatë përlogaritjes së vlerës limit të kontratës, duhet të ketë si qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes të sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Menjëherë dhe në vijimësi

13-Gjetje nga auditimi: Kontrata midis B “F” SHPK & “4” SHPK dhe Bashkisë Tropojë, është me nr. 3360/3 Prot., datë 08.12.2020 dhe objekt “Ujësjiellësi Fshatit Dragobi”. Është me afat 6 muaj nga dita e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, sipas nenit 3 të kontratës së lidhur midis palëve “Afati i realizimit të punimeve”. Vlera e plotë e kontratës është 68,269,460.11 lekë me TVSH. Me shkresën nr. 5098/11 Prot., datë 24.03.2021, është nënshkruar amendamenti nr.1 i kontratës bazë. Ky amendament i referohet nenit 3 të kontratës bazë dhe zgjat afatin e ekzekutimit të punimeve edhe 3 muaj të tjerë ose në total 9 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit ose me datë përfundimi datën 29.09.2021. Arsyeja e zgjatjes së afatit të punimeve, sic cilësohet tek amendamenti, janë ngricat dhe rishikimi i projektit. Nga dokumentat e cilësuar më lart, justifikohen vonesa vetëm nga data 16.02.2021 deri në datën 23.03.2021 pra justifikohen vetëm 36 ditë vonesë për arsye të pezullimit të punimeve. Në fakt, Bashkia Tropojë, ka miratuar një shtyrje afati për më shumë kohë pra për tre muaj kur vonesat janë vetëm një muaj. Veprim ky në kundërshtim me nenin 33, “Ndryshimi i ligjeve dhe rregulloreve” dhe nenin 38 “Ndryshimi i porosisë” të kontratës nr. 3360/3 prot., datë 08.12.2020. Me shkresën nr. 4939 Prot., datë 28.12.2021, është nënshkruar amendamenti nr.2 i kontratës bazë. Ky amendament i referohet nenit 3 të kontratës bazë dhe zgjat afatin e ekzekutimit të punimeve edhe 20 ditë nga data e njoftimit për rifillimin e punimeve. Amendamenti i mëparshëm ai me nr. 5098/11 Prot., datë 24.03.2021, përcakton se afati i punimeve zgjatet deri në datën 29.09.2021. Në këto kushte, amendamenti me nr. 4939 Prot., datë 28.12.2021, është nënshkruar pas skadimit të afatit të punimeve e si i tillë, është nënshkruar nga Bashkia Tropojë, në kundërshtim me ligjin. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2. 4.1, faqe 108-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandim: Bashkia Tropojë, të marrë masat që në të ardhmen, të respektojë afatet dhe kushtet e vendosura në kontratën bazë, duke nënshkruar amendamente kontratash vetëm nëse ato i referohen kushteve/kritereve mbi të cilat, OE është shpallur fitues i një procedure.

13.2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë, të marrë masat që në të ardhmen, në rastet e nënshkrimit të amendamenteve të kontratave bazë, ato të nënshkruhen përpara përfundimit të kontratës bazë ose të amendamentit të mëparshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

14-Gjetje nga auditimi: Kontrata midis B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK dhe Bashkisë Tropojë, është me nr. 3814/3 Prot., datë 18.12.2020 dhe objekt “Rikonstruksion i 5(pesë) segmenteve rrugore, fshati Gri, Buljan, Cerrnikë, Tropojë”. Është me afat 12 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit ose me datë përfundimi datën 29.12.2021. Vlera e kontratës është 408,506,281.2 lekë me TVSH. Nga auditimi i zërave të preventivit dhe zërave të situacionit përfundimtar të punimeve sipas kontratës së lidhur, u konstatua se nuk është ekzekutuar zëri “An. 3.226/1 Shtresë asfaltbetoni”. Ky zë nuk është ofertuar dhe nuk është situacionuar pra faturuar. Mos ekzekutimi i këtij zëri, pra i tapetit mbi binder, e bën investimin të jetë më shumë i ekspozuar ndaj fenomeneve natyrore. Binderit në vetvete, ka tendencën që të ngurtësohet me kalimin e kohës prandaj rolin e amortizuesit ose të materialit më të përshtatshëm ndaj kushteve atmosferike si në dimër dhe në verë, e kryen tapeti ose shtresa e asfaltit e cila hidhet mbi shtresën e binderit. Kjo shtresë, jo vetëm që e mbron nga shkatërimi

shtresën e binderit ndaj kushteve natyrore por mbi të gjitha, garanton sigurinë në lëvizjen e mjeteve rrugore për arsye të mbajtjes në nivelin e duhur të forcave të fërkimit midis sipërfaqeve të gomave të mjeteve dhe shtresës së asfaltit. Në këto kushte që është kryer investimi dhe nuk është hedhur shtresa e asfaltit, shtresa e binderit dhe vijëzimet mbi të, janë të destinuara të shkatërrohen me kalimin e kohës nëse nuk merren masa për hedhjen e asfaltit mbi binder. Vlera e binderit të investuar dhe vlera e vijëzimeve mbi binder, mund të sjellin dëm ekonomik në të ardhmen pasi për hedhjen e asfaltit duhet një frezim i binderit në rastin më të mirë ose shtresë e re binderi në rastin më të keq. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2. 4.1, faqe 108-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandim: Bashkia Tropojë, të marrë masat që në të ardhmen, në të gjitha procedurat e prokurimit me objekt “Kryerje punimesh”, të përfshihen në preventivat e tyre, të gjitha zërat e domosdoshëm për garantimin e sigurisë dhe standarteve teknike me qëllim, shmangien e dëmtimit të investimit në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

15-Gjetje nga auditimi: Kontrata midis B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK dhe Bashkisë Tropojë, është me nr. 3814/3 Prot., datë 18.12.2020 dhe objekt “Rikonstruksion i 5(pesë) segmenteve rrugore, fshati Gri, Buljan, Cernikë, Tropojë”. Është me afat 12 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit ose me datë përfundimi datën 29.12.2021. Vlera e kontratës është 408,506,281.2 lekë me TVSH. Kontrata bazë dhe amendamentet e saj, janë nënshkruar midis B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK dhe Bashkisë Tropojë me përfaqësues Nënkryetarin e saj z. A.K. Z. A.K, nuk ka atributet e Kryetarit aktual në detyrë të Bashkisë Tropojë pasi vetëm Kryetari i zgjedhur i Bashkisë Tropojë përfaqëson institucionin në marrëdhënie me të tretë. I cilësuar ky përcaktim tek Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë”, gërma (gj) ku cilësohet se Kryetari Bashkisë, midis të tjerash “Ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët”. Gjithashtu, tek rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Bashkisë Tropojë”, e miratuar me urdhrin nr. 41, datë 06.03.2018 të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, tek neni 33, Kryetari i Bashkisë, cilësohet se: “Kryetari i Bashkisë, përfaqëson institucionin në marrëdhënie me organe shtetërore, me organet e Njësive të Vetqeverisjes Vendore, me persona fizikë/juridikë vendas ose të huaj”. Si rezultat, në të gjitha rastet që në marrëdhënie me të tretët, dokumenti/akti përkatës nuk është nënshkruar nga Kryetari Bashkisë si përfaqësuesi ligjor i saj, e bën këtë dokument/akt, të pavlefshëm dhe një akt i tillë administrativ, i pavlefshëm juridikisht, nuk ka asnjë fuqi ligjore. Nga auditimi i dokumentacionit të ndodhur tek grupi i auditimit lidhur me delegimin e kompetencave nga Kryetari i Bashkisë Tropojë tek Nën Kryetari, u konstatuan dy urdhra të cilët në gjykimin e grupit të auditimit, nuk janë në konformitet me ligjin. Konkretisht, urdhri nr. 229 sipas shkresës me nr. 5123 Prot., datë 31.12.2020, të konceptuar nga znj.K.A. dhe urdhri nr. 01 sipas shkresës me nr. 11 Prot., datë 05.01.2022 të konceptuar nga A.H. Të dy këto urdhra, janë nxjerr në bazë të ligjeve dhe neneve të gabuar. Konkretisht janë nxjerr bazuar tek nenet 8/2, 59/3 dhe neni 64 të ligjit 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore kur në fakt duhej të bazoheshin tek neni 8, neni 64

dhe neni 66 gërma (h) e këtij ligji. Gjithashtu, këta urdhra janë nxjerr bazuar edhe tek kreu VII, neni 56 të Vkm nr. 914, datë 29.12.2014, Për miratimin e rregullave të prokurimeve publike kur në fakt duhej të cilësohej neni 28 dhe neni 29 i ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë. Në të dy aktet e delegimit, mungon përcaktimi i saktë i detyrave që do ketë i deleguari. Nuk cilësohet se çfarë do ketë të drejtë të nënshkruajë në emër të Kryetarit të Bashkisë. Nuk cilësohet as se ku do të publikohet akti i delegimit të kompetencave për transparencë për publikun. Të dy aktet cilësojnë se i deleguari do të angazhohet për organizimin dhe realizimin e procedurave të prokurimit por pa përcaktuar se çfarë dokumentash ose urdhrash do ketë të drejtë për të nënshkruar. Gjithashtu, kontrata bazë është nënshkruar nga Nën Kryetari i Bashkisë Tropojë z. A.K, në datën 18.12.2020 dhe urdhri për delegimin e kompetencave (nëse do ishte i rregullt ligjërisht) është nxjerrë në datën 31.12.2020 e si i tillë, nuk mund të ketë fuqi prapavepruese. Veprimet e mësipërme, ngarkojnë me përgjegjësi konceptuesit e këtyre urdhrave dhe Kryetarin e Bashkisë Tropojë pasi janë veprime jo në përputhje me: Ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 8, neni 64 gërma (gj) dhe neni 66 gërma (h); Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 28 dhe neni 29; Neni 33 i Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Bashkisë Tropojë” të miratuar me urdhrin nr. 41, datë 06.03.2018 të Kryetarit të Bashkisë Tropojë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2. 4.1, faqe 108-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë, të marrë masa që në të ardhmen, në rastet e delegimit të kompetencave tek vartësit e tij, të përcaktojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e të deleguarit konform ligjeve dhe rregullave në fuqi, duke kryer dhe njoftimet e duhura në transparencë për publikun por dhe duke monitoruar njëkohësisht vendimet e marra nga i deleguari.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.2.Rekomandim: Bashkia Tropojë, Drejtori i Kabinetit, Sektori Juridik, të marrin masa që në të ardhmen, përpara konceptimit të shkresave për delegimin e kompetencave të Kryetarit të Bashkisë tek cilido nga vartësit e tij, të argumentohet dhe dokumentohet arsyeja e delegimit të kompetencave duke respektuar njëkohësisht ligjin për formën dhe përmbajtjen e dokumentit të delegimit të kompetencave por dhe për afatin e delegimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

16-Gjetje nga auditimi: Kontrata midis B “F” SHPK & “4” SHPK dhe Bashkisë Tropojë, është me nr. 3360/3 Prot., datë 08.12.2020 dhe objekt “Ujësjiellësi Fshatit Dragobi”. Është me afat 6 muaj nga dita e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, sipas nenit 3 të kontratës së lidhur midis palëve “Afati i realizimit të punimeve”. Vlera e plotë e kontratës është 68,269,460.11 lekë me TVSH. Dosja e zbatimit të procedurës së mësipërme, e dorëzuar pranë grupit të auditimit, nuk është e inventarizuar dhe nuk është marrë në dorëzim konform rregullave dhe ligjeve në fuqi. Për këtë arsye, korespondenca e gjendur në dosjen e zbatimit, nuk ka hierarki në mbajtjen e protokollit. Janë pa numër protokollit njoftimet e pezullimit të punimeve dhe të rifillimit të tyre. Problemet e hasura në terren nga banorë të zonës sipas shkresave të gjendura në dosjen teknike,

nuk janë të bazuara në fakte apo prova por vetëm të deklaruara se sipërmarrësi ka hasur kundërshtime për zbatimin e projektit nga banorë të zonës. Këto mangësi e bëjnë të vështirë nxjerrjen e një konkluzioni të saktë nga grupi i auditimit mbi rregullshmërinë e dokumentacionit për arsye të mungesës së gjurmës së auditimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 19 ku cilësohet se “19. Gjurma e auditimit" përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve”, neni 16, pika 2 dhe pika 3 ku cilësohet se “2. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. 3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”, neni 23 pika 5 ku cilësohet se “Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi, që sigurojnë: 5. Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2. 4.1, faqe 108-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandim: Bashkia Tropojë, të marrë masat që në të ardhmen, të miratohen gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të Bashkisë, me qëllim dokumentimin e të gjitha veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

Menjëherë dhe në vijimësi

17-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave për dhënie të lejeve të ndërtimit u konstatuan mangësi në miratimin e disa lejeve si vijon:

- Çështja me nr. 4858 prot. , datë 07.12.2020, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: “Godine banimi dhe shërbimi 1-6 kat dhe 1kat nëntokë”, Qyteti Bajram Curri.

- Çështja me Nr. 5032 Prot. , datë 22.12.2020, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: “Ndërtim Thertore dhe përpunim mishi+prodhim nën produktesh mishi”, Qyteti Bajram Curri.

- Çështja me Nr. 108 prot. , datë 13.01.2021, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: “Magazinë në funksion të përpunimit, dhe magazinimit të produkteve bujqësorë 1 kat”, Fshati Bujan. Sa më sipër rezultoi se në dosjet e lejeve mungon dokumentacioni i plotë tekniko-ligjor, specifikisht të pesë pikat si më poshtë konstatohet që nuk procedohen në kërkesën për plotësim të tyre nga subjektet përfitues të lejeve dhe miratohen pa to, duke qenë në kundërshtim me nenin 15 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pikën e) Deklarata e projektuesit të licencuar, sipas formatit të aplikimit, të përcaktuar në sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit, nëpërmjet së cilës konfirmohet përputhshmëria e projektit me lejen e zhvillimit, dokumentet e planifikimit e kontrollit të zhvillimit, në fuqi, dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri dhe higjieno-

sanitare; pikën ë) Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit; piken g)Kopje e policës së sigurimit të projektuesve, për mbulimin e përgjegjësive profesionale; te Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, Datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

Referuar sistemit e-Leje rezulton për lejet e sipërcituara, Drejtoria e Planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe IMTV, nuk ka mbajtur akt kontrolli i piketimit të objektit me subjektin zhvillues, nuk rezulton të ketë mbikëqyrës të punimeve dhe nuk kemi firmë zbatuese të punimeve të ndërtimit, në zbatim të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores se Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar, neni 16.

Veprimet dhe mosveprimet e sipërcituar janë në kundërshtim me Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5. faqe 131-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1.Rekomandimi: Bashkia Tropojë dhe Drejtoria e Punëve Publike, Administrimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratimit të lejeve të ndërtimit të mbahen aktet e kontrollit sipas përcaktimeve ligjore.

Menjëherë dhe ne vijmësi

18-Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligjin 9780/2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar dhe VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga IKMT dhe INUV” i ndryshuar, IMT Bashkia Tropojë, krahas masave të tjera, ka marrë 2 vendime për prishje objektësh pa leje, të cilët rezultojnë të pa ekzekutuar. Në këto 2 raste rezulton se është mbajtur procesverbal konstatimi dhe procesverbal prishje, por nuk është marrë asnjë masë tjetër nga ana e IMT Bashkia Tropojë për prishjen e ndërtimeve dhe kthimin e gjendjes në situatën e mëparshme, për të cilat nga IMT duhej vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9780/2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6. faqe 145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1.Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndaj të cilave është mbajtur procesverbal prishje objekti, dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, duke zbatuar vendimin e prishjes së objektit. Në rast kundërshtimi ndajë personave përgjegjës, të ndiqen procedurat ligjore, duke kërkuar bërjen e kallëzimit penal ndaj shkelësve.

Menjëherë dhe në vijmësi

19-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i fundit i kryer në Bashkinë Tropojë, nga KLSH janë rekomanduar masa për përmirësimin e gjendjes, të cilat janë dërguar në subjekt me shkresën nr. 572/12 prot., datë 22.09.2022. Nga auditimi i zbatimit të këtyre rekomandimeve u konstatua

se nuk janë marrë masa të plota për zbatimin e tyre. Statusi i zbatimit të rekomandimeve është si vijon:

- Janë rekomanduar 10 masa organizative, të cilat janë pranuar, nga këto është zbatuar 1 masë, 6 masa janë në proces zbatimi dhe 3 masa organizative nuk janë zbatuar.
- Janë rekomanduar 5 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara, për arkëtimin e vlerës 56,461,393 *lekë*, dhe janë zbatuar pjesërisht 5 masa, duke *arkëtuar 7,994,195 lekë, si dhe është në proces vlera 48,467,198 lekë.*
- Masa disiplinore, i janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Tropojë t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse, rekomandim i cili nuk është zbatuar. Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15, "Të drejtat e KLSH". (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 145-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1.Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, si dhe Kryetarit të GMS-së, duhet të marrë masa të menjëhershme për:

- Hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshkrimit të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësisë dhe të drejtave të punonjësve të njësisë.
- Grupi i Menaxhimit Strategjik, të hartojë strategjinë e riskut, regjistrin e riskut, si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.

1.2.Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa për përditësimin e rregullores së brendshme, rregullimin e pozicioneve të punës për punonjësit të cilët janë trajtuar si punonjës me "Kodin e Punës", ku në fakt pozicioni i punës trajtohet sipas ligjit të "Nëpunësit Civil".

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë të marrë masa për organizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm në bashki, duke krijuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm brenda strukturës organizative të Bashkisë Tropojë. Në përzgjedhjen e punonjësve të kihet në konsideratë fakti se audituesi i brendshëm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e "Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publik".

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Gjithashtu të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës/Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Taksave Vendore dhe Inspektoratin Vendore Mbrojtjes Territorit (IVMT), të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, për arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën 42,876,907 lekë, të paraqitura në fund të periudhës 31.12.2021, kjo për të ulur nivelin e borxhit dhe rritur nivelin e të ardhurave të Bashkisë Tropojë.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë të ngrëjë grup pune me specialistë të fushës për evidentimin e të gjitha aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (AQT) të cilat janë pasuri e bashkisë, duke evidentuar statusin dhe gjendjen e tyre faktike në teren.

6.2.Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me strukturat e tjera të bashkisë të plotësojë regjistrin e të gjitha aktiveve sipas llogarive përkatëse, i cili të jetë elektronikë dhe shkresor dhe të marrë masa për regjistrimin e pronave në ASHK dhe kontabilitet. Për çdo vit, të kryhet inventarizimi i këtyre aktiveve.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.1.Rekomandimi: Nëpunësit zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek “Ujësjellës Kanalizime Tropojë ShA me vlerë 764,579,800 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.1.Rekomandim: Drejtoria Ekonomike të marrë masa për plotësimin e listës së kreditorëve me të gjithë elementët e duhur, si objektin e prokurimit, numrin e faturës, datën e faturës, etj., elementë të cilët identifikojnë plotësisht llojin, kohën e lindjes së detyrimit, arsyen e detyrimit që Bashkia Tropojë ka ndaj të tretëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të përshpejtuara për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të pa zbatuara dhe në proces zbatimi si vijon;

Për 14 masa organizative të cilat janë konsideruar në proces zbatimi si dhe për 13 masa organizative të pa zbatuara.

Për 3 masa shpërbllim dëmi me vlerë **9,587,836 lekë**.

Për 9 persona masa administrative me gjobë në vlerën 1,020,000 lekë sipas vendimit të APP.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE. (TËARDHURA TË MUNGUARA)

1.1 Rekomandimi: Sektori i Taksave e Tarifave Vendore të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve në mënyrë progresive në vlerën 43,951,182 lekë. Për këtë, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për të gjitha subjektet e private të nxjerrë njoftim për vlerësimet tatimore dhe në vazhdim të merren masa për arkëtimin e këtij detyrimi, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit (ASHK) dhe Zyrën Vendore të e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRVPP), kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet neni 93 i ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë 1. Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit.

c- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1.Rekomandimi: Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Tropojë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës 4,600,000 lekë nga 5 subjektet debitor për taksën e lëshimit të licencave për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, sipas listës në aneksin nr.6 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.1 Rekomandimi: Zyra Juridike në hartimin e kontratave dhe shtesave të tyre me operatorë të ndryshëm në bashkëpunim dhe me Sektorin Pyjor i cili përpilon raportin teknik dhe me

Drejtorin e Financës, të arkëtojnë detyrimin e kontraktuar në vlerën 2,201,048 lekë, aneksit nr. 10 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

3.2 Rekomandimi: Bashkia Tropojë të përdorë të gjitha mekanizmat ligjorë, për lidhjen e 22 kontratave me operatorët për nxjerrje dhe shfrytëzim të mineralit të kromit, të cilët ushtojnë aktivitetet prej disa vitesh në asetet e Bashkisë Tropojë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Tropojë të merren masa administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej **4,059,163 lekë**, gjë që ka sjell të ardhura të munguara **në Bashkinë Tropojë** për subjektet që kanë lidhur kontrata qiraje sipas aneksit nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.1. Rekomandim: Inspektorati Vendor i Mbrojtës Territorit (IVMT) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Tropojë, të kërkohet në Gjykatë, shndërrimi i 14 vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24 “Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv” dhe neni 30 “Arkëtimi i shumave të detyrimeve” të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe arkëtimi i vlerës **1,650,000 lekë**, që kanë kryer ndërtim pa leje në territorin e Bashkisë Tropojë.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Tropojë** t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Gjithashtu i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tropojë që bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, si dhe në kontratën e punës, të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

20-Gjetje nga auditimi: Bashkia Tropojë nuk ka zbatuar procedura të rregullta për planifikimin e kryerjes së investimeve, konstatohet se në investimet:

- Rikonstruksioni rrugës së fshatit Kasaj, për vitin 2023 vlera 11,630,654lekë;

- Rikonstrukcioni rrugës “Bylbyl Breçani, për vitin 2023 vlera 9,976,370 lekë;

- Rikonstrukcioni rrugës Luzhë, për vitin 2023 vlera 4,579,074 lekë;

janë pjesë e buxhetit vjetor 2023, por nuk janë pjesë e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025, veprim në kundërshtim me pikën 5 dhe pikën 123 të UMF Nr. 23, datë 30.07.2018” Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, ku thuhet: “Përgatitja e buxhetit vjetor është pjesë përbërëse e procesit të programit buxhetor afatmesëm, ku buxheti vjetor do të jetë viti i parë i këtij programi”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1. Rekomandim: Titullari i Bashkisë Tropojë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa, që në vijimësi investimet e planifikuara për tu kryer të jenë pjesë e programit buxhetor afatmesëm, si dhe në buxhetin vjetor, i cili është pjesë e këtij programi.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **nga Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **7,666,320 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

1-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikualifikim urban “Lagja Partizani” Blloku 1&2, Bajram Curri”, Bashkia Tropojë, me vlerë të kontratës 64,460,799 lekë me TVSH, fituar nga B.N& “R.C” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 186,810 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 866/2 Prot, datë 03.03.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Tropojë dhe B.N& “R.C” ShPK (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 108-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Tropojë të merren masa, të ndiqen të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës prej **186,810 lekë pa tvsh** nga B.N& “R.C” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 866/2 Prot, datë 03.03.2022, me objekt “Rikualifikim urban “Lagja Partizani” Blloku 1&2, Bajram Curri”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera. Gjithashtu të kryhet verifikimi në objekt me grup pune, në prezencë të mbikëqyrësit dhe subjektit kontraktues, lidhur me numërin e pusetave të shiut të vendosura në objekt, dhe në varësi të diferencave me ato të situacionuara, të procedohet me likuidimin financiar të tyre.

Menjëherë

2-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raportimit të pasqyrave financiare, konstatohen shkelje dhe parregullsi nga Bashkia Tropojë, si më poshtë:

1. Janë kryer shpenzime të pa justifikuara në vlerën **960,000 leke**, sipas urdhër shpenzimit nr. 234 date 16.08.2022 dhe nr. 315 date 10.11.2022, për pritje-përcjellje (dreka për hapjen e sezonit turistik Sulbica,Valbone 11.06.2022), të cilat nuk argumentohen nga ana ligjore, veprime në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999.

2. Janë kryer shpenzime për qira banese 220 m² për vlerën 20,000 leke ne muaj, marre “Ait sha”, sipas kontratës date 11.02.2022 dhe likuiduar vlera 61,200 lekë sipas urdhër shpenzimit nr. 47 dhe datë 23.02.2022 dhe vlera 66,000 lekë sipas urdhër shpenzimit nr. 113 dhe datë 05.05.2022 , rezulton:

*Bashkia ka likuiduar me tepër diferencën 6000 leke për 3 muaj (likuiduar 66,000 leke - 60,000 leke qe duhej) ose tepër 2000 leke/muaj (22,000-20,000=2000 leke/muaj x 3 muaj= 6000 leke), ne kundërshtim me kushtet e nenit 2 te kontratës date 11.02.2022.

* Bashkia ka likuiduar padrejtësisht edhe muajin janar 2022 për vlerën 20,000 leke, pasi kontrata date 11.02.2022, neni 12/12.1 nuk ka fuqi prapavepruese.

Përfundimisht, bashkia ka likuiduar tepër vlerën **26,000 leke** ne adrese të Ait sha, për periudhën Janar - Qershor 2022.

3. Ne 4 raste, rezulton se është likuiduar 2 here TVSH-ja e pajisjeve dhe mjeteve, në vlerën **560,600 leke**, në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 ,“Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh dhe vihet në fund të situacionit, për rrjedhojë është përfituar padrejtësisht nga subjektet, konkretisht:

*Sipas urdhër shpenzimeve nr. 408 datë 30.12.2022 dhe nr. 281 datë 13.10.2022 likuiduar “Sh.A” shpk per 77,200 lekë (386,000 x20%) + 102,000 lekë (510,280 x20%), për rikonstrukcionin e shkollës mesme Llugaj dhe për rehabilitim shëtitores qytetit Bajram Curri, sipas zërave ne situacionin nr. 1.

* Sipas urdhër shpenzimit nr. 203 dhe datë 21.07.2022 dhe nr. 258 date 21.09.2022 është likuiduar “K.B + V”, për mirëmbajtje shkolla, çerdhe, kopshte, vlera 131,400 lekë 657,000 x20%), sipas zërave ne situacion.

* Sipas urdhër shpenzimit nr. 205 datë 01.08.2022 likuiduar “4” shpk, për Ujësjiellës fshati Dragobi, për vlerën 120,000 lekë (600,000 x20%), sipas zërave ne situacionin 1 e 2.

* Sipas urdhër shpenzimit nr. 228 datë 12.08.2022 likuiduar “N” shpk, për Rikualifikim urban blloku 1 dhe 2 lagjja Partizani, për vlerën 130,000 lekë (650,000 x20%), sipas zërave ne situacionin 1 e 2.

4. Janë paguar **519,722 leke** për 5 ish-punonjës te saj te larguar ne vitin 2015, për pushime vjetore te pakryera dhe vjetërsi ne pune, sipas urdhër shpenzimit nr. 352 datë 01.04.2022. Pagesa është kryer pa asnjë baze ligjore dhe pa asnjë dokument gjykate, pas 7 viteve dhe duke renduar padrejtësisht fondet e vitit ushtrimor 2022, ne vend qe te ishin zgjidhur ne periudhën e largimit tyre, konkretisht:

- M.S 105,400 leke, vendim i kryetarit bashkisë nr. 115 date 05.09.2016 “ .

- K.R 117,300 leke, vendim i kryetarit bashkisë nr. 36 date 08.03.2017 “ “ .
- J.J 61,478 leke, mungon vendim i kryetarit bashkisë për largim nga puna.
- A.H 56,657 leke, mungon vendim i kryetarit bashkisë për largim nga puna.
- A.G 178,888 leke, mungon vendimi i kryetarit bashkisë për largim nga puna.

5. Është likuiduar OSHE për vlerën **65,233 leke** kamat vonesa për energjinë elektrike për periudhën janar- mars 2022, sipas urdhër shpenzimeve nr. 104, 104, 105 datë 15.04.2022, duke krijuar dem në buxhetin e njësisë vendore, si rezultat i mos likuidimit të faturave të energjisë elektrike brenda afateve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 49-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Bashkia Tropoje për shkeljet me veprimet e bankës te vitit 2022, te marre masa duke ndjekur të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës totale **2,131,555 leke**, konkretisht:

*Te arkëtohet vlere 519,722 leke nga 5 ish-punonjës e larguar ne 2015, për pagesa te paligjshme te pushimeve vjetore te pakryera dhe vjetërsi ne pune, te paguar pas 7 viteve pa baze ligjore, sipas urdhër shpenzimit nr. 352 datë 01.04.2022, konkretisht: M.S 105,400 leke, K.R 117,300 leke, J.J 61,478 leke, A.H 56,657 leke, A.G 178,888 leke.

*Te arkëtohet vlere 65,233 leke kamat vonesa për energjinë elektrike nga financa e bashkisë, për periudhën janar- mars 2022, sipas urdhër shpenzimeve nr. 104, 104, 105 datë 15.04.2022.

*Te arkëtohet vlere 960,000 leke shpenzime të paligjshme, për pritje-përcjellje dreka, nga pjesëmarrësit, sipas urdhër shpenzimit nr. 234 date 16.08.2022 dhe nr. 315 date 10.11.2022,

*Te arkëtohet ose ti zbritet vlere 26,000 leke Ait sha, për periudhën Janar- Qershor 2022, pasi janë likuiduar tepër qira banese.

*Te arkëtohet vlere 560,600 leke, për likuidim 2 here TVSH, ne 4 raste, konkretisht:

- vlere 77,200 lekë, nga OE “Sh.A” shpk , sipas urdhër shpenzimeve nr. 408 datë 30.12.2022 dhe nr. 281 datë 13.10.2022

- vlere 131,400 lekë, nga B “K.B + V”, sipas urdhër shpenzimit nr. 203 dhe datë 21.07.2022 dhe nr. 258 date 21.09.2022.

- vlere 120,000 lekë , nga OE “4” shpk, sipas urdhër shpenzimit nr. 205 datë 01.08.2022,

- vlere 130,000 lekë , nga OE “N”, sipas urdhër shpenzimit nr. 228 datë 12.08.2022.

Menjëherë

3-Gjetje nga auditimi: Kontrata midis B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK dhe Bashkisë Tropojë, është me nr. 3814/3 Prot., datë 18.12.2020 dhe objekt “*Rikonstruksion i 5(pesë) segmenteve rrugore, fshati Gri, Buljan, Cerrnikë, Tropojë*”. Është me afat 12 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit ose me datë përfundimi datën 29.12.2021. Vlere e kontratës është 408,506,281.2 lekë me TVSH. Procesverbali i fillimit të punimeve është mbajtur në datën 29.12.2020. Punimet kanë filluar në datën 29.12.2020 dhe përfundojnë pas 12 muajsh ose në datën 29.12.2021. Me shkresën nr. 3814/12 Prot., datë 10.11.2021, nënshkruhet amendamenti i parë i kontratës bazë dhe zgjatet afati i ekzekutimit të punimeve edhe 3 muaj kalendarik nga data e përfundimit të kontratës bazë ose me datë përfundimi datën 29.05.2022. Arsyeja e zgjatjes së afatit të punimeve, është moti ekstrem me ngrica. Me shkresën nr. 3814/15 Prot., datë 08.04.2022, nënshkruhet amendamenti i dytë i kontratës bazë dhe zgjatet afati i

ekzekutimit të punimeve edhe 3 muaj kalendarik nga data e përfundimit të kontratës bazë ose me datë përfundimi datën 29.07.2022. Arsyeja e zgjatjes së afatit të punimeve, është përsëri moti ekstrem me ngrica. Me shkresën nr. 3814/19 Prot., datë 29.07.2022, nënshkruhet amendamenti i tretë i kontratës bazë dhe zgjatet afati i ekzekutimit të punimeve deri në datën 29.10.2022. Arsyeja e zgjatjes së afatit të punimeve, është mungesa e furnizimit me lëndë të parë (binder/asfaltobeton).

1. Amendamenti i tretë me nr. 3814/19 Prot., datë 29.07.2022, është i pavlefshëm juridikisht pasi është nënshkruar me justifikime/argumentime të cilat nuk qëndrojnë dhe konkretisht, justifikimi/argumentimi i zgjatjes së afatit të ekzekutimit të punimeve *“ku cilësohet se shtyrja kërkohet pasi kontraktori ka mugesë të furnizimit me lëndë të parë dhe konkretisht për lëndën e parë binder/asfaltobeton”*, nuk duhej të merrej në konsideratë nga Bashkia Tropojë pasi ofertuesi ose kontraktori nuk ka paraqitur paraprakisht ndonjë marrëveshje bashkëpunimi me operatorë të tjerë furnizues të lëndës së parë por mbi të gjitha, nuk është kërkuar në DST dhe as në kriteret e kualifikimit që operatori ekonomik ofertues, të dorëzojë marrëveshje bashkëpunimi me prodhues të lëndës së parë binder/asfaltobeton dhe në vazhdim të kërkohet që kontraktuesi të dorëzonte gjatë ekzekutimit të kontratës edhe dokumentacionin vërtetues nga furnizuesi në kohën e furnizimit me lëndë të parë binder/asfaltobeton. Vetëm në këtë mënyrë amendamenti i tretë do të ishte plotësisht i arsyetuar dhe bindës. Kontrata bazë është nënshkruar nga Bashkia Tropojë dhe B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK e si e tillë, Bashkia Tropojë nuk mund të mbajë përgjegjësi për vonesat që vijnë nga palë të treta jashtë kësaj marrëveshjeje/kontrate për më tepër që Bashkia Tropojë nuk ka qenë paraprakisht në dijeni të ekzistencës së ndonjë marrëveshjeje midis B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK dhe ndonjë prodhuesi të materialit binder/asfaltobeton.

Si rezultat, punimet pas datës 29.07.2022, datë e cila është përcaktuar tek amendamenti i dytë si datë përfundimi punimesh (duke marrë në konsideratë rregullshmërinë ligjore të amendamentit të parë dhe të dytë dhe jo fuqinë e nënshkruesit si përfaqësues i Bashkisë), deri në datën 29.10.2022, datë në të cilën kanë përfunduar punimet, konsiderohen punime të kryera jashtë afateve ligjore e si të tilla duhej që Bashkia Tropojë të kalkulonte penalitetin që i duhej mbajtur B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK për 90 ditë vonesa në ekzekutimin e punimeve për zërat e punimeve të ekzekutuara jashtë afateve ligjore. Vlera e punimeve të kryera me 3 muaj vonesë (90 ditë), referuar ditarit të punimeve të gjendur në dosjen teknike të procedurës, është 54,489,120.5 lekë. Për këtë vlerë, referuar gërmës (c) të nenit 36, “Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve” të kontratës me nr. 3814/3 Prot., datë 18.12.2020, me afat ekzekutimi punimesh më shumë se 12 muaj, Bashkia Tropojë, duhej të aplikonte formulën sipas përcaktimit të gërmës (c). Vlera e penalitetit me efekte negative për Bashkinë Tropojë, është: $54,489,120.5(\text{lekë}) * 90(\text{ditë vonesë}) * 1/1000 = \mathbf{4,904,021 \text{ lekë}}$. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 108-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandim: Bashkia Tropojë, të marrë masat për të kryer verifikimet e duhura lidhur me vonesat e konstatuara nga grupi i auditimit gjatë zbatimit të punimeve sipas kontratës me objekt “Rikonstruksion i 5(pesë) segmenteve rrugore, fshati Gri, Buljan, Cernikë, Tropojë”, si rezultat i amendimeve të cilësuara nga grupi i auditimit, me mangësi ligjore, dhe nëse rezultojnë të pa bazuara në ligjet dhe rregullat në fuqi, atëherë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur

të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 4,904,021 lekë, nga B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK, si vlerë që i përket penaltetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve të përcaktuara në kontratë.

Menjëherë

4-Gjetje nga auditimi: Kontrata midis B “F” SHPK & “4” SHPK dhe Bashkisë Tropojë, është me nr. 3360/3 Prot., datë 08.12.2020 dhe objekt “Ujësjetillësi Fshatit Dragobi”. Është me afat 6 muaj nga dita e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, sipas nenit 3 të kontratës së lidhur midis palëve “Afati i realizimit të punimeve”. Vlera e plotë e kontratës është 68,269,460.11 lekë me TVSH. Nga auditimi në terren i zërave të punimeve, u konstatuan diferenca në zëra punimesh. Konkretisht në lagjen Metaliaj dhe Sokolaj, u konstatua mungesa e një cajruesi dhe një valve sigurie përkatësisht në Sokolaj dhe Metaliaj. Në total, vlera e faturuar më tepër në situacionin përfundimtar, është 60,000 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1 faqe 108-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandim: Bashkia Tropojë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimin e vlerës 60,000 lekë**, nga B “F” SHPK & “4” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar, faturuar dhe likuiduar por të pa kryer.

Menjëherë

5-Gjetje nga auditimi: Kontrata midis B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK dhe Bashkisë Tropojë, është me nr. 3814/3 Prot., datë 18.12.2020 dhe objekt “Rikonstruksion i 5(pesë) segmenteve rrugore, fshati Gri, Buljan, Cerrnikë, Tropojë”. Është me afat 12 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit ose me datë përfundimi datën 29.12.2021. Vlera e kontratës është 408,506,281.2 lekë me TVSH. Nga auditimi në terren i zërave të punimeve, u konstatuan diferenca në zëra punimesh. Në situacionin përfundimtar, janë pasqyruar 30 tabela trekëndore dhe 30 tabela rrethore për rrugën Bujan-Tplan. Nga verifikimet në terren, u konstatuan se tek kjo rrugë, ishin vendosur 22 tabela trekëndore ose 8 tabela trekëndore më pak dhe 18 tabela rrethore ose 12 tabela rrethore më pak. Gjithashtu janë pasqyruar 24 tabela trekëndore dhe 24 tabela rrethore për rrugën Kërnaj-Zhenaj. Nga verifikimet në terren, u konstatuan se tek kjo rrugë, ishin vendosur 20 tabela trekëndore ose 4 tabela trekëndore më pak dhe 16 tabela rrethore ose 8 tabela rrethore më pak. Në total, vlera e faturuar më tepër, është 384,000 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1 faqe 108-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandim: Bashkia Tropojë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimin e vlerës 384,000 lekë**, nga B “F” SHPK & “4” SHPK & “V” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar, faturuar dhe likuiduar por të pa kryer.

Menjëherë

D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1-Gjetje nga auditimi: Në kuadër të auditimit të të ardhurave të Bashkisë Tropojë u auditua realizimi i të ardhurave nga asetet e bashkisë të dhëna me qira. Konstatohen shkelje dhe parregullsi, pasi subjektet e kontraktuara nuk kanë shlyer detyrimet kontraktore të qirave të aseteve 15 subjekte për vlerën 3,835,358 leke (2,227,077+1,608,281), për vitin 2021-2022, në kundërshtim me kushtet e kontratave respektive, me VKM 1064 datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, me VKM 54 datë 05.02.2014, me VKM 693 datë 05.10.2016 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, konkretisht:

- “Sh Al” shpk =151,730 leke, detyrim qiraje për vitin 2022,
- “V. A.” sha =255,000 leke, detyrim qiraje për vitin 2022,
- “A.E.E”= 473,495 leke, detyrim qiraje për vitin 2022,
- “H.V” shpk= 1,050,852 leke, detyrim qiraje për vitin 2022,
- “M” shpk =115,000 leke, detyrim qiraje për vitin 2021,
- “L” shpk=181,000 leke, detyrim qiraje për vitin 2021,
- I.M=465,000 leke detyrim qiraje për 2 kontratat, përkatësisht: 450,000 leke për vitin 2021 (4.11.2020-4.11.2021) dhe 15,000 lekë për vitin 2022 (24.01.2022-23.01.2023),
- P.Gj= 34,934 leke qira për vitin 2022,
- “B.R” shpk= 294,925 leke qira për vitin 2022,
- “T.A” sha, =190,000 leke qira për 2022 (paguar deri 24.5.2021).
- “B” shpk, =206,800 leke për vitin 2022,
- B.T =47,422 leke për vitin 2022,
- “L” shpk, =181,000 leke për vitin 2022, (paguar 2017-2018 vlerën 181,000).
- “S.A”, shpk= 117,000 leke për 2022,
- “M.I” shpk, =71,200 leke për 2022,

Gjithashtu mungojnë inventarët e dosjeve dhe paraqiten mangësi dokumentare në disa dosje të qirave të aseteve të bashkisë, konkretisht: mungojnë dokumentet bankare të likuidimit qirave, mungojnë njoftimet ndaj subjektit për mos-pagesat në afat, mungojnë procedurat ligjore deri në zgjidhjen e kontratës për subjektet e parregullta, mungojnë kamat vonesat, mungojnë inventarët për secilën dosje në vitin 2022, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me VKM 433 datë 03.06.2016 “Për transferimin në pronësi bashkive pyjeve, kullotave sipas inventarit MM.” me ligjin 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil RSH”, me nenin 3 e 29 ligjit 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 49-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1.Rekomandimi: Bashkia Tropoje për qiratë e pa likujduara që lidhen me përdorimin e aseteve të saj, të marrë masa duke ndjekur të gjithë hapat ligjorë dhe administrativë, për arkëtimin e vlerës totale 3,835,358 leke, nga 15 subjektet, si më sipër, për detyrime kontraktore të pa likujduara, nga përdorimi i aseteve të Bashkisë Tropojë. Gjithashtu të kryhet

insventarizimi i të gjitha dosjeve të kontratave të qirave, si dhe të plotësohen me dokumentacionin e konstatuar në mungesë.

Menjëherë

2- Gjetje nga auditimi: Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Tropojë nuk ka zbatuar procedurat, duke mos njoftuar Zyrën Juridike për vazhdimin e procedurave për arkëtimin e gjobave të vendosura. Nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit (IMT) Bashkia Tropoje për periudhën objekt auditimi janë vendosur 5 gjoba në vlerën 1,550,000 lekë nga të cilat nuk është arkëtuar asnjë lekë, si dhe nuk ka filluar procesi i kërimit të arkëtimin të tyre, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë. Veprime në kundërshtim me neni 16 ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", me ndryshime; neni 1 ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2 ligji nr.10324, datë 23.9.2010, nenet, 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative". (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 144-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat, të ndjekin të gjitha hapat ligjore dhe administrative, me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën **1,550,000 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

3-Gjetje nga auditimi: Kontrata midis B "F" SHPK & "4" SHPK & "V" SHPK dhe Bashkisë Tropojë, është me nr. 3814/3 Prot., datë 18.12.2020 dhe objekt "Rikonstruksion i 5(pesë) segmenteve rrugore, fshati Gri, Buljan, Cernikë, Tropojë". Është me afat 12 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit ose me datë përfundimi datën 29.12.2021. Vlera e kontratës është 408,506,281.2 lekë me TVSH. Nga auditimi i zërave të preventivit dhe zërave të situacionit përfundimtar të punimeve sipas kontratës së lidhur, u konstatua se nuk është ekzekutuar zëri "An. 3.226/1 Shtresë asfaltobetoni". Ky zë nuk është ofertuar dhe nuk është situacionuar pra faturuar. Mos ekzekutimi i këtij zëri, pra i tapetit mbi binder, e bën investimin të jetë më shumë i ekspozuar ndaj fenomeneve natyrore. Binderit në vetvete, ka tendencën që të ngurtësohet me kalimin e kohës prandaj rolin e amortizuesit ose të materialit më të përshtatshëm ndaj kushteve atmosferike si në dimër dhe në verë, e kryen tapeti ose shtresa e asfaltit e cila hidhet mbi shtresën e binderit. Kjo shtresë, jo vetëm që e mbron nga shkatërrimi shtresën e binderit ndaj kushteve natyrore por mbi të gjitha, garanton sigurinë në lëvizjen e mjeteve rrugore për arsye të mbajtjes në nivelin e duhur të forcave të fërkimit midis sipërfaqeve të gomave të mjeteve dhe shtresës së asfaltit. Në këto kushte që është kryer investimi dhe nuk është hedhur shtresa e asfaltit, shtresa e binderit dhe vijëzimet mbi të, janë të destinuara të shkatërrohen me kalimin e kohës nëse nuk merren masa për hedhjen e asfaltit mbi binder. Binderit dhe vijëzimet mbi binder, mund të dëmtohen në të ardhmen pasi për hedhjen e asfaltit nevojitet një frezim i binderit në rastin më të mirë ose shtresë e re binderit në rastin më të keq. Si rezultat, vlera e investuar prej 129,181,200 lekë, që i përket binderit dhe vijëzimeve, është

vlerë e investuar në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, efencës dhe efektivitetit të fondeve publike, në rast se nuk hidhet sa më parë shtresa e asfaltobetonit mbi binder. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1 faqe 108-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandim: Bashkia Tropojë, të marrë masat për hedhjen e Shtresës së asfaltobetonit, sa më shpejt, me qëllim, shmangien e kthimit të investimit me vlerë 129,181,200 lekë, në një investim me pasoja negative financiare në të ardhmen, në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, efencës dhe efektivitetit të përdorimit të fondeve publike.

Menjëherë

E. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, dhe në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, i ndryshuar, si dhe në kontratën e punës, **i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Tropojë**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse:

E. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil,

Marrjen e masave disiplinore përkatëse nga “Vërejtje” deri në “Paralajmërim për largim nga shërbimi civil”, si më poshtë:

1. Z. K.B, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor,

- Në cilësinë e anëtarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kritereve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në disa procedura prokurimi: me objekt “Blerje kamioni”; me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2” dhe procedura me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë -Lekurtaj”;

2. Z. K.S, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave,

- Për problemet e konstatuara në lidhje me realizimin e ulët të të ardhurave në buxhetin e bashkisë.

- Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurat e prokurimit me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2” dhe procedura me objekt “Blerje dru zjarri”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

3. Z. E.M, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

- Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit: me objekt “Blerje kamioni”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

- Në cilësinë e anëtarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2”;

4. Z. M.K, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Pronave dhe Hartografisë

- Në cilësinë e antarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurat e prokurimit me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë -Lekurtaj” dhe procedura me objekt “Rikonstruksion thertorja Shudenicë+ Ndërtim i tregut të bagëtive”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

6. Znj. F.D, me detyrë specialiste në Sektorin e Tatim Taksave

- Në cilësinë e antarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kamioni”;

- Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje dru zjarri”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

6. Znj. E.D, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit e Financës,

- Për problemet e konstatuara në lidhje me aktivitetin ekonomik financiar:

- Mos shlyerjen në kohën e duhur të faturave të pa likuiduara prej 86 milion leke, si dhe detyrimeve të planifikuara të vitit 2022 për detyrimet prapambetura, detyrime të cilat i kanë krijuar Bashkisë Tropojë vështirësi financiare. Për shkelje me veprimet e bankës për vitin 2022 në vlerën totale 2,131,555 leke, duke kryer likuidime të pa argumentuara, si dhe për 2 raste, lejimin e shkeljeve teknike në inventarizimin dhe në nxjerrjet jashtë përdorimit.

- Në cilësinë e anëtarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kamioni”;

7. Znj. Sh.Gj, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ndihmës Ekonomike,

- Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

8. Znj. S.M, me detyrë specialiste në Sektorin e Pyjeve,

- Në cilësinë e anëtarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në disa procedura prokurimi: me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2”, “ Rikonstruksion i Shkollës “Oso Dauti”, Njësia Administrative Llugaj” dhe procedura me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë - Lekurtaj”;

9. Znj. E.H, me detyrë specialiste në Sektorin e Pyjeve,

- Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje dru zjarri”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

10. Znj. A.M, me detyrë specialiste Sektori Buxhet Finasncë

- Për problemet e konstatuara në lidhje me aktivitetin ekonomik financiar:

- Për mungesë dokumentacioni justifikues për dhënien e ndihmave të menjëhershme nga fondi rezervë, për vështirësi ekonomike dhe arsye shëndetësore, si dhe emërtim dhe për shkelje në procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit materialeve.

- Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion thertorja Shudenicë+ Ndërtim i tregut të bagëtive”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

11. Znj. M.Gj, me detyrë specialiste Sektori i Pronave dhe Kadastrës

- Në cilësinë e anëtarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në procedurpën e prokurimi me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë -Lekurtaj”;

12. Znj. J.Gj, me detyrë specialiste Sektori Buxhet Finasncë

- Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë -Lekurtaj”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

13. Znj. A.S specialiste kontabiliteti (*Hartuese bilancit 2022*), për shkeljet e mëposhtme:

- Per disa mangesi në mbajtjen e dokumentacionit te kontabilitetit, perkatesisht: mungesa e partitarëve analitik, ditari i veprimeve të ndryshme dhe libri i madh ose centrilizatori.

- Për mos ndjekjen e të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e vlerës 44,710,681 leke te llogarisë 468 “detyrime ndryshme”, debitorë taksave dhe qirave asetëve si dhe detyrimet e lëna nga KLSH dhe detyrime tjera prapambetura.

14. Znj. A.H, me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike dhe Apelimit Tatimor.

- Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

15. Znj. J.Q, me detyrë specialist jurist Sektori Juridik dhe Apelimit Tatimor

- Per mos ndjekjen e të gjithë hapave ligjore dhe për mos ndërprerjen e kontratave, ndaj subjekteve qe nuk kane respektuar detyrimet dhe kushtet e kontratave për asetet e bashkisë te marra me qira, për pasoje krijimin e vlerës totale debitore 3,835,358 leke nga 15 subjekte, Për mangësi dokumentare në dosjet e qirave të asetëve dhe mos inventarizimin e tyre,

16. Znj. E.K.M, me detyrë specialiste në Zyrën e Integritimit European

- Në cilësinë e anëtarit të Specifikemeve Teknike-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Kamioni”, pasi specifikimet teknike nuk janë të plota dhe të argumentuara.

E. 2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës, si dhe kontratën e punës respektive, marrjen e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

I - Ulje në detyrë dhe kalimin në një pozicion pune të përshtatshëm me kualifikimin dhe nivelin arsimor, për:

1. Z. A.K, me detyrë Zv/Kryetar Bashkie, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor(I Autorizuar)

- Për shkelje dhe parregullsi të konstatuara në 6 procedura prokurimi, pasi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës, si dhe janë shpallur fitues OE që nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

2. Znj. Z.I me detyrë Zv/Kryetar Bashkie dhe ish Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, si dhe në cilësinë e personit përgjegjës në fushën e prokurimeve.

- Për shkelje dhe parregullsi të konstatuara në procedurat e prokurimit, copëzimi i fondeve (ndarja e vlerës së kontratës) dhe për pasojë devijimi nga aplikimi i LPP-së për shkak të mosaplikimit të rregullt të llojit të procedurës, që përbën një risk eventual për prokurimin e objektit me një vlerë më të lartë.

- Për të meta e mangësi në hartimin e projekt buxhetit në drejtim të numrit të lartë prej 361 veta të organikes Bashkisë Tropojë, për efekt të mos justifikimit të ngarkesës dhe punës së tyre me dokumente e programe pune, çka ka ndikuar negativisht në buxhetin 2022.

- Për mos përmirësimin e politikave sociale-ekonomike, për të zbutur papunësinë dhe varfërinë, pasi ndihma sociale për 2022 zënë peshën kryesore prej 386 milion lekë ndaj shpenzimeve gjithsejtë ose 47 %, dhe ka tendence në rritje, në vend që të ndodhte e kundërta si rezultat i shpërnguljes banoreve brenda dhe jashtë vendit.

- Për lejimin e krijimit të vështirësisë financiare, sipas nenit 56 të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, që do të rëndojë në fondet e viteve në vazhdim. Për mos shlyerjen e detyrimeve të planifikuara të vitit 2022 për detyrimet prapambetura në masën 30% ose në vlerë absolute 23 milion leke, pasi janë likuiduar vetëm 6,2 milion leke nga 23 milion që duhej.

II – Masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” për këta punonjës:

1. Z. P.R, me detyrë përgjegjës tek Bordi i Kullimit;

- Në cilësinë e antarit të Specifikemeve Teknike-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Kamioni”, pasi specifikimet teknike nuk janë të plota dhe të argumentuara. Gjithashtu në cilësinë e antarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës. Pjesmarrja në këto dy komisione për të njëjtën procedurë prokurimi, ka shkaktuar konflikt interesi.

2. Z. B.B, me detyrë Teknik ndërtimi në Drejtorinë e Shërbimeve Publike;

- Në cilësinë e antarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurat e prokurimit me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë -Lekurtaj” dhe procedura me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

E. 3. Për punonjësit e larguar:

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e përmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre, si më poshtë.

1. **Z. A.Z**, me detyrë ish-Drejtor I Drejtorisë së Turizmit dhe Shërbimeve Publike,

- Në cilësinë e antarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurat e prokurimit me objekt “Blerje kamioni”;

2. **Znj. Sh.Gj**, me detyrë ish-specialiste Sektori i Emergjencave Civile,

- Në cilësinë e antarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurat e prokurimit me objekt “Blerje kamioni”;

3. **Znj. E.N**, me detyrë ish-specialiste Sektori Juridik,

- Në cilësinë e antarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në procedurën e prokurimit me objekt ”, “Rikonstruksion i Shkollës “Oso Dauti”, Njësia Administrative Llugaj”.

4. **Z. E.S**, me detyrë ish-specialist Sektori Juridik,

- Në cilësinë e antarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Shkollës “Oso Dauti”, Njësia Administrative Llugaj”.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

1.L.K

2.B.B

3.F.C

4.A.T

DREJTORI I DEPARTAMENTIT
B.D

ANEKSET

Pasqyra PF1: Përlllogaritja e Materialitetit për të ardhurat dhe shpenzimet në Bashkinë Tropojë, për vitin ushtrimor 2022.

Bashkia Tropoje viti 2022			
Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (mund të jetë 0.7 ose 2 ose 3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga (600)	193,328	0.70	10
Sigurime Shoqërore (601)	30,237	0.70	2
Mallra e Shërbime (602)	61,405	2.00	9
Investime të brend. (230-231)	148,418	2.00	22
Te tjera transfer. korren (604)	391,209	0.70	20
Total	824,597		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti në vlerë	16,492		
Kalkulimi i precizonit			
Materialiteti	16,492		
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	1,649		
Nëntotali	14,843		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
Vlera e precizonit	13,358		

Pasqyra PF2-Lista analitike e faturave te pa likuiduara deri ne periudhën 31.12.2022

Tabela nr. 8

Subjekti	Viti i detyrimit	Detyrime 31.12.2021	Likuiduar 2022	Detyrime 31.12.2022
1. D.Z	2004	1,946,383		1,946,383
2. I.C	22.12.2014	1,440,000	1,440,000	-
3. K. shpk	07.07.2015	2,040,000	1,500,000	540,000
4. Detyrime trashëg ish kom llugaj	07.07.2015	849,200		849,200
5. Vendime titullarit	viti 2015	755,000	603,872	151,128
6. Ujesjellesi kolaudim	19.12.2017	210,391		210,391
7. H sh.p.k. Sh sh.p.k.	06.06.2018	567,086	565,757	1,329
8. GB C.E	30.08.2018	667,558		667,558
9. R.	27.02.2019	17,832		17,832
10. A. 2018	20.03.2019	87,600		87,600
11. F.E sh.p.k.	12.03.2019	117,960		117,960
12. N.M	08.04.2019	179,040	179,040	
13. N shpk	27.05.2019	706,320		706,320

14. A	31.05.2019	83,400		83,400
15. C.G	01.07.2019	478,800		478,800
16. F SH.P.K.	10.07.2019	20,511,820		20,511,820
17. H sh.p.k.	16.07.2019	19,538,781		19,538,781
18. H sh.p.k.	18.07.219	7,934,844		7,934,844
19. G.I	19.07.2019	143,028		143,028
20. E.L	31.07.2019	87,960		87,960
21. M sh.p.k.	31.07.2019	13,204,787		13,204,787
22. M S	04.09.2019	6,598		6,598
23. M S	04.09.2019	34,124		34,124
24. Posta	31.10.2019	872,171		872,171
25. IH sh.p.k.	viti 2019	495,000		495,000
26. OSHEE DEGA Tropoje	2019	765,891		765,891
27. 4 SH.P.K.	2019	913,253		913,253
28. G.B	2018	578,717		578,717
29. K.C		331,286	331,286	0
30. Diference e projekteve	dhjetor 2020	1,670,147	1,614,240	55,907
Total		77,234,977	6,234,195	71,000,782

Pasqyra PF3, Subjektet debitorë për taksa e tarifa te pa likuiduara për vitin 2022

Tabela nr. 11

Nr	Personi Fizik/Juridik	NUIS	Viti 2022	TOTALI PROG. 31.12.2022
1	2d	L.....U	382,342	382,342
2	A.Gj	S'ka	25,534	171,352
3	A.E.E shpk	L.....E	69,120	207,360
4	A.Sh	s'ka	0	65,738
5	A.M shpk	L.....K	69,120	209,274
6	A.I	L.....L	0	32,499
7	A.K	L.....S	15,948	107,260
8	A.N	L.....C	25,113	105,952
9	A.G	K.....A	0	47,687
10	A.M	L.....O	16,932	50,796
11	A.G	L.....F	0	38,822
12	A shpk	L.....U	23,620	149,666
13	A.I	K.....E	0	154,423
14	A.G	s'ka	0	60,360
15	A.T	L.....J	60,120	60,120
16	A.H	L.....E	0	26,491
17	A.Gj	L.....F	28,979	56,906
18	A.M	K.....P	0	12,190
19	A.gj	L.....P	0	77,405
20	A.GJ	L.....C	0	34,132
21	A.P	L.....L	23,366	23,366
22	A.M	L.....L	26,491	147,609
23	A.Gj	L.....Q	0	39,525
24	A.S	M.....C	23,640	23,640
25	A.P	L.....O	0	60,492
26	A.A	L.....C	0	31,593
27	A.A	L.....H	0	27,208

28	A.H	L.....D	26,491	212,761
29	A.B	s'ka	0	68,703
30	A.H	L.....M	0	30,599
31	A.Gj	L.....P	0	44,882
32	A.D	L.....J	0	42,860
33	A.M	L.....L	31,716	63,432
34	A.M	L.....A	36,175	159,365
35	A.P	s'ka	24,577	191,418
36	A.Gj	L.....L	9,000	164,000
37	A.B	L.....R	0	26,400
38	A.L	L.....T	0	96,075
39	A.B	s'ka	0	119,462
40	A.V	s'ka	0	43,260
41	A.L	M.....N	19,448	32,453
42	A.Gj	s'ka	25,534	171,352
43	A.V	L.....A	33,190	212,642
44	A.B	L.....R	0	162,205
45	A.Xh	L.....N	69,120	184,360
46	B.Xh	L.....Q	25,534	25,534
47	B.Gj	K.....A	0	138,858
48	B.S	M.....R	37,753	37,753
49	B.S	M.....D	19,305	19,305
50	B.H	K.....D	123,996	342,488
51	B.J	L.....Q	0	124,557
52	B.J	s'ka	26,491	214,614
53	B.Gj	M.....K	0	8,292
54	B.K	L.....L	0	31,572
55	B.A shpk	L.....P	0	93,912
56	B	M.....A	60,120	96,906

57	B.A	K.....I	0	49,028
58	B.B	M.....T	39,836	39,836
59	B.K	L.....B	29,362	199,581
60	B.I	K.....U	0	49,259
61	B.S	L.....K	26,491	26,491
62	C.L.B	L.....A	36,895	112,845
63	C.C	L.....A	6,474	71,100
64	C.O shpk	M.....V	69,120	69,120
65	C.Gj	K.....J	0	103,444
66	CMA	K.....E	48,120	397,971
67	C.E	M.....V	75,120	117,738
68	D.Gj	M.....D	0	35,548
69	D.Gj	L.....S	3,468	3,468
70	D shpk	L.....E	0	354,442
71	D.M	M.....I	34,860	34,860
72	D.A	L.....J	0	4,983
73	D.H	s'ka	0	46,322
74	D.H	L.....N	25,534	178,317
75	D shpk	L.....Q	128,496	128,496
76	D.M	s'ka	0	90,564
77	D.O	SKA	0	71,585
78	D.I	L.....T	0	69,434
79	E.H	M.....P	15,948	23,318
80	E.K	L.....D	26,491	111,766
81	E.D	s'ka	0	171,610
82	E.M	M.....N	26,491	30,227
83	E.N	M.....P	11,620	11,620
84	E.K	L.....S	0	9,120
85	E.N	L.....S	0	8,183
86	E.P	L.....Q	23,432	77,216

87	E.K	L.....R	75,120	123,240
88	E.L	M.....J	5,211	5,211
89	E.T	L.....N	0	6,596
90	E.H	s'ka	0	21,333
91	E sshpk	K.....M	0	176,913
92	E.H	M.....N	11,370	11,370
93	E.K	L.....V	400	26,690
94	E.a	K.....F	0	10,853
95	E.N	L.....K	0	345,789
96	EC	L.....R	69,120	561,845
97	EC	L.....J	598,507	598,507
98	F.S	L.....D	0	268,894
99	F.A	L.....D	0	19,772
100	F.A	s'ka	0	32,499
101	F.H	L.....A	53,680	53,680
102	F.Gj	L.....S	25,821	227,702
103	F.H	L.....T	34,503	61,568
104	F.Gj	L.....J	0	104,063
105	F.N	L.....H	30,606	110,234
106	F shpk	M.....F	11,489	43,261
107	F.Gj	L.....K	0	102,880
108	F.	s'ka	0	43,260
109	F.S	M.....T	0	16,781
110	G.M	L.....Q	48,120	144,360
111	G.P	s'ka	0	84,805
112	G.S	M.....D	9,010	9,010
113	G.G	s'ka	25,917	203,237
114	G/H	L.....U		29,402
115	G.T	L.....A	48,120	271,883
116	G.B	L.....C	0	23,189

117	G.M	K.....H	0	22,698
118	G.Gj	L.....O	58,484	399,287
119	G.K	L.....N		15,604
120	Gj.K	Ska	0	61,482
121	Gj.G	K.....A	69,120	293,755
122	Gj.B	s'ka	13,612	50,548
123	Gj.GJ	L.....A	0	145,107
124	G.GJ	L.....K	0	196,654
125	G.Gj	L.....M	14,378	123,451
126	G.M.M	L.....K	69,120	279,475
127	G.A	M.....G	69,120	161,337
128	H1	K.....F	145,427	1,394,855
129	H.C	K.....E	0	33,206
130	H.N	L.....N	0	48,415
131	H.D	K.....F	0	244,087
132	H.V shpk	L.....T	60,120	120,240
133	H.K	L.....L	0	66,392
134	H.K	L.....R	69,120	468,092
135	H.M	s'ka	13,612	112,029
136	I shpk	L.....H	48,120	502,263
137	I.K	L.....D	48,120	305,840
138	I.B	L.....D	0	30,425
139	I.K	L.....I	37,975	336,886
140	J.Gj	L.....N	0	40,188
141	J.M	L.....L	0	21,186
142	J.B	L.....P	0	1,757
143	J.M	K.....L	25,056	167,827
144	K.D	L.....N	4,659	4,659

145	K	K.....I	172,584	172,584
146	K.H	K.....P	0	28,464
147	L shpk	K.....L	69,120	69,120
148	L.M	s'ka	0	160,244
149	L.G	K.....F	69,120	517,121
150	L.gj	K.....B	0	90,272
151	L.C	L.....S	0	45,693
152	L.K	L.....H	18,820	54,564
153	L.C	s'ka	24,577	233,364
154	M.B	s'ka	14,276	116,997
155	M.G	s'ka	0	36,936
156	M.A	L.....V	21,578	166,091
157	M shpk	L.....I	0	70,077
158	M.I	K.....D	69,120	626,213
159	M.Q	s'ka	0	31,016
160	M shpk	K.....F	0	26,111
161	N.J.C shpk	L.....P	48,120	533,531
162	N.Gj	s'ka	0	59,502
163	N.R	L.....N	25,534	171,352
164	N.D	s'ka	0	9,143
165	N.D	s'ka	13,612	112,029
166	N.K	L.....O	69,120	462,429
167	P.K	L.....H	0	133,041
168	P.M	s'ka	0	110,669
169	P.M	L.....R	0	50,776
170	P.C	L.....H	30,120	30,120
171	P.I	L.....G	0	6,970
172	P.K	J.....L	0	366,225
173	Q.A	L.....S	0	35,101
174	R.Q	L.....A	0	139,426

175	R.C	L.....K	0	24,161
176	R.M	L3.....N	30,503	61,006
177	R.I	L.....S	0	13,633
178	R.S	L.....I	18,120	76,448
179	R.P	L.....K	0	43,539
180	R.K	s'ka	25,534	171,352
181	R.Sh	s'ka	0	33,240
182	R.L	s'ka	25,534	207,557
183	R.H	L.....U	0	3,201
184	R.D	K.....Q	0	24,087
185	R.Sh	K.....O	0	137,920
186	R.K	K.....S	0	78,321
187	S.H	M.....S	9000	37,388
188	S.D	L.....D	19,932	19,932
189	S.D	L.....P	0	85,182
190	S.Sh	L.....U	0	31,757
191	S.M	L.....L	116,744	211,988
192	S.S	L.....G	0	9,412
193	S.V	s'ka	0	103,253
194	S.M	K.....N	0	16,986
195	S.M	M.....K	33,190	60,858
196	S.M	s'ka	0	164,400
197	S.S	K.....F	24,577	165,435
198	S.M	L.....F	25,534	25,534
199	S.H	L.....R	0	107,613
200	S.M	L.....G	0	31,261
201	S.I	M.....Q	6,589	6,589
202	S.Gj	L.....N	25,953	25,953
203	Sh.H	s'ka	0	66,777
204	Sh.K	L.....M	0	49,920
205	Sh.N	L.....V	0	28,330
206	Sh.M	M.....P	30,120	52,740

207	Sh.B	s'ka	0	168,705
208	Sh.S	s'ka	0	21,942
209	Sh.H	s'ka	0	33,240
210	S.B	K.....L	111,742	111,742
211	S.M	L.....F	25,917	86,750
212	S.A	s'ka	25,151	196,761
213	S.B	L.....C	12,948	12,948
214	S.M	L.....Q	12,284	12,284
215	S.D	L.....I	0	21,644
216	S.I	s'ka	0	102,591
217	Sh.G	M.....T	19898	19898
218	T.Gj	SKA	0	109,073
219	T.H	M.....J	8,678	8,678
220	T.S	K.....U	28,309	28,309
221	T. shpk	K.....Q	60,120	60,120
222	TB sha	K.....H	0	221,687
223	U.D	K.....O	5,838	126,683
224	V.I	L.....S	60,120	290,012
225	E.	L.....M	0	98,056
226	V.B	L.....S	22,957	22,957
227	V.Gj	L.....K	9,869	9,869
228	Xh.H	s'ka	24,194	188,594
229	Y.B	L.....R	4,357	47,195
230	A.P	L.....N	26,491	26,491
231	A.Gj	s'ka	0	192,906
232	Z.H	L.....N	0	27,114
233	Z.D	s'ka	0	109,073
234	D.th.T	L.....E		117,240
235	OSHE	K.....H		351,720
236	E.o.P	L.....C	900,000	900,000
237	P shpk	L.....K	800,000	800,000
238	D.O	L.....G	1,000,000	1,000,000
239	S. shpk	L.....K	1,000,000	1,000,000
240	A.I.D	Individ		27,359

241	A.R	Individ		23,112
242	B.R	Individ		3,247
243	C.A	Individ		62,485
244	F.B	Individ		45,208
245	D.Q	Individ		60,824
246	U.I	Individ		37,623
247	R.F	Individ		39,415
248	G.A	Individ	47,855	
249	H.Z	Individ		46,830
250	I.S.B	Individ		55,138
251	Sh.T.M	Individ		29,609
252	H.I	Individ		9,830
253	A.A.H	Individ		19,103
254	S.A	Individ		4,249
255	A.B	Individ		122,337
256	N.Sh.A	Individ	4,861	
257	D.N	Individ		49,911
258	I.B	Individ	41,923	
259	P.S	Individ		2,303
260	I.A	Individ		40,423
	Totali :		7,275,474	31,787,531

Pasqyra PF4, Detyrime progresive deri 31.12.2022:

Tabela nr. 12

Nr	Pershkrimi	Gjendje debit 31.12.2021	Arktuar 2022	Shtuar 2022	Gjend deb 31.12.2022
1	Debitor taksa/tarifa vendore te periudhes 2012-2019	10,870,530	184,429		10,686,101
2	Kamat vonesa per debitoret 2012-2019 llogarit.2021	2,380,646	28,747		2,351,899
3	Debitor taksa/tarifa vendore te vitit 2020	3,258,473	233,202		3,025,271
4	Debitor taksa/tarifa vendore te vitit 2021	6,020,879	1,618,697		4,402,182

5	Debitor taksa/tarifa vendore te vitit 2022			5,275,474	5,275,474
6	Debitor Institucione per taksa/tarifa te 2019-2021	509,080	40,120		468,960
7	Debitor takse infrastrukture te vitit 2018	773,644	-		773,644
8	Debitor tarif sherbime subjekte zbuluar KLSH 2021	1,613,000	1,409,000		204,000
9	Debitor tarif licensimi 5 vjecar karburantet, zbuluar KLSH 2021	4,480,000	1,880,000		2,600,000
10	Debitor tarif licensi5 vjecar karburantet, KLSH 2022			2,000,000	2,000,000
	Totali :	29,906,252	5,394,195	7,275,474	31,787,531

Pasqyra PF5 -Qirate e subjekteve 2021-2022 si dhe debitorët deri me 31.12.2022,

Tabela nr. 13

Nr	SUBJEKTI	KONTRATA		OBJEKTI	PERIUDHA	VLERA VJETOR QIRASE	DATA ARKTIMIT 2021-2022	ARKETIMI 2021 - 2022	DEBITOR 31.12.2022
		NR	DATE	ADRESA					
1	A SHA	1572	16.5.2019	LEibaj	15.4.2021-14.4.2022	56.460	10.8.2021	56.460	-
		2842/2	26.12.2019	Dragobi (Margeg)	24.5.2022-23.5.2023	61.270	13.6.2022	61.270	-
2	T SHA	1191	6.3.2019	Berishe-Bytyc	20.11.2022-19.2.2023	47.500	13.12.2022	47.500	-
		3623/2	23.12.2019	LE(Log Shk)	18.10.2021-17.10.2022	25.000	1.12.2021	25.000	-
3	Sh.A shpk	3359/7	5.12.2020	Lugina Kolgecaj	6.12.2021-5.12.2022	151.730			151.730
4	D	1024/1	1.3.2022	Pall.Kult B.Curr	01.09.2022-01.11.2022	23.200	10.11.2022	23.200	-
5	S.Xh shpk	2099	9.5.2018	Berishe-Bytyc	9.5.2021-8.5.2022	52.920	30.9.2021	52.920	-
6	A.L shpk	4058/3	1.11.2018	Berishe-Bytyc	01.11.2021-31.10.2022	121.350	10.11.2021	121.350	-

7	V.A sha	1575	16.5.2019	B.Curri-Muzeu	01.8.2021-31.7.2022	425.000	19.11.2021	425.000	-
		1574	16.5.2019	LEibaj	31.5.2022-30.5.2023	255.000	9.9.2022	255.000	-
		1573	16.5.2019	Dragob (Margeg)	15.11.2021-14.11.2022	255.000			255.000
8	A.E.E	2365/7	24.8.2017	Lugina e T'Planit	24.8.2021-23.8.2022	473.495			473.495
9	M shpk	1673	20.4.2017	Lugina e T'Planit	20.4.2021-19.4.2022	115.000			115.000
10	L shpk	1672	11.4.2017	T'Pla	11.4.2021-10.4.2022	181.000			181.000
11	A shpk	3079/2	27.7.2018	Kam 6	28.7.2021-27.7.2022	75.550	7.9.2021	75.550	-
12	B shpk	2204	7.4.2021	Lugina Tropoj	1.4.2021-1.4.2022	159.600	6.4.2022	159.600	-
13	S.A shpk	2965/2	27.8.2019	Kam 2	28.7.2021-27.2.2022	117.000	9.11.2021	117.000	-
14	A.D	1895/2	16.6.2021	Pallatit Kultures	16.6.2021-15.6.2022	242.400	16.2.2021	242.400	-
15	A.H	1053/1	23.2.2021	B.Curri	23.3.2021-22.3.2022	26.400	29.4.2021	26.400	-
16	F shpk	1896/5	26.6.2022	B.Curri	26.6.2022-25.6.2023	65.280	3.10.2022	65.280	-
17	I.N shpk	231/3	20.6.2021	Berishe-Bytyc	21.6.2021-20.6.2022	58.100	22.6.2021	58.100	-
18	H.V	2705/3	24.7.2019	Berishe-Bytyc	24.7.2021-23.7.2022	1.050.852			1.050.852
19	I.M	3415/7	9.11.2020	Lugina Kolgecaj	4.11.2021-3.11.2022	450.000	8.11.2021	450.000	-
	totali					4.489.107		2.262.030	2.227.077

Pasqyra PF6- Aktivi i bilancit 2022.

Tabela nr. 14

Ref. Llog.	E M E R T I M I	Ushtrimi I mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
------------	------------------------	---------------------------	----------------------------

A	A K T I V E T	3,449,266,232	3,404,007,917
	I.Aktivitet Afat shkurtra	242,051,505	266,619,711
	I.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	82,325,373	67,145,258
531	Mjete monetare ne Arke	0	0
512,56	Mjete monetare ne Banke		
520	Disponibilitete ne Thesar	82,325,373	67,145,258
50	Letra me vlere		
532	Vlera te tjera		
54	Akreditiva dhe paradhanie		
59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
	2.Gjendje Inventari qarkullues	16,135,344	18,054,581
31	Materiale	1,862	40,259
32	Inventar I imet	16,133,482	18,014,322
33	Prodhim nre proces		
34	Produkte		
35	Mallra		
36	Kafshe ne rritje e majmeri		
37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
	3.Llogari te Arketushme	143,590,788	104,184,895
411	Kliente e llogari te ngjashme		
423,429	Personeli, paradhanie, deficite, gjoba	48,934	48,934
431	Tatim e Taksa		
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
435	Sigurime Shoqerore		
436	Sigurime Shendetstore		
437,438,	Organizma te tjere shteterore		
44	Institucione te tjera publike		
465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
468	Debitore te ndryshem	44,710,681	42,876,907
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	98,831,173	61,259,054
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	0	77,234,977
409	Parapagime		
473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
477	Diferenca konvertimi aktive		

481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		77,234,977
	II.Aktivt Afat gjata	3,207,214,728	3,137,388,206
20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	13,701,620	13,688,863
201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
202	Studime dhe kerkime	13,701,620	13,688,863
203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
21	2.Aktive Afatgjata materiale	2,844,903,066	2,923,507,821
210	Toka, T,roje, Terene	22,460,270	22,460,270
211	Pyje, Plantacione	10,017,959	10,017,959
212	Ndertesa e Konstruksione	1,057,967,697	1,113,618,583
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	1,676,415,929	1,695,583,073
214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	15,364,209	16,651,964
215	Mjete Transporti	20,200,183	14,784,630
216	Rezerva Shtetore		
217	Kafshe pune e prodhimi		
218	Inventar ekonomik	30,705,437	38,619,961
24	Aktive afatgjata te demtuara	11,771,382	11,771,382
28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0
25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
	4.Investime	348,610,042	200,191,522
230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
231	Per Aktive Afatgjata materiale	348,610,042	200,191,522
B	PASIVET(DETYRIMET)	173,247,030	215,617,019
	I.Pasivet Afat shkurtra	173,247,030	215,617,019
	1. Llogari te Pagushme	173,053,560	215,423,549
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	71,000,782	108,423,719
42	Detyrime ndaj personelit	14,071,445	12,696,668
16,17,18	Hua Afat shkurtra		
460	Huadhenes		
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	552,447.00	645,774
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
435	Sigurime Shoqerore	4,144,183	3,737,000
436	Sigurime Shendetsore	570,567	512,738
437,438,	Organizma te tjere shtetore		
44	Institucione te tjera publike		

45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	29,656,242	34,197,147
467	Kreditore te ndryshem	8,298,279	12,284,662
4341	Operacione me shtetin(detyrime	44,759,615	42,925,841
49	Shuma te parashikuara per zhvleresim(-)		
	2.Te tjera pasive afatshkurtra	193,470	193,470
419	Kreditore, Parapagime	193,470	193,470
475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
478	Diferenca konvertimi pasive		
480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
	II.Pasivet Afat Gjata	0	0
Klase 4	Llogari te pagushme		
16.17,18	Huate Afat gjata		
	Provigionet afatgjata		
Klasa 4	Te tjera		
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	3,276,019,202	3,188,390,898
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	3,276,019,202	3,188,390,898
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	2,874,740,029	2,955,251,265
12	Rezultatet e mbartura		
85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	52,669,131	32,948,111
111	Rezerva		
115	Nga Fondet e veta te investimeve		
15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime		
105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	348,610,042.00	200,191,522.00
106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
107	Vlera e mjeçeteve te caktuara ne perdorim		
109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
	Te Tjera		
E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	3,449,266,232	3,404,007,917

Pasqyra PF6-Te ardhurat dhe shpenzimet 2022,

Tabela nr. 15

Nr.Llogarie	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	VITI USHTRIMOR	VITI I MEPARSHEM
b	c	1	2
A	TE ARDHURAT	730,767,672	665,048,416
70	<i>ITE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET</i>	69,318,184	67,133,220
700	1.Tatimi mbi te Ardhurat	6,373,995	5,713,367
7000	Tatim mbi te ardhurat personale	6,171,380	5,464,197
7001	Tatim mbi Fitimin		
7002	Tatim mbi Biznesin e vogel	202,615	249,170
7009	<i>Te tjera Tatime mbi te ardhurat</i>		
702	2.Tatimi mbi Pasurine	3,414,105	2,799,553
7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme	3,414,105	2,799,553
7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshme		
7029	Te tjera tatime mbi Pasurine		
703	3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit	28,788,942	27,198,168
7030	Tatim mbi vleren e shtuar(TVSH)		
7031	Akciza		
7032	Takse mbi sherbimet specifike		
7033	Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	11,553,183	9,980,812
7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	17,235,759	17,217,356
704	4.Takse mbi tregtine dhe transaksionet nderkombtare	0	0
7040	Takse doganore per mallrat e importit		
7041	Takse doganore per mallrat e eksportit		
7042	Tarife sherbimi doganor e kaliposte		
7049	Te tjera taksa mbi tregtine e transaksionet nderkombtare		
705	5.Takse e rruges		
708	6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare		
709	7.Gjoha e Kamat vonesa		
75	<i>II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQ. SHENDETESORE</i>	0	0
750	NGA TE PUNESUARIT		
751	NGA PUNEDHENESI		
752	NGA TE VETPUNESUARIT		
753	NGA FERMERET		
754	NGA SIGURIMET VULLNETARE		
755	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHOQERORE		
756	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIG. SHENDET		
71	<i>III.TE ARDHURA JO TATIMORE</i>	30,741,142	31,422,132
710	1.Nga ndermarrjet dhe pronesia	4,859,549	3,468,798

7100	Nga Ndermarrjet publike jo financiare 7200102-1101		
7101	Nga Ndermarrjet publike financiare		
7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia	4,859,549	3,468,798
711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	25,881,593	27,953,334
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	18,736,847	15,548,527
7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	6,457,484	11,778,964
7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale		
7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve		
7114	Te ardhura nga biletat		
7115	Gjoha, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime	687,262	625,843
7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje		
719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore	0	
76	IV.TE ARDHURA FINANCIARE		
760	Nga interesat e huadhenies se brendshme		
761	Nga interesat e huadhenies se Huaj		
765	Nga interesat e depozitave		
766	Nga kembimet valutore		
72	V.GRANTE KORENTE	630,708,347	471,067,596
720	1.Grant korent I Brendshem	630,708,347	471,067,596
7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	386,136,001	237,489,011
7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)	244,572,346	95,278,024
7202	Nga Buxheti per pagesa te posacme te ISSH		
7203	Nga Buxheti per mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)		
7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale		
7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
7206	Financim I pritshem nga buxheti		138,300,561
7207	Sponsorizime te brendshme(nga te trete)		
7209	Te tjera grante korente te brendshme		
721	2.Grant korent i Huaj	0	
	Nga Qeveri te Huaja		
	Nga Organizata Nderkombetare		
	VI.TE ARDHURA TE TJERA	0	95,425,468
781	Te ardhura nga investimet ne ekonomi		
782	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatshkurtra		
783	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatgjata		
784	Rimarrje Shumash per shpenzime te viteve ardhshme		
787	Terheqje nga seksioni I investimeve		95,425,468
73	VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENT. PRODUKTEVE	0	
B	SHPENZIMET	678,098,541	632,100,305

600	LPAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	193,328,605	189,577,437
6001	Paga, personel i perhershëm	193,328,605	189,577,437
6002	Paga personel i Perkohshëm		
6003	Shperblime		
6009	Shpenzime te tjera per personelin		
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	30,237,162	31,095,277
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	30,237,162	31,095,277
6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore		
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	61,404,665	56,664,384
602	Mallra dhe sherbime te tjera	61,404,665	56,664,384
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme		
6021	Materiale dhe sherbime speciale		
6022	Sherbime nga te trete		
6023	Shpenzime transporti		
6024	Shpenzime udhetimi		
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme		
6026	Shpenzime per qeramarije		
6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale		
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua		
6029	Shpenzime te tjera operative		
603	IV.SUBVECIONE	0	0
6030	Subvecione per diference cmimi		
6031	Subvecione per te nxitur punesimin		
6032	Subvecione per te mbuluar humbjet		
6033	Subvecione per siper marrjet individuale		
6039	Subvecione te tjera		
	V.TRANSFERIME KORENTE	391,208,872	356,045,859
604	1.Transferime korente te brendshme	4,983,954	70,000
6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	4,983,954	70,000
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shendetesore		
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse		
605	2.Transferime korente me jashte	0	0
6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare		
6052	Transferime Per Qeverite e Huaja		
6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurse te huaja		
6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit		
606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe	386,224,918	355,975,859
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		

6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	386,224,918	355,975,859
	VI.SHPENZIME FINANCIARE	0	0
65	1.Shpenzime Financiare te brendshme	0	0
650	Interesa per bono thesarit dhe kredi direkte		
651	Interesa per huamarrje te tj. Brendshme		
652	Interesa Letra tjera vlere Qeverise		
656	Shpenz.nga kembimet valutore		
66	2.Shpenzime Financiare te jashtme	0	0
660	Interesa per huamarrje nga Qeveri.te Huaja		
661	Interesa per financime nga Institucionet.nderkomb		
662	Interesa per huamarrje te tjera jashtme		
	VII.KUOTA AMORTIZ E SHUMA PARASHIKUARA	0	0
681	Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytezimit		
682	Vlera e mbetur e AAGJ, te nxjerra jashte perdorimit e te shitura		
683	Shuma te parashikuara te shfrytezimit		
686	Shuma te parashikuara per aktivet financiare		
63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	1,919,237	-1,282,652
	IX.SHPENZIME TE TJERA		
85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIU DHES	52,669,131	32,948,111
	<i>(Rezultati I Veprimtarise se vititUshtrimor)</i>		

Pasqyra e realizimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Aneksi 1

Nr	Emërtimi	Rekomandimet ne numër :					Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike							
		Rekomandim gjithsej	Nga rekomandimet janë:				Rekomanduar Gjithsej		Zbatuar arkëtuar		(në proces)		Pa zbatuar	
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Proces zbatimi	Pa zbatuar	Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek
1	Masa organizative	10	1	5	0	4								
2	Shpërblim demi													

3	Të ardhura të munguara	5		2		3	5	56,461,393	2	7,994,195		3	48,467,198
4	Masa efekte negative												
5	Eliminimin e borxhit tatimor												
6	Masa disiplinore												
7	Masa administrative'												
	Totali	15	1	7	0	7	5	56,461,393	2	7,994,195		3	48,467,198

Nga rekomandimet gjithsej: Sa për eliminimin e efekteve negative			
Rekomanduar Gjithsej	Zbatuar	(në proces)	Pa zbatuar
Në mijë/lek	Në mijë/lek	Në mijë/lek	Në mijë/lek
56,461,393	7,994,195		48,467,198

ANEKSI 2 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

Procedura prokurimi të realizuara për vitin 2021

Nr.	Objekti i Prokurimit	Kodet CPV	Fondi Limit	LLoji i Procedures se Prokurimit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	NIPT i Operatorit Ekonomik
1	Blerje kamioni	Kamionë pune	6400000.00	E hapur e thjeshtuar	6360000.00	T	M.....U

2	Dru Zjarri	Dru	5442722.00	E hapur e thjeshtuar	5398785.00	N.M	K.....K
3	Mirembajtje objekteve ndertimore kopshte cerdhe shkolla,Bashkia Tropoje	Mirëmbajtje çatie	4500450.00	Kerkes per propozim	4,443,910	B.K B	
4	Rikualifikim urban Lagjia Partizani Blloku 1&2 ,Bajram Curri	Rrugica dhe sipërfaqe të tjera prej çakulli	60338235.00	e hapur	53717333.00	N	K.....I
5	Blerje Karburant		8,000,000.00	E hapur e thjeshtuar	16.2	K	J.....P

Procedurat e zhvilluara viti 2022

Nr.	Objekti i Prokurimit	Kodet CPV	Fondi limit	LLoji i Procedures se Prokurimit	Vlera e kontratës	Data e zhvillimit te procedures se prokurimit	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	NIPT i Operatorit Ekonomik
1	Blerje Dru zjarri	Dru zjarri	5,500,000	E hapur e thjeshtuar	4,560,000	24/10/2022 10:00 AM	A L X H E F	K.....C
2	Blerje Karburanti per emergjencat civile Shatator 2022	Karburant diesel	2,570,000	Me negociim pa shpallje	2,570,000	17/10/2022 03:00 PM	K	J.....P

3	Karburant diesel viti 2022	Karburant diesel	10,000,000	E hapur e thjeshtuar	10,000,000	03/02/2022 12:00 PM	K	J.....P
4	Kosha mbeturinash	Kosha mbeturinash	3,445,887	E hapur e thjeshtuar	3,148,500	11/02/2022 10:00 AM	Z	J.....A
5	Mirembajtje kanaleve vaditese te Bashkise Tropoje	Rruge ujore të ndryshme nga kanalet	4,500,000	E hapur e thjeshtuar	4,261,611	04/05/2022 11:00 AM	V	J.....IO
6	Rikonstruksion i shkolles Oso Dauti Njesia Administrative Llugaj	Çimento, Instalime elektrike	47,167,647	E hapur	37,728,928	12/10/2022 02:00 PM	SH - AL	K.....IN
7	Rikonstruksion rruga Blini i Grise- Lekurtaj	Rrugica dhe sipërfaqe të tjera prej çakulli	10,986,652	E hapur e thjeshtuar	10,079,883	07/04/2022 12:00 PM	V	J.....O
8	Rikonstruksion Thertore Shudenic + Ndertim i tregut te Bagetive	Shtresë e punueshme, Gërmime të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara	12,786,238	E hapur	12,678,100	31/05/2022 10:00 AM	T	L.....F
9	Instalim Sistemi Semaforik Kryqzimi I Dragobise	Instalime të semaforëve	3,095,436	E hapur e thjeshtuar	3,075,168	9/5/2022 12:00	I.D.	K.....J
10	Rrehi dekorativ I stadiumit te lojrave me dore	Rrethrotullime per parqe lojrash	3,335,385	E hapur e thjeshtuar	3,321,287	4/1/2023 0:00	HTSH	L.....A

11	Sistemim I tregut industriale lagja Dardania	Gërmime rrugore të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara	2,024,758	E hapur e thjeshtuar	1,994,414	3/10/2022 0:00	HTSH	L.....A
----	--	--	-----------	----------------------	-----------	----------------	------	---------

ANEKSI 3-Regjistri i realizimit të procedura të prokurimit me blerje të vogla për vitin 2021

Nr.	Objekti i Prokurimit	Kodet CPV	Fondi Limit	Lloji i Procedures se Prokurimit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	NIPT i Operatorit Ekonomik
1	Mirembajtje rruga markaj	Lëndë druri	800000.00	Blerje e vogel	724172.00	V	J.....O
2	Blerje materiale ndërtimi	Çimento	800000.00	Blerje e vogel	689000.00	K.B	L.....K
3	Blerje dyshek dhe batanie per sektorin e MZSH-se	Dyshekë, Batanije	500000.00	Blerje e vogel	93600.00	P.A	M.....T
4	Rikonstruksion I kanalit Krasniqes	Hekur	800000.00	Blerje e vogel	645000.00	HTSH	L.....A
5	Blerje karrike dhe tavolina	Karrige	800000.00	Blerje e vogel	582000.00	K.B	L.....K
6	Blerje kondicionere	Punime ngrohje, ventilimi dhe kondicioneresh	300000.00	Blerje e vogel	166000.00	P.H	M.....R
7	Riparim ura Beli	Produkte drusore	800000.00	Blerje e vogel	380000.00	4A	L.....O
8	Furnizim dhe vendosje te materialeve dekorative per festat e fundvitit	Dekorime	300000.00	Blerje e vogel	228900.00	M.V	L.....C

9	Blerje materiale te ndryshme,dezinfektim	Alkool	500000.00	Blerje e vogel	249080.00	M.V	L.....C
10	Sherbim per mirembajtje makinash	Pjesë dhe aksesorë për makineri	800000.00	Blerje e vogel	778400.00	A.S	L.....V
11	Blerje stufa	Ngrohësa ajri jo elektrik ose shpërndarësa ajri të ngrohtë	300000.00	Blerje e vogel	250000.00	K.B	L.....K
12	Rikonstruksion kanali ujites gashi pjesa 2	Tuba të brendshëm	760000.00	Blerje e vogel	749000.00	T	L.....F
13	Blerje artikuj ushqimore	Bukë	800000.00	Blerje e vogel	798800.00	N.M	K.....K
14	Blerje vegla pune	Lopata, Kazma	800000.00	Blerje e vogel	700000.00	K.B	L.....K
15	Blerje materiale zyre	Dosje	300000.00	Blerje e vogel	150000.00	I.S	J.....Q
16	Kanal i ujrave te larta lagja Zelaj fshati Begaj	Gërmime të mbuluara	750000.00	Blerje e vogel	713000.00	T	L.....F
17	Blerje kancelari	Dosje	250000.00	Blerje e vogel	133333.00	L.D	L.....J
18	Blerje karburant	Karburant diesel	1000000.00	Blerje e vogel	836000.00	K	J.....P
19	Kualidim i Ujesjellesi i fshatit Dragobi	Konsulencë biznesi	183667.00	Blerje e vogel	183667.00	2	M.....J
20	Rikonstruksio I rrjetit te ndricimit rrugor Margegaj -Kocanaj	Priza dhe spina	800000.00	Blerje e vogel	785000.00	V	J.....O
21	Blerje materiale pastrimi	Kova	500000.00	Blerje e vogel	218900.00	M.V	L.....C

22	Blerje orendi paisje zyre	Karrige me rrota,	800000.00	Blerje e vogel	382000.00	K.B	L.....K
23	Blerje kompjutera dhe printera	Mirëmbajtja e softëareve	700000.00	Blerje e vogel	425800.00	P.O	L.....G
24	Sherbim mirembajte makinash	Pjesë mjetesh	800000.00	Blerje e vogel	630000.00	A.Sh	L.....V
25	Mirembajtje rruge	Kripë	1000000.00	Blerje e vogel	960872.00	T	L.....F
26	Ndertim godine ujesjellesi Dushaj Eperm	Gërmime të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara	1000000.00	Blerje e vogel	999000.00	V	J.....O
27	Rikonstruksion rruga Salce-Brice km 2060-2970	Rrjete	798425.00	Blerje e vogel	797000.00	HTSH	L.....A
28	Rruga Salce-Brice	Punime gërmimi	665050.00	Blerje e vogel	656500.00	HTSH	L.....A
29	Sherbim interneti	Rrjet i komunikimeve	416667.00	Blerje e vogel	410000.00	I.N	L.....K
30	Sherbim per makina	Sherbim me ndermjetesues per siguracion	800000.00	Blerje e vogel	745010.00	A.Sh	L.....V
31	Sherbim fadromat	Sherbim me ndermjetesues per siguracion	1000000.00	Blerje e vogel	750000.00	S	J.....E
32	Aktiviteti sylbice	Uniforma policie	500000.00	Blerje e vogel	369420.00	H.H	L.....N

33	Rikonstruksion kanali ujites gashi pjesa 1	Rruge ujore të ndryshme nga kanalet	666667.00	Blerje e vogel	398000.00	T	L.....F
34	Blerje printera laptop mouse	Mirëmbajtja e softëareve të teknologjisë së informacionit	333334.00	Blerje e vogel	148000.00	K.B	L.....K
35	Hapja e sezonit turistik te valbones	Ushqim, pije, duhan dhe produkte të përafërta	500000.00	Blerje e vogel	498320.00	N.M	K.....K
36	Kolaudim rikonstruksion I varrezave te deshmeshoreve	Konsulencë biznesi dhe menaxhimi dhe shërbime të lidhura me të	250000.00	Small Value	6510.00	M.S	L.....O
37	Kolaudim mirembajtje rruge 2020				8100.00	M.S	L.....O
38	Supervizor mirembajtje rruge				79666.00	2	M.....J
39	Supervizor Rikonstruksion I rrethimit				89471.70	V.E	M.....I
40	Transport i materilae per Kanali i Gashit pjesa trete	Transport i udhëtarëve me mjete qe terhiqen nga kafshet	800000.00	Blerje e vogël	798500.00	T	L.....F
41	Akomodim hoteli per ekipin e valnona	Transport i udhëtarëve i paplanifikuar	800000.00	Blerje e vogel	792000.00	V	J.....O

42	Blerje bojra per fotokopje dhe printera		260,000.00	Blerje e vogel	159,500.00	B.T	L.....G
43	Blerje materiale pastrimi	Lecke pastrimi fuser	343,000.00	Blerje e vogel	163,000.00	N	L.....U
44	Festa e geshtenjes		300,000.00	Blerje e vogel	289,000.00	T.K	L.....H

ANEKSI 4-Regjistri i realizimit të procedura të prokurimit me blerje të vogla për vitin 2022

Nr.	Objekti i Prokurimit	Kodet CPV	Fondi limit	LLoji i Procedures se Prokurimit	Vlera e kontratës	Data e zhvillimit te procedures prokurimit	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	NIPT i Operatorit Ekonomik
1	Blerje flamuj dhe materiale te ndryshme	Ushqime të përgatitura, Pije alkoolike	1,000,000	Blerje e vogel	450,000	30/12/2022 02:30 PM	E.D	L.....C
2	Blerje benzine pa plumb	Benzinë	360,000	Blerje e vogel	330,000	16/06/2022 04:00 PM	P.A	M.....T
3	Blerje Buke per kopshtet dhe cerdhet	Bukë	300,000	Blerje e vogel	300,000	03/03/2022 02:30 PM	N.M	K.....K
4	Blerje grila/perde	Grila	400,000	Blerje e vogel	300,000	29/12/2022 01:00 PM	M.M	L.....F

5	Blerje tuba te brinjezuar	Dru	1,000,000	Blerje e vogel	597,000	28/12/2022 04:00 PM	G.	L.....U
6	Blerje leter format	Letër fotokopjuese dhe letër kopjative, Letër fotokopjuese	300,000	Blerje e vogel	275,000	26/01/2022 02:00 PM	I.S	J.....Q
7	Furnizim dhe vendosje materiale elektrike	Materiale elektrike	500,000	Blerje e vogel	419,900	01/04/2022 12:30 PM	M.V	L.....C
8	Blerje aksesor elektik per mirembajtjen e ndricimit	Pajisje ndriçimi dhe llamba elektrike	700,000	Blerje e vogel	382,000	18/11/2022 01:30 PM	A.B	L.....H
9	Blerje materiale per nevojat e bashkise	Çimento	1,000,000	Blerje e vogel	921,930	22/11/2022 11:30 AM	K.B	L.....K
10	Furnizim dhe vendosje xhamash	Shërbime zëvendësimi xhamash	600,000	Blerje e vogel	552,000	07/10/2022 02:00 PM	K.B	L.....K
11	Blerje materiale dekori per festat dhe aktivitete	Pemët e krishtlindjeve dhe pjesët e tjera të valvulave	1,000,000	Blerje e vogel	738,000	13/12/2022 03:30 PM	M.V	L.....C
12	Blerje ushqime per kopshtet dhe cerdhet	Oriz, Perime, Mish, Vaj gatimi	1,000,000	Blerje e vogel	999,400	13/04/2022 10:00 AM	H.H	L.....N
13	Blerje vaj dhe filtra	Filtra ajri, Filtra vaji	650,300	Blerje e vogel	570,000	23/11/2022 12:30 PM	T.O	K.....F
14	Bojra printer per fotokopje	Bojë shkrimi	300,000	Blerje e vogel	238,890	16/06/2022 01:00 PM	A.K	L.....I

15	Furnizim dhe vendosje te materialeve per shkolla	Tavolina, Korniza	800,000	Blerje e vogel	768,000	25/02/2022 02:00 PM	S.Rr	L.....Q
16	Goma dhe bateri	Bateri	800,000	Blerje e vogel	525,000	20/04/2022 04:00 PM	S	J.....E
17	Sherbim interneti	Rrjet i komunikimeve	500,000	Blerje e vogel	410,000	27/04/2022 11:30 AM	I.N	L.....K
18	Blerje kancelari	Stilolapsa, Letër fotokopjuese	500,000	Blerje e vogel	177,777	31/01/2022 10:00 AM	L.D	L.....J
19	Kolaudim i Rikonstruksionin te 5-segmenteve	Kanalizime kryesore	344,000	Blerje e vogel	246,197	29/12/2022 02:00 PM	V.E	M.....I
20	Materiale pastrimi/ dizenfektim		500,000	Blerje e vogel	278,700	30/03/2022 04:00 PM	M.V	L.....C
21	Furnizim dhe vendosje te materialeve per mjetin tip JCB eskavator varings	Pjesë këmbimi për motorë	1,000,000	Blerje e vogel	167,890	09/02/2022 01:00 PM	T.K	L.....H
22	Veshje tradicionale per aktivite te rrethit te tropjes	Ushqim, piqe, duhan dhe produkte të përafërta	300,000	Blerje e vogel	285,000	27/05/2022 01:00 PM	B.B	M.....T
23	Sherbime dhe mirembajtje makinash	Pjesë dhe aksesorë për makineri	1,000, 000	Blerje e vogel	172,000	31/03/2022 02:00 PM	S	J.....E
24	Blerje vajra per mjetet e sherbimit	Pjesë dhe aksesorë për makineri		Blerje e vogel	397,600	25/02/2022 02:30 PM	T.O	K.....F

25	Supervizor i rikualifikimit te lagjes partizani	Konsulencë biznesi dhe menaxhimi dhe shërbime të lidhura me të	689,044	Blerje e vogel	613,308	25/02/2022 03:00 PM	V.E	M.....I
26	Supervizor Rikonstruksion i Kanaleve Vaditese	Konsulencë biznesi dhe menaxhimi dhe shërbime të lidhura me të	116,634	Blerje e vogel	107,000	20/05/2022 01:00 PM	4	M.....L
27	Supervizor Rikonstruksion i Rruges Blini i Grise-Lekurtaj	Konsulencë biznesi dhe menaxhimi dhe shërbime të lidhura me të	200,199	Blerje e vogel	176,084	27/05/2022 12:00 PM	n.S	L.....C
28	Vegla pune	Lopata, Kazma	200,000	Blerje e vogel	133,000	01/04/2022 02:00 PM	N	L.....U
29	Blerje materiale per uren Kojel-Shumice	Hekur, Binarë	500,000	Blerje e vogel	442,800	16/11/2022 14:00 PM	K.B	L.....K
30	Supervizor Rikonstruksion i thertores shudenice + ndertimi I tregut te bagetive	Konsulencë biznesi dhe menaxhimi dhe shërbime të lidhura me të	213,637	Blerje e vogel	200,199	01/07/2022 15:00 PM	V.E	M.....I
31	Rikonstruksion i rruges Auto-Zllame Kobile NJA Bujan	Gërmime rrugore të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara	395,480	Blerje e vogel	350,000	22/04/2022 15:00 PM	A.G	
32	Rikonstruksion i rruges auto Markaj-Zllame, Njesia administrative bujan	Gërmime të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara	392,000	Blerje e vogel	392,000	22/04/2022 15:30 PM	HTSH	L.....A

33	Sherbim fadrome	Pjese dhe akseser per makineri	1,000,000	Blerje e vogel	950,000	28/12/2022 16:00 PM	A.S	L.....V
----	-----------------	--------------------------------	-----------	----------------	---------	------------------------	-----	---------

ANEKSI 5-Te dhena per objektet e realizuara Periudha 2021-2022

Nr.	Emertimi I investimit te kryer	Vlera e investimit me TVSH sipas Kontrates	Data e fillimit te punimeve	Afati I punimeve sipas kontrates	NR.dhe data e kontrates	Data e perfundimit te punimeve sipas kontrates	Nr.dhe data e amandamentit te kontrates (nese ka).	Data e perfundimit te punimeve sipas amandamentit te kontrates (nese ka)	Data ne fakt e perfundimit te punimeve	Data e marrjes ne dorzim te investimit
1	Rikonstrukcion I rrjetit te ndriçimit rrugore,Margegaj-Koçanaj	942,000	dt.20.12.2021	30 dite	nr.22.dt.20.12.2021	dt.18.01.2022	ska	ska	dt.18.01.2022	dt.18.01.2022
2	Rikonstrukcion rruga Blini i Grise - Lekurtaj	12,095,860	dt.15.08.2022	90 dite	nr.9,dt.17.05.2022	dt.15.12.2022	ska	ska	dt.28.11.2022	dt.13.01.2023
3	Mirmbajtje rruge Markaj,lagjia Breçan-Zenelaj+(rruge rurale)	869,007	dt.19.10.2021	2 dite	nr.19,dt.19.10.2021	dt.20.10.2021	ska	ska	dt.20.10.2021	dt.21.10.2021
4	Ndertim ujsjellesi Dushaj-Eper(faza e dyte)	1,198,799	dt.05.01.2022	90 dite	nr.23,dt.05.01.2022	dt.05.04.2022	ska	ska	dt.31.01.2022	dt.01.02.2022

5	Rikonstruksion kanaleve vaditese Bashkia Tropoje,viti 2022	5,113,934	dt.03.06.2022	60 dite	nr.7,dt.26.05.2022	dt.01.08.2022	ska	ska	dt.01.08.2022	03.10.2022
6	Sistemim I tregut industrial Lagjia Dardania B.Curri	2,393,296	dt 23.12.2022	60 dite	nr 17 dt 06.12.2022	dt 22.02.2023	ska	ska	dt 22.02.2023	dt 14.04.2023
7	Rikonstruksion I 5 segmenteve rrugore	408,506,281	dt 29.12.2020	12 muaj	Nr 19 dt 18.12.2020	dt 18.12.2021	3814/12 dt 10.11.2021 3814/15 dt 08.04.2022 3814/19 dt 29.07.2022	29.10.2022	29.10.2022	09.03.2023
8	Ujesjellesi I fshatit Dragobi	68,269,461	29.12.2020	6 muaj	Nr 3360/3 prot date 18.12.2020	29.06.2021	5098/11 prot dt 24.03.2021 4939 prot dt 28.12.2021 2348 prot dt 25.05.2022	07.03.2023	07.03.2023	
9	Rikualifikimi urban Lagjia Partizani blloku 1,2 Bajram Curri	64,460,799	02.06.2022	3 muaj	Nr 2 dt24.02.2022	01.12.2022	ska	ska	23.11.2022	21.12.2022

